

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR POLICOR NË LUFTIMIN E KRIMINALITETIT NË KOSOVË PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË

MUHAMET BERISHA

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Juridike, me profil “ E drejtë Ndërkombëtare”, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Lulzim Tafa

Numri i fjalëve: 55 446

Tiranë, Dhjetor 2016

© DEKLARATË E AUTORESISË

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim me titull: **“Bashkëpunimi ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë”**, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi

Muhamet Berisha

Tiranë, 2016

ABSTRAKT

Pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008, në Kosovë u krijua një situatë e re edhe në marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe anasjelltas. Në këtë këndvështrim, edhe për institucionin policor të Republikës së Kosovës u krijuan mundësi, por edhe obligime të reja lidhur me Bashkëpunimin Ndërkombëtar Policor. Kjo situatë, sigurisht, i ngarkonte ato me përgjegjësi dhe me detyra të shumta për përfshirjen e tyre në mënyrë efikase në bashkëveprim dhe në marrëdhënie institucionale me agjencitë policore dhe me ato të sigurisë ndërkombëtare.

Zgjedhja e temës “Bashkëpunimi ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë” për ta trajtuar në një punim doktoral u diktua nga fakti se në vendin tonë kjo çështje ka dalë në rendin e ditës dhe se më parë ajo nuk ishte trajtuar mjaftueshëm në aspektin shkencor dhe praktik. Sot kjo temë përbën një çështje aktuale jo vetëm për policinë e Republikës së Kosovës, pasi kriminaliteti në vendin tonë ka shënuar rritje të ndjeshme dhe paraqet kërcënim serioz për jetën, pronën dhe të mirat e qytetarëve. Ky shtim i kriminalitetit ka ardhur, si për shkak të faktorëve të brendshëm ekonomikë dhe socialë, ashtu edhe të rritjes dhe ndikimit të botës së krimit në shkallë ndërkombëtare dhe globale.

Analiza e kësaj gjendjeje, nxjerr në pah domosdoshmërinë, jo vetëm të forcimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm të strukturave policore të Kosovës dhe të përmirësimit të punës së tyre parandaluese dhe të luftës kundër krimit, por edhe domosdoshmërinë e shtimit të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit policor ndërkombëtar me agjencitë policore të vendeve të tjera.

Fjalët kyçe: kriminalitet, bashkëpunim, polici, shtet, ndërkombëtar, global.

ABSTRACT

After the independence in 2008, in Kosovo is created a new situation in regional and international relations of the Republic of Kosovo institutions and vice versa. In this respect, for the Republic of Kosovo police institutions were created opportunities, but also new obligations concerning the International Police Cooperation (IPC). This situation, of course, loads them with responsibility and multitasking for their involvement in the interaction efficiently and institutional relationships with law enforcement agencies and those of international security.

The choice of the thesis "International police cooperation in fighting crime in Kosovo after the declaration of independence" to tackle the doctoral dissertations was dictated by the fact that in our country, this issue has come up on the agenda and that earlier it was not sufficiently addressed in scientific and practical terms. International police cooperation today is a topical issue not only for Police of the Republic of Kosovo since criminality in our country has increased significantly and poses a serious threat to lives, property and the benefits of citizens. This increase in crime has become, both due to domestic economic factors and social, as well as the growth and influence of the underworld in international and global scale.

Analysis of this situation highlights the need not only to strengthen and further qualification of police structures in Kosovo and improve the work of their prevention and fight against crime but also the necessity of adding relations and international police cooperation with police agencies in other countries.

Key Words: crime, cooperation, police, state, internationalization, globalization.

FALËNDERIME

Puna për realizimin e kësaj doktorature u bë e mundur edhe në sajë të ndihmës së shumë personave, që më kanë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme që nga përcaktimi dhe strukturimi i temës, në gjetjen e literaturës bazë, ashtu edhe gjatë punës sime kërkimore dhe sidomos gjatë trajtimit të temës për çka i falënderoj të gjithë.

Në radhë të parë, një falënderim të posaçëm meriton udhëheqësi im shkencor, prof. dr. Lulzim Tafa, i cili, që në fazat e para të konceptimit të temës, të strukturimit të saj dhe grumbullimit të literaturës, më është gjetur pranë me gatishmërinë dhe profesionalizmin, me udhëzimet dhe këshillat e tij, duke më ndihmuar në aspektin shkencor që punimi të jetë në standardet e kërkuara.

Falënderoj, gjithashtu, pedagogët dhe stafin e UET për mbështetje dhe mirëkuptim, kolegët dhe miqtë që më kanë inkurajuar gjatë gjithë kohës në punën time kërkimore shkencore.

Një falënderim i veçantë nga zemra shkon për prindërit dhe familjen time, e cila më qëndroi afër në çdo fazë të punës në disertacion, andaj edhe meriton respekt dhe mirënjohje të thellë për durimin dhe përkrahjen e vazhdueshme.

Mbi të gjitha, falënderoj Zotin që më dha shëndet si dhe më mundësoi që të arrij deri aty ku disa vite më parë i kisha vënë kusht vetes.

Muhamet BERISHA

Tiranë, 2016

PËRMBAJTJA:

DEKLARATË E AUTORËSISË	II
LISTA E TABELAVE	XI
LISTA E DIAGRAMEVE	XIII
LISTA E SHKURTIMEVE.....	XIV
 KAPITULLI I: HYRJE	 15
1.1. Shtrimi i problemit	15
1.2. Qëllimi i studimit	26
1.3. Pyetjet dhe hipotezat	27
1.4. Metodologjia e punimit	28
1.5. Kufizimet e hulumtimit.....	31
1.6. Struktura e punimit.....	31
 KAPITULLI II: ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË BNP	 34
2.1. Vështrim i shkurtër historik i BNP	34
2.2. Aspekte teorike dhe konceptet mbi BNP	40
2.3. Vullneti i shteteve për bashkëpunim ndërkombëtar	47
2.4. Subjektet e marrëdhënies juridike të BNP	50
2.5. Objekti i marrëdhënies juridike të BNP	51
2.6. Marrëveshjet ndërkombëtare - bazë e BNP	53
Marrëveshjet shumëpalëshe.....	53
Marrëveshjet dypalëshe	55
2.7. Marrëveshjet e Republikës së Kosovës në fushën e BNP	57
Memorandum bashkëpunimi Kosovë-Shqipëri	58
Memorandume bashkëpunimi mbi organizimin e shërbimeve të përbashkëta të strukturave të policisë rrugore ndërmjet Shqipërisë dhe të Kosovës	63
Shkëmbimi i informacioneve me shtetet e tjera, lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore	64
Memorandum i bashkëpunimit mes Kosovës dhe Austrisë	67
Marrëveshje për bashkëpunim mes Kosovës dhe Hungarisë	70
Memorandum i Bashkëpunimit mes vendeve - ILECU	71
Marrëveshje për bashkëpunim policor Kosovë - Maqedoni.....	81

Deklaratë e përbashkët Kosovë-Francë	85
Memorandum i bashkëpunimit mes SHBA dhe MPB të Kosovës	86
2.8. Zhvillimi i bashkëpunimit policor në Kosovë gjatë periudhës së administrimit të Kombeve të Bashkuara, në vitet 1999-2008	87
Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet INTERPOL-it dhe UNMIK-ut	96
2.9. Zhvillimi i BNP në Kosovë pas vitit 2008	98
Ekstradimi.....	101
Bashkëpunimi dhe komunikimi me INTERPOL-in	106
Bashkëpunimi dhe komunikimi me EUROPOL-in	107
Ndërlidhësit policorë	108
Procedura Standarde e Operimit (PSO) për ILECU-n	109
EULEX-i dhe roli i tij në luftimin e kriminalitetit në Kosovë	110
Marrëveshjet teknike të Republikës së Kosovës me Misionin e EULEX-it	111
Marrëveshje mbi shkëmbimin e informatave	112

KAPITULLI III: ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE POLICORE DHE BNP

3.1. Interpol-i e para organizatë ndërkombëtare policore	116
3.2. Roli dhe struktura e Interpol-it	117
3.3. Interpol-i dhe çështjet ligjore	122
3.4. Roli i Interpolit në luftimin e kriminalitetit në Kosovë.....	125
3.5. Organizata e Inteligjencës Europiane - Europol	127
3.6. Roli dhe struktura e Zyrës Policore – Europol.....	128
Struktura Organizative e Europol-it	129
3.7. Europol-i në bashkëpunimin ndërkombëtar policor.....	131
3.8. Shoqatat ndërkombëtare policore.....	132
3.9. Roli i organizatave të tjera ndërkombëtare dhe i ambasadave të akredituara në Kosovë	135
3.10. Bashkëpunimi me agjencitë e huaja ligj-zbatuese në Kosovë	139

KAPITULLI IV: BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR POLICOR NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR.....

4.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër terrorizmit si domosdoshmëri globale	142
4.2. Parimet themelore të bashkëpunimit ndërkombëtar kundër terrorizmit	148
Obligimet që kanë shtetet për bashkëpunim ndërkombëtar kundër terrorizmit ..	150

Respektimi i të drejtave të njeriut gjatë bashkëpunimit ndërkombëtar	151
4.3. Masat shtetërore të Kosovës për BNP kundër terrorizmit.....	153
4.4. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër krimit të organizuar.....	156
4.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër tregtisë me skllevër, trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandës me migrantë dhe trafikeve të drogës	159

KAPITULLI V: REZULTATET DHE ANALIZA E TË DHËNAVE EMPIRIKE

5.1. Rezyme e analizës së të dhënave empirike	163
5.2. Rezultatet e hulumtimit të rasteve me bashkëpunim ndërkombëtar	165
5.3. Rezyme e të dhënave nga pyetësi	167
5.4. Rezultatet e pyetësorit	169

KAPITULLI VI: KUADRI LIGJOR DHE INSTRUMENTET PËR BASHKËPUNIM KUNDËR KRIMINALITETIT

6.1. Instrumentet ndërkombëtare.....	182
Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC).....	183
Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.....	185
6.2. Kuadri ligjor kombëtar i BNP në Kosovë	186
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e vitit 2008.....	186
Ligji Nr. 04/L-076, për Policinë e Kosovës - 2012	187
Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale nr.04/L-213	188
Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar 2009-2012 dhe Strategjia-Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2012-2017..	189
Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit	192
Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër narkotikëve 2012-2017..	194
Strategjia nacionale kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2011.....	198
Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit	199
6.3. Nisiativat rajonale	205
Konventa për Bashkëpunim Policor për Europën Juglindore (PCCSEE)	205
6.4. Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në EJT, RACVIAC	207
6.5. SECI – Nisiativa e Europës Juglindore për Bashkëpunim.....	209

6.6. SEECp – Procesi i Bashkëpunimit i Europës Juglindore (EJL).....	211
6.7. ILECU – Njësia Kordinuese për Zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar	212
KAPITULLI VII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	215
7.1. Përfundime	215
Përfundimet në lidhje me hipotezat e punimit daktoral	222
7.2. Rekomandime	224
LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA	227
Literaturë	227
Literaturë parësore	233
Literaturë dytësore.....	238
SHTOJCË.....	240

LISTA E TABELAVE

Table 1: Ekstradimet/Transferimet nga Kosova në vitin 2013	103
Table 2: Ekstradimet, Transferimet dhe Deportimet në vitin 2014	104
Table 3: Ekstradimet, Transferimet dhe Deportimet në vitin 2015.	104
Table 4: Skedulimi i hulumtimit	168
Table 5: Çfarë niveli-pozite përfaqësoni në sektorin/departamentin tuaj?	170
Table 6: A flisni ndonjë gjuhë të huaj dhe a zhvilloni komunikim me zyrtarë policorë ndërkombëtarë?	170
Table 7: Përvoja juaj në njësitë lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar policor?	171
Table 8: Në cilën periudhë kohore punoni apo keni punuar në këtë njësi (ju lutemi shënoni vitin prej kur keni filluar)?	171
Table 9: A keni vijuar ndonjë trajnim jashtë Kosovës apo ndonjë trajnim të përbashkët me zyrtarët policorë të shteteve të tjera në Kosovë?	172
Table 10: A keni marrë pjesë në konferenca, seminare apo workshope të përbashkëta me zyrtarët policorë të shteteve të tjera dhe a kanë ndikuar në ngritjen e performancës dhe të efikasitetit në detyrat tuaja?	173
Table 11: Si e vlerësoni rolin e konferencave ndërkombëtare, trajnimeve në ngritjen e aftësive profesionale dhe në krijimin e pikave të bashkëpunimit?	173
Table 12: Cili është niveli i komunikimit mes zyrtarëve policorë vendas dhe atyre ndërkombëtarë që punojnë në kuadër të misioneve ndërkombëtare në Kosovë?	174
Table 13: Sa ju ka ndihmuar prezenca dhe përvoja e pjesëtarëve të misioneve ndërkombëtare policore në zgjidhjen e rasteve në punën tuaj?	174

Table 14: Cili është roli i bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?	175
Table 15: A keni pasur shkëmbim të informatave dhe zyrtarëve policorë me agjencitë policore të shteteve të tjera në luftimin e krimit dhe cilat janë përvojat tuaja në këtë aspekt?.....	176
Table 16: A është vërejtur trend i zvogëlimit të krimit në Republikën e Kosovës pas bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet apo organizatat ndërkombëtare policore?	176
Table 17: A paraqet pengesë për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare policore mos anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/ Europol/ Frontex etj.)?	177
Table 18: Në cilat fusha (specifikoni fushën tuaj) janë shënuar rezultate konkrete me organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/ Europol/ SECI/ etj.)?	178
Table 19: Me kalimin e kohës, a ka shënuar ngritje besimi në organizatat ndërkombëtare që kontribuojnë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?	178
Table 20: Sipas përvojës suaj, ku ka më së shumti ngecje në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë?	179
Table 21: Të dhënat lidhur me veprat penale në fushën e terrorizmit 2013-2015	194

LISTA E DIAGRAMEVE

Diagrami 1: Rastet e bashkëpunimit policor me Shqipërinë.....	62
Diagrami 2: Shkëmbimi i informacioneve me shtetet e tjera.....	66
Diagrami 3: Bashkëpunimi policor me Austrinë	69
Diagrami 4: Bashkëpunimi policor me Hungarinë	71
Diagrami 5: Bashkëpunimi policor me vendet e ILECU	81
Diagrami 6: Bashkëpunimi policor me Maqedoninë	84
Diagrami 7: Bashkëpunimi policor me Eulex-in	114
Diagrami 8:Viktimat e trafikimit të identifikuara në Kosovë pas vitit 2008, sipas origjinës.....	166

Lista e Shkurtimeve

BE	Bashkimi European
BNP	Bashkëpunimi Ndërkombëtar Policor
BPBSD	Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e së Drejtës
DKKO	Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar
EULEX	Misioni i Bashkimit European për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUROJUST	Njësia e Bashkimit European për Bashkëpunim Gjyqësor
EUROPOL	Zyra e Policisë Europiane
FRONTEX	Agjencia Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit European
ILECU	Njësia e Kordinimit Ndërkombëtar për Zbatim të Ligjit
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
IPA	Shoqata Ndërkombëtare Policore
IPCOS	Organizatat Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Policor
KKE	Komuniteti Ekonomik European
KO	Krimi i Organizuar
KRB	Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit
NATO	Organizata e Paktit të Atlantikut të Veriut
NJPH	Njësitë e Përbashkëta Hetimore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONP	Organizata Ndërkombëtare Policore
PCCSEE	Konventa e Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore
PRSK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
RKS	Republika e Kosovës
SEECp	Procesi i Bashkëpunimit të Europës Juglindore
SELEC	Qendra për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore
SEPCA	Shoqata e Shefave të Policisë së Europës Juglindore
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TBE	Traktati i Bashkimit European
TN	Terrorizmi Ndërkombëtar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

KAPITULLI I: HYRJE

“Ndërkombëtarizimit të krimit duhet t’i kundërvihemi

me ndërkombëtarizimin e represionit”.

(H. Donnedieu de Varbes, 1928:30)

1.1. Shtrimi i problemit

Në kohën e sotme të globalizimit, të zhvillimeve shumë të shpejta, bota është bërë shumë e afërt për të gjithë. Shtetet dhe kombet janë përafruar shumë me njëri-tjetrin, kanë zgjeruar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis tyre, kanë rritur shkëmbimet ekonomike dhe kulturore dhe bashkëveprojnë rregullisht për përballimin dhe zgjidhjen e problemeve, me të cilat ballafaqohen njerëzimi dhe shtetet. Sot, gjithnjë e më shumë, po krijohet bindja se mjaft probleme, ato ekonomike dhe sidomos ato që lidhen me parandalimin dhe me luftimin e kriminalitetit dhe të terrorizmit shtetet, nuk mund t’i zgjidhin të vetme, pa bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

Bombardimet në Mumbai të Indisë në vitin 1993, sulmi i Al Kaidës në Qendrën Botërore të Tregtisë, sulmi Qeqen në shkollën Beslan, pastaj sulmet në Madrid dhe Londër, (Baylis, *at al* ,2010: 236), sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001, si dhe sulmet e të ashtuquajturit Shteti Islamik në Irak dhe Siri dhe aktet terroriste në vitin 2015 në Paris dhe 2016 në Bruksel, kthyen vëmendjen ndërkombëtare më shumë se kurrë në luftën e përbashkët të shteteve dhe është bërë subjekt i diskutimeve të ndryshme politike e shoqërore. Kjo ka arsyen e vet, pasi, në kuadrin e zhvillimeve globale që kanë ndodhur dhe po ndodhin në botë, krimi dhe terrorizmi kapërcejnë tashmë kufij shtetesh dhe kanë marrë dimensione transnacionale. Shumë institucione rajonale janë krijuar për të shmangur konfliktet në mes të shteteve dhe luftuar për interesa të përbashkëta (Craig &

Burca, 2011:3-4). Përgjigjja më e mirë ndaj kësaj dukurie është bashkëpunimi i frytshëm ndërshtetëror dhe ai ndërmjet strukturave dhe agjencive policore të shteteve të ndryshme, të cilat janë përditë në luftë me kriminalitetin, në përgjithësi, dhe me krimin e organizuar dhe terrorizmin ndërkombëtar, në veçanti.

Kriminaliteti, si një dukuri negative dhe e rrezikshme, jo vetëm është shtuar e zgjeruar, por edhe ka marrë forma më të organizuara dhe të sofistikuara. Ai është bërë shumë i rrezikshëm dhe më i vështirë për t'u zbuluar dhe për t'u asgjësuar, sepse grupet kriminale dhe format bashkëkohore të krimit të organizuar jo vetëm kalojnë kufijtë kombëtarë, por edhe sepse individët dhe organizatat kriminale veprojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë të kualifikuar dhe mjaft komplekse. Nga mediat, por edhe në mjaft studime dhe kërkime empirike konkludohet se krimi i organizuar dhe sidomos terrorizmi kanë krijuar edhe rrjete ndërkombëtare të krimit, kanë arritur shkallë të lartë përsosmërie, ndërsa kriminelët profesionistë tregojnë aftësi të veçanta organizimi dhe kamuflimi. Ata e bazojnë punën e tyre në mbledhjen e informacioneve, si dhe në aftësitë për t'i ndjekur ecuritë e ndryshme në sferat ekonomike dhe financiare, organizimin dhe punën e institucioneve shtetërore, sidomos të policisë dhe të strukturave tjera që merren me ndjekjen e tyre (Halili, 2011:138).

Jemi dëshmitarë se krimi i organizuar dhe sidomos terrorizmi, si dhe format tjera të manifestimit të tyre, janë prezentë në të gjithë globin. Duke i tejkaluar kufijtë e brendshëm të shteteve, është evidente se krimi në mjaft raste lëviz dhe vepron me shpejtë se agjencitë e zbatimit të ligjit, si policia, prokuroria dhe gjykatat.

Në këtë kuadër, kuptohet, edhe Republika e Kosovës,¹ nuk ka si të jetë e imunizuar ndaj kriminalitetit, në tërësi, dhe as ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit.

¹ Republika e Kosovës, është shpallur shtet sovran dhe i pavarur përmes Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

E dalë nga lufta në vitin 1999, përveç shkatërrimeve të shumta materiale, gjendjes psiko-emocionale të popullatës, mungesës së zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, papunësisë, mungesës së infrastrukturës ligjore i kanë munguar edhe institucionet dhe mekanizmat shtetërore, të cilët do të kontrollojnë dhe do të luftojnë me efikasitet të gjitha format e kriminalitetit. Përveç kësaj, Kosova ka pasur kapacitete të kufizuara të kontrollit të kufirit dhe të lëvizjes së personave në dhe jashtë Kosovës, me çka u ka kontribuar kriminelëve të lëvizin lirshëm (Komisioni Europian, *Raporti i progresit për Kosovë*, 2008:58). Mund të themi se shtimi i kriminalitetit në Kosovë ka ndodhur si rezultat i disa faktorëve, tashmë, të identifikuar, si:

- statusi politik ndërkombëtar i pazgjidhur i Kosovës pas vitit 2008 dhe paaftësia e mekanizmave vendase dhe ndërkombëtare të instaluar në Kosovë për të luftuar format e kriminalitetit;
- paaftësia e institucioneve për të krijuar raporte bashkëpunimi të shëndosha, të integruara dhe të vazhdueshme me organizmat ndërkombëtarë të sigurisë;
- mungesa e anëtarësimit të Policisë së Kosovës në organizatat ndërkombëtare policore të specializuara, të cilat, pa dyshim, luajnë rolin kryesor në identifikimin, qasjen, krijimin e infrastrukturës dhe në shkëmbimin e informacioneve ndërmjet agjencive policore dhe atyre të inteligjencës;
- përvoja e munguar në institucionet vendore dhe mungesa e kapaciteteve administrative të krijuara rishtas dhe boshllëqet juridike ligjore, mungesa e mekanizmave dhe e instrumenteve të domosdoshme për t'ju qasur në mënyrë profesionale dhe pa kompromis dukurive kriminale në shoqërinë e pasluftës;
- kompleksiteti kulturor, familjar, tradicional dhe zakonor në shoqërinë kosovare, problemet e brendshme ekonomike, pasiguria politike dhe problemet e

pazgjidhura në pjesën Veriore të pintegruar të Kosovës, të populluar kryesisht me banorë të nacionalitetit serb;

- ndikimet nga ana e fqinjës verior – Serbisë, dhe implikimet e saj, përmes strukturave destabilizuese, në punët e brendshme të Kosovës, duke ndikuar te popullata e kësaj pjese për padëgjueshmëri dhe mosrespektim të institucioneve dhe ligjeve të Kosovës;
- mostrajtimi me kohë dhe neglizhenca e organeve shtetërore të Kosovës në trajtimin e veprimeve dhe të qasjes ndaj krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Këta faktorë kanë ndikuar në rritjen e kriminalitetit të brendshëm, të kontrabandës dhe të formave tjera të krimit, të cilat kanë pasur ndikim negativ për imazhin e përgjithshëm ndërkombëtar të Kosovës. Këtë e pohojnë dhe autorë të ndryshëm në punimet e tyre. Në Kosovë dhe në pjesë të tjera të Ballkanit, ku ka pasur një fluks të madh të personelit të huaj, të parave dhe të organizatave ndërkombëtare, ishin krijuar mundësi të reja ilegale për krime në fusha të ndryshme (Berdal & Serrano, 2002:138). Gjithashtu, situata e tensionuar dhe luftërat e zhvilluara në Lindjen e Mesme kanë ndikuar relativisht edhe në Kosovë, ku një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve nga Kosova, të frymëzuar nga ideologjia fetare, janë bërë pjesë e luftërave në Irak dhe në Siri. Kjo ka ndikuar që institucionet e sigurisë në Kosovë të reagojnë dhe të marrin masa për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në vend.

Institucionet e Kosovës kanë qenë jo të fuqishme dhe nuk kanë pasur kapacitetet e nevojshme që t'i qasen të vetme krimit, i cili po përhapej në Kosovë. Policia e Kosovës (PK), si një shërbim i ri policor, i themeluar në fund të vitit 1999 (atëherë si

Shërbimi Policor i Kosovës),² ka qenë jo e përgatitur për të luftuar me efikasitet elementët kriminalë në shoqërinë e Kosovës. Në fillimet e saj, PK udhëhiqej dhe mbështetej nga një staf policor ndërkombëtar nga shtete të ndryshme të botës. Në këto kushte, bartja e kompetencave në luftimin e terrorizmit dhe të krimit të organizuar të brendshëm dhe ndërkombëtar tek policia vendore ka qenë hapi i fundit që bëri misioni i Kombeve të Bashkuara në fund të mandatit të tij.

Duke parë peshën e secilit nga faktorët e përmendur më sipër, del e qartë se sa e domosdoshme është nevoja për përmirësimin cilësor të punës së strukturave policore në Kosovë dhe rritja e pandërprerë e forcës së tyre goditëse ndaj krimit. Njëkohësisht, ata nxjerrin në rendin e ditës edhe domosdoshmërinë e bashkimit të forcës së shteteve të ndryshme dhe sidomos të bashkëpunimit ndërkombëtar me strukturat e tyre policore, për t'i luftuar së bashku krimin dhe terrorizmin, me të gjitha mjetet në dispozicion. Është fakt i pamohueshëm që sot shtetet e veçanta, pra edhe Kosova, kanë shumë nevojë për ndihmë në përballimin e problemeve që hasin në luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar, gjë që kërkon që edhe format dhe rrugët e kësaj lufte të jenë shumëdimensionale.

Strategjitë për zhvillimin e partnershipit në mënyrë që të zgjidhen problemet e krimit ndërkombëtar duhet të analizohen dhe formulohen para se strukturat e krimit ndërkombëtar të jenë zhvilluar (Wiarda, 1997:20-23). Sidomos në rajonin tonë të Gadishullit Ballkanik, kriminelët nga të gjitha shtetet bashkëpunojnë me lehtësi dhe pa kurrfarë problemesh me njëri-tjetrin, kur është fjala për trafikimin e qenieve njerëzore, trafikimin e drogës, për kontrabandën me migrantë, për terrorizmin dhe për forma të tjera të krimit të organizuar.

² Shërbimi Policor i Kosovës është themeluar zyrtarisht më 6 shtator të vitit 1999, në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2005/54.

Qarkullimi i madh i njerëzve nga një shtet në tjetrin, si dhe proceset integruese midis shteteve në shkallë kontinentale, madje, edhe ndërkontinentale, përveç anës shumë pozitive, kanë mundësuar kryerjen e një numri të madh të veprave penale me elemente ndërkombëtare (Salihu, 2005:25).

Sipas autorëve Berdal dhe Serrano, janë dy strategji për luftimin e kriminalitetit në rajonin e Ballkanit: masat preventive përmes zhvillimit të aspektit social dhe politik dhe duke forcuar sistemin ligjor dhe ndërtimin e shoqërisë civile, dhe, e dyta, sistemi represiv, duke ndihmuar në zhvillimin e sistemit të policimit dhe përmes bashkëpunimit policor ndërkombëtar (Berdal dhe Serrano, 2002: 138).

Pas shpalljes së Pavarësisë, edhe në Kosovë filloi të bëhet prezent problemi i bashkëpunimit ndërkombëtar policor, jo vetëm si një nevojë e brendshme, por edhe si një obligim i përbashkët në marrëdhëniet e shtetit të pavarur me vendet dhe organizatat ndërkombëtare. Fillimet e këtij procesi të rëndësishëm të BNP në Kosovë kanë filluar nga viti 1999. Hapat e parë në këtë drejtim janë hedhur nga Këshilli i Sigurimit (KS) i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Në mbledhjen e vet të 4011-të, të mbajtur më 10 qershor 1999, duke marrë parasysh qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe përgjegjësinë primare për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare: nxjerr Rezolutën (Resolution 1244, UN Doc. S/Res/1244 (10 June 1999), me anën e së cilës i jepet fund luftës në Kosovë dhe bëhet vendosja e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe e një pranie civile ndërkombëtare në Kosovë.

Fillimisht, fusha e BNP të Kosovës ka qenë e mbuluar nga Policia e Kombeve të Bashkuara, e njohur si UNMIK-Police. Në këtë studim ne nuk ndalemi shumë në këtë periudhë, por edhe nuk e anashkalojmë rolin e këtij organizmi ndërkombëtar në Kosovë në përgatitjen e infrastrukturës dhe në ekzekutimin e normave, me të cilat është

rregulluar kjo fushë. UNMIK-u, kjo forcë policore ndërkombëtare, ka dhënë kontributin e vet përmes angazhimit primar dhe praktik në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike në Kosovë, duke hedhur bazat e krijimit të infrastrukturës ligjore, përmes rekrutimit dhe trajnimit të personelit vendor dhe ngritjes së kapaciteteve vendore në të gjitha fushat e zbatimit të ligjit. Prandaj dhe veprimtaria e tij në këtë fushë gjen pasqyrimin e vet në studimin tonë.

Vetëm pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008, kompetencat në fushën e BNP i kaluan policisë vendore, megjithë ballafaqimet dhe kufizimet për sa u përket kapaciteteve, raporteve dhe qasjes të Policisë së Kosovës në forumet dhe organizatat ndërkombëtare policore (ONP). Por duhet thënë se edhe në këtë periudhë të re zhvillimi, krahas Policisë së Kosovës, rol të rëndësishëm në fushën e BNP ka luajtur edhe policia e EULEX-it,³ përmes misionit të BE-së në Kosovë, sidomos në disa fusha të rezervuara, që kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar. Ndihma dhe bashkëpunimi me EULEX-in ishin dhe mbeten të domosdoshme edhe për faktin se kriminaliteti, si dukuri e organizuar në vendin tonë, ka shënuar rritje edhe për shkak të dobësisë së institucioneve shtetërore dhe policore, që u krijuan rishtas dhe nuk kishin as mjetet dhe as përvojën e duhur.

Institucionet dhe Policia e Kosovës kanë bashkëpunuar dhe bashkëpunojnë ngushtë me misionin e EULEX-it, i cili i ka mbështetur dhe i ka ndihmuar ato në disa fusha, duke qenë në rolin e mentorit, të këshilluesit, dhe në disa sfera të tjera duke luajtur edhe rol ekzekutiv.

³ EULEX-i është mision i integruar i BE-se për sundimin e ligjit që funksionon në fushën e drejtësisë, të policisë dhe të doganës. Misioni do t'u ndihmojë autoriteteve të Kosovës, autoriteteve gjyqësore dhe agjencive për zbatimin e ligjit që të arrijnë përparim drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies. Do ta zhvillojë dhe forcojë edhe më tej një sistem të pavarur dhe shumetnik të drejtësisë, si dhe një polici e shërbim doganor shumetnik, duke u siguruar që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrja politike dhe t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikatat më të mira europiane (Burimi: Doracak për sundimin e ligjit).

Veprimtaria e policore ishte një praktikë dhe një përvojë e re, e cila ka ardhur ndër vite duke u zgjeruar dhe duke u pasuruar, falë edhe ndihmës së dhënë nga shtetet e tjera dhe nga organizatat ndërkombëtare policore. Në vazhden e përpjekjeve të saj në proceset integruese, në rrjedhat e BE-së dhe në strukturat veri-atlantike, Kosova ka treguar gatishmërinë e saj për përfshirjen në proceset e bashkëpunimit policor në kuadrin e luftës pa kompromis kundër të këqijave globale, që po përshtjellojnë rajonin dhe botën mbarë. Në këtë aspekt, Kosova ka ndërmarrë një varg masash në kuadër të harmonizimit të legjislacionit të saj të brendshëm me atë të BE-së dhe legjislacionit ndërkombëtar.

Në këtë studim bëhen përpjekje që, përmes një analize të zgjeruar, të jepet një trajtim i hollësishëm mbi problematikën e zgjedhur dhe kahet e rregullimit të saj përmes akteve juridike të brendshme dhe harmonizimit të tyre me ato ndërkombëtare. Në këtë drejtim mund të themi se është e padiskutueshme epërsia e akteve juridike ndërkombëtare ndaj atyre të brendshme, në kuptim të normave që e rregullojnë çështjen e BNP në tërësi.

Studimi i bashkëpunimit policor ka treguar se shtetet në axhendën e tyre shpeshherë përballen me sfida me karakter, sa normativ, aq edhe politik. Por trajtimi juridik dhe praktik i studimit ndërlidhet shumë edhe me aspektin politik të rrethanave dhe të zhvillimeve në arenën ndërkombëtare dhe të pozicionit jo të favorshëm juridik të Kosovës në forumet rajonale dhe ndërkombëtare. Qasja jonë analitike dhe shkencore, është e fokusuar në gjetjen e metodës më të përshtatshme për t'ju qasur problematikës, duke e analizuar atë në këndvështrim të gjetjes së mënyrave më të pranueshme të ndërtimit të konceptit, duke identifikuar përparësitë, mangësitë, si dhe sfidat që kanë dalë në këtë proces. Studimi vë në dukje se Kosova, me hartimin e legjislacionit të saj

ka përgatitur dhe harmonizuar aktet e saj të brendshme dhe ka arritur të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi ndërshtetëror për të lehtësuar luftën kundër grupeve të organizuara kriminale, terroriste, të cilat kanë krijuar kapital të madh dhe ushtrojnë ndikime shkatërrimtare ndaj institucioneve dhe rendit policor dhe juridik (Halili, 2011:142).

Një rol të pazëvendësueshëm, natyrisht, luajnë edhe nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat hapin rrugën dhe janë të nevojshme për zhvillimin e proceseve. Referuar marrëveshjeve ndërkombëtare, vlerësohet se shtetet që kanë zhvilluar marrëveshje të tilla, zakonisht, kanë një lidhje të fortë historike, ideologjike, sociale dhe ekonomike, shpërndajnë të njëjtat probleme të krimit dhe kanë nevojë për një front të përbashkët që të luftojnë krimin (Sang, 1997).

Në kuadër të agjencive ligjzbatuese, Policia përbën një segment të rëndësishëm të institucioneve shtetërore në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ajo, ndër të tjera, është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve dhe e akteve juridike që rrjedhin nga vullneti i shteteve për të bashkëpunuar dhe që burojnë nga marrëveshjet dhe aktet e tjera juridike ndërkombëtare. Ky bashkëpunim dhe ndihma juridike konkrete ndërlidhen me të gjitha ONP që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit e, në veçanti, të terrorizmit, krimit të organizuar, llojeve të kontrabandës, trafikimit të qenieve njerëzore, prostitucionit, trafikut të drogës, kontrabandimit me migrantë, kalimet ilegale të kufirit etj.

BNP për kërkimin, ndjekjen, mbikëqyrjen, identifikimin, demaskimin e kriminelëve në bazë të këtyre marrëveshjeve vë përpara policisë detyrën për plotësimin e kërkesave që përmbajnë konventat dhe marrëveshjet e nënshkruara, për shkëmbimin e

komunikimeve të sigurta, të fshehta, dhe të shpejta ndërmjet byrove qendrore kombëtare (Latifi, 2014:27).

Se sa do të jetë efikasiteti i organeve që merren me luftimin e kriminalitetit në Kosovë, varet edhe nga interesimi dhe bashkëpunimi i pashmangshëm me organet përkatëse në shtetet e tjera. Procesi i integritetit në strukturat veriatlantike, si NATO dhe BE, është i lidhur ngushtë edhe me këtë proces. Përmbushja e kriterëve dhe e standardeve të kërkuara nga aleatët tanë perëndimorë, si dhe efikasiteti dhe efektiviteti i organeve të ligjit për të luftuar të gjitha format e krimit në vendin tonë është një sfidë, e cila duhet ditur si të menaxhohet.

Kjo paraqet një rëndësi të veçantë në përpjekjet e Kosovës për përmirësimin e kushteve dhe të lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Kosovës edhe në kuadër të liberalizimit të vizave, sidomos kur kemi parasysh faktin që shtetasit e Kosovës janë të vetmit në rajonin e Ballkanit, të cilëve ende u duhen viza për të udhëtuar lirshëm në shtetet e BE-së dhe më gjerë. Kjo do të ndikonte në parandalimin dhe zvogëlimin edhe të dukurive tjera negative, siç janë kontrabandimi me migrantë dhe format tjera të kontrabandës, kalimi ilegal i kufijve, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda me narkotikë, trafikimi i armëve etj.

Në këtë drejtim, gjithashtu, ka munguar edhe BNP, e cila ka qenë mëse e nevojshme sidomos në periudhën kur shteti i Kosovës kishte nevojë për përkrahje ndërkombëtare dhe për hapje të rrugës drejt inkuadrimin në organizatat ndërkombëtare të sigurisë.

Kriminaliteti dhe format e prezencës së tij ndryshojnë varësisht zhvillimeve shoqërore dhe situatave të ndryshme që ndodhin në arenën ndërkombëtare, siç janë krizat ekonomike, protestat e tejzgjatura, konfliktet, luftërat etj. Në këto kushte,

kriminelë të ndryshëm që kryejnë vepra të ndryshme kriminale në Kosovë a në vende të tjera, duke shfrytëzuar situatat, arratisen në vende të tjera. Në këto rrethana Kosova ka nevojë për mbështetje, sepse rrezikon që të bëhet një çerdhe për kriminelë ndërkombëtarë dhe të vendoset, kështu, në listën e vendeve që prodhojnë pasiguri dhe jostabilitet në rajon.

Pavarësisht ashpërsimit të politikave kundër krimit në Europë dhe krijimit të organeve, si Europol, Eurojust etj., dhe mbështetjes së madhe nga institucione dhe organizata ndërkombëtare, si: KE, BE, OKB, SECI, Pakti i Stabilitetit etj., krimi më shumë vëzhgohet si fenomen kombëtar dhe vendet po hasin në vështirësi të bashkëpunimit institucional sidomos ato të Europës Juglindore (CARPO, *Raporti mbi situatën*, 2006:14). Rrjetet ndërkombëtare kriminale kanë aftësi që t'i njohin dhe t'u shmangen me zgjuarsia përpjekjeve të organeve për zbatimin e ligjit, duke shfrytëzuar dobësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Lidhur me këtë dukuri, një rol të madh luan sidomos sigurimi i informacioneve rreth kriminelëve dhe lëvizjeve të tyre nga një vend në tjetrin. Shkëmbimi i informacioneve në rang ndërkombëtar paraqet domosdoshmëri për zbulimin e tyre, si dhe për parandalimin e aktiviteteve kriminale. Krahas kësaj, kërkohet edhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe kordinimit sa më të frytshëm mes vendeve të ndryshme e, në veçanti, atyre të rajonit të Ballkanit, ku shtetet po hasin në vështirësi të mëdha për sa i përket sundimit të ligjit dhe luftës kundër kriminalitetit.

Për këtë, nevojiten një varg masash dhe reformash ligjore e organizative në institucionet e zbatimit të ligjit, që ndikojnë edhe në rritjen e integritetit, të profesionalizmit, të përkushtimit dhe të përgjegjshmërisë në punë të punonjësve të

policisë, si dhe në senzibilizimin e opinionit qytetar se luftimi i kriminalitetit është një detyrë, nder dhe patriotizëm që duhet ta ushtrojnë të gjithë.

1.2. Qëllimi i studimit

Punimi synon të plotësojë një boshllëk në fushën e studimeve teorike dhe praktike të çështjes së bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit dhe të terrorizmit në Kosovë. Kjo temë nuk është trajtuar mjaftueshëm në Kosovë dhe ndaj ishte krijuar me kohë nevoja për më shumë kërkime shkencore në këtë fushë. Duke qenë edhe vetë pjesë e strukturave policore të Kosovës e kam ndier vetë mungesën e studimeve të tilla.

Me kryerjen e këtij disertacioni synoj jo vetëm avancimin e njohurive të mia të përgjithshme dhe konkrete rreth bashkëpunimit ndërkombëtar policor, por, kryesisht evidencimin e rolit që ka pasur ky bashkëpunim në luftën kundër kriminalitetit në Kosovë, si dhe rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë.

Si të gjitha kërkimet, edhe ky kërkim bëhet për t'ju përgjigjur disa pyetjeve që, në këtë rast lidhen me dukurinë bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftën kundër kriminalitetit dhe terrorizmit. Ky është motivi që më çoi në zgjedhjen e këtij objekti të studimit tim, për t'u ardhur në ndihmë drejtuesve të strukturave policore të Kosovës në përpjekjet e tyre për ngritjen e nivelit cilësor dhe të efikasitetit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Përmes këtij studimi synohet gjithashtu të kemi një pasqyrim shkencor të dukurive praktike të kësaj fushe, si dhe në aspektin ligjor të problematikave të saj dhe t'i bëhet një analizë e infrastrukturës aktuale ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe instrumenteve juridike në fushën e bashkëpunimit policor. Gjithashtu, jemi munduar që

përmes këtij pasqyrimi të çështjes të nxjerrim edhe specifikat, arritjet, mangësitë që ka ai në Kosovë dhe problemet që dalin për ta zhvilluar e përsosur më tej atë.

Duke dhënë vendin e duhur edhe trajtimit praktik të problemit përmes hulumtimit empirik të faktorëve që ndihmojnë ose pengojnë BNP në Kosovë, synojmë që të arrijmë në disa përfundime dhe të formulojmë disa rekomandime lidhur me nevojën dhe mënyrat e përmirësimit dhe të zgjerimit të BNP të Kosovës dhe sidomos për rritjen e efikasitetit të tij.

1.2. Pyetjet dhe hipotezat

Studimi është përqendruar në një pyetje primare hulumtuese: “Cili është roli dhe si të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?”. Në mënyrë që të adresoj sa më qartë këtë pyetje kryesore, kam identifikuar edhe pyetjet përcjellëse analizuese:

- 1. Çfarë specifikash ka pozicioni i Policisë së Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor përballë statusit aktual të Republikës së Kosovës?*
- 2. Si funksionon bashkëpunimi ndërkombëtar policor dhe çfarë po bëhet për ta realizuar atë në Kosovë?*
- 3. Si ka funksionuar Policia e UNMIK-it në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë?*
- 4. Çfarë roli ka Policia e EULEX-it në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë?*

Në këtë këndvështrim janë ngritur edhe **hipotezat** e ndërtuara lidhur me temën, të cilat janë:

- 1) Mungesa e një bashkëpunimi të mirëfilltë ndërkombëtar policor ka ndikuar negativisht në efikasitetin e Policisë së Kosovës në luftimin e kriminalitetit në Kosovë.*
- 2) Bashkëpunimi ndërkombëtar policor në Kosovë pas vitit 2008 ka dhënë rezultate të dukshme në zvogëlimin dhe në luftimin e kriminalitetit.*
- 3) Memorandumet e bashkëpunimit policor, në pamundësi të anëtarësimit të Policisë së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë policorë, janë parë si forma të vetme të bashkëpunimit ndërkombëtar policor dhe të luftimit të kriminalitetit në Kosovë.*

Për të sqaruar pyetjet dhe për të vërtetuar dhe argumentuar hipotezat, kam ndërtuar edhe një pyetësor, të cilin e kam shpërndarë te zyrtarët policorë të angazhuar në njësitë përkatëse për luftimin e kriminalitetit dhe në fushën e bashkëpunimit policor.

1.4. Metodologjia e punimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim është në shërbim të shfrytëzimit të dhënave nga periudha pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Në këtë kontekst janë shfrytëzuar informacionet përmbajtësore dhe të dhënat lidhur me memorandumet e bashkëpunimit, të nënshkruara nga Policia e Kosovës, gjegjësisht, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, rastet dhe statistikat e bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Të dhënat statistikore të mbledhura dhe të përpunuara nga rastet e bashkëpunimit policor me karakter ndërkombëtar dhe të dhënat e pyetësorëve i kemi paraqitur nëpërmjet tabelave dhe janë analizuar.

I tërë procesi i punimit të kësaj teme ka kaluar në tri faza:

- Faza e parë, paraprake dhe e hedhjes së themeleve, përfshin saktësimin e qëllimit të studimit, përcaktimin e objektit të studimit, sqarimin e koncepteve të cilave do t'u referohem, mbledhjen e studimeve dhe të botimeve të deritanishme për këtë fushë, formulimin e tezave të përgjithshme dhe hipotezat specifike, përcaktimin e teknikës së nxjerrjes së të dhënave empirike, si dhe formulimin e projektit apo të planit (strukturës) të studimit.
- Faza e dytë përfshin nxjerrjen e të dhënave nga literatura përkatëse, nga punimet më të rëndësishme të kësaj fushe, nga aktet ligjore dhe nga dokumentacioni kryesor vendor dhe ai ndërkombëtar, si dhe mbledhjen e të dhënave nga terreni, përmes pyetësorit dhe kontakteve të tjera.
- Fazën e tretë, që është kryesorja, përfshin përpunimin, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave, si dhe shtjellimin e temës, duke dhënë rezultatet e arritura në njohjen e dukurisë që studiohet dhe përfundimet e rekomandimet, me të cilat mbyllet studimi.

Gjatë punimit të kësaj teme jemi bazuar në përdorimin e metodave të nevojshme për të arritur deri te rezultatet e dëshiruara, siç janë metoda historike, normative, e krahasimit, statistikore, përdorimi i pyetësorëve.

Metoda historike Përdorimi i saj konsiston në paraqitjen historike të çështjes së BNP-së, duke trajtuar zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale të mekanizmave përgjegjëse policore në këtë fushë, duke dhënë periudhat e paraqitjes së Policisë së UNMIK-ut, EULEX-it dhe Policisë së Kosovës. Me anë të kësaj metode është mundësuar edhe studimi kronologjik i problematikës dhe i zhvillimit të BPN deri në ditët e sotme të kësaj çështje.

Metoda normative Trajtimi i problemeve në këtë punim është bërë duke u mbështetur në të gjitha rastet në aket normative, juridike dhe në standardet e vendosura. Kjo metodë na ka ndihmuar për të pasqyruar përkufizimin, respektivisht, nocionin e BNP, por sidomos të rregullimit juridik të realizimit në praktikë të këtij bashkëpunimi me strukturat dhe organizatat ndërkombëtare.

Metoda statistikore është aplikuar për të paraqitur dhe analizuar me shifra të dhënat që sqarojnë zhvillimin e BNP në periudha të ndryshme, paraqitjen e trendeve të këtij bashkëpunimi, të dhënat për shkëmbimet e ndryshme të informacionit dhe të bashkëpunimit policor, si dhe shifrat për trendet e krimit. Aplikimi i kësaj metode përdoret më gjerësisht tek analizimi i statistikave të ndryshme, gjatë interpretimeve përkatëse.

Metoda krahasimore aplikohet për të bërë edhe krahasime të të dhënave të fushës së BNP, të formave të ndryshme të këtij bashkëpunimi, kur bëjmë krahasimin e të dhënave apo të statistikave, të rezultateve gjatë periudhave të caktuara etj.

Si rezultat i aplikimit të kësaj metode, në fund të punimit jepen edhe disa rekomandime për përmirësimin dhe zhvillimin e BPN në Kosovë.

Metoda e anketimit Gjatë realizimit të kësaj teme është aplikuar edhe anketa me pyetësor, që është plotësuar nga zyrtarë policorë të niveleve të ndryshme të drejtimit, të departamenteve policore dhe të drejtorive të tjera, gjë që ka ndihmuar që studimi të jetë më i plotë.

1.5 Kufizimet e hulumtimit

Meqë ky studim fokusohet në bashkëpunimin ndërkombëtar policor të Kosovës me shtete të ndryshme dhe me organizata të rëndësishme ndërkombëtare të sigurisë, në të nuk trajtohen dhe nuk gjejnë pasqyrim format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar lidhur me çështjet gjyqësore, me ndihmën juridike ndërkombëtare etj.

Në kuptim të çasjes kufizim ka paraqitur pamundësia të gjejmë dhe të përfshijmë në studim marrëveshje të BNP të lidhura nga shtetet e tjera për ngritjen, ndërtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet agjencive të sigurisë, dhe rastet e praktikës në BE dhe format e bashkëpunimit policor në rastet kur shtetet të cilat për shkakë të statusit specifik ndërkombëtar p.sh. si mos njohja në OKB kanë trajtuar fushën e BNP.

Gjithashtu, kufizim i këtij studimi është edhe fakti i lidhur me faktorin kohë, pasi periudha para vitit 2008 jepet shkurt dhe thjesht në kontekstin historik.

Edhe mosposedimi dhe pamundësia e sigurimit nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial të Kosovës, të disa të dhënave, lidhur me të dënuarit e përfshirë në rastet ndërkombëtare, na ka kufizuar pasqyrimin e këtij problemi.

Kufizime janë krijuar edhe nga mos sigurimi i disa të dhënave për periudhën kohore 2008-2012 nga Policia e Kosovës, për shkak të mungesës së bazave të të dhënave, gjë që ka bërë që të mos më ofrohen disa të dhëna që do të më shërbenin shumë për studimin.

1.6. Struktura e punimit

Ky punim doktrate është strukturuar në shtatë kapituj kryesorë, të cilët, po ashtu, janë të ndarë në nënkapituj dhe seksione.

Kapitulli i parë përfshin një Hyrje lidhur me çështjen që trajtohet. Në të bëhet një rezyme e problematikave të bashkëpunimit ndërkombëtar policor dhe jepet rëndësia

e tij në luftimin e kriminalitetit në Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare. Në këtë kapitull hyrës është bërë një shqyrtim kornizë i temës dhe qëllimi i studimit të saj. Më tej është vazhduar me metodologjinë që është përdorur në hulumtimin dhe trajtimin e temës, përfshirë pyetjet, hipotezat e punimit dhe kufizimet e tij. Në fund është pasqyruar struktura e punimit.

Kapitulli i dytë përmban një vështrim historik dhe aspekte teorike dhe praktike lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Një vëmendje e veçantë u është kushtuar natyrës juridike dhe rëndësisë që paraqet BNP në luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit, njohjes së subjekteve kryesore të marrëdhënieve juridike dhe llojeve të marrëveshjeve, si objekt i marrëdhënies juridike në BNP. Një trajtim dominues dhe analizë thelbësore i bëhet BNP në periudhën pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Këtu jepen me theks të veçantë marrëveshjet bilaterale të nënshkruara për bashkëpunim policor me shtete të ndryshme, duke e evidencuar thelbin e përmbajtjes së tyre dhe fushat e bashkëpunimit, si dhe ndikimin e tyre në fushën e sigurisë dhe të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Kapitulli i tretë shtjellon rolin e organizatave ndërkombëtare policore në luftimin e kriminalitetit. Kryesisht ndalemi te roli dhe funksionet e Interpol-it dhe Europol-it, si dy organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, instrumentet që ato përdorin dhe format e aspekteve ligjore në këtë fushë. Në këtë kapitull trajtohet edhe bashkëpunimi me organizatat tjera policore që veprojnë në Kosovë, në frymën e bashkëpunimit dhe të ndihmës që ato ofrojnë për organet e sigurisë.

Kapitulli i katërt trajton bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe fenomeneve kriminale, të cilat paraqesin preokupim kryesor për shtetet dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë. Këtu bëjmë shqyrtimin dhe analizimin e

trendeve të shfaqjes dhe domosdoshmërinë e luftimit sa më efikas të këtyre dukurive, si dhe impaktet e tyre në të drejtat e njeriut. Po ashtu, jepen edhe parimet themelore të bashkëpunimit dhe bazën legale të autoriteteve kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kapitulli i pestë përmban analizën dhe rezultatet e hulumtimit të të dhënave empirike të nxjerra nga anketa me zyrtarë të policisë së Kosovës.

Kapitulli i gjashtë përmban instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare më të rëndësishme që udhëheqin zhvillimin e BNP, përfshirë rolin e OKB-së, BE-së dhe të organizmave të tjera ndërkombëtare dhe nacionale. Theksi vihet në ndikimin e konventave ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me rregullimin në aspektin juridik të luftimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit në kontekstin e krijimit të raporteve të bashkëpunimit mes shteteve. Gjithashtu, këtu flitet për raportet që prodhojnë konventat ndërkombëtare me të drejtën e brendshme dhe rregullimin juridik që e trajtojnë Kushtetuta e Kosovës dhe aktet tjera juridike, në kuadër të sistemit ligjor të brendshëm të Republikës së Kosovës.

Punimi mbyllet me *kapitullin e shtatë*, i cili përmban përfundimet dhe rekomandimet, që janë rezultat i shqyrtimit dhe i analizës që bëhen në këtë punim.

Në fund të punimit jepet e plotë literatura e shfrytëzuar për hartimin e këtij punimi, si dhe skema e pyetësorit të përdorur.

KAPITULLI II: ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË BNP

2.1. Vështrim i shkurtër historik i BNP

Aktivitetet e bashkëpunimit ndërkombëtar në tërësi, por dhe forma konkrete, janë shfaqur qysh herët në historinë e njerëzimit, në kohët e krijimit të shteteve. Bashkëpunimi midis shteteve atëherë ishte në raste episodike dhe në forma fare të thjeshta, që nuk ishin të strukturuar në trajtën e sotme, por përmbanin elemente të nevojës që kishin shtetet për të bashkëpunuar midis tyre për shumë çështje me interes të përbashkët, “edhe pse në këtë fazë nuk mund të bëhej fjalë për kurrfarë rregullash fikse” (Puto, 2010: 34).

Gjurmë të hershme të rregullave të bashkëpunimit ndërkombëtar i gjejmë në *Lindjen e Afërt*, ku kanë lindur edhe shtetet e para. Dokumentet e ndryshme historike tregojnë se qysh në mijëvjeçarin e dytë para erës së re faraonët e Egjiptit, mbretërit e Babilonisë dhe Asirisë, princat sirianë dhe ata palestinezë kishin krijuar marrëdhënie reciproke midis tyre. Përvoja ka treguar se bashkëpunimit mes të shteteve i ka paraprirë lidhja e marrëveshjeve, e traktateve. Traktati më i vjetër i përket shekullit XIII para erës së re (Puto, 2010: 35). Është fjala për Traktatin mes faraonit të Egjiptit, Ramses II, dhe mbretit të Hititëve, Hetushili III, i lidhur në vitin 1278 para e.s. dhe që i jepte fund luftës. Sipas këtij traktati, shtetet merrnin përsipër të ndërprisnin veprimet ushtarake, t'i jepnin ndihmë njëri-tjetrit në luftën kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm dhe të dorëzonin dezertorët (Puto, 2010: 36). Traktati përmbante edhe dispozita për ekstradimin e autorëve të krimeve të ndryshme dhe ka shërbyer si model për marrëveshjet e mëvonshme (Gruda, 2007: 25).

Edhe pse këto forma të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar nuk specifikojnë në mënyrë taksative çështje të fushës së bashkëpunimit policor, ato mund të shihen dhe të konsiderohen si formë e parë e bashkëpunimit mes shteteve.

Në kohët e vjetra si veprimtari kriminale ndërkombëtare dominonte pirateria. Prandaj dhe këtu përqendroheshin, përpjekjet unilaterale dhe bilaterale midis shteteve kundër piraterisë detare, banditizmave dhe kontrabandës. “Piratët, banditët dhe kontrabandistët, u kanë shkaktuar gjithmonë probleme udhëheqësve që nga kohët e lashta (Andreas & Nadelman, 2006:4).

Ideja e bashkëpunimit dhe e ndihmës së ndërsjellë për t’i luftuar këto krime, e mbështetur në idealin e besimit reciprok, ka sjellë, në fakt, edhe lindjen e së drejtës ndërkombëtare penale, e cila është pararendëse e aktiviteteve të përbashkëta të shteteve për të gjetur zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare dhe penalizimin e krimit që kapërcen kufijtë e shteteve. Por, siç shprehet Green, “Historia e bashkëpunimit ndërmjet agjencive policore ose ndërmjet shteteve ishte shumë komplekse dhe ka qenë e përcjellë me shumë faktorë” (Greene, 2007: 705).

Ky kompleksitet i bashkëpunimit policor duket edhe në faktin që, në fillimet e shekullit të pesëmbëdhjetë, konstatoheshin raste kur organizmat policore dhe strukturat e tjera të shtetit nuk kishin një bashkëpunim të rregullt dhe as kordinim të veprimeve të tyre për luftën kundër krimit. Madje, viheshin re raste që ata nuk merreshin vesh dhe kundërshtonin njëri-tjetrin. Mund të përmendim këtu Austrinë, ku, edhe pse Stadguardia dhe Policia Ushtarake duhej të punonin së bashku, ndërmjet tyre ekzistonte një konflikt i hapur, i cili ngadalësonte zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes tyre, dhe e vetmja mënyrë që të arrihej bashkëpunimi ishte eliminimi i njërës forcë (Greene, 2007: 705).

Me kalimin e kohës, nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar policor nis e vlerësohet gjithnjë e më shumë nga shtetet e ndryshme. Kujtojmë këtu faktin se gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, agjentët policorë europianë, sidomos ata të Carit të Rusisë dhe ata të monarkisë së Habsburgëve kanë mbajtur kontakte të ngushta lidhur me disidentët dhe kërcënimet tjera potenciale për regjimet e tyre jashtë kufijve të tyre (Andreas & Nadelman, 2006: 4). Në të njëjtin shekull, Britania e Madhe iu përkushtua me një energji substanciale pakësimit dhe ndëshkimit të tregtisë transnacionale të skllëvërve nga Afrika (Andreas & Nadelman, 2006: 4). Ndërsa në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në dekadën e parë të shekullit të njëzetë, u bënë hapa më cilësorë në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar policor midis shteteve, diktuar kjo nga shpërthimet e akteve terroriste dhe nga vrasjet e politikanëve të rëndësishëm nga grupet anarkiste transnacionale. Në këtë kohë u ndërmorën përpjekjet e para të qëndrueshme nga qeveri të shteteve të ndryshme dhe nga agjencitë e tyre policore që t'i kordinojnë më mirë aktivitetet dhe të bashkëvepronin institucionalisht në luftën kundë krimeve transnacionale. Përpjekjet e ndryshme të organeve policore për të ndërtuar trupa policore bashkëpunuese që të adresojnë probleme të lëvizjeve globale kishte gjithandej botës (Gerspacher, 2008: 172).

Sipas literaturës që trajton ecurinë e këtij bashkëpunimi, del se format e mirë organizuara dhe, pak a shumë, të strukturuar janë shfaqur aty nga fillimi i shekullit XIX, në kohën e fillimit të lindjes dhe të shtimit të shteteve kombe. Në përgjithësi, në atë kohë u vu re tendenca që organet policore t'i braktisin detyrat politike dhe të bëjnë objekt kryesor të punës së tyre çështjet tipike policore. Pikërisht këto çështje do të vireshin edhe në qendër të veprimeve të përbashkëta të strukturave policore të vendeve të ndryshme. Agjencitë policore të vendeve të veçanta, në fillimet e tyre punën për

parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit ndërkombëtar e përqendronin kryesisht brenda kufijve nacionalë të shteteve, prandaj dhe nuk kishin ndonjë rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Përgjithësisht, veprimtaria policore në secilin shtet ishte e fokusuar në çështje që kishin të bënin me mbrojtjen e qeverive diktatoriale, me përpjekjet për ngritjen dhe identifikimin e institucioneve të sigurisë dhe me ofrimin e shërbimeve konkrete të shtetasve të tyre. Në SHBA, për shembull, gjatë shekullit XIX, institucionet policore nuk kanë luajtur ndonjë rol sinjifikant në praktikën ndërkombëtare policore. Sipas autorëve Wright dhe Miller, edhe detyrat policore me dimension ndërkombëtar ishin të fokusuara apo të lidhura me rrethanat amerikane, siç ishin zbatimi i detyrave që asocionin me skllavërinë, me emigrimin dhe me themelimin e kufijve kombëtarë në kontinentin e Amerikës Veriore (Wright & Miller, 2005: 795).

Nëse e shohim dukurinë e bashkëpunimit ndërkombëtar policor nëpër kontinente, vëmë re se ka dallime për sa i përket mënyrës së shfaqjes dhe zhvillimit të tij. Në Amerikën Veriore, për shembull, ku përfshihen tri shtete, Kanadaja, SHBA dhe Meksika, bashkëpunimi policor ka qenë më pak i zhvilluar, sesa në Europë. Aty format e BPN kanë qenë të ndryshme dhe kanë përfshirë nismatë lidhur me ndryshimet në kufijtë e tyre. Përgjithësisht, nismatë dhe bashkëpunimi kanë qenë më të lehtë në marrëdhëniet mes SHBA dhe Kanadasë, sesa me palën meksikane (Koenig & Das, 2001: 72). Kjo është konstatuar edhe nga Shoqata Ndërkombëtare e shefave të policisë, i cili që nga fillimi i veprimtarisë së tij, më 1901, ka pasur shumicën e anëtarëve të vet nga zyrtarë policorë nga Kanadaja dhe SHBA dhe më pak përfaqësues nga Amerika Latine dhe nga Europa (Koenig & Das, 2001: 72). Ndërkohë që marrëdhëniet ndërmjet SHBA dhe Meksikës i karakterizonin problemet e mbikëqyrjes dhe të kontrollit të kufirit, dhe ato të SHBA me Kanadanë ishin të preokupuara me kontrabandën, në anën

tjetër, me Europën, këto marrëdhënie janë karakterizuar nga barriera psikologjike, për shkak të distancës gjeografike (Koenig & Das, Deflem 2001: 72).

Ndërsa në kontinentin europian, aktivitetet dhe praktikat lidhur me BNP nga mesi i shekullit XIX ishin dukshëm më të avancuara. Në pjesën e parë të shekullit XX u bënë disa përpjekje për formalizimin e BNP, por ato, fillimisht, dështuan. Ndër këto përpjekje ishte edhe Kongresi i Parë i Konferencës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale, i mbajtur në Monako, në vitin 1914 ([Interpol timeline](#)", *Interpol.int*. 30 January 2011) dhe, më pas, Konferenca Ndërkombëtare e Policisë, e mbajtur në Nju Jork, më 1922. Është me rëndësi të thuhet se Kongresi i Monakos ishte një dështim, ngaqë ishte organizuar nga ekspertë ligjorë dhe zyrtarë politikë dhe jo nga zyrtarë policorë profesionistë, ndërsa Konferenca e Nju Jorkut dështoi në tërheqjen e vëmendjes ndërkombëtare.

Në vitin 1923 u mor një tjetër nisativë: me zhvillimin e Kongresit të Dytë Ndërkombëtar të Policisë, në Vjenë, u themelua KNPK, i cili konsiderohet si paraardhës i drejtpërdrejtë i Interpol-it. Anëtarët themelues të këtij Komisioni ishin agjencitë policore nga Çekosllovakia, Polonia, Austria, Belgjika, Kina, Egjipti, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Rumania, Suedia, Zvicra dhe Jugosllavia ([Interpol members and dates of membership](#)", *Interpol.int*: 17 April 2011). Shtetet e Bashkuara nuk iu bashkuan Interpol-it deri në vitin 1938, edhe pse një zyrtar policor nga SHBA-të, jo zyrtarisht, ishte i pranishëm në Kongresin e mbajtur më 1923 ([Interpol Member States: The United States](#)". *interpol.int*: 5 January 2012). Policia nga Mbretëria e Bashkuar iu bashkua Komisionit në vitin 1928 (*Interpol Member States: The United Kingdom*,*interpol.int*: 17 August 2012).

Me aneksimin e Austrisë nga Gjermania në vitin 1938, Komisioni ra nën kontrollin e nazistëve gjermanë dhe qendra drejtuese e tij u transferua në Berlin, në vitin 1942. Në vitet 1938-1945, si presidentë të Interpol-it kanë qenë edhe Oto Steinhäusl, Reinhard Heydrich, Arthur Nebe dhe Ernst Kaltenbrunner. Të gjithë këta ishin gjeneralë të ushtrisë naziste, në njësitet “SS”. Kaltenbrunneri ishte zyrtari më i lartë i rangut “SS”, i cili më pas u ekzekutua, pas gjyqit të Nurembergut. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, ky Komision u riemërua si Organizatë Ndërkombëtare e Policisë Kriminale, nga aleatët europianë si Belgjika, Franca, shtetet Skandinave dhe Mbretëria e Bashkuar. Selia e saj në këtë kohë u vendos në Saint-Cloud, të Francës, një qytet në periferi të Parisit, deri në vitin 1989, kur ajo u zhvendos në Lion, të Francës, ku edhe ndodhet aktualisht.

Para dhe pas Luftës së Parë Botërore rritet shqetësimi i falsifikimit të monedhave nacionale, e cila ka qenë një shtysë e fortë për krijimin e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë - Interpol. Duhet theksuar se gati përgjatë të njëjtës periudhë kohore ka pasur një rritje edhe të shqetësimit ndërkombëtar lidhur me problemin e opiumit në Kinë dhe me konsumimin e tij në Filipine, me përdorimin dhe abuzimin me opium dhe kokainë në Europë dhe në Amerikën Veriore. Këto dukuri nxitën reagimet e para ndërkombëtare për domosdoshmërinë e penalizimit dhe të kontrollit të drogave psikoaktive.

Si përfundim, mund të themi se me kalimin e kohës, format e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, jo vetëm nisën të bëhen më të shpeshta, por edhe të vihen në baza të shëndosha institucionale, përmes marrëveshjeve të përhershme të qëndrueshme, përmes formave më të strukturuar të bashkëpunimit, derisa mbërritën në këtë shkallë të organizimit modern të bashkëpunimit ndërkombëtar policor që kemi sot.

Edhe organizatat ndërkombëtare policore (ONP) që nisën të krijoheshin, në fillim nuk u formuan me përfaqësim të gjerë ndërkombëtar. Këtë ato e arritën kur institucionet policore u bënë mjaft të pavarura nga qendrat politike të secilit shtet, pra, kur filluan të funksionojnë si të pavarura dhe në mënyrë profesionale. Kur institucionet policore u vunë në pozita të mirë strukturuara pune, u bë i mundur edhe bashkëpunimi institucional policor transnacional, duke dalë dhe duke vepruar edhe jashtë kufijve shtetërorë, mbi bazën e koncepteve të përbashkëta në lidhje me zhvillimet ndërkombëtare dhe të mbështetura në akte juridike dhe organizative ndërkombëtare.

2.2. Aspekte teorike dhe konceptet mbi BNP

Me synimin të flasim në vija konkrete për aspektin teorik të dukurisë së BPN pa pretenduar për një parashtrim teorik të zgjeruar, jemi përpjekur të evidencojmë idetë dhe pikëpamjet e ndryshme teorike lidhur me këtë temë.

Tashmë, është pranuar dhe vërtetuar edhe teorikisht, se në fushën e veprimtarisë së strukturave dhe organizatave policore vendore dhe atyre ndërkombëtare ka një lëmë të rëndësishëm bashkëpunimi të domosdoshëm, siç është puna për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, në tërësi, dhe të krimit të organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar, në veçanti, duke i bashkuar forcat dhe duke harmonizuar operacionet e tyre në shkallë ndërkombëtare.

Duke i hedhur një vështrim literaturës që i kushtohet hulumtimit dhe formave të kooperimit policor ndërmjet vendeve të ndryshme, vihet re se kjo çështje ka ngjallur një interesim të madh dhe permanent. Janë të shumtë autorët dhe studiuesit që janë marrë dhe merren intensivisht dhe gjerësisht me problemin në fjalë, duke hedhur dritë në aspektin historik, teorik, si dhe në atë praktik, dhe duke arritur dhe në përfundime konstruktive lidhur me zhvillimin dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi mbi baza

shkencore, juridike dhe organizative. Një numër gjithnjë e më i madh autorësh, me të drejtë, parashtrojnë pikëpamjen se ky bashkëpunim dhe bashkërendim ndërkombëtar policor, në asnjë mënyrë nuk paralizon operacionet e strukturave policore vendore, përkundrazi, i inkurajon dhe i ndihmon ato. Disa të tjerë shprehin një parapëlqim për anën praktike të zhvillimit të BPN, duke e vënë theksin më shumë këtu, sesa tek teoria. Por, sidoqoftë, si literatura teorike, ashtu edhe përvoja konkrete nxjerrin në pah domosdoshmërinë e BNP dhe të perfeksionimit të vazhdueshëm të tij.

Nga perspektiva e të drejtës ndërkombëtare, kjo temë është trajtuar gjerësisht nga autorë të njohur të vendeve të ndryshme, të cilët i kanë dhënë një vend të merituar mbështetjes teorike të saj. Prandaj edhe në hartimin e këtij studimi, ne jemi konsultuar në mënyrë analitike me botime të spikatura të kësaj fushe, përfshirë edhe kontributin e autorëve kosovarë, si Ismet Salihu, Vesel Latifi etj., të cilët i trajtojnë problematikat e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në kuadër të aspekteve ndërkombëtare penale dhe parandalimit, zbulimit dhe luftimit të krimit transnacional.

Siç shprehet autori Salihu, kontributi i BNP-së në ndihmën juridiko penale ndërkombëtare për çështje të tilla, si gjetja e dëshmitarëve dhe e të pandehurve, sigurimi i tyre në procedurë penale, kryerja e hetimeve në shtete të tjera, angazhimi në procedurën e ekstradimit në mungesë të marrëveshjeve ndërshtetërore, mund të paraqitet substitut i ndihmës formale juridike (Salihu, 2005: 216-217).

Lidhur me përkufizimet shkencore të BPN, në hulumtimet e bëra nga autorë të ndryshëm, që e kanë studiuar këtë çështje, kam konstatuar se bashkëpunimi ndërkombëtar policor përfshin:

“akte apo veprime të ndryshme hetimore, operative, teknike, inteligjente, të cilat ndërmerren nga organet e policisë, me qëllim për të shpërndarë dhe për të kërkuar lloje të ndryshme të informacionit nga organet e huaja policore, të nevojshme për kryerjen e detyrave policore.”

Nga ky përkufizim del rëndësia e madhe që kanë kërkimi i informacionit dhe këmbimi i tij në këtë fushë. Të tjerë studiues vënë në dukje se, përmes bashkëpunimit policor, të dhënat inteligjente rreth aktiviteteve kriminale shkëmbehen përtej kufijve nacionalë dhe atyre gjeopolitikë. Autori Ismet Salihu në një punim të tij thekson shprehimisht se ky shkëmbim i informatave realizohet, përveç formave dhe procedurave të tjera, edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar policor (Salihu, 2005: 132).

Gjithashtu studiuesi tjetër, sikurse Bigo, kur flet lidhur me funksionin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor për shkëmbimin e të dhënave, thekson se informacioni i mbledhur gjatë hetimeve penale, krijon rrjete dhe lidhje midis profesionistëve të policisë (Bigo, 1996). Kjo është shumë e rëndësishme, pasi në këtë mënyrë bëhet i mundur rritja e efikasitetit të punës së policisë dhe garantohet suksesi i operacioneve të përbashkëta policore. Ndërsa sipas Lemieux, BNP u lejon strukturave policore të caktojnë burimet e informacionit në dispozicion të tyre në vende të tjera, në mënyrë që të kuptojnë më mirë *modus operandi* e të dyshuarve të tyre (Lemieux, 2010: 1).

Me rëndësi është dhe fakti që studiues të ndryshëm evidencojnë edhe një tjetër faktor, sa të domosdoshëm, aq edhe pozitiv, për këmbimin e informacionit në bashkëpunimin policor. Ky faktor është sigurimi i besimit reciprok ndërmjet strukturave që ndërmarrin veprime të përbashkëta. Lidhur me këtë, Anderson shprehet se bashkëpunimi policor për shkëmbimin e informacioneve “përshkon një rrugë të gjatë në

ndërtimin e besimit të bazuar në parimet e reciprocitetit dhe të komunikimit të ndërsjellë” (Anderson, 2002: 35-46).

Autorë të tjerë, kur japin definicionin e BPN, shkojnë më tej, pra, nuk mbeten vetëm tek kërkimi dhe grumbullimi i informacionit. Sipas Frederic Lemieux, BNP është një ndërveprim i qëllimshëm apo i paqëllimshëm ndërmjet dy ose më shumë njësive policore (përfshirë agjencitë publike dhe private) për qëllime të shpërndarjes së informatave inteligjente (për veprimtaritë kriminale – *shën.im, M.B.*), të kryerjes së hetimeve dhe, përfundimisht, për kapjen e të dyshuarve (Lemieux, 2010: 1). Pra, siç shohim, kemi këtu një zgjerim të përmbajtjes së përkufizimit të BPN, e cila shkon deri në qëllimin final të këtij bashkëpunimi: kapjen dhe arrestimin e të dyshuarve si autorë të krimeve.

Profesori i shquar Ethan Nadelman, ka një tjetër këndvështrim për marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Ai shprehet se këto marrëdhënie, gjithmonë kur janë vlerësuar të suksesshme, përgjithësisht, i referohen një procesi tri shkallësh, që harmonizon: 1) rregullimin e marrëdhënieve; 2) akomodimin e sistemeve të ndryshme me njëri-tjetrin; dhe 3) kordinimin drejt një norme të përbashkët (Nadelman, 1993:35).

Pa dyshim, në konceptin e bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive policore për kordinimin dhe zhvillimin sa më të kualifikuar të aktiviteteve të tyre të përbashkëta, përfshihet edhe organizimi i konferencave, simpoziumeve, debateve apo krijimi i forumeve të ndryshme, që ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të punës së policisë dhe në eliminimin e pengesave të ndryshme që paraqiten në komunikimin ndërmjet tyre. Sipas këtij koncepti, në bashkëpunimin ndërkombëtar policor nuk mjafton vetëm sasia e operacioneve të përbashkëta policore, por sidomos zhvillimi cilësor i tyre. Këtij të fundit i shërbejnë pikërisht veprimtaritë e përbashkëta ndërkombëtare, që përmendëm më

sipër, ku policitë e vendeve të ndryshme shkëmbejnë përvojë, rrahin mendime, zhvillojnë debate dhe arrijnë në përfundime teorike dhe praktike për realizimin me sukses të luftës kundër krimit. Në këto veprimtari, ku bëhet edhe analiza teorike të problematikave të bashkëpunimit bilateral, rajonal dhe multilateral është vënë në pah edhe nevoja e shtimit të studimeve shkencore në këtë fushë. Përmendim këtu Simpoziumin e katërt ekzekutiv të policisë ndërkombëtare, të mbajtur në Vjenë, të Austrisë, nga 20-23 maj të vitit 1997, me temë “Bashkëpunimi ndërkombëtar policor: perspektiva botërore”. Në të diskutimet dhe prezantimet ishin me përmbajtje të lartë shkencore dhe i përshkruanin llojet e ndërveprimit policor ndërkombëtar në tri nivele, të cilat autorët Daniel J. Koenig dhe Dilip K. Das i përcaktojnë si më poshtë:

Niveli *makro*, i cili përfshin marrëveshjet kushtetuese dhe ndërkombëtare ligjore, si dhe harmonizimin e ligjeve dhe të rregulloreve kombëtare.

Niveli *i mesëm*, që ka të bëjë me strukturat operationale, me praktikën dhe me procedurat e policisë dhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit; dhe

Niveli *mikro*, që përfshin hetimin e veprave penale të veçanta, parandalimin dhe kontrollin e formave të veçanta të krimit (Koenig & Das, 2001: 4).

BNP, sipas studiuesve, u mundëson hetuesve të shërbimeve të ndryshme policore që, në bazë të zgjerimit të njohurive teorike rreth bashkëpunimit ndërkombëtar policor, të arrijnë të përpilojnë plane më të sakta pune dhe veprimi, si për zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të grupeve kriminale, ashtu edhe për kapjen dhe asgjësimin e tyre.

Është me interes të theksojmë se shumë studiues konsiderojnë dhe shohin edhe dy faktorë të tjerë shumë të rëndësishëm për zhvillimin me sukses të bashkëpunimit ndërkombëtar policor: profesionalizmin dhe sidomos pavarësinë institucionale e strukturave policore nga politika.

Lidhur me këtë, profesori i sociologjisë në universitetin e Karolinës së Jugut, Mathieu Deflem, në një artikull të tij lidhur me historinë e bashkëpunimit policor, me titull “Bureaucratization and Social Control: *Historical Foundations of International Police Cooperation*”, argumenton se, për një bashkëpunim ndërkombëtar policor, forcat nacionale të zbatimit të ligjit duhet të kenë një shkallë të konsideruar institucionale të pavarësisë nga qendrat e tyre politike.

Shumë autorë të tjerë, duke trajtuar çështjet e BNP, prekin nevojën e kujdesit që duhet treguar që gjatë këtij bashkëpunimi të mos shkelen parimet e sovranitetit të shteteve të veçanta. Ata theksojnë se, duke hyrë në një organizatë për bashkëpunim ndërkombëtar, çdo anëtar pranon aspektet institucionale, duke plotësuar, kështu, në mënyrë formale parimin e detyrimeve që burojnë nga parimi i barazisë sovrane. Rrjedhim i pavarësisë dhe i barazisë së shteteve, është obligimi për të mos ndërhyrë në punët e brendshme apo të jashtme të shteteve të tjera. Kjo ka të bëjë me atë që quhet parimi qeverisës, i cili nuk lejon që një shtet të marrë masa në territorin e një shteti tjetër, pa miratimin e këtij të fundit.

Në territorin e një shteti tjetër nuk mund të arrestohen persona, nuk mund të dërgohen thirrje gjyqësore, nuk mund të zhvillohen hetime policore apo financiare dhe nuk mund të ekzekutohen urdhra për lëshimin e dokumenteve, përveçse sipas kushteve të një traktati apo të një miratimi tjetër të dhënë. Bashkëpunimi, pra, duhet të mbështetet në procedurën e kërkesës dhe miratimit të saj, të rregulluar nga disa parime të përgjithshme, me akte dhe marrëveshje ndërkombëtare.

Një përkufizim tjetër të bashkëpunimit ndërkombëtar policor, që sjellin autorë të ndryshëm, ka të bëjë me dimensionet e tij. Ata pohojnë qartë se ky bashkëpunim ka dimension *dypalësh*, por edhe *shumëpalësh*. Bashkëpunimi ndërkombëtar policor,

shprehet Deflem, në mënyrë tipike zhvillohet në dimension bilateral, mes policive të dy shteteve dhe kjo vetëm në baza të përkohshme, për një hetim të veçantë; ndërsa ai shumëpalësh mes policive është i natyrës bashkëpunuese dhe nuk ka të bëjë me formimin e një force policore mbikombëtare (Deflem, 2007: 18). Siç shihet, këtu bëhet fjalë për një moment shumë të rëndësishëm të BNP, rreth të cilit shpesh në praktikë krijohen edhe keqkuptime, sikur, meqë në këtë bashkëpunim përfshihen strukturat policore të shumë vendeve, ato formojnë një forcë policore mbinacionale dhe kështu cenojnë sovranitetin shtetëror. Kjo gjë nuk nuk duhet të ndodhë, pasi, në fakt, të gjitha shtetet dhe policitë e tyre në këtë bashkëveprim janë të barabarta dhe thjesht bashkëpunuese me njëra-tjetrën.

Në të mirë të dhënies së përkufizimit të BNP, mjaft autorë dhe burime të tjera u referohen edhe formave me të cilat realizohet ky bashkëpunim. Ata vënë në dukje se bashkëpunimi mes policive të kombeve të ndryshme mund të zyrtarizohet me anë të takimeve të rregullta, me anë të rrjeteve të përbashkëta të komunikimit, gjithashtu, nëpërmjet konferencave, forumeve apo ekipeve të përbashkëta hetimore dhe institucioneve të tjera të bashkëpunimit.

Duke trajtuar koncept e BNP, studiuesit theksojnë se ky bashkëpunim u krijon agjencive të zbatimit të ligjit mundësinë për operacione policore të përbashkëta, duke e trajtuar dhe duke vepruar në shkallë ndërkombëtare dhe, më saktë, për të bërë vlerësimin e prioriteteve të grupeve kriminale, të dobësive dhe të kërcënimeve të tyre (Lemieux, 2010: 1).

Në kohën e sotme, kur krimi i organizuar dhe sidomos terrorizmi ndërkombëtar janë bërë një rrezik i madh global, suksemi në parandalimin dhe luftimin e tyre kërkon edhe një njohje të thelluar teorike të rrënjëve të këtyre veprimtarive kriminale e

terroriste, kërkon evidencimin dhe analizën e shkaqeve dhe të faktorëve që bashkëveprojnë në lindjen dhe zhvillimin e këtyre dukurive të rrezikshme. Zbërthimi teorik i faktorëve historikë, socialë, ideologjikë, fetarë, teknologjikë do të ndihmojë edhe për të shpërndarë mjegullën që kanë krijuar mjaft pështjellime teorike në këtë fushë, si dhe mjaft debate në nivel ndërkombëtar, deri edhe probleme politike dhe ushtarake.

Në këtë kuptim, krahas impenjimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve në përballjen me këto të këqija dhe rreziqe të mëdha për jetën e njerëzve dhe sigurinë e shteteve, shtrohet nevoja që edhe puna e organizmave ndërkombëtare dhe veçanërisht e organizatave të specializuara policore të shoqërohet me një punë kërkimore të thelluar teorike në këto fusha, për t'i paraprirë dhe për t'i orientuar sa më drejt bashkëveprimet e forcave policore dhe të shteteve të lidhura me sigurinë publike, me luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe krimit të organizuar.

Ndonëse në ka një rritje të literaturës për çështjet e BNP-së, kërkohet një shumëllojshmëri sqarimesh teorike, që, siç shprehet Lemieux, t'i ofrohet bashkëpunimit multilateral në luftën kundër krimit dhe aktiviteteve kriminale një mbështetje e duhur dhe një udhëzues për autoritetet e policive nacionale (Lemieux, 2010:2).

2.3. Vullneti i shteteve për bashkëpunim ndërkombëtar

Nevoja dhe gatishmëria e shteteve për të bashkëpunuar për çështje të ndryshme, por edhe në fushën policore, ka ekzistuar në të gjitha kohët. Duke u ndier të pafuqishme për t'i bërë ballë të vetëm ndonjë problemi, konflikti apo veprimtarie kriminale, shtetet i kanë shtrirë dorën shtetit fqinj ose dhe më gjerë për ndihmë, për bashkëpunim. Kjo nuk është parë vetëm si shfaqje e inferioritetit të një shteti të caktuar, të vogël e të pafuqishëm, por edhe si sinjal se ajo e keqe që i kishte rënë atij, mund të godiste edhe

shtetin, të cilit i kërkohej ndihma, dhe kjo kërkon bashkëpunim ndërkombëtar në sferën e legjislativit, gjyqësorit dhe ekzekutivit (Moore, 1996: 54).

Kështu, u krijuan praktika dhe tradita e mirë e bashkëpunimit midis shteteve, më së shumti, duke lidhur marrëveshje dhe bashkëpunim dypalësh. Sepse në ato kohë kjo shihej si forma më e lehtë dhe e realizueshme e komunikimit dhe e bashkëpunimit. Sigurisht që për këtë kërkohej edhe vullneti i mirë i shtetit, të cilit i kërkohej bashkëpunim, që ky t'i përgjigjej pozitivisht kërkesës.

Por edhe sot, kur format bashkëkohore të bashkëpunimit kundër kriminalitetit dhe terrorizmit ndërkombëtar janë të institucionalizuara dhe mjaft të avancuara, përsëri nuk injorohet, por mbetet si faktor i dorës së parë, vullneti dhe gatishmëria e shteteve dhe e forcave të zbatimit të ligjit të tyre për t'u përfshirë në veprimtaritë bashkëpunuese ndërkombëtare.

Mund të themi se kjo ka qenë dhe mbetet një sfidë edhe në kohët moderne, pasi në shtete të veçanta nuk mungojnë paragjykime dhe frika se gjatë bashkëpunimit mund të preken dhe të cenohen sovraniteti dhe interesat e tyre gjeopolitike. Ndaj nuk kanë munguar edhe rastet kur ndonjë shtet i caktuar ka reflektuar hezitim, stepje, madje, edhe refuzim për të bashkëpunuar në një veprimtari apo operacion ndërkombëtar kundër krimit transnacional.

Kjo është, në fakt, një çështje jo dhe aq e lehtë. Ende ka shtete që e shohin sovranitetin e tyre si pengesë për një qasje konstruktive lidhur me përfshirjen e tyre në bashkëpunimin ndërkombëtar. Kjo ndodh për shkak se paragjykohet që, me nënshkrimin e marrëveshjeve dhe të konventave dobësohet dhe kufizohet sovraniteti i tyre, madje, se u merret edhe një pjesë e pushtetit shtetëror në vend nga struktura mbikombëtare.

Megjithatë, duhet thënë se në botën e sotme kur luftimi i kriminalitetit dhe i terrorizmit, cenonë rendin e brendshëm demokratik, por edhe ndërkombëtar përdorin shtetin si bartës oficial i sigurisë, dhe policisë si organ ekzekutiv, (Maslesha, 2008: 24), nevoja e bashkëpunimit dhe e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë ka bërë që shtetet, në përgjithësi, të tregohen të gatshme për të dhënë kontributin e tyre në sferën e sigurisë dhe të paqes globale. Ato po shprehin vullnet që të bashkëpunojnë aktivisht dhe të bashkërendojnë forcat dhe resurset e tyre me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare të sigurisë. Vlera e kësaj qëndron në faktin, se kur ekziston ky vullnet i mirë për bashkëpunim ndërkombëtar, krijohen kushte dhe mundësi më të mëdha që rezultatet të jenë të ndjeshme. Të krijosh kushte dhe rrethana që të punojnë së bashku shtete me sisteme të ndryshme, me gjuhë të ndryshme dhe me kultura të ndryshme, këtë e bëjnë vetëm nevoja të rëndësishme vitale, siç është bashkëpunimi ndërkombëtar për të përballuar probleme të përbashkëta (Pradel, *at al*, 2009: 52).

Kur ekziston vullneti i sa më shumë palëve për bashkëpunim ndërkombëtar në zgjidhjen e çështjeve aktuale në arenën ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve ndërkombëtare, sidomos kur është fjala për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar, është e sigurt që rriten edhe besimi reciprok, edhe efikasiteti i strukturave që bashkëpunojnë dhe i operacioneve të tyre të përbashkëta.

Lidhur me këtë, Lemieux shprehet se si elemente fundamentale të nevojshme për një bashkëpunim policor të mirëfilltë është vlerësuar se janë besimi dhe komunikimi. *“Ku ekziston bashkëpunimi,- vë në dukje ai,- atje është edhe besimi dhe ku është besimi, atje ekziston bashkëpunimi”* (Lemieux, 2010: 27).

Për ndërgjegjësimin e shteteve të veçanta për bashkëpunim ndërkombëtar policor, një rol të rëndësishëm kanë luajtur dhe luajnë jo vetëm opinionin dhe mjetet e

informimit dhe të komunikimit, mediat ndërkombëtare, por, pa dyshim, edhe organizata të tilla, si OKB-ja, BE-ja, KE-ja, OSBE-ja etj., të cilat, në rrugë të ndryshme, ndihmojnë në ngritjen e shtetesh anëtare të tyre të frymës së bashkëpunimit, të vullnetit e të gatishmërisë për të bashkuar forcat dhe resurset për qëllime dhe interesa globale dhe të përbashkëta.

Një shërbim të mirë në këtë drejtim bëjnë edhe institucionet shkencore dhe akademike me studimet e botimet e tyre, si dhe qendrat ushtarake dhe ato të inteligjencës, të cilat vlerësojnë realisht kërcënimet që i kanosen njerëzimit sot dhe ngrenë alarmin për rreziqet nga krimi transnacional dhe efektet e tij, duke e quajtur këtë edhe “perandoria e re e së keqes” (Giraldo & Trikunas, 2013: 433).

2.4. Subjektet e marrëdhënies juridike të BNP

Si palë të bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftën kundër krimit të organizuar (KO) dhe terrorizmit ndërkombëtar (TN) janë përfshirë një numër i konsiderueshëm subjektesh kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktorë kryesorë në këtë fushë, në radhë të parë, janë agjencitë shtetërore të specializuara për këtë çështje, siç janë policia, prokuroria dhe gjykata, si organe të drejtpërdrejta, të përgatitura dhe pajisura me kapacitetet e duhura për luftimin e kriminalitetit në përgjithësi.

Ministria e Punëve të Brendshme është hallka e parë në zinxhirin e të gjitha agjencive dhe strukturave të tjera që përfshihen në BNP. Është kjo ministri ajo që, duke përdorur mjetet diplomatike realizon lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, përmes negocimit dhe adoptimit të instrumenteve ligjore, kordinimit të shkëmbimit të praktikave më të mira, përqendrimit në çështje të tilla, si krimi i organizuar dhe terrorizmi.

Gjithashtu, ky dikaster siguron mbështetjen e nevojshme financiare, ndihmën për të hartuar dhe për të zbatuar politikat kombëtare të luftës kundër kriminalitetit etj. Kuptohet që në këtë veprimtari ajo vë në lëvizje dhe mbështetet nga strukturat e ndryshme policore që ka në varësinë e saj dhe stafet drejtuese të tyre.

Njëkohësisht, subjekte shumë të rëndësishme të BNP janë aktorët ndërkombëtarë të sigurisë, si: Interpol-i, Europol-i, ILECU, EULEX-i etj., të cilat kanë një rol të dorës së parë në zhvillimin dhe drejtimin e luftës kundër krimit dhe terrorizmit ndërkombëtar. Gjithashtu ato gjatë angazhimit luajnë një rol të veçantë ndihmës, mbështetës dhe instruktues për subjektet kombëtare dhe i ndihmojnë ato në realizimin e operacioneve dhe të veprimtarive të përbashkëta në kuadër të BNP.

2.5. Objekti i marrëdhënies juridike të BNP

Objekti i marrëdhënies juridike të BNP, në tërësi, por edhe në luftimin e kriminalitetit në veçanti, duhet vlerësuar në kontekstin e metodologjisë kërkimore. Objekti thelbësor i bashkëpunimit janë marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale në fushën e sigurisë dhe të luftimit të krimit të organizuar dhe të terrorizmit. Krahas tyre vijnë konventat ndërkombëtare, informacionet dhe të dhënat e ndryshme lidhur me veprimtarinë e personave dhe të grupeve të ndryshme kriminale dhe terroriste.

Nënshkrimi dhe aderimi në marrëveshjet ndërkombëtare nga ana e shteteve ka mundësuar që agjencitë e zbatimit të ligjit, më konkretisht, ato policore, të përgatiten për sfida edhe më të mëdha në luftën e përbashkët kundër këtyre fenomeneve negative, që kanë kapluar shoqëritë bashkëkohore. Por objekt i marrëdhënies juridike të BNP janë

edhe instrumentet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, që merren me rregullimin e kësaj fushe në aspektin e sigurisë.

Edhe për Kosovën objekt kryesor i BNP janë sidomos marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, pasi në kushtet kur ajo ende nuk është anëtare e disa organizatave ndërkombëtare, këto janë të vetmet forma bashkëpunimi ndërkombëtar që mund të përdorin për momentin agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë për luftimin e kriminalitetit. Këto marrëveshje të bashkëpunimit ndërkombëtar konsistojnë në lidhjen e Kosovës me shtetet e tjera veç e veç, si edhe në lidhjen e saj me organizata të veçanta ndërkombëtare të sigurisë.

Caktimi i objektit të bashkëpunimit ndërkombëtar ka shumë rëndësi, sepse nëpërmjet tij do të realizohen komunikimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve të agjencive të sigurisë sipas problematikës dhe rastit që paraqitet. Prandaj zgjedhja e objektit duhet të bëhet e studiuar mirë, që bashkëpunimi të jetë sa më i frytshëm dhe rezultativ.

Natyrisht, këtu nuk mund të anashkalohen strukturat e shkëmbimit të informatave dhe vetë zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit. Edhe ato në vetvete janë një objekt i rëndësishëm i BNP.

Si aspekte të sferës metodologjike, si objekt i BNP mund të radhisim këtu edhe dokumentet që burojnë nga organet qeveritare, ligjet, rregulloret, statutet, udhëzimet administrative, strategjitë kombëtare dhe aktet tjera nënligjore që lidhen me fushën, si edhe librat apo artikujt akademikë që trajtojnë bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Të gjitha këto duhen njohur dhe studiuar, ndaj përbëjnë një objekt të rëndësishëm.

Edhe anketimet, intervistat me zyrtarët e strukturave policore, pyetësorët, aktet dhe analiza të ndryshme që bëhen për impaktin strategjik të BNP në aspektin vendor,

rajonat dhe global, janë objekt i kësaj veprimtarie, që duhen vlerësuar si shumë të rëndësishme për mbarrëvajtjen e BNP.

Të gjitha këto elemente që përmendëm si objekte të BNP, kanë vlera dhe rolet specifike të tyre. Ato jo vetëm duhen njohur mirë, por, për më tepër, duhen përdorur dhe duhen vënë në lëvizje në mënyrë të studiuar, në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, sipas rasteve konkrete dhe programeve të BNP.

Në sythin e mëposhtëm po shtjellojmë më hollësisht disa nga marrëveshjet ndërkombëtare, si objekti thelbësor dhe bazë e BNP.

2.6. Marrëveshjet ndërkombëtare - bazë e BNP

Më sipër argumentuam se marrëveshjet ndërkombëtare janë objekti themelor i bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Por, në ç'formë paraqiten ato?

Më së shumti, marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar mund të paraqiten në formë të tilla, si: traktate, konventa, rezoluta dhe akte të tjera normative të bashkëpunimit midis shteteve, të cilat kanë mbështetur dhe promovuar bashkëpunimin policor përmes proceseve, shkëmbimit të informatave, politikave dhe praktikave (Lemieux, 2010: 7).

Këto formë konkretizohen në bashkëpunimin midis dy ose më shumë shteteve. Në këtë kontekst njohim marrëveshje *shumëpalëshe* dhe marrëveshje *dypalëshe*.

Marrëveshjet shumëpalëshe

Shumica e traktateve shumëpalëshe, që përfshijnë më shumë se dy shtete, nënshkruhen nën kujdesin e organizatave ndërkombëtare, si OKB-ja, apo të organizatave rajonale, si KE-ja dhe BE-ja (UNODC, 2010).

Sipas paragrafit 1.6, Marrëveshje për bashkëpunim ndërinstitucional është “një marrëveshje ose memorandum i lidhur në emër dhe në bazë të kompetencave të ministrive apo të agjencive shtetërore dhe të institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës me institucionet dhe organizatat përkatëse të shteteve të huaja, që nuk lidhet në emër të shtetit dhe qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nuk është subjekt i ratifikimit”. Ky lloj i marrëveshjeve ka kryesisht karakter teknik (Ligji nr. 04/l-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare).

Në aspektin e luftimit të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar rëndësi të veçantë ka *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (UNTOC) dhe protokollet e saj*, si edhe *Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime (UNDOC)*.

Për sa i përket lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të **BE-së**, është **Këshilli i Europës**,⁴ ai që nënshkruan çdo vit disa marrëveshje mes Bashkimit Europian dhe vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare. Këto marrëveshje mund t'u referohen sektorëve të ndryshëm, përfshi bashkëpunimin dhe zhvillimin, ose mund të trajtojnë tema specifike me objekt bashkëpunimi në fushën e lirisë, të sigurisë dhe të ligjit.

Memorandume të bashkëpunimit konkret midis shteteve nënshkruhen, kryesisht, ndërmjet shteteve fqinje, të cilave kushtet dhe rrethanat në kufijtë e tyre u mundësojnë të bëhen zona të përshtatshme për aktivitete kriminale, si trafikim i qenieve njerëzore apo edhe kontrabandë (Instrumente Ligjore dhe Teknika të Luftës Kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Përballje Përvojash, 2007).

⁴ Këshilli i Europës ka gjashtë detyra qendrore, ndërmjet të cilave është edhe lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare mes BE-së dhe shteteve apo organizatave të tjera ndërkombëtare.

Në Kosovë, çështja e marrëveshjeve ndërkombëtare është rregulluar me normativën e brendshme ligjore, së pari, me Kushtetutën e Kosovës, si dhe me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare, në bazë të të cilave hapet rruga për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërnstitucionale.

Sipas nenit 3, paragrafi 1.5, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare, për këto lloj marrëveshjesh jepet ky përkufizim: është “një marrëveshje ndërkombëtare, përkatësisht, traktat i lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare në formë të shkruar, e rregulluar me të drejtën ndërkombëtare, pavarësisht nga emërtimi dhe nga përfshirja në një, dy apo më shumë instrumente të ndërlidhura”.

Kosova, tashmë, ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit policor dhe në çështjet e sigurisë me shtetet tjera, mbështetur në Ligjin Nr.04/l-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet dypalëshe

Marrëveshjet dypalëshe janë më të shpeshta dhe më të shumta në praktikë në bashkëpunimin midis shteteve në luftën kundër krimit të organizuar. Të gjitha shtetet kanë për këtë strategjinë dhe planet e tyre të veprimit dhe kanë nënshkruar posaçërisht marrëveshje me shtetet fqinje. Strategjitë e bashkëpunimit policor në mes të shteteve anëtare të BE-së, kanë rrënjët shumë mbrapa në krijimin e qëllimit të paqes, krijimit të prosperitetit dhe stabilitetit ekonomik në KEE (Hufnagel, 2013).

Marrëveshjet bilaterale, zakonisht, zhvillohen ndërmjet shteteve që kanë kufij të përbashkët, ndërmjet shteteve që kanë pasur dhe kanë lidhje historike të ngushta midis

tyre apo janë pjesë e një rajoni gjeografik të përbashkët. Struktura e bashkëpunimit e vendosur nga këto marrëveshje është e fokusuar në operacionet policore ose adreson një problem specifik të krimit, si trafikimi me narkotikë apo kontrabanda (Koenig & Das, 2001:4-5).

Në këtë drejtim rol të rëndësishëm ka luajtur edhe eliminimi i kufijve të brendshëm ndërmjet shteteve, siç ka ndodhur në BE, ku shtetet, tashmë, kanë krijuar tregje të brendshme të përbashkëta.

Aspekti social, kulturor dhe tradicional është, gjithashtu, një faktor i rëndësishëm, që në disa raste dikton formulimin e marrëveshjeve ndërmjet shteteve. Po ashtu, shtetet që kanë gjuhë të ngjashme, traditë ligjore dhe probleme kriminale të ngjashme lidhin midis tyre marrëveshje, të cilave domosdoshmërisht u ka prirë edhe janë nxitur nga vullneti dhe klima e mirë politike ndërmjet tyre (Koenig & Das, 2001: 6).

Marrëveshjet bilaterale, kanë shumë rëndësi. Mungesa e tyre nganjëherë ndikon negativisht jo vetëm për dy shtetet respektive, por edhe për rajonin e më gjerë. Kështu ka ndodhur që nismat të ndryshme rajonale kanë krijuar probleme dhe sfida, ngaqë në disa instanca, bashkëpunimi bilateral ka hasur në pengesa, për shkak të kushteve politike, siç ka qenë rasti mes SHBA dhe Meksikës (Deflem, 2001: 72).

Për sa i përket Kosovës, ajo pas vitit 2008, në rrafshin ndërkombëtar, ka lidhur marrëveshje bilaterale, më së shumti, me Shqipërinë. Kjo ka adhur edhe për faktin se liria e lëvizjes midis dy shteteve, ku banon një komb dhe ku flitet një gjuhë, ka krijuar rrethana që autorët e veprave penale të kalojnë lirshëm prej një shteti në shtetin tjetër, gjë që i ka bërë disi të vështirë identifikimin, kapjen dhe dorëzimin e tyre në organet e drejtësisë.

Ndërsa sa i përket shteteve tjera në raport me Kosovën si ato të rajonit edhe me gjerë vërehet një qasje pranuese dhe opinion pozitiv në bashkëpunimin e ndërsjell në çështje të sigurisë por në këtë fushë sidomos kur është në pyetje pjesëmarrja e institucioneve përfaqësuese të Republikës së Kosovës në organizatat dhe forumet ndërkombëtare policore gjithmon pengesë paraqitet fqinji verior i Kosovës që është Serbia e cila vazhdimisht bënë opstruksione dhe pengesa kur merrë pjesë Kosova.

2.7. Marrëveshjet e Republikës së Kosovës në fushën e BNP

Diktuar nga zhvillimet ndërkombëtare, nga nevojat e sigurisë, si dhe për arsye të vullnetit të shtetit më të ri për të luftuar kriminalitetin brenda dhe jashtë kufijve, qeveria dhe institucionet e Kosovës janë përfshirë aktivisht në bashkëpunim ndërkombëtar dhe kanë nënshkruar memorandume të ndryshme mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në sfera të ndryshme të sigurisë dhe të luftës së përbashkët në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.

Një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh ndërkombëtare për bashkëpunimin policor në fushën e sigurisë Kosova i ka nënshkruar, kryesisht, me shtete të ndryshme të Europës. Mund të themi se, duke filluar nga viti 2008 e deri tani MPB ka nënshkruar mbi 35 marrëveshje bashkëpunimi, kryesisht, në fushën policore (Raport nga Departamenti i Hetimeve i Policisë së Kosovës, 2014). Të tilla marrëveshje ajo ka arritur me Austrinë, Suedinë, Kroacinë, Turqinë, Bullgarinë, Shqipërinë, Maqedoninë, Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Çekinë, Estoninë, Norvegjinë, Slloveninë. Gjithashtu, ka lidhur marrëveshje me Francën, për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore; marrëveshje të sigurisë me Gjermaninë dhe një marrëveshje për luftimin e migracionit të parregullt me Hungarinë.

Është për t'u theksuar se funksionon në baza jo-formale edhe bashkëpunimi strategjik dhe operacional në fushën e zbatimit të ligjit, me vendet rajonit dhe vendet anëtare të BE-së.

Për sa i përket bashkëpunimit policor me vendet e rajonit, mund të pohojmë se me Shqipërinë dhe Maqedoninë ai konsiderohet i fuqishëm, ndërsa marrëdhëniet me Serbinë, përmes lehtësimit nga ana e BE-së, dhe ato me Bosnjë dhe Hercegovinën janë duke u përmirësuar.

Por duhet thënë se nuk mungojnë rastet, kur, megjithëse me disa shtete janë nënshkruar marrëveshje, ende nuk ka bashkëpunim konkret. Në mjaft raste të BNP, të hetuara nga njësitet e policisë, të dhënat kanë qenë të kufizuara dhe jo të plota, në aspektin kohor, pas vitit 2008, për shkak të mungesës së të dhënave dhe mungesës së data-bazës. Informacionet e ofruara janë jo të plota edhe për shkak të kufizimit të informacioneve dhe të diskrecionit për publikun.

Në vijim do të shqyrtojmë disa prej memorandumeve mbi BNP në luftimin e kriminalitetit mes Kosovës dhe shteteve tjera, si dhe rezultatet e arritura në fushën e luftimit të krimit.

Memorandum bashkëpunimi Kosovë-Shqipëri

Numrin më të madh të memorandumeve të bashkëpunimit në fushën e punëve të brendshme Republika e Kosovës, nga viti 2008 e në vazhdim, i ka me Republikën e Shqipërisë. Për këtë kanë ndikuar shumë faktorë të njohur që i lidhin këto dy shtete.

Përmendim këtu Memorandumin e nënshkruar më 25 shtator të vitit 2008, që kishte për qëllim fillimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet policive të dy vendeve për parandalimin e efektshëm të luftës kundër krimit në përgjithësi, krimit të organizuar,

terrorizmit, trafikut të drogave dhe lëndëve psikotrope, trafikut të qenieve njerëzore dhe pastrimit të parave. Në frymën e këtij memorandum u ngrit Komisioni i Përbashkët ndërmjet MPB të Kosovës dhe MPB të Shqipërisë, me qëllim hartimin e protokolleve të ardhshme në fushat me interes të përbashkët, si dhe përditësimin dhe operacionalizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Një tjetër memorandum është ai i bashkëpunimit policor ndërkufitar midis dy vendeve, dekretuar në janar të vitit 2010. Në bazë të tij, bashkëpunimi është rritur dhe janë shënuar rezultate konkrete në luftimin e krimit transnacional.

Këtu më poshtë po rendisim disa raste të bashkëpunimit midis policive të dy vendeve, bazuar në aq informacione sa na janë ofruar nga Policia e Kosovës, si dhe duke pasur parasysh sensitivitetin e tyre.

Rasti i koduar “*Trekëndëshi*” (2011), është zhvilluar në kuadrin e luftës kundër krimit të organizuar, për posedim dhe trafikim të substancave narkotike. Si rezultat, u arrestuan 6 persona dhe u konfiskuan 5 kg heroinë (Raport nga Policia e Kosovës, 2014).

Rasti i koduar “*Patkoi*” (2011), është hetuar po për trafikim narkotikësh, dhe u arrestuan 12 persona, prej të cilëve një shtetas turk, dhe u konfiskuan 17 kg e 150g substancë narkotike, që dyshohej e llojit heroinë, një sasi preparatesh për përzierje të substancave narkotike, 1 peshore, 1 mikser, si dhe 17.985 euro dhe dy vetura.

Rasti i koduar “*Unaza*” (2012), *Krim i organizuar, trafikim qeniesh njerëzore*. Në këtë operacion u zhvilluan hetime të përbashkëta me policinë e Shqipërisë dhe të Moldavisë. Autoritetet moldave erdhën në Kosovë në shtator të vitit 2012 dhe më pas iniciuan hetime në vendin e tyre. U identifikuan 22 viktima potenciale të trafikimit nga Moldavia dhe u arrestuan 12 persona shqiptarë të Kosovës. U kontaktuan edhe

autoritetet shqiptare, të cilët filluan hetime për falsifikim të dokumenteve zyrtare, si pasaporta dhe diploma universitare.

Rasti i koduar “**Era**” (2012), është hetuar në bashkëpunim me autoritetet policore të Republikës së Shqipërisë. Hetimet rezultuan me arrestimin e 3 personave të dyshuar dhe me konfiskimin e 109.00 kg marihuanë.

Një tjetër operacion i përbashkët i Policisë së Kosovës dhe i Policisë së Shqipërisë, i koduar “**Kokaina**“, u zhvillua në vitin 2014, gjatë të cilit u shkatërrua një grup kriminal dhe u sekuestrua një sasi e konsiderueshme droge, u arrestuan 4 persona në Kosovë, dhe 2 persona në Shqipëri, u sekuestruan substanca narkotike dhe prova të ndryshme materiale. Në kuadër të hetimeve u bënë kërkesa për masa të fshehta hetimore. U pranuan nga gjyqtari i procedurës paraprake urdhëresat përkatëse, të cilat kanë filluar të implementohen në funksion të hetimeve. Në mesin e vitit 2014, Prokuroria Speciale e Kosovës, pranoi informacionin nga Prokuroria për Krime të Rënda e Republikës së Shqipërisë, lidhur me disa dyshime se do të silleshin në Republikën e Kosovës nga disa të dyshuar nga Shqipëria 17 kg lëndë narkotike të llojit kokainë për t’u përpunuar dhe, në këmbim, do të merreshin nga Kosova 17 kg lëndë narkotike të llojit kokainë, që do të transportohej në Shqipëri. Ky operacion vazhdoi gjithnjë në kordinim mes Prokurorisë Speciale dhe hetuesve të Policisë së Kosovës me Prokurorinë dhe hetuesit e Shqipërisë. Si rezultat i hetimeve, në qershor të 2014, në pikën kufitare Vërmicë, në kufirin e Kosovës me Shqipërinë, nga policia e Shqipërisë (në territorin e saj), u ndalua një person i dyshuar, i cili transportonte 7 kg kokainë. Si pjesë e operacionit policor, në bazë të informatave, hetuesit e Policisë së Kosovës reaguan dhe bastisën në rajonin e Pejës një shtëpi, ku u gjetën pajisje që shërbejnë për matje, përzierje dhe paketim të substancës narkotike. Po u gjetën, në cilësi të provave

materiale, dhe u sekuestruan: 18 kg e 235 g kokainë, 5.955 kg prekursorë, 8 litra acid klorhidrik, 246 litra aëeton, 7 litra hidrokiselinë, pajisje laboratorike (mikserë, sita, korita, ventilatorë, llampa, dorëza, peshore etj.), 2 vetura, 3 armë dhe 18 fishekë 7.65mm, 1200 euro, 7.040 lekë shqiptarë, 65 Franga zvicerane, telefona celularë dhe prova tjera. Si të dyshuar për veprimtari kriminale të krimit të organizuar dhe për trafikim substancash narkotike, u arrestuan nga Policia e Kosovës 3 persona, prej tyre një femër shqiptare me shtetësi amerikane, dhe dy meshkuj shqiptarë të Kosovës. Si pjesë e këtij operacioni u realizua edhe një bastisje tjetër, me ç'rast u arrestua një person shqiptar i Kosovës, i dyshuar se ishte pjesë e këtij grupi kriminal. Në Shqipëri, në kuadër të këtij operacioni, si rezultat i hetimit të përbashkët dhe i shkëmbimit të informacioneve, u arrestuan 2 persona dhe u konfiskuan 207 kg e 360 g kanabis sativa, 22 kg e 323 g heroinë, 2.8 gr. kokainë, 22 bidona 25 litrash me aëeton, 6 armë zjarri dhe 929 fishekë, 143.000 euro, 3 automjete, 25 telefona celularë dhe prova të tjera të rëndësishme.


Në vitin 2015 u zhvilluan dy projekte të përbashkëta në vazhdimësi, “**Ballkani 2014**” dhe “**Porta**“, në bashkëpunim me Shqipërinë.

Rasti i koduar “**Penta**”, (2015) ishte për trafikimin e qenieve njerëzore dhe mundësim i prostitucionit. Hetimet e përbashkëta me policinë e Shqipërisë filluan pas shkëmbimit të informatave fillestare dhe ekzistimit të dyshimit të bazuar se disa persona rekrutnin vajza të reja nga Shqipëria dhe i dërgonin për të punuar në Kosovë, në lokale të ndryshme, me qëllim shfrytëzimi për prostitucion. Lidhur me këtë rast, u zhvillua një takim operacional mes dy policive. Në Shqipëri u arrestuan dy të dyshuar të grupit kriminal, ndërsa në Kosovë, gjashtë persona, prej tyre, pesë shtetas kosovarë dhe një

femër shtetase e Shqipërisë. Sipas autoriteteve në Kosovë, rasti vazhdon të jetë nën hetim.

Është konkluduar se niveli i bashkëpunimit ndërshtetëror varet nga efikasiteti i sistemeve të shpërndarjes në kohë të informatave të duhura. Megjithë ekzistimin e marrëveshjeve për bashkëpunim policor me Shqipërinë, Austrinë, Kroacinë, Francën e Maqedoninë etj., suksesi në Kosovë është i kufizuar, për shkak të mungesës së teknologjisë së avancuar. Për shembull, sistemi informativ për automjetet e vjedhura nuk është i lidhur dhe kjo kufizon performancën e policisë në këtë fushë (Reformat në Policinë e Kosovës, Forumi për Siguri, 2011:16).

Diagrami 1: Rastet e bashkëpunimit policor me Shqipërinë



Burimi: Raportet policore nga DHTN-DHTQNJ, Policia e Kosovës

Memorandume bashkëpunimi mbi organizimin e shërbimeve të përbashkëta të strukturave të policisë rrugore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës

Këto Memorandume të bashkëpunimit kanë nisur të nënshkruhen që nga viti 2010 dhe, tashmë, janë bërë tradicionale dhe vazhdojnë së funksionuari çdo vit. Përmes memorandumit për patrullim në akset rrugore të Shqipërisë, nga pala dërguese, respektivisht, njësitet policore të Policisë së Kosovës, dërgohen që të patrullojnë së bashku me ato shqiptare në territorin e Shqipërisë, për parandalimin e kundërvajtjeve administrative, për rritjen e efikasitetit të luftës ndaj humbjes së jetëve njerëzore në aksidente rrugore dhe për sigurinë rrugore të qytetarëve të të dyja vendeve, sidomos atyre të Kosovës, për shkak të frekuentimit të bregdetit shqiptar gjatë sezonit veror (Memorandumet e bashkëpunimit, 2010-2015).

Përmes këtij bashkëpunimi, ku oficerët e palës dërguese, pra, policët e Kosovës, nuk kanë kompetenca ekzekutive policore, realizohet edhe shkëmbimi i praktikave më të mira të policimit rrugor. Pala pritëse, ajo shqiptare, bënë vlerësimin e nevojës së vazhdimit të bashkëpunimit policor lidhur me dërgimin e përkohshëm të oficerëve të palës dërguese në Shqipëri gjatë sezonit turistik.

Bazuar në praktikat e policive të dy shteteve, gjatë pesë viteve të kaluara është nxjerrë një përfundim që një formë e tillë patrullimi rrit nivelin e sigurisë në qarkullimin rrugor dhe, njëkohësisht, ndihmon qytetarët kosovarë, që, në komunikim të drejtpërdrejtë me Policinë e Kosovës, të trajtojnë çështje që lidhen me sigurinë rrugore në akset rrugore të Shqipërisë, por edhe me çështje të tjera të natyrës kriminale.

Implementimi i memorandumit të bashkëpunimit policor, çdo vit nis në fillim të muajit korrik dhe përfundon në fund të gushtit. Realizimi i aktiviteteve të zyrtarëve policorë të Kosovës në Shqipëri është bërë me gjashtë turne, me nga tri patrulla

policore, për një periudhë dhjetëditore. Në bazë të një analize të nivelit të dyanshëm profesional, implementimi i Memorandumit vlerësohet të ketë arritur rezultate të larta. Aktivitetet bashkëvepruese, si kontrollimi i shpejtësisë, tejkalimet e ndaluara, transporti publik i udhëtarëve, pikat e kontrollit, asistime në aksidente rrugore, ku janë përfshirë vetura me targa të Republikës së Kosovës, asistencë ndaj personaliteteve të larta që kanë vizituar shtetin shqiptar, si dhe masa të tjera ndaj kundërvajtësve, zyrtarët policorë i kanë realizuar me korrektësi, brenda intervaleve të ndryshme kohore, në akset rrugore: Tiranë – Durrës – Golem, Tiranë – Kukës; Tiranë - Fushë Krujë; Milot – Kukës; Milot – Lezhë; Lezhë – Shkodër; Lezhë – Morinë etj.

Në lidhje me kundërvajtjet e shkaktuara nga qytetarët e Kosovës, në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit, pjesëtarët e Policisë së Kosovës nuk kishin rol ekzekutiv, megjithatë, gjatë qëndrimit në detyrë, policët e Kosovës asistonin policinë shqiptare. Si rezultat i këtij bashkëpunimi profesional, është arritur të krijohet një ambient më i sigurt për qytetarët dhe për përdoruesit e rrugës, që qarkullojnë në akset rrugore që lidhin dy vendet, duke ndikuar pozitivisht në parandalimin e ngjarjeve aksidentale me pasoja për jetën e qytetarëve dhe në reduktimin e akteve kriminale.

Shkëmbimi i informacioneve me shtetet e tjera, lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Në lidhje me rastet e trafikimit të qenieve njerëzore është rritur bashkëpunimi policor me shtetet tjera dhe numëri i shkëmbimit të informatave policore për çështje të rasteve transkufitare ndër vite.

Po sjellim këtu disa të dhëna të shkëmbimit të informatave të Drejtorisë për Hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore nga Policia e Kosovës, për rastet


transnacionale të trafikimit, si dhe për hetimet e përbashkëta me shtete të tjera, por nuk përfshihen në tërësi ato të vitit 2008, për mungesë të të dhënave statistikore dhe të mos funksionalizimit të mirëfilltë të njësive që janë marrë me këto çështje.

Nga pasqyra në vijim shihet se janë shkëmbyer gjithsej 125 informata lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore ndërmjet Kosovës dhe shteteve të ndryshme, kryesisht, të rajonit dhe të Europës.

Shikuar ndër vite, me Shqipërinë janë shkëmbyer 41 informata ose 28 %; me Serbinë, 16 informata ose 16.11 %; me Belgjikën, 12 informata ose 12.08 %; me Maqedoninë, 11 informata ose 11.07 %; me Malin e Zi, 9 informata ose 9.06 %; me Zvicrën, 9 informata ose 9.06 %; me Holandën, 5 informata ose 5.03; me Gjermaninë, 8 informata ose 8.05 %; me Britaninë e Madhe, 6 ose 6.04%; me Moldavinë, 6 informata ose 6.04 %; me Italinë, 5 informata ose 5.03 %; me Suedinë, 5 informata ose 5.03 %; me Ukrainën, 3 informata ose 3.02 %; me Kroacinë, Sllovakinë, Norvegjinë, Rumaninë, Austrinë, Çekinë, SHBA, EBA, Turqinë, Francën dhe Islandën me nga 1 informatë ose 1.01 %.

Nga kjo analizë mund të vërehet se ka pasur rritje të shkëmbimit të informatave ndër vite me shtetet tjera dhe se numrin më të madh prej tyre e përbëjnë ato me Shqipërinë.

Diagrami 2: Shkëmbimi i informacioneve me shtetet e tjera



Burimi: Raportet policore, DHTQNJ, Policia e Kosovës

Memorandum i bashkëpunimit mes Kosovës dhe Austrisë

Ky është lidhur ndërmjet Ministrisë federale të Punëve të Brendshme të Republikës së Austrisë dhe MPB të Kosovës, për avancimin e bashkëpunimit dhe të ndihmës dypalëshe në luftën kundër krimit ndërkombëtar dhe përhapjes së tregtimit ilegal të drogave, të substancave psikotrope dhe lëndëve të para të drogave. Më konkretisht, kjo fushë e bashkëpunimit përfshin luftën kundër: mbjelljes ilegale, prodhimit, importit, eksportit ilegal, transportit dhe tregtimit ilegal të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe lëndëve të para të drogave, kundër terrorizmit ndërkombëtar, si dhe formave të tjera të krimit të organizuar.

Bashkëpunimi realizohet përmes shkëmbimit të informacioneve të ndërsjella për të gjitha aktivitetet e kundërligjshme, përmes përkrahjes reciproke, realizimit të masave policore të kordinuara, ndihmës së ndërsjellë në luftën kundër migrimit ilegal, përmes shkëmbimit të përvojave lidhur me zbatimin e akteve ligjore, me parandalimin e krimit, si dhe me metodat, mjetet dhe teknikat e aplikuara të kriminalistikës.

Si formë tjetër e realizimit të këtij bashkëpunimi është paraparë edhe aktivizimi i oficerëve ndërlidhës, që kryejnë veprimtari informimi dhe këshillimi. Oficeri ndërlidhës nga Policia e Kosovës është atashuar në Austri në vitin 2014. Është me interes të theksohet se shkëmbimi i informacioneve midis palëve kontraktuese në kuadrin e Interpol-it mund të plotësohet në përputhje me legjislacionin kombëtar përmes kontakteve të shërbimeve direkte të specializuara (Memorandumi Austri-Kosovë, pas vitit 2008, pa datë). Si rezultat i bashkëpunimit janë inicuar dhe zhvilluar hetime të përbashkëta ndërmjet policive të dyja shteteve.

Rasti i koduar “*Tentativa*” (2012). Lidhur me të u zhvilluan hetime të përbashkëta disamujore me autoritetet austriake. Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të

Narkotikëve kreu një operacion policor në rajonin e Pejës, gjatë të cilit u kryen bastisje në gjashtë vende të ndryshme në komunën e Pejës, Klinës dhe Gjakovës, ku u arrestuan 3 persona dhe u konfiskuan, në cilësi të provave materiale: rreth 34 kg substancë narkotike, që dyshohej si heroinë, rreth 10 kg marihuanë, dy armë (1 armë e gjatë AK-47 dhe një pistoletë TT) dhe 217 fishekë të kalibrave të ndryshme.


Rasti i koduar “**Mekaniku**” (“JIT” - Joint Investigation Teams) në bashkëpunim me Austrinë. Deri tani janë arrestuar 11 persona dhe janë konfiskuar 222.500 kg marihuanë. Të dyshuarit janë pjesëtarë të një grupi që është marrë me trafikimin ndërkombëtar të narkotikëve, gjegjësisht, në Kosovë, Serbi, Shqipëri, Maqedoni, në Mal të Zi, Çeki, Gjermani, Zvicër dhe në Turqi. Me qëllim që të hetohej i tërë grupi i organizuar kriminal, doli e nevojshme që Policia e Kosovës të bashkëpunonte me policitë e këtyre shteteve. U realizua bashkëpunim ndërmjet Kosovës, Austrisë, Gjermanisë, Zvicrës dhe Shqipërisë dhe, me ekipe të përbashkëta hetuese, u zhvilluan disa operacione. Në fund të vitit 2013 u ndalua një person në një qytet të Kosovës, u arrestua personi dhe iu gjetën 44 kg marihuanë. Në prill të vitit 2014, në Austri nga policia vendase u sekuestruan rreth 88 kg marihuanë dhe u ndaluan 4 persona. Më 2014 u ndalua një person me një furgon dhe u sekuestruan 24 kg marihuanë. Në mesin e vitit 2014 u ndalua një autobus në pikën kufitare të Merdares dhe, pas kontrollimit, u sekuestruan 24 kg marihuanë dhe u arrestuan 2 persona të dyshuar.

Rasti i koduar “**Perëndimi**” (2014), në të cilin janë shkëmbyer informata dhe u zhvilluan hetime të përbashkëta me autoritetet e Republikës së Shqipërisë dhe të Austrisë. Pas hetimeve rreth gjashtëmujore, në vitin 2014, në rajonin e Pejës, saktësisht, në magjistralen Klinë-Pejë, u realizua operacioni “Perëndimi”, gjatë të cilit u ndalua një kamionçinë në lëvizje, e cila dyshohej se transportonte substancë narkotike. U arrestuan

3 persona të dyshuar dhe u konfiskuan rreth 115 kg substancë narkotike e dyshuar si marihuanë. Gjatë kontrollit, nga hetuesit policorë u vërejt se kamionçina ishte e modifikuar për transportim ilegal të substancës narkotike, e cila u gjend e fshehur në të. Në vazhdimësi të këtij operacioni policor, u bastisën edhe dy shtëpi me lokalet që kishin, dhe dy automjete, të cilat dyshohej se ishin përdorur nga personat e dyshuar në këtë aktivitet kriminal. Në cilësi të provave materiale u konfiskuan 115 kg marihuanë, një kamionçinë dhe dy vetura, një armë gjuetie dhe 645 Euro.

Në vazhdimësi të bashkëpunimit me shtetin e Austrisë, në vitin 2015 u zhvillua projekti operacional “**Perëndimi 2**”.

Diagrami 3: Bashkëpunimi policor me Austrinë



Burimi: *Raportet policore, DHTN, Policia e Kosovës*

Marrëveshje për bashkëpunim mes Kosovës dhe Hungarisë


Palët kontraktuese, në kuadrin e BNP në luftimin e kriminalitetit në të dyja vendet, sidomos të krimit të organizuar, të terrorizmit, të krimeve të lidhura me drogën, të trafikimit të qenieve njerëzore, të migrimit të jashtëligjshëm dhe të kontrabandës së paligjshme të personave, si dhe në interesin e tyre të përbashkët të sigurisë, janë marrë vesh që, përmes agjencive të tyre qendrore, të luftojnë në mënyrë efikase të gjitha format e kriminalitetit (Marrëveshja Kosovë-Hungari, 2009). Kjo u arrit përmes agjencive bashkëpunuese të palëve, për Policinë e Kosovës - Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit, ndërsa për palën hungareze - Qendra Ndërkombëtare e Bashkëpunimit për zbatimin e ligjit, e shtabit të policisë kombëtare. Autoritete të tjera janë edhe ato organet gjyqësore të të dyja vendeve, si gjykatat dhe zyrat e prokurorisë. Bashkëpunimi i palëve ka konsistuar në fushën e parandalimit, të zbulimit dhe të përndjekjes së veprave penale në bazë të ligjeve kombëtare të të dyja palëve. Bashkëpunimi për krimet ushtarake apo për krime politike është paraparë që të realizohet përmes kërkesave reciproke. Format e bashkëpunimit konsistojnë në shkëmbimin e informacioneve, siç janë paraparë në nenin 5 të marrëveshjes (Marrëveshja, 2009: neni 5).

Rasti i koduar “***Tisa***” - kontrabandim me migrantë. U arrestuan 6 persona, nacionalitetet e të cilëve janë shqiptar, serb, hungarez. Lidhur me këtë rast, ka pasur bashkëpunim ndërkombëtar me Hungarinë, kurse me Serbinë, bashkëpunimi është bërë përmes Hungarisë. Në këtë rast pati edhe viktimë, të cilat janë mbytur në lumin Tisa (Raportet nga Policia e Kosovës, ZIMP:2015).

Rasti i koduar “***Matrix***” (2013) - kontrabandim migrantësh dhe krim i organizuar. Për rastin, me nismën e shtetit hungarez u zhvillua një takim pune në

Hagë, në selinë e Europol-it, ku u vendos që të fillohen hetimet e përbashkëta. Autoritetet kosovare i filluan hetimet me autorizim të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, u zhvilluan hetime të përbashkëta me komponentin e EULEX-it dhe me disa shtete të BE-së, nën ombrellën e Europol-it. Gjatë hetimeve u aplikuan masat e fshehta të hetimit. Në fund të vitit 2013, DKKO së bashku me EULEX-in, pas hetimeve të përbashkëta disamujore, ndërmorën operacionin, gjatë të cilit u kontrolluan shtëpitë dhe objekte të tjera të të dyshuarve, u arrestuan 5 të dyshuar, njëri u arrestua në vitin 2014.

Diagrami 4: Bashkëpunimi policor me Hungarinë



Burimi: *Rapotet policore DHTN, Policia e Kosovës*

Memorandum i Bashkëpunimit mes vendeve - ILECU

Ky memorandum i bashkëpunimit është nënshkruar me rastin e konferencës përmbyllëse lidhur me projektin e bashkëpunimit policor, që kishte qëllim luftën kundër krimit të organizuar posaçërisht kontrabandën e narkotikëve dhe parandalimin e

terrorizmit (DET ILECUS II). Pjesëmarrëse në këtë konferencë ishin shtetet e rajonit të Ballkanit, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Serbia, Kroacia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe Austria.

Memorandumi u nënshkrua nga shefat e policive të këtyre vendeve, në nëntor të vitit 2012. Ai u arrit si rezultat i parimeve bazë të BE-së në fushën e zbatimit të ligjit dhe të politikave dhe prioritetëve të këtyre vendeve në inkuadrimin në strukturat eurointegruese dhe në harmonizimin e ligjeve të secilit vend me legjislacionin europian. Të vetëdijshëm për nevojën e bashkëpunimit në fushën kundër krimit të organizuar të trafikimit të narkotikëve, kundër terrorizmit, dhe të përkrahjes së këtyre vendeve në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar, u ra dakord që Ministria e Punëve të Brendshme e Austrisë të vazhdojë t'i mbështesë ato në forcimin e rolit të bashkëpunimit të ILECU-t dhe, në përputhje me memorandumin e mirëkuptimit të vitit 2009, të nënshkruar në Bërdo, të Sllovenisë. Fushat e bashkëpunimit përfshijnë, gjithashtu, mbështetjen dhe forcimin e nismatave të rrjeteve të ILECU-t, si mekanizma efikasë të bashkëpunimit, krijimin e urave të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të eksperiencave dhe të praktikave më të mira, mbështetjen e ushtrimeve të simuluar, forcimin e kapaciteteve hetuese në fushën rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit operacional, në shkëmbimin e informatave dhe në forcimin e kapaciteteve kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit të drogave, krimeve financiare dhe fenomeneve tjera negative. Kjo marrëveshje konsiderohet si bazë e bashkëpunimit të mëtejshëm në fushat e caktuara (Memorandum of Understanding, ILECU 2012:2-4).

Në vijim po japim disa nga rastet me bashkëpunim mes këtyre vendeve në fushën e luftës kundër krimit.

Rasti i koduar **‘Fortuna’** (2008). Lidhur me këtë rast, hetimet nisën pasi autoritetet policore të Sllovenisë kishin kërkuar ndihmë juridike ndërkombëtare nga Policia e Kosovës, lidhur me një grup të krimit të organizuar nga Kosova, i cili aktivitetin e zhvillonte në Kosovë dhe në disa vende të Europës. Vepra ishte krim i organizuar/ kontrabandim droge. Kërkesën për ndihmë juridike ndërkombëtare autoritetet sllovene e bënë përmes Interpol-it.

Rasti u hetua nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar. Fillimisht, qe një i dyshuar, por, më pas, hetimet u zgjeruan edhe për 6 të tjerë. Lidhur me këtë rast, pati bashkëpunim ndërkombëtar policor me Slloveninë, Italinë, Gjermaninë, Zvicrën, Shqipërinë, Çekinë dhe Maqedoninë. U mbajtën pesë takime të strukturave policore, në Kosovë, Slloveni, Gjermani dhe Maqedoni. Hetimet që u zhvilluan në Slloveni rezultuan me arrestimin e 12 të dyshuarve, të akuzuar për 200 kg heroinë, dhe të gjithë këta u dënuan në Slloveni. Në vitin 2008 u arrestuan edhe 2 të dyshuar sllovenë dhe 1 korrier droge, shqiptar nga Kosova. Të dyshuarit ishin të nacionalitetit slloven, boshnjak dhe shqiptar nga Kosova. Drogën e kishin shpërndarë, kryesisht, në Slloveni, Itali, Zvicër dhe në disa vende tjera.

Këtë grup e hetoi edhe Italia, me rastin e koduar **‘Gazolin’**, për të cilin realizuan me DKKO-n një operacion të përbashkët kontrolli në disa vende në Kosovë. Nacionaliteti i të arrestuarve është italian, shqiptar, kosovar dhe slloven. Në Gjermani u arrestuan 4 të dyshuar, të cilët u dënuan. Në Kosovë u arrestuan 5 persona, 3 shqiptarë të Kosovës dhe 2 nga Shqipëria. Ndërsa në Shqipëri u arrestuan 3 shtetas të Shqipërisë. Gjithsej, në rastin e koduar “Fortuna”, në bashkëpunim me shtetet e tjera, u arrestuan gjithsej 27 persona, të shtetësive të ndryshme (Burimi: Raport nga Policia e Kosovës).

Rasti i koduar **‘Pink’** (2011) - *Krim i organizuar, kontrabandim me migrantë*. Kosova, në këtë rast, ishte përdorur nga të dyshuarit si shtet tranzit për trafikim migrantësh nga Turqia, të cilët ishin, kryesisht, nga Siria dhe Libia. Në këtë hetim të përbashkët, fillimisht, nga Policia e Kosovës dhe EULEX-i u angazhuan së bashku me autoritetet policore të Sllovenisë dhe, më pas, Austria, Bosnjë dhe Hercegovina, Italia, Kroacia, Maqedonia, Turqia, Hungaria. Me këtë rast, në bashkëpunim me Europol-in u zhvilluan disa takime, si: në vitin 2011, në Lubljanë të Sllovenisë dhe në Trieste të Italisë; në vitin 2012, në Spielfeld të Austrisë dhe në Europol, në Holandë. Sllovenia kërkoi ndihmë juridike ndërkombëtare, përmes Ministrisë së Drejtësisë, në Prokurorinë Speciale të Kosovës. Të arrestuarit ishin të nacionalitetit shqiptar, turk, boshnjak, kroat, slloven, italian. Rasti është duke u gjykuar dhe dënimet ende nuk janë shqiptuar.

Në prill 2012 u organizua një operacion i përbashkët, ku u arrestuan 43 persona, katër prej tyre në Kosovë. Në dhjetor 2012 u organizua një tjetër operacion i përbashkët, gjatë të cilit u arrestuan 45 persona në Kroaci, B&H dhe në Slloveni, ndërsa në Kosovë 4 persona. Në total, deri në fund të vitit 2012, nga të gjitha shtetet e përfshira në këtë operacion u arrestuan 96 persona. Operacioni vazhdoi dhe në janar 2013 në Kosovë, ku u arrestua edhe 1 person. Në janar 2013 u zhvillua operacioni i tretë, ku u arrestuan 57 persona në shtetet tjera dhe 3 persona në Kosovë. Në total, deri në fund të janarit 2013, në të gjitha shtetet u arrestuan lidhur me këtë rast 157 persona. Ky operacion paraqet një nga operacionet më të suksesshme, në të cilat ka marrë pjesë në bashkëpunimin policor ndërkombëtar Policia e Kosovës. Ai ka ndikuar në luftimin e kriminalitetit në Kosovë, por edhe në rajon e më gjerë (Burimi: Raportet policore nga Policia e Kosovës).

Rasti i koduar **‘Kulla’** (2010). Hetimet u zhvilluan në bashkëpunim me policinë e Malit të Zi, me ç`rast u mbajtën dy takime të përbashkëta, njëri në Pejë dhe tjetri në

Podgoricë. Lidhur me këtë rast u arrestuan 2 persona dhe u konfiskuan rreth 20 kg heroinë. 11 kg heroinë u konfiskuan në pikën kufitare në Kullë, ndërsa 9 kg u konfiskuan në qytetin e Pejës. Për një person është lëshuar fletarrest ndërkombëtar (Raportet policore nga Policia e Kosovës, 2015).

Rasti i koduar “**Adoptim**”, 2015 - Trafikim i qenieve njerëzore /Adoptim i paligjshëm i fëmijës. Informacioni është pranuar nga autoritetet e Malit e Zi në fillim të vitit 2015. Si rezultat i shkëmbimit të këtyre informacioneve, janë kontaktuar autoritete policore britanike përmes ILECU-t dhe, njëkohësisht, janë filluar hetime të përbashkëta. U arrit që në Kosovë të arrestohet një i dyshuar, ndërsa në Britani u arrestuan 3 persona. Viktima e rastit u gjet në Britani dhe u vu nën kujdestari (Raportet policore nga Policia e Kosovës, 2015).

Rasti i koduar “**Kontrabanda**”, 2013 - *Kontrabandim migrantësh*. Lidhur me këtë rast janë zhvilluar hetime të përbashkëta dhe operacion i përbashkët me policinë e Kroacisë. Hetimet vazhduan duke aplikuar masa të fshehta hetimi. Në janar të vitit 2014 u ndërmor një operacion në tri vende të ndryshme në rajonin e Gjilanit. Ky operacion erdhi pas hetimeve të përbashkëta me autoritetet policore të Kroacisë, të zhvilluara ndaj një grupi personash të dyshuar se në vazhdimësi janë marrë me kontrabandim migrantësh nga Kosova përmes Kroacisë dhe që dërgoheshin në shtete të tjera të BE-së. Operacioni filloi dhe u zhvillua në të njëjtën kohë me autoritetet kroate. Me urdhëresë të gjykatës kompetente, janë kontrolluar tri vende, shtëpitë dhe objekte të tjera të 3 personave të dyshuar; u arrestuan nga Policia e Kosovës 2 persona të dyshuar, në rajonin e Gjilanit, dhe 1 nga Policia Kroate, në Zagreb. Gjatë kontrollit, si prova materiale, u sekuestruan kopje dokumentesh të ndryshme, që mund të përdreshin në procedurën e mëtejme penale. Personat e dyshuar, me vendim të Prokurorit kompetent,

u dërguan në qendrën për mbajtje. Lidhur me rastin, në muajin mars, përfunduan të gjitha autorizimet, prandaj konsiderohet se rasti ka përfunduar. Të arrestuar janë 3 persona (Raport policor nga Policia e Kosovës, 2015).

Rast tjetër i rëndësishëm i bashkëpunimit policor është **"Rando"**, 2014 - *Kontrabandim migrantësh*. Ky rast filloi pas shkëmbimit të informatave dhe pas disa takimeve operationale me policinë e Hungarisë, të Zvicrës, Francës dhe Austrisë, në Prishtinë.

Në pjesë e parë të vitit 2014 kishin filluar hetimet ndaj disa personave që dyshoheshin se në bashkëveprim kryenin veprën penale të kontrabandimit të migrantëve. Në këtë rast u aplikuan masat e fsheta të hetimit. Lidhur me hetimet e rastit, policia e Kosovës bashkëpunoi edhe me autoritetet policore të shteteve të tjera për shkëmbimin e informacioneve, si: Austri, Hungari, Francë dhe Zvicër. Në vitin 2014 u zhvillua një takim operacional në Kosovë, me zyrtarë nga pesë shtete të BE-së. Ndërsa në fund të vitit 2014 u ndërmor një operacion, sipas planit operativ **"Rando"**, gjatë të cilit u kontrolluan dymbëdhjetë vende të ndryshme në rajonin e Prizrenit dhe të Mitrovicës. U arrestuan 11 persona të dyshuar, të cilët, me vendim të prokurorit të çështjes, u dërguan për mbajtje. Në cilësi të provave materiale u sekuestruan kopje pasaportash dhe dokumente të ndryshme, të rëndësishme për procedurë, si një pushkë AK-47, një pushkë gjuetie, dy revole kalibrash të ndryshëm, 123 fishekë, 800 euro, dhe 21 telefona celularë. Ky rast u bart në vitin 2015.

Në Hagë, në fillim të vitit 2015, u mbajt një takim operacional me Europol-in, ku morën pjesë edhe zyrtarët e Policisë së Kosovës. U zgjeruan hetimet ndaj disa personave të tjerë të dyshuar dhe, në bazë të urdhërësive, u aplikuan masat e fshehta të hetimit. Me autoritetet zvicerane u shkëmbyen disa informata me vlerë për të gjitha

palët e përfshira. Një takim i dytë operacional u mbajt në Hagë, në vitin 2015, dhe u vendos të kryhet operacion policor i përbashkët në disa shtete të BE-së dhe në Kosovë, nën ombrellën e Europol-it. Ky qe një operacion i gjerë policor në tetë shtete të Europës, përfshirë edhe Kosovën. Me këtë rast, në Kosovë u arrestuan 4 persona të dyshuar dhe u kontrolluan dy vende, u sekuestrua një veturë, një telefon, një kartë telefonike *sim*, një kompjuter PC dhe një fletore me shënime të rëndësishme për rastin. Vlen të thuhet se, gjatë këtij operacioni, në të gjithë Europën u arrestuan 46 të dyshuar, përfshirë edhe ata në Kosovë. Gjatë operacionit në qendrën kordinuese në Europol është përfaqësuar edhe Policia e Kosovës. Edhe në këtë operacion të përbashkët morën pjesë shtetet: Franca, Gjermania, Zvicra, Austria, Çekia, Sllovakia, Hungaria dhe Kosova.

Rasti i koduar ‘**Adler**’, (2015) – *Krim i organizuar, trafikim qeniesh njerëzore – mundësim i prostitucionit*. Hetimet e përbashkëta filluan së bashku me Gjermaninë pas shkëmbimit të informatave të iniciuara nga DHTQNJ. Rasti është krim i organizuar dhe trafikim qeniesh njerëzore, ku dyshohet se të dyshuarit kosovarë që jetojnë në Gjermani rekrutnin vajza të reja kosovare dhe i dërgonin për të punuar në Gjermani, me qëllim shfrytëzimi për prostitucion. U bënë disa takime operationale mes dy policive, ndërsa në muajin dhjetor të 2015 hetuesit e DHTQNJ arrestuan në Kosovë 1 femër shqiptare kosovare për mundësim prostitucioni dhe për tentim trafikimi. Rasti vazhdon të jetë nën hetime të përbashkëta (Raportet policore nga Policia e Kosovës, 2015).

Rasti i koduar ‘**Roseti**’, (2015) - *Kontrabandë migrantësh*. Ky rast është në bashkëpunim me Gjermaninë, në kuadër të shkëmbimit të informatave. Në këtë rast u aplikuan masat e fshehta të hetimit. Përmes ILECU-t u shkëmbyen disa informata edhe me autoritetet e Sllovenisë. Nga autoritetet sllovene janë pranuar informatat kthyesë. Përmes zyrës së ILECU-t, janë shkëmbyer informata edhe me autoritetet e Gjermanisë.

Në këtë rast u arrestuan 4 persona. Edhe trafikimi ilegal i armëve është vepër që hetohet në bashkëpunim me shtete të tjera, por deri tani nuk ka pasur ndonjë rast bashkëpunimi, përveç disa shkëmbimeve të informatave, pa i trajtuar si raste.

Rasti i pakoduar, i hapur, në vitin (2011) “YWV”. Gjatë hetimit të rastit pati bashkëpunim policor me autoritetet zvicerane, maqedonase dhe me Europol-in. Në sajë të këtij bashkëpunimi, për rastin në fjalë u mbajtën disa takime të organizuara dhe të financuara nga Europol-i. Në këtë rast u identifikuan të dyshuarit dhe baza e tyre, ku falsifikoheshin dokumente të shteteve të ndryshme. Nga kjo pikë furnizoheshin thuajse i gjithë rajoni dhe Europa. Në këtë rast, në vitin 2012 u arrestuan në Kosovë 7 të dyshuar, në Maqedoni u arrestuan 27 të dyshuar, të gjithë të lidhur me të dyshuarit në Kosovë. Në Gjermani u identifikua Zyra Komunale, ku dyshohet se janë vjedhur dhe janë shitur 44 pasaporta gjermane të paplotësuara, të cilat u gjetën gjatë bastisjes në Kosovë. Gjithashtu, në Kosovë u identifikuan dy të dyshuar, të cilët kishin përdorur dokumente false të Finlandës për të marrë vetura me qira në kompani RentaCar dhe që nuk i kanë kthyer më, por i kanë shitur në Shqipëri. Lidhur me këtë, u kontaktuan autoritetet e Shqipërisë, të cilëve u ishte kthyer një veturë e marrë në RentaCar nga të dyshuarit dhe u bashkëpunua me autoritetet shqiptare për gjetjen e vendit ku ishin shitur veturat e vjedhura në Kosovë. Vlen të thuhet se dëshmitë elektronike të konfiskuara në rastin në fjalë janë ekzaminuar nga Europol-i.

Gjatë periudhës 2008-2012 janë shënuar edhe katër raste tjera bashkëpunimi ndërkombëtar, që kanë të bëjnë me dy lloje veprash penale: *Kontrabandim migrantësh* dhe *Falsifikim dokumentesh*. Si rezultat i bashkëpunimit policor në këto katër raste u arrestuan 44 persona (Burimi: Raportet e policisë kufitare, 2015).

Si rezultat i shkëmbimit të informatave në 2014, u zhvillua edhe rasti ku DHTN ka konfiskuar 2.563 kg kokainë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, u arrestua një person, shtetas kolumbian, me initiale M.R., i lindur më 23.04.1971, në Bogota Col/Colombiana-Kolumbi, ku edhe jeton, nr. i pasaportës AP 542943, e shtetit kolumbian. Nga zyrtarët e Doganës së Kosovës, më 16.04.2014, është njoftuar DHTN se në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” Prishtinë, me kompaninë ajrore “Turkish Airlines”, ka arritur pasagjeri/ i dyshuari M.R. Gjatë kontrollit të valixheve të personit në fjalë u gjetën shtatë paketime të ndryshme të substancave të dyshimta, me peshë 2563.72 gr (të cilat dyshohej se ishin kokainë). Të gjitha paketimet u gjetën të fshehura në valixhen e kompjuterit personal dhe në valixhen me rroba të të dyshuarit M.R. Atij iu konfiskua edhe një lap-top, i firmës “Dell“, ngjyrë të zezë, tri karta bankare të lëshuara në Kolumbi, dy rezervime të biletave “Dream travel“, të datës 12.04.2014, si dhe rezervimi për në hotelin “Parlament“, Prishtinë. Sipas raportit të pranuar nga Dogana e Kosovës (listë distribuimi), i dyshuari kishte deklaruar se dy valixhet me substancë të dyshuar narkotike atij ia kishte dhënë një person me emrin Viktor, në Kolumbi, i cili kishte kontraktuar punë në Kosovë si shef kuzhine.

Rasti i koduar “*Elenika*” - Operacion i përbashkët ndërkombëtar në kordinim të policive të shteteve Itali, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni dhe Austri. Më 21 tetor 2013, u bënë 117 bastisje në Itali, Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Kosovë, ku u arrestuan 71 persona të nacionaliteteve të ndryshme. Në Itali u konfiskuan 600 kg heroinë dhe 500 kg marihuanë, në Kosovë u konfiskuan 3 armë automatike, një armë me gaz. Këtij operacioni me karakter ndërkombëtar, që u zhvillua në tri vende, i paraprinë hetimet që nga viti 2009.


Rasti i koduar **‘Tranziti’** – Për këtë rast janë zhvilluar hetime të përbashkëta me katër shtete (Kosovë, Shqipëri, Itali, Zvicër). Operacioni rezultoi me arrestimin e 6 personave (3 në Zvicër dhe 3 në Kosovë) dhe me konfiskimin e 127 kg marihuanë (25 kg në Zvicër dhe 102 kg në Kosovë), 8000 euro dhe një veturë.

Janë duke u zhvilluar hetime të përbashkëta me hetuesit e Europol-it lidhur me një rast, që ka të bëjë me shumë shtete dhe me një grup kriminal, që përbëhet nga shtetas të ndryshëm. Është zhvilluar një takim i përbashkët në Qendrën e Europol-it, në Hagë, dhe komunikimet janë në vazhdimësi.

Rasti i koduar **“Trafikimi”** (2014), në bashkëpunim ndërkombëtar, kryesisht, me shtetin e Sllovenisë. U bashkëpunua ngushtë me autoritetet sllovene gjatë zbatimit të masave të fshehta edhe në shkëmbimin e informacioneve. Pasi autoritetet sllovene arrestuan të dyshuarin A.A. në Slloveni, me urdhër të Prokurorisë Speciale dhe Gjykatës themelore, departamenti për krime të rënda, më datën 09.07.2014, në Prizren, u kontrollua shtëpia e të dyshuarit A.A. Gjatë kontrollit, në një garazh të shtëpisë u gjetën të fshehura dy çanta me 9 paketime me marihuanë, me peshë të përgjithshme rreth 10 kg. Në Kosovë nuk u arrestua asnjë person.

Rasti i koduar **‘Izolimi’** – *Trafikim i qenieve njerëzore, Vendosje e skllavërisë* - Në këtë rast, hetime kanë iniciuar edhe autoritetet moldave. Informata erdhi nga Moldavia dhe veprimet hetimore u kryen në Kosovë, ku u identifikua viktima e trafikimit dhe u arrestua një i dyshuar shqiptar i Kosovës.

Diagrami 5: Bashkëpunimi policor me vendet e ILECU



Burimi: Raportet policore nga DHTN dhe DHTQNJ/Policia e Kosovës

Marrëveshje për bashkëpunim policor Kosovë - Maqedoni

Në frymën e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve fqinjësore bilaterale dhe me vullnetin e të dyja palëve për të dhënë kontributin për sigurinë e vendeve të tyre dhe për bashkëpunimin policor në Europë, Kosova dhe Maqedonia u morën vesh për

bashkëpunim në parandalimin dhe zbulimin e akteve kriminale në fushat e trafikimit të kundërligjshëm të drogave narkotike, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në luftën e krimit ndërkufitar, falsifikimit të dokumenteve, të kontrabandës së armëve, të formave të tjera të krimit dhe për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Kjo marrëveshje do të implementohej përmes shkëmbimit të informacioneve për të dyshuarit, për *modus operandi* e tyre, për raportimet në kohë, për operacionet ose veprimet në zonat kufitare.

Palët ranë dakord për krijimin e komisioneve të përbashkëta për të vëzhguar implementimin e marrëveshjes, të paktën, një herë në vit. Komisionet mund të krijojnë edhe grupe pune, që të bëhen aktivitete taktike për identifikimin e kanaleve të trafikantëve të qenieve njerëzore dhe të drogës. Ky bashkëpunim do të realizohet duke përcaktuar strukturat për bashkëpunim në luftën kundër krimit, duke hapur zyra të përbashkëta, duke përgatitur analiza të përbashkëta, si dhe duke kryer operacione të kordinuara në pika të përbashkëta kufitare dhe në zona të tjera. Gjithashtu, palët janë marrë vesh për trajnime dhe seminare të përbashkëta, për shkëmbimin e përvojave dhe të metodologjive, për zhvillimin e patrullimeve të përbashkëta dhe forma tjera. Kjo marrëveshje nuk ka datë të nënshkrimit, por është dekretuar më datën 21 janar 2010.

Rasti i koduar “*Glloboçica*” (2011, është iniciuar si rezultat i shkëmbimit të informatave me policinë maqedonase dhe ka filluar me hetime të përbashkëta kundër një grupi, i cili merrej me mbajtje në pronësi, nën kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Gjatë hetimeve rezultoi se këta persona shisnin armë dhe municione të llojeve të ndryshme, që dyshohej se ndodheshin në Kosovë dhe do të kalonin në Maqedoni. Personat e zbuluar u arrestuan nën dyshimin e bazuar se kanë

kryer veprën penale: furnizimin, transportimin, prodhimin, këmbimin dhe shitjen e paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 327, lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës. Me këtë rast, u konfiskua një sasi e konsiderueshme armësh dhe municionesh. Gjithsej, nga ky rast u arrestuan 3 të dyshuar (Raport nga Policia e Kosovës, 2015).

Rasti i koduar **“Harku”** (2011). Hetimet për këtë rast u zhvilluan në bashkëpunim me autoritetet maqedonase. U bënë shumë takime dhe biseda telefonike. I dyshuari kryesor, që kishte të bënte me rastin, ishte strehuar në Kosovë, për shkak se në Maqedoni kishte pasur fletarrest për trafikim të narkotikëve. Ai kishte vazhduar me këtë veprimtari edhe në Kosovë, ku dhe u inicua rasti nga Policia e Kosovës. Me të kuptuar se kërkohej nga autoritetet maqedonase, filloi bashkëpunimi, nga i cili u bë i mundur arrestimi i të dyshuarit, konfiskimi i rreth 2 kg heroinë, 6.2 g marihuanë dhe 3 kg substancë e dyshuar për kokainë, por që pas ekzaminimit laboratorik nuk rezultoi të ishte e tillë (shumica ishte lidokainë). Në këtë rast u lëshua fletarrest edhe për një të dyshuar tjetër, për bashkëpunim në kryerjen e veprës kriminale *Trafikim i substancave narkotike*.


Rasti i koduar **“Enigma”** (2012). Ky rast u hetua në bashkëpunim policor me Maqedoninë dhe rezultoi me arrestimin e 5 personave të dyshuar dhe me konfiskimin e 4.41 kg marihuanë.

Hetime të përbashkëta me Maqedoninë janë shënuar edhe në rastin e quajtur **“Shoqata”** për *Trafikim të qenieve njerëzore/punë e detyruar*. Informacioni u pranua nga autoritetet maqedonase dhe u bënë hetime të përbashkëta policore. Në Kosovë u arrestuan 6 persona (3 shqiptarë të Maqedonisë dhe 3 shqiptarë të Kosovës). Në këtë rast u identifikuan dy viktima shqiptare/kosovare.

Rasti i koduar **‘Terminali’** (2013) - *Kontrabandë me mallra, Falsifikim dokumentesh, Krim i organizuar*. Lidhur me këtë rast, në fillim të vitit 2013 është mbajtur një takim pune me autoritetet maqedonase, me qëllim hetimin e përbashkët të rastit. Hetimi u bë me aplikimin e masave të fshehta dhe si rezultat u kuptua se ishte duke u zhvilluar aktivitet kriminal. Në kordinim të plotë me PSRK u veprua në terren dhe u arrit të arrestoheshin 5 persona të dyshuar, të cilëve, pas ndalimit të tyre në një qytet të Kosovës, iu gjetën dhe iu konfiskuan mallra dhe medikamente të kontrabanduara nga Maqedonia në Kosovë.

Lidhur me këtë rast, mund të themi se ka pasur ngecje në bashkëpunimin me autoritetet maqedonase, pasi policia maqedonase nuk u tregua shumë e interesuar për bashkëpunim (Raport i DKKO, Policia e Kosovës, 2015).

Diagrami 6: Bashkëpunimi policor me Maqedoninë



Burimi: *Raportet policore DHTQNJ, Policia e Kosovës*

Deklaratë e përbashkët Kosovë-Francë

Rrjetet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe rrjete të tjera shfrytëzojnë hapësirat e mundshme për kontrabandë. Duke marrë parasysh interesat e Kosovës dhe të Francës, si dhe të partnerëve të tyre ndërkombëtarë dhe sidomos interesat e qytetarëve të tyre, veçanërisht, mbrojtjen e fëmijëve dhe të grave nga trafiqet ilegale dhe parandalimin e krimit të organizuar, dy vendet janë marrë vesh për një luftë të përbashkët kundër këtyre rrjeteve dhe për bashkëpunim në luftimin e rrjeteve të parregullta të migrimit dhe të rrjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Deklarata për këtë marrëveshje, e nënshkruar më 2009, konsiston, gjithashtu, në bashkëpunimin operacional policor edhe me policinë e EULEX-it në Kosovë, në forcimin e përpjekjeve të Kosovës në aspiratat e saj drejt Bashkimit Europian dhe, së pari, për krijimin e rrethanave për liberalizimin e vizave për shtetasit kosovarë.

Pjesë e kësaj deklarate është edhe shtojca që parasheh intershipet dhe trajnimet e zyrtarëve policorë në luftimin e krimit të organizuar, pjesëmarrjen në modulën e trajnimit tematik lidhur me luftimin e falsifikimit të dokumenteve dhe trajnimin për procedurat e kontrollimit të pasaportave biometrike (Deklarata e përbashkët, 2009). Qëllimi është luftimi i rrjeteve të parregullta të migrimit dhe të rrjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo do të arrihet përmes shkëmbimit të informacioneve, të personelit dhe të ekspertëve. Dy shtetet kanë rënë dakord për një varg fushash, ndër të tjera, për një program bashkëpunimi për teknikat e mbledhjes, për analizat dhe procesimin ligjor të inteligjencës, për mbrojtjen e viktimave dhe për luftimin e falsifikimit të dokumenteve. Implementimi i këtyre nismatave do të bëhet nga organet franceze, në kordinim me departamentin për bashkëpunim policor teknik ndërkombëtar.

Deri tani, Franca e ka mbështetur Policinë e Kosovës në disa trajnime dhe ka pasur disa shkëmbime të informatave për çështje me interes të përbashkët.

Memorandum i bashkëpunimit mes SHBA dhe MPB të Kosovës

Bazuar në nevojën dhe në dëshirën e Departamentit të Mbrojtjes së SHBA, por edhe të qeverisë së Kosovës për të shkëmbyer informata lidhur me sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, u pa i nevojshëm nënshkrimi i një memorandumi për shkëmbimin e informatave lidhur me identifikimin biometrik të individëve të dyshimtë që hasen në Kosovë.

Përmes këtij memorandumi, të nënshkruar më 24 shkurt 2012, bëhet e mundur që të ndalohen, të pengohen dhe të jepen përgjigje ndaj kërcënimeve të drejtuara kundër sigurisë kombëtare. Përmes tij, Departamenti i Mbrojtjes së SHBA dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës synojnë të mbrojnë vendet e tyre dhe të luftojnë terrorizmin. Gjithashtu, është mundësuar që të jepen informata, përmes të cilave, Departamenti i Mbrojtjes së SHBA i ka kthyer në formë raportesh të rregullta. Edhe MPB e Kosovës i kthen në baza të rregullta informatat lidhur me identifikimin biometrik në Departamentin e Mbrojtjes të SHBA. Për sa i përket qasjes në informata, Departamenti i Mbrojtjes nuk ofron informata rreth shtetasve amerikanë.

Shërbimet e parashikuara në këtë memorandum do të kryhen në një nivel të kontrolluar/mbrojtur/ vetëm për qëllime zyrtare, sensitive për zbatimin e ligjit/nivelit të kufizuar (Memorandumi i Bashkëpunimit, 2012.)

Shkëmbime të informatave janë duke u zhvilluar edhe me DEA-n, lidhur me tri raste: “Ballkani 2014”, “Porta” dhe “Klani”. Drejtori dhe shefi i Sektorit Qendror të DHTN kanë marrë pjesë në një takim në Kolumbi.

Duhet theksuar se SHBA është sponzorizuesi më i madh i Policisë së Kosovës, jo vetëm me pajisje dhe mjete, por edhe me trajnime në SHBA dhe në Kosovë.

2.8. Zhvillimi i bashkëpunimit policor në Kosovë gjatë periudhës së administrimit të Kombeve të Bashkuara, në vitet 1999-2008

Administrimi tranzitor i Kosovës sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ishte një masë, përmes të cilës, Kombet e Bashkuara u hapën rrugën institucioneve vendore për kompletimin e infrastrukturës ligjore dhe zhvillimin e kapaciteteve për luftimin e kriminalitetit në përgjithësi. Në bazë të kësaj Rezolute është rregulluar edhe baza ligjore e policisë së UNMIK-ut. Në paragrafin 11 (i) të saj janë vendosur kornizat dhe detyrat e Policisë civile të UNMIK-ut (CIVPOL), përfshirë vendosjen e ligjit dhe të rendit; si dhe përgjegjësia për çështjet që kanë të bëjnë me sektorin e sigurisë, respektivisht, themelimin e një force lokale të policisë (S/RES/1244-1999).

Në këtë aspekt, Policia e UNMIK-ut luajti rolin e saj në luftimin e kriminalitetit dhe pranoi të gjitha detyrat e zbatimit të ligjit, duke filluar nga patrullimet, hetimet, arrestimet, kontrollin e trafikut, kontrollin e kufirit të Kosovës, hetimet inteligjente e të tjera, duke u kujdesur, në të njëjtën kohë, për trajnimin e policisë lokale të emërtuar ‘Shërbimi Policor i Kosovës’ (SHPK) së bashku me OSBE-në (S/2000/177, 3 mars, 2000: 10). Në këtë fazë të organizimit, më 22 maj 2001, u riorganizua Shtylla e Parë e UNMIK-ut dhe u quajt “Policia dhe Drejtësia”. Qëllimi ishte plotësimi në një periudhë kalimtare i zbrazëtirës juridike, në mënyrë që të mos krijohet vakum institucional dhe të shmangej mungesa e rendit dhe e ligjit, të rritej siguria e qytetarëve, të miratoheshin

ligje dhe të krijoheshin institucione të qëndrueshme për luftimin, sidomos, të krimit të organizuar.

Roli i policisë së UNMIK-ut në luftimin e kriminalitetit në Kosovë në këtë periudhë ishte sipërfaqësor. Në disa raste ai ka kryer operacione të përbashkëta me KFOR-in, si në kontrollin për pasaporta false, në bashkëpunim me policinë kufitare, në kontrollimin e veturave dhe të dokumenteve, në konfiskimin e armëve dhe të municioneve, në zbulimin e migrantëve ilegalë etj. Duhet thënë se policia e UNMIK-ut që përbëhej me efektivë nga më shumë se 50 shtete, pati rezultate minimale në luftimin e kriminalitetit. Kjo ishte si pasojë e një vargu faktorësh, duke filluar nga standardet dhe praktikat e ndryshme që praktikonin këta zyrtarë policorë në vendet e veta e deri te sistemi jocilësor i raportimit, te mungesa e data-bazave cilësore, si dhe te ndikimet e ndryshme politike. Këta faktorë, shto edhe mungesën e infrastrukturës së duhur krijuan hapësirën e mjaftueshme që në Kosovë të mbinte embrioni i krimit të organizuar.

Me kalimin e kohës, UNMIK-u filloi të krijonte kapacitete dhe njësi të specializuara, por, në të njëjtën kohë, punoi për të krijuar edhe kapacitete të policisë vendore. Ai hyri në bashkëpunim me to në përballjen me krimin e organizuar. Gjithashtu, krijoi një strukturë të inteligjencës qendrore dhe rajonale, e cila do të vepronte në kuadër të policisë së UNMIK-ut. Në këtë qendër do të kontribuonin shtetet anëtare. Mbështetje për këtë ofruan Britania e Madhe dhe Irlanda Veriore, që dërguan ekspertët e tyre dhe dhanë mbështetje tjetër profesionale dhe logjistike. Por edhe disa shtete të tjera anëtare dhanë mbështetjen e tyre për këtë nismativë (S/2000/177, 3 mars 2000: 10).

UNMIK-u miratoi, gjithashtu, edhe bazën juridike për luftimin e krimit të organizuar përmes krijimit të rregulloreve, që krijuan hapësirë të nevojshme për një

luftë më efikase kundër disa formave të krimit të organizuar. Duke pasur parasysh se ndër aktivitetet negative që kishin marrë hov menjëherë pas luftës ishte krimi i organizuar, i cili ishte shfaqur në format e trafikimit të lëndëve narkotike, të qenieve njerëzore, të kontrabandës me migrantë, derivateve, cigareve e të tjera, u pa i nevojshëm miratimi i shpejtë i infrastrukturës ligjore. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në pajtim me autorizimin që iu dha në bazë të Rezolutës 1244 (1999) e KS të OKB-së, datë 10 qershor 1999, duke vlerësuar nevojën për parandalimin dhe luftimin e krimit në Kosovë, miratoi dispozitat e para në këtë fushë. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/22, e miratuar më 20 shtator 2001, “*Mbi masat kundër krimit të organizuar*” krijoi bazën për luftimin e tij dhe jep përkufizimin e krimit të organizuar. Në të thuhet:

Me “krim të organizuar” nënkuptohet kryerja e një “krimi të rëndë” nga një “grup i organizuar”, për të realizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfitime financiare ose ndonjë përfitim tjetër material: (UNMIK, REG/2001/22, 20 shtator 2001:1).

Gjithashtu, në këtë rregullore parashikohen dispozita me të cilat sanksionohen personat që kryejnë vepra penale të konsideruara si krim i organizuar, personat që ndihmojnë apo nxisin kryerjen e krimit të organizuar, si dhe personat që organizojnë, themelojnë dhe udhëheqin organizata kriminale (Latifi & Beka, 2013: 171).

Në këtë drejtim, masat e para u morën nga mesi i vitit 2002, kur, pas një shkëmbimi të letrave të Përfaqësuesit Special me ministrinë e Punëve të Jashtme maqedonase, i është mundësuar një paneli ndërkombëtar të gjyqtarëve në Kosovë të gjykojë një komandant të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për „krime” të kryera në IRJM

(S/2002/779, 17 korrik 2002: 4-5). Kjo ishte hera e parë që aplikohet kjo procedurë në Kosovë dhe që përbente një precedent të madh.

Ngaqë lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit po rritej, më 31 maj 2002 u nënshkrua një protokoll i bashkëpunimit policor me Republikën Federale të Jugosllavisë, me të cilin mundësohet shkëmbimi i informacioneve mes dy policive. Në këtë kohë kemi negociimet e para të UNMIK-ut edhe me autoritetet e Republikës së Shqipërisë dhe ato të Malit të Zi, për të nënshkruar protokolle të ngjashme të bashkëpunimit policor.

Gjatë kësaj periudhe, UNMIK-u dhe SHPK ndërmorën disa operacione për luftimin e kontrabandës, që rezultuan me sukses, përfshi edhe konfiskimin e një sasive të madhe cigaresh, derivatesh dhe alkooli në kufirin me Malin e Zi, si dhe të një sasive prej 20 milionë cigaresh gjatë një bastisjeje në komunën e Leposaviqit, në pjesën veriore të Kosovës (S/2002/779, 17 korrik 2002: 4-5). Krahas formave tjera të kriminalitetit, në Kosovë nisën të zbulohen edhe krime ekonomike dhe të korrupsionit, lidhur me të cilat u bënë disa arrestime dhe akuza për evazion, kontrabandë, pastrim parash dhe për mashtrime.

Një dispozitë tjetër juridike që rregullon aktivitetin në luftën kundër kriminalitetit në Kosovë është Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/4 “*Mbi ndalimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë*”, e cila hyri në fuqi më 12.01.2001. Përmes saj është mundësuar krijimi i një legjislacioni të veçantë për ndjekjen dhe ndëshkimin e autorëve të krimeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të veprave të tjera penale të ngjashme, si dhe për ndihmën në mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe të veprave të tjera penale të ngjashme (Rregullore e UNMIK-ut, 2001/4:1).

Në kapitullin e parë, te veprat penale dhe ndëshkimet, në nenin 1, paragrafi 1.1, seksioni ‘i’ jepet përkufizimi lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, ku thuhet:

“trafikimi me njerëz” do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi a pranimi i personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthitjes, keqpërdorimit të kompetencave ose të pozitës së dobët me anë të dhënies a të pranimit të pagesave ose të beneficioneve për të arritur pëlqimin e ndonjë personi që ka kontroll mbi një person tjetër me qëllim të shfrytëzimit: (UNMIK, REG/2001/4, 12 janar 2001: 1).

Në këtë rregullore u kushtohet vëmendje sanksioneve ndaj personave që merren me trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe procedurës hetimore dhe ngritjes së procedurës gjyqësore ndaj personave që kryejnë këto vepra.

Strukturat që merreshin me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit u plotësuan me dy komponente nga UNMIK-u. Krijimi i njësisë sensitive për hetime dhe operacione në departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut, në shkurt 2002, kishte për qëllim të ofrojë për KFOR-in dhe për Policinë e UNMIK-ut të dhëna ndjekjeje për krimin e organizuar, terrorizmin dhe çështje kufitare dhe t’i mbështesë këto me ofrimin e analizave për gjyqtarët dhe prokurorët e UNMIK-ut, (S/2002/436, 22 prill 2002: 5).

Më 18 mars 2002 u miratua Rregullorja tjetër e UNMIK-ut, ajo me nr. 2002/6, “*Mbi masat e fshehta dhe masat teknike të vëzhgimit dhe hetimit*”. Kjo kishte si qëllim përmirësimin e hetimeve penale dhe të luftimit të krimit të organizuar dhe të terrorizmit në Kosovë. Përmes saj përcaktohen këto masa: vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video; përgjimi i fshehtë i bisedave; kontrollimi i dërgesave postare; përgjimi i telekomunikimeve; përgjimi i komunikimeve përmes rrjetit kompjuterik; përdorimi i

mjeteve të gjurmimit apo pozicionimit; blerja e simuluar e ndonjë sendi; simulimi i ndonjë veprë të korrupsionit; hetimet e fshehta; matja e thirrjeve telefonike dhe zbulimi i të dhënave financiare (UNMIK,REG/2002/6, 18 mars 2002: 2).

Por disa studiues dhe qarqe të ndryshme kanë vlerësuar se të gjitha këto masa mund të shkelin të drejtat dhe liritë e qytetarëve të Kosovës. Ndërsa zyrtarë të UNMIK-ut vlerësuan se kjo rregullore është hartuar duke marrë parasysh standardet më të larta ndërkombëtare dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Krijimi i bazës ligjore i ka mundësuar UNMIK-ut që, krahas rritjes së kapaciteteve të policisë vendore, të bëjë edhe ndjekje dhe arrestime për armëmbajtje ilegale dhe për kalime ilegale të kufirit. Rezultatet nuk kanë munguar edhe në kontrollin e kufirit në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës, ku, si rezultat i ngritjes së profesionalizmit, është arritur të konfiskohen shumë dokumente false udhëtimi. Në vitin 2002, UNMIK-u që i suksesshëm edhe në luftimin e kontrabandës dhe në konfiskimin e derivateve që vinin nga Mali i Zi. Këto përgjegjësi në ruajtjen dhe kontrollin e kufirit u bartën tek UNMIK-u dhe SHPK-ja nga KFOR-i në fund të vitit 2002, me anë të një memorandumi.

Rregullore tjetër, që ka të bëjë me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe të formave të tjera të krimit dhe me krijimin e masave legislative për t'i nxitur dëshmitarët bashkëpunues në gjykatë, është: Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/21, "*Mbi dëshmitarët bashkëpunues*", miratuar më 20 shtator 2001. Përmes saj pritet që dëshmitarët bashkëpunues të ofrojnë dëshmi në gjykatë, me qëllim që të pengohen vepra të mëtejme penale të një personi tjetër dhe të shpien në konstatimin e së vërtetës në një procedurë penale. Me këtë bashkëpunim është e mundur që, nëse dëshmia vlerësohet nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë, mund të kalohet në ndjekjen e

suksesshme penale të autorëve të tjerë të një veprë penale (UNMIK,REG/2001/21, 20 shtator, 2001: 2).

Duke ditur se pastrimi i parave kërcënon zhvillimin ekonomik, sundimin e së drejtës, sigurinë, stabilitetin dhe kontribuon në krijimin e një klime të përshtatshme për krim të organizuar, korrupsion dhe terrorizëm, dhe për krijimin e një kornize ligjore për pengimin dhe zbulimin e të gjitha formave të pastrimit të parave dhe të aktiviteteve të ngjashme në Kosovë, UNMIK-u, më 5 shkurt 2004, miratoi Rregulloren Nr. 2004/2 *“Mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale”*. Sipas nenit (2), Qendra e Informimit Financiar themelohet në kuadër të Shtyllës së Policisë dhe Drejtësisë. Kjo Qendër autorizohet të pranojë dhe të analizojë raporte dhe informacione të përgatitura apo të ruajtura, që janë të siguruara për Qendrën nga organet e ngarkuara për zbatimin e ligjit, përfshi edhe Interpol-in ose çdo organ tjetër ndërkombëtar apo ndërqeveritar, institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, UNMIK-un ose KFOR-in. Gjithashtu, kjo qendër siguron të dhëna dhe raporte lidhur me analizimin për dyshimin e pastrimit të parave apo për financimin e aktiviteteve terroriste, të dhëna këto që i sigurohen në mënyrë vullnetare Qendrës, por edhe që gjenden publikisht, madje, edhe përmes bazës së të dhënave, që është në dispozicion në mënyrë komerciale.

Në pajtim me marrëveshjet, kjo Qendër ka këmbyer dhe ka kërkuar informacione nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit jashtë Kosovës, lidhur me dyshimin për pastrimin e parave apo për financimin e aktiviteteve terroriste. Përmes mbledhjes së këtyre të dhënave statistikore ajo u ka bërë rekomandime ministrit të Financave, atij të Ekonomisë, zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Drejtësi, drejtorit të Departamentit të Drejtësisë, policisë dhe Shërbimit të Doganave në Kosovë, lidhur me masat që mund të ndërmerren dhe me

ligjet që mund të miratohen për luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të aktiviteteve terroriste (UNMIK, REG/2004/2, 5 shkurt 2004: 5).

Në vazhden e konsolidimit me personel të profesionalizuar dhe të specializuar, është themeluar edhe Njësia e Hetimit të Trafikimit dhe Prostitucionit (TPIU), që në vjeshtë të vitit 2000 evoluon në një departament të specializuar, i cili u bë funksional vetëm në vitin 2002. Po ashtu, u ngrit Njësia Qendrore Inteligjente (CIU), e cila në vitin 2001 zhvillohet më tej si Njësia Qendrore e Hetimeve Kriminale (CCIU), me autoritet dhe resurse të specializuara qendrore hetimore, për të siguruar inteligjencën dhe kapacitetin e duhur për operacionet e krimit të organizuar (Saint Group, 2007: 15).

Për të plotësuar kapacitetet dhe për t'i ndihmuar UNMIK-ut, në vitin 2001 u krijuan edhe njësi tjera të specializuara për të hetuar krimin e organizuar. Kështu, në këtë kohë u themelua Byroja e Kosovës për Krim të Organizuar (KOSB), e cila, me kalimin e kohës, erdhi duke u profesionalizuar dhe, në të njëjtën kohë, u furnizua me pajisje teknike dhe me personelin e nevojshëm. KOSB ka bashkëpunuar me forca të zbatimit të ligjit edhe jashtë vendit, siç ka qenë rasti me Nisativën Policore për Bashkëpunim të Europës Juglindore dhe me Interpol-in (S/2002/1126: 5).

Nuk mund të lëmë pa përmendur këtu edhe Njësinë për Personat e Zhdukur, të krijuar në nëntor 1999, si një qendër kordinuese dhe mbledhëse për të hetuar për personat e zhdukur (Saint Group, 2007:15), si dhe Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, që u iniciua në vitin 2001. Ai ka të bëjë me mbrojtjen dhe me bashkëpunimin me shkelësit, lidhur me deklarin e tyre për krimin e organizuar. Mund të themi se në këtë fushë kishte ende ngecje, për shkak të burimeve të kufizuara dhe të vullnetit jo të mjaftueshëm të dëshmitarëve.

Në fillim të vitit 2003, UNMIK-u kërkoi asistencë nga shtetet anëtare të OKB-së që t'i pranojë dëshmitarët në programet nacionale të mbrojtjes së dëshmitarëve (Saint Group, 2007: 15). Ndërsa në Policinë e Kosovës, Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve është themeluar në vitin 2012. Ajo është duke u zhvilluar dhe duke u plotësuar me personel.

Një hap përpara u shënuar edhe me nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit të UNMIK-ut me Interpol-in, me Shqipërinë, me IRJM dhe me Serbinë, me qëllim mundësimin e bashkëpunimit policor. Ndonëse në këto bashkëpunime janë shfaqur vështirësi të natyrës politike, rezultatet në luftën kundër krimit të organizuar nuk kanë munguar. Në vitin 2003 një operacion i kryer me bashkëpunim rajonal policor ndërmjet UNMIK-ut-Interpol-it dhe policive nga Serbia, Mali i Zi dhe IRJM, kundër krimit të organizuar dhe trafikeve, rezultoi me sukses (Saint Group, 2007: 15).

Sipas statistikave, nga mesi i vitit 2004, zyrtarët e SHPK-së u integruan në njësitet e specializuara hetimore, përfshi edhe Njësinë e Hetimeve kundër trafikimit dhe prostitucionit, e cila përfshinte afro 50% të njësisë: 21 pjesëtarë SHPK, 25 ndërkombëtarë; Byroja e Kosovës kundër Krimit të Organizuar: 11 pjesëtarë SHPK, 76 ndërkombëtarë, Njësia për zbatim kundër drogave: 22 pjesëtarë të SHPK, 17 ndërkombëtarë dhe Njësia Qendrore e Hetimeve Kriminale: 2 pjesëtarë të SHPK, 57 ndërkombëtarë (Saint Group, 2007: 15).

Në vazhden e bashkëpunimit me organizatën policore më të madhe në botë, Interpol, lidhur me intensifikimin e bashkëpunimit policor, UNMIK-u nënshkroi një memorandum mirëkuptimi, i cili hapi rrugën e bashkëpunimit dhe të luftimit të kriminalitetit në Kosovë në atë periudhë. Këtë memorandum do të shqyrtojmë më hollësisht më poshtë, për të parë format e bashkëpunimit ndërkombëtar me Interpol-in.

Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet INTERPOL-it dhe UNMIK-ut

Ky memorandum është lidhur në fushën e bashkëpunimit në parandalimin e krimit dhe në fushën penale. Ai shënon formën e parë të bashkëpunimit për luftimin e kriminalitetit në Kosovë dhe jashtë saj. Me këtë marrëveshje merret në konsideratë apo i paraprihet marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Interpol-it dhe Kombeve të Bashkuara, në vitin 1997, që ka pasur për synim fushën e hetimeve dhe çështje tjera që lidhen me policinë, me misionet paqeruajtëse dhe me operacione të ngjashme.

Qëllimi i këtij memorandumi është vendosja e kornizës së bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e parandalimit të krimit dhe të drejtësisë penale, përfshirë edhe shkëmbimin e informatave, publikimin dhe rrjedhjen e njoftimeve, transmetimin e difuzioneve, qasjen në databazën dhe në rrjetin e telekomunikimeve të Interpol-it (Memorandumi Unmik-Interpol, 2002).

Për sa i përket fushës së shkëmbimit të informatave dhe atyre policore, palët janë marrë vesh që ato të bëhen në pajtim me rregullat dhe me procedurat e Interpol-it. Në këtë drejtim, Interpol-i e ka mbështetur UNMIK-un në qasjen ndaj databazës dhe në rrjetin e telekomunikimeve të Interpol-it, dhe qasja e UNMIK-ut është bërë në pajtim me apendiksin e Memorandumit të Mirëkuptimit.

Lidhur me modalitetet e bashkëpunimit, është caktuar një pikë kontakti në policinë e UNMIK-ut që t'i kryejë detyrat në mënyrë normale dhe funksionale sikurse është e paraparë në Byrotë Qendrore Nacionale të shteteve anëtare. Komunikimi ndërmjet UNMIK-ut, Sekretariatit Qendror të Interpol-it dhe Byrove Qendrore nacionale të shteteve anëtare, është bërë, si rregull, përmes pikës së kontaktit të UNMIK-ut, duke rënë dakord që të shkëmbejnë të dhëna në interes të përbashkët të palëve.

Gjithashtu, sipas memorandumit, UNMIK-u kishte të drejtë të merrte pjesë në Asamblenë e Përgjithshme vjetore të Interpol-it, në konferencat rajonale europiane të organizuara nga Interpol-i, në kapacitetet e ashtuquajtura vëzhguese (Memorandumi Unmik-Interpol, 2002).

Publikimi dhe rrjedhja e njoftimeve të Interpol-it i jep të drejtë UNMIK-ut të kërkojë nga Sekretariati i Përgjithshëm i Interpol-it që t'i publikojë dhe t'i shpërndajë të gjitha llojet e njoftimeve, përfshirë edhe njoftimin **e kuq**, subjekt nga kërkesat që bëhen sipas nenit 5.2 të Memorandumit. Aplikimi nga UNMIK-u për njoftimet e kuqe të Interpol-it për persona të akuzuar për kryerje të krimeve në kuadër të jurisdiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare për krime në ish-Jugosllavi, duhet të jetë në përputhje me procedurat që janë në fuqi në kohën e aplikimit ndërmjet Interpol-it dhe Gjykatës Ndërkombëtar për krime në ish-Jugosllavi (ICTY). Njoftimet e lëshuara nga Sekretariati i Përgjithshëm i Interpol-it, të kërkuara nga shtetet anëtare të Interpol-it, kanë qenë të disponueshme për UNMIK-un.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve dhe interpretimeve të memorandumit zgjidhen me negociata dhe me mirëbesim ndërmjet palëve.

Ky memorandum hyri në fuqi me nënshkrimin e tij në mesin e dhjetorit të vitit 2002, për misionin e UNMIK-ut në Kosovë, nga zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara për Polici dhe Drejtësi, z. Jean Christian Cady, dhe z. Ronald K. Noble, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Policisë Kriminale Ndërkombëtare - Interpol.

Memorandumi ishte parashikuar të vlente në kohëzgjatje për aq sa do të ishte mandati i UNMIK-ut në Kosovë.

2.9. Zhvillimi i BNP në Kosovë pas vitit 2008

Në vitin 2008, kur Kosova shpalli Pavarësinë, institucionet vendore të sigurisë kanë qenë të përgatitura pjesërisht për marrjen e të gjitha përgjegjësiave në fushën e sigurisë, në luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit. Fusha e BNP deri në këtë vit ishte domeni në kompetencë të autoriteteve të UNMIK-ut, duke u mbuluar nga Zyra për Ndërlidhje me Institucionet Vendore dhe Ndërkombëtare, në të gjitha komunikimet me autoritetet vendore dhe të huaja brenda në Kosovë dhe me shtete tjera. Konstatohet që në vitin 2008 janë regjistruar 581 shkresa të sferës së BNP, që janë shkruar për transmetim brenda, dhe 198 shkresa ekskluzivisht jashtë Policisë së Kosovës (Raporti vjetor, 2008:6).

Nga autoritetet e Kosovës, kjo fushë nisi të mbulohej dhe të zhvillohej gradualisht me plotësimin e kapaciteteve vendore. Me kalimin e kohës, pas vitit 2008, u fillua me projektin ILECU, si nevojë për t'iu përshtatur rrethanave dhe zhvillimeve rajonale. Me ndryshimin e strukturës së brendshme të policisë lindi nevoja e përfshirjes së Zyrës së Interpolit, Zyrës së Europolit dhe të Frontex në kuadrin e Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatim të Ligjit (Struktura e brendshme e Policisë së Kosovës e miratuar nga ministri i MPB i Republikës së Kosovës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë më 17.05.2012).

Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatim të Ligjit - ILECU - Kosovë

Për të forcuar BNP dhe në pamundësi të anëtarësimit të Kosovës në Organizatat Ndërkombëtare Policore, është parë e nevojshme që, krahas përpjekjeve të institucioneve të brendshme për anëtarësim, me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj, të mbajtur më 2 mars 2011, miratoi

vendimin për themelimin e Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatim të Ligjit (Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.04/02, dt.02.03.2011 <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/>, Vendimet e mbledhjes së dytë të Qeverisë 2011.pdf)⁵, njësi që do të jetë funksionale në kuadër të Policisë së Kosovës. Në kuadër të kësaj njësie do të përfshiheshin zyrat e INTERPOL-it, EUROPOL-it, EUROJUST-it dhe FRONTEX-it. Si qëllim të saj primar njësia ka kordinimin e aktiviteteve mes agjencive të zbatimit të ligjit, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Pas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, të nënshkruar nga institucionet, ILECU bëri hapjen zyrtare të tij, më 22 qershor 2011. Megjithatë, ai kishte filluar edhe më herët veprimtarinë, duke marrë pjesë në konferencat rajonale, si Konferenca e Dytë Rajonale, zhvilluar në Zarë të Kroacisë, në maj 2011. Pas hapjes zyrtare të tij, ILECU ka marrë pjesë rregullisht në Konferencën e Tretë, të zhvilluar në Beograd të Serbisë, në tetor 2011, si dhe në Konferencën e Katërt Rajonale, të zhvilluar në Prishtinë, në kuadër të projektit DET ILECU II.

Themelimi i kësaj njësie më pas u shoqërua nga një Marrëveshje Bashkëpunimi, që u nënshkrua nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Shtetit dhe Ministria e Financave (ILECU 2011). Kjo u bë, duke pasur parasysh edhe përvojën e të gjitha shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor, të cilat, kur e kanë krijuar ILECU-un, e kanë bërë edhe këtë marrëveshje, ngaqë kjo e bën shumë më të lehtë edhe

⁵ Kjo njësi është themeluar me vendimin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, vendim nr.04/02 dt.02.03.2011. Me aprovimin e strukturës organizative të Policisë së Kosovës dt. 17.05.2012, kjo njësi është fuqizuar në Drejtori, në kuadër të zyrës së zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për Operativë, duke marrë parasysh rolin e saj në fushën e BNP, prioritetin që i është dhënë dhe vlerësimin nga ana e drejtuesit të lartë të policisë (Struktura Organizative e Policisë së Kosovës 17.05.2012).

lidhjen e marrëveshje të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare (Memorandumi i Mirëkuptimit, 2011:2-5).

Me këtë marrëveshje secila ministri obligohet të caktojë një pikë kontakti për komunikimin mes tyre. Si rrjedhojë e kësaj, tashmë, ka takime të rregullta mujore mes Drejtorisë së ILECU-t, Prokurorisë, Agjencisë për Mbikëqyrje të të dhënave personale, Doganës, Agjencisë Tatimore të Kosovës, Njësisë së Inteligjencës Financiare, IPKO-s, Postës së Kosovës, MPB, MPJ etj. (Revista e Policisë së Kosovës - Mbrojtësi, 2012).

ILECU-u, përmes takimeve, që financohen nga Komisioni European, njihet në praktikë me secilën strategji të shtetit tjetër. Detyrë kryesore e kësaj drejtorie është të japë rekomandime sesi duhet vepruar, çka duhet bërë në të ardhmen. Në këto takime ajo formulon rekomandime për institucionet e tjera, bëhet njohja e pjesëmarrësve me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe me planet për të ardhmen.

Në kuadër të projektit DET ILECU II, Kosova ka hartuar edhe Strategjinë për periudhën 2013-2017. Kjo, në vetvete, përfshin edhe aderimin, përgatitjen për aderim në institucionet ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, si Interpol, Europol, Selec, Frontex dhe të tjera.

Sipas marrëveshjes, Drejtoria do të jetë funksionale për një ngritje optimale të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërinstitutional, shkëmbim të kordinuar të të dhënave në sferën ndërkombëtare dhe përmirësim të proceseve ekzistuese të punës (<http://www.psh-ks.net/repository/docs/ILECU.pdf>). Edhe bashkëpunimi në fushën e zbatimit të ligjit me vendet fqinje është përmirësuar pas vitit 2008. Kosova ka marrëdhënie të fuqishme me Shqipërinë, ndërsa me Maqedoninë në nivel më të ulët në bashkëpunimin policor, doganor dhe në bashkëpunimin kufitar, përfshirë patrullat e

përbashkëta, shkëmbimin e informatave dhe takimet e rregullta (<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2013:0066:FIN:EN:>)

Po në kuadër të ILECU-t është Procedura Standarde e Operimit (PSO), e cila përcakton punën rutinore të policëve që veprojnë në këtë drejtori. Një ndër prioritetet e ILECU-t është që të marrë pjesë në trajnime, të cilat do të ndikonin pozitivisht në zhvillimin e brendshëm të Policisë së Kosovës dhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit. Në bazë të statistikave të deritashme, që nga themelimi i ILECU-t e deri më 7 gusht 2013 janë trajtuar 6931 raste/informata nga kjo drejtori. Në vitin 2011 ka pasur 1326 raste/informata. Në vitin 2012 janë punuar 3373 raste/informata, ndërsa nga janari deri më 7 gusht 2013 janë shqyrtuar 2232 raste/informata (Raport nga Drejtoria-ILECU, 2013).

Në nëntor 2012 ILECU është emëruar pikë qendrore e kontaktit për gjurmimin e armëve. Gjatë kësaj periudhe janë bërë mbi 1200 verifikime të [në] prapaskenës për rastet kur qytetarët kanë kërkuar leje për armëmbajtje, si edhe disa gjurmime të armëve. Sipas Policimit të udhëhequr nga inteligjenca, ILECU është pikë kordinuese për shkëmbim të informacioneve të inteligjencës mes shteteve të tjera dhe Kosovës dhe anasjelltas. Si rrjedhojë e kësaj, janë arritur suksese, si: konfiskimi i 21 kg heroinë në një shtet të BE-së, në bazë të informacioneve të ofruara nga kjo drejtori etj.

Ekstradimi

Policia e Kosovës ka edhe njësitin e ekstradimit, i cili është funksional dhe, sa herë që kërkohet, ai angazhohet për të kryer detyrat e tij. Deri tani ky njësit ka realizuar dhjetëra ekstradime. ILECU, si pjesë e grupit të punës që merret me marrëveshjet bilaterale mes shtetit të Kosovës dhe shteteve të tjera, në mandatin e tij ka edhe

kordinimin e komunikimeve që ndërlidhen me Ministrinë e Drejtësisë dhe Njësitë operative të Policisë së Kosovës, si dhe me atë për asistimin mbi ekstradimin, transferimin dhe deportimin e shtetasëve tanë nga vendet tjera për në Kosovë dhe anasjelltas.

Më poshtë shtjellohen statistikat e ekstradimit në vitet 2013-2015 dhe llojet e veprave penale, të paraqitura në tabelë:

EKSTRADIMET – 2013

	Data e ekstradimit	Vepra penale	Nga	Në
	23.01.2013	Mashtrim	Gjermania	Kosovë
	27.01.2013	Falsifikim i dokumentit dhe mashtrim	Kroacia	Kosovë
	13.02.2013	Vrasje e rëndë në tentativë	Mali i Zi	Kosovë
	14.02.2013	Grabitje në bashkëpunim	Belgjika	Kosovë
	27.02.2013	Trafikim me narkotik	Kosova	Francë
	18.03.2013	Vjedhje e rëndë	Bullgaria	Kosovë
	15.05.2013	Vjedhje e rëndë	Shqipëria	Kosovë
	31.05.2013	Vjedhje e rëndë	Bullgaria	Kosovë
	03.07.2013	Trafikim narkotikësh	Gjermania	Kosovë
	04.07.2013	Vjedhje e rëndë	Kosova	Mal të Zi
	14.07.2013	Dhunim	Zvicra	Kosovë
	08.07.2013	Vjedhje me grabitje	Hungaria	Kosovë
	17.07.2013	Vrasje e rëndë	Gjermania	Kosovë
	09.09.2013	Rrezikim i trafikut publik	Gjermania	Kosovë
	10.09.2013	Rrëmbim/burgosje e paligjshme	Sllovenia	Kosovë
	17.09.2013	Vrasje në tentativë	Italia	Kosovë
	10.09.2013	Vrasje e rëndë	Suedia	Kosovë
	02.10.2013	Vjedhje e rëndë	Zvicra	Kosovë
	25.10.2013	Trafikim i qenieve njerëzore	Shqipëria	Kosovë
	25.10.2013	Trafikim i qenieve njerëzore	Shqipëria	Kosovë
	15.11.2013	Vjedhje e rëndë	Austria	Kosovë

Nr.	Shtetësia	Data e Transferimit	Vepra / Dënimi	Nga	Në
1	I panjohur	10.18.2013	Riatdhesim jo i rregullt	Kosova	Belgjikë

Table 1: Ekstradimet/transferimet nga Kosova në vitin 2013

EKSTRADIMET - 2014

Data e ekstradimeve	Vepra penale	Nga	Në
09.01.2014	Kontrabandim emigrantësh	Kroacia	Kosovë
01.04.2014	Vrasje	Kosova	Suedi
03.04.2014	Vjedhje e rëndë	Gjermania	Kosovë
03.04.2014	Vjedhje e rëndë	Zvicra	Kosovë
16.05.2014	Vjedhje e rëndë	Kosova	Maqedoni
20.05.2014	Vrasje	Kosova	Suedi
25.09.2014	Tentim për vrasje	Gjermania	Kosovë
22.09.2014	Krimi i organizuar (shitje narkotikësh)	Shqipëria	Kosovë
13.04.2014	Vrasje e rëndë	Suedia	Kosovë
10.10.2014	Vjedhje e rëndë	Mali i Zi	Maqedoni
13.10.2014	Veprime të panatyrshme seksuale	Zvicra	Kosovë
05.11.2014	Terrorizëm / Eksplozivë	Kosova	Maqedoni
12.11.2014	Trafikim narkotikësh	Shqipëria	Kosovë
18.12.2014	Tentim për vrasje të rëndë	Italia	Kosovë

TRANSFERIME

Shtetësia	Data e transferimit	Vepra / Dënimi	Nga	Në
	10.01.2014	Urdhërlargim	Kosova	USA
	12.01.2014	Vrasje/Vrasje në tentativë	Suedia	Kosovë
	22.04.2014	Urdhërlargim (Prezantim i rrejshëm)	Kosova	Serbi
	24.07.2014	Urdhërlargim pas vuajtjes së dënimit	Kosova	Shqipëri

DEPORTIMET

Shtetësia	Data e Transferimit	Vepra / Dënimi	Nga	Në
/	15.09.2014	Vrasje nga pakujdesia dhe armëmbajtje pa leje	Kosova	Shqipëri
/	03.10.2014	Trafikim lëndësh narkotike	Shqipëria	Kosovë

Table 2: Ekstradimet, Transferimet dhe Deportimet në vitin 2014

Statistikat e përgjithshme të ILECU-t për periudhën: nga 01.01.2015 deri me 31.12.2015.

EKSTRADIME, TRANSFERIME DHE DEPORTIME

Data	Vepra Penale	Nga	Në
22.01.2015	Mashtrim	Sllovenia	Kosovë
26.01.2015	Vrasje	Kosova	Maqedoni
13.03.2015	Vjedhje e rëndë	Suedia	Kosovë
27.03.2015	Vjedhje e rëndë	Shqipëria	Kosovë
09.04.2015	Trafikim narkotikësh, krim i organizuar	Kosova	Shqipëri
13.05.2015	Grabitje në bashkëveprim	Austria	Kosovë
15.07.2015	Person i zhdukur	Kosova	Mal të Zi
22.06.2015	Dhunim	Franca	Kosovë
03.08.2015	Narkotikë	Shqipëria	Kosovë
28.07.2015	Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë	Gjermania	Kosovë
10.08.2015	Vjedhje e rëndë	BIH	Kosovë
18.09.2015	Mashtrim	Mal i Zi	Maqedoni
15.09.2015	Armëmbajtje pa leje	Kroacia	Kosovë
18.09.2015	Lëndim i rëndë trupor	Kosova	Mal të Zi
19.09.2015	Qëndrim ilegal	Kosova	Gjermani
06.10.2015	Trafikim qeniesh njerëzore, sulm dhe pastrim parash	Kosova	Belgjikë
15.10.2015	Vjedhje e rëndë	Kosova	Maqedoni
15.10.2015	Trafikim narkotikësh	Maqedonia	Kosovë
05.11.2015	Krime lufte	Shqipëria	Kosovë
04.12.2015	Narkotikë	Shqipëria	Kosovë
07.12.2015	Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	BIH	Kosovë
18.12.2015	Shmangie nga tatimi	Shqipëria	Kosovë

Table 3: Ekstradimet, Transferimet dhe Deportimet në vitin 2015.

Brenda periudhës Janar/Dhjetor 2013 Drejtoria e ILECU-t ka rekomanduar (dhe në bazë të rekomandimit edhe janë marrë vendime) për mosndryshim të të dhënave personale për 84 persona; në vitin 2014 ishin gjithsej 70 persona, ndërsa në vitin 2015, për mosndryshim të të dhënave personale për 65 persona.

Të gjithë këta persona besoj se dëshironin që t'i ndryshonin të dhënat personale, me qëllim që t'u shpëtojnë sanksioneve, që u ishin shqiptuar nga ndonjë vend i BE-së (ndalesa në zonën Shengen).

Në vitin 2013 ILECU është përfshirë ose ka lehtësuar 17 takime operationale, që përfshinin 10 raste të bashkëpunimit ndërkombëtar me karakter hetimi të përbashkët dhe 2 operatione të përbashkëta të udhëhequra nga Europol-i (njëra kishte të bënte me narkotikë dhe tjetra, me autovetura).

Po në vitin 2013, ILECU mori pjesë në dy konferenca të organizuara në Hagë, të Holandës (njëra e organizuar nga Europol, tjetra nga UNODC). Po ashtu, ka pasur takim në Qendrën e Interpol-it, në Lion të Francës, ku është njoftuar për punën operationale. Nga dhjetori i vitit 2013 ka filluar puna për vendosjen e pasaportave të pavlefshme në data bazën e Interpol-it për dokumentet e humbura/vjedhura.

Bashkëpunimi dhe komunikimi me INTERPOL-in

Në aspektin praktik bashkëpunimi ndërkombëtar dhe komunikimi me zyrat kombëtare të Interpol-it në shtetet e tjera bëhet nëpërmjet Interpol-UNMIK. Kjo drejtori tani ka bashkëpunim shumë efikas me shtetet e Ballkanit Perëndimor, që veprojnë në kuadër të projektit ILECU (Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia dhe Sllovenia) ose edhe nëpërmjet atasheve policorë, që janë të akredituar në Kosovë (Shqipëri, Francë, Austri, Gjermani, Zvicër, në shtetet nordike dhe në Itali).

UNMIK-u ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Interpol-in që nga viti 2002 dhe funksionon si zyrë qendrore kombëtare, ndërsa në Interpol ka statusin e vëzhguesit në Asamblenë e Përgjithshme të Interpol-it. UNMIK-Interpol është e ndarë fizikisht me zyrë dhe komunikimi bëhet në linkun I /24/7 të UNMIK-ut dhe ata e vendosin se cilat informata janë për Policinë e Kosovës dhe cilat jo.

Momentalisht, në zyrat e Interpol-UNMIK janë të vendosur fizikisht 4 zyrtarë të UNMIK-ut, 7 të EULEX-it dhe 1 zyrtar i Policisë së Kosovës, i cili merret me krime që lidhen me automjete (Raport nga ILECU, 2014).

Policia e Kosovës nuk është pronare e informatave dhe, për pasojë, komunikimi kërkon kohë (në momentin që ka ndërmjetësim, atëherë kjo paraqet vonesë). Policia e Kosovës merr pjesë në konferencat e Asamblesë së Përgjithshme të Interpol-it, si në atë të vitit 2014 që u zhvillua në Monako; në konferencat e Interpol-it European (në maj 2015), në atë të shefave të Interpol-it european apo në ndonjë operacion të përbashkët, ku përdoren kanalet e Interpol-it. Në këto takime marrin pjesë edhe përfaqësues të UNMIK-ut.

Rastet që vijnë nga UNMIK-Interpol përbëjnë 40-42% të rasteve që ka në total ILECU. ILECU përdor në afro 60% të rasteve kanale të tjera komunikimi, ose zyrtarët ndërlidhës të Policisë së Kosovës të akredituar jashtë shtetit, ose zyrtarët e huaj të akredituar në Kosovë apo drejtpërdrejt ILECU-n. Duke e ditur se EULEX-it do t'i skadojë mandati në qershor të vitit 2016, ky i fundit ka financuar një projekt, ku dy ekspertë të fushave të teknologjisë informative dhe të mbrojtjes së të dhënave personale kanë ardhur në Kosovë dhe kanë bërë vlerësim të situatës në Policinë e Kosovës. Rekomandimi i tyre ishte që Kosova i ka kapacitetet njerëzore, teknike dhe ligjore që të lidhet me linkun e Interpol-it. Në prill 2015, Kosova ka aplikuar në Interpol dhe është në pritje të përgjigjes. Kosova i ka modalitetet e komunikimit me Interpol-in, edhe pse kërkohet që të lidhet marrëveshje strategjike dhe operacionale, sepse në këtë mënyrë Policia e Kosovës do të ishte pronare, llogaridhënëse dhe përgjegjëse për punën dhe për bashkëpunimin me këtë organizatë.

Bashkëpunimi dhe komunikimi me EUROPOL-in

EUROPOL-i ka një link të komunikimit me Kosovën përmes Deskut suedez. Ky desk është i vendosur në inteligjencën e EULEX-it. Në vitin 2014, Policia e Kosovës kishte gjithsej 6 raste të komunikimit me EUROPOL-in dhe, po ashtu, edhe në vitin 2015 kishte 6 raste. Në korrik të vitit 2015, në Policinë e Kosovës ishte një delegacion i EUROPOL-it, i cili ishte i interesuar që të shqyrtonte modalitetet e bashkëpunimit mes Kosovës dhe EUROPOL-it, meqë ishte planifikuar që EULEX-i të largohet nga Kosova në qershor të vitit 2016. Policia e Kosovës i propozoi këtij delegacioni që një zyrtar i Europol-it të vendosej në Kosovë ose një zyrtar i saj të vendosej pranë Europol-it. Ndërsa propozimi i delegacionit ishte që një shtet i BE-së të caktohej si ndërmjetës

derisa të tejkaloheshin problemet politike, por Policia e Kosovës kërkoi që ky shtet të caktohej nga ana e tyre, pasi, sipas përvojës së mëparshme, kur është komunikuar me shtete të treta, kjo nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara. Momentalisht, komunikimi zhvillohet duke ndjekur procedurën apo zinxhirin komunikues: Europol - Desku suedez në Eulex -Ipcu – Ilec - njësitë përkatës.

Ideja për një Marrëveshje Strategjike, e cila shtyn edhe për Marrëveshje Operacionale, sipas tyre do të realizohet pasi Komisioni European të japë lejen dhe ta vendosë emrin e Kosovës në listën e aprovuar për negociim.

Në vitin 2015, Policia e Kosovës bëri kërkesë për qasje në EPE (Europol Platform for Experts) në shumë lëmi dhe deri tani ka qasje në Mbrojtjen e dëshmitarëve, në Shenjat e gishtërinjve dhe Asset Recovery (pika e kontaktit për CARIN).

Komunikimi i Policisë së Kosovës me EUROPOL-in bëhet përmes një shteti të BE-së, që është Suedia dhe, nëse atashetë policorë të akredituar në Kosovë kanë qasje në çdo kohë në bazat e të dhënave në EUROPOL, komunikimi i Policisë së Kosovës me shtetet ku janë themeluar ILECU-t, është i drejtpërdrejtë.

Ndërlidhësit policorë

Roli i zyrtarëve ndërlidhës konsiderohet i rëndësishëm në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor (Den Boer, 2005:196). Të përfshirë në kuadër të politikave të jashtme të shteteve ata, zakonisht, janë të vendosur në ambasada, në konsullata apo në organizata ndërkombëtare. Sipas autorit Bigo, me rritjen e tregtisë së lirë dhe të lëvizjes së njerëzve, roli i tyre është crucial sepse ndërlidhësit janë ata që menaxhojnë kalimin e informatave ndërmjet agjencive të tyre (Bigo, 2006).

Në tetor 2012 u nënshkrua marrëveshja për dërgimin e zyrtarëve ndërlidhës të MPB në misionet diplomatike të Republikës së Kosovës, në të cilën parashikohet që përzgjedhja e ndërlidhësve policorë do të bëhet përmes një procesi konkurrimi brenda Policisë. Deri tani janë përzgjedhur 5 zyrtarë policorë ndërlidhës me shtetet e Bashkimit Europian dhe me Turqinë. Zyrtarët ndërlidhës janë dërguar në Bruksel, Berlin, Vjenë, Paris dhe në Ankara. Është planifikuar që në të ardhmen të ketë ndërlidhës policorë edhe në shtete të tjera. Sipas PSO-së, ILECU është i inkuadruar, mes të tjerash, edhe në përshkrimin e detyrave për zyrtarët ndërlidhës.

Procedura Standarde e Operimit (PSO) për ILECU-n

ILECU ka linjë të sigurt komunikimi me Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF) dhe komunikim të drejtpërdrejtë edhe me kordinatorët e prokurorive të ndryshme dhe të gjykatave të Kosovës. Komunikimi i kësaj agjencie të zbatimit të ligjit (apo i agjencive të tjera) është i drejtpërdrejtë.

Ideja e ILECU-t është që të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor të kenë një raport të ngjashëm përfundimtar, një PSO dhe, po ashtu, edhe strategjitë e këtyre shteteve të përfshira për luftimin e krimit të jenë të ngjashme. Këto do të mundësojnë krijimin dhe implementimin e formave unike në punën për përballimin e sfidave që shfaqen dhe që, së bashku, shtetet të kontribuojnë për një rajon të qetë dhe të sigurt.

ILECU është caktuar si pikë kordinuese e shkëmbimit të programeve me CEPOL (European Police College). Në vitin 2013 u caktuan zyrtarët që do të shkonin në Hungari, Estoni dhe në Gjermani, për të shkëmbyer përvojat e tyre dhe për të krijuar kontakte të drejtpërdrejta. Pas vendosjes së pesë ndërlidhësve policorë, parashikohet të rritet vëllimi i punës dhe i aktiviteteve në shkëmbimin dhe bashkëpunimin

ndërkombëtar dhe të kalohet në sistemin me 3 turne në ditë. Policia e Kosovës, tashmë, ka krijuar kapacitetet profesionale për zbatimin e marrëveshjeve ndërshtetërore të mirëkuptimit në fushën e zbatimit të ligjit, duke funksionalizuar Drejtorinë për bashkëpunim ndërkombëtar në zbatimin e ligjit, gjë që e lehtëson punën e policisë në fushën e shkëmbimit të informacioneve dhe në realizimin e operacioneve të përbashkëta policore.

EULEX-i dhe roli i tij në luftimin e kriminalitetit në Kosovë

Sipas deklaratës së misionit, në nenin (2) të Veprimit të Përbashkët apo siç quhet *Joint action*, mandati i EULEX-it në Kosovë duhet të asistojë institucionet e Kosovës, autoritetet e drejtësisë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit në progresin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, si dhe në zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një sistemi të pavarur multietnik të drejtësisë, të policisë dhe të shërbimit të doganave. Ky mandat i është siguruar, me qëllim të forcimit të këtyre institucioneve, që këto të jenë të pavarura dhe jo të ndikuara nga ndërhyrjet e politikës, dhe për respektimin dhe njohjen e standardeve ndërkombëtare dhe të praktikave më të mira europiane (Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX Kosovo, OJ 2008 L 42, Article 2.).

Veprimi i Përbashkët nënkupton mandatin e misionit në një numër detyrash operacionale për të tri komponentet e ndryshme të EULEX-it, domethënë, të drejtësisë, të policisë dhe të doganave. Mandati i EULEX-it, ndër të tjera është, të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, të terrorizmit, të krimit të organizuar, të korrupsionit, të krimeve ndëretnike, të krimeve financiare ekonomike dhe të krimeve të tjera të rënda, të hetohen, të ndiqen, si dhe të gjykohen çështjet pronësore dhe të zbatohen ato në pajtim me ligjin

në fuqi, si dhe të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe kordinimit gjatë tërë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar, dhe të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimeve financiare (Spernbauer, 2010: 15-16).

EULEX-i ka arritur të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me Policinë e Kosovës në disa fusha, duke kontribuar në luftimin e kriminalitetit në Kosovë dhe në uljen e kriminalitetit, në përgjithësi.

Marrëveshjet teknike të Republikës së Kosovës me Misionin e EULEX-it

MPB, respektivisht, Policia e Kosovës ka lidhur marrëveshje teknike me misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX), në lidhje me mbështetjen e vazhdueshme nga Drejtoria e Forenzikës e Policisë së Kosovës për EULEX-in në Kosovë.

EULEX-i operon nën autoritetin e Këshillit të Përgjithshëm 2008/124/CFSP, datë 4 shkurt 2008 (CJA) me synimin parësor për të ndihmuar dhe për të përkrahur autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit (Marrëveshja PK-EULEX, 2009: paragraf 1,3) dhe ruajtjen e rendit publik dhe të sigurisë në mënyrë të pavarur ose në përkrahje të autoriteteve të Kosovës, si përgjegjëse për hetimin e shkeljeve dhe të krimeve të luftës, të krimit të organizuar dhe atij ekonomik, të korrupsionit dhe të terrorizmit, fusha këto që do të kenë kërkesa të vazhdueshme për mbështetje forenzike lidhur me hetimet nga Departamenti i Policisë së EULEX-it (DEP).

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, PK ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur DEP-in në çështjet e forenzikës pas kërkesës nga autoritetet e tij. Qëllimi është që PK t'i ofrojë asistencë teknike DEP-it në fushën e forenzikës dhe të menaxhimit të vendit të

ngjarjes së krimit. Sipas marrëveshjes, gjithashtu, është caktuar oficeri ndërlidhës, i cili është pikë kontakti për zgjidhjen e çdo çështjeje a problemi mes palëve.

Marrëveshje mbi shkëmbimin e informatave

Kjo është nënshkruar midis PK dhe EULEX-it dhe ka për synim lehtësimin lidhur me parandalimin, zbulimin dhe reduktimin e krimeve brenda Kosovës, sipas përgjegjësi të tyre në zbatimin e ligjit. Kjo marrëveshje ka të bëjë, në radhë të parë, me luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe atë të narkotikëve, krimet financiare, nivelin e lartë të korrupsionit dhe trazirat qytetare (Marrëveshja PK-Eulex, 2013: parag. 1.1).

Si pika kontaktuese ndërmjet palëve janë Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë e PK dhe Zyra e BE-së për Inteligjencë Kriminale, të cilat shkëmbejnë të gjitha informatat e nevojshme lidhur me hetimet e përbashkëta mes PK dhe DPE-së. Informatat duhet të trajtohen në mënyrë të sigurt dhe të ruhen sipas kriterëve të parashikuara me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë (Ligji nr. 03/L-178, neni 6), me ligje të tjera në fuqi dhe me udhëzuesin e Këshillit të Europës mbi sigurinë e informatave, të vitit 2006.

Fakti që jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së e kanë njohur Kosovën, bën që kjo të mos ketë bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe marrëveshje strategjike me EUROPOL-in. Për pasojë, me EUROPOL-in lidhet EULEX-i, i cili mban komunikim të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunon me të.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi me EULEX-in është arritur të zgjidhen disa raste në bashkëpunim me shtete të tjera. Po përmendim këtu disa prej tyre:


Rasti i koduar “**Pisha**” (2011), lidhur me të cilin, përmes EULEX-it, janë shkëmbyer informata hetimore me autoritetet zvicerane dhe çeke. Hetimet e zhvilluara me këtë rast kanë rezultuar me konfiskimin e 257.92 kg marihuanë dhe me arrestimin e 7 personave të dyshuar.

Rasti i koduar “**Merimanga**” (2011), i cili është hetuar në bashkëpunim me autoritetet gjermane. Si rezultat, u arrestua 1 person i dyshuar dhe u konfiskuan 12.9 g kokainë.

Rasti i koduar “**Vazhdimi**” (2012). Kështu e emërtoi këtë rast DHTN-ja, ndërsa autoritetet gjermane e quajtën “**Bavaria**”, ngaqë ai u krye pas hetimeve të përbashkëta me autoritetet gjermane dhe me aksion të përbashkët me Policinë e EULEX-it dhe me Prokurorin Special të EULEX-it. Operacioni rezultoi me arrestimin e 1 personi të dyshuar dhe me konfiskimin e 15 g heroinë, 4 g marihuanë, 1 peshore për matjen e narkotikëve, 2 revoleve (njëra me gaz) dhe të 2 veturave.

Rasti i koduar “**Sitnica**” (2012), për të cilin hetimet janë zhvilluar në bashkëpunim ndërkombëtar me Gjermaninë, si dhe me policinë e EULEX-it. Policia e Gjermanisë, gjegjësisht nga Mynihu, ka dhënë informacione për një grup personash të dyshuar se merren me trafikimin e heroinës nga Kosova për në Gjermani. Me kërkesën e policisë së Gjermanisë, në vitin 2012 është mbajtur një takim në Mynih, në cilësinë e bashkëpunimit në rastin e koduar në Gjermani, të quajtur “**Merimanga**”, që lidhej me rastin “**Sitnica**”, që ishte nën hetim nga DHTN-ja. Epilogu i këtij rasti që arrestimi i 3 personave të dyshuar dhe konfiskimi i 1.8 kg heroinë, 2 armëve, 67 fishekëve, 2 veturave dhe i 1900 eurove.

Diagrami 7: Bashkëpunimi policor me Eulex-in



Burimi: Raportet policore nga DHTN, Policia e Kosovës

KAPITULLI III:ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE POLICORE DHE BNP

Krijimi i organizatave ndërkombëtare erdhi si rrjedhojë e rritjes së krimeve transnacionale në botën e sotme. Gjithnjë e më shumë, policitë e vendeve të ndryshme shtronin kërkesa imperative për bashkëpunim ndërkombëtar me njëra-tjetrën në luftimin e krimit. U bë e domosdoshme që ato të bashkëpunonin në forma dypalëshe dhe, më së shumti, në format shumëpalëshe, sepse organizatat kriminale që po merrnin dimensione ndërkombëtare i shtrinin tentakulat e tyre në disa shtete. Kësisoj, zbulimi, hetimi dhe ndjekja e tyre bëheshin shumë të vështirë dhe shpesh të pamundur, për shkak të mungesës së mundësive të shteteve të veçanta dhe të organeve të tyre policore për të komunikuar dhe për të vepruar në vende të tjera. Për më tepër, teknikat e aplikuara të kimisë dhe fizikës u kanë siguruar kriminelëve metoda të avancuara për falsifikim të dokumenteve, kryerjen e vjedhje me thyerje, duke bërë të holla të rreme, mashtrimin e viktimave etj. (Fooner, 1989: 27). Në këto kushte, kërkohej një formë, një strukturë ndërmjetësuese, që të bënte të mundur komunikimin dhe bashkëveprimin midis policive të shteteve të ndryshme. Pra, kërkohej një medium që do të hartonte politikat e BNP në tërë rruzullin tokësor. Me konkretizimin e kësaj ideje, do të kemi organizatën e parë policore ndërkombëtare, e cila, me kalimin e kohës, u pasua nga krijimi edhe i disa organizatave të tjera policore ndërkombëtare.

Roli i këtyre organizatave ka qenë një shtysë e madhe në krijimin e lidhjeve mes shteteve në shkëmbimin e informacioneve, në zbulimin dhe kapjen e kriminelëve të kërkuar. Me krijimin e tyre u kapërcye hendeku i madh që i pengonte shtetet dhe i bënte ato të ngurta në shkëmbimin e informacioneve, nën pretekstin e ruajtjes së sovranitetit

shtetëror apo edhe për shkak të ruajtjes nga ndërhyrje dhe ndikimeve të politikës, kur bëhej fjalë për bashkëpunimin midis policive të shteteve të ndryshme.

3.1. Interpol-i e para organizatë ndërkombëtare policore

E para organizatë ndërkombëtare policore konsiderohet Interpol-i. Lindja e tij lidhet me vitin 1914, kur princi Albert, i Monakos, thirri një konferencë ndërkombëtare të policisë dhe të zyrtarëve tjerë të drejtësisë penale. Në këtë takim, anëtarët formuluan një projekt paraprak për krijimin e një organizate të policisë ndërkombëtare dhe ishin të vendosur që brenda dy viteve të takohen sërish për ta implementuar këtë projekt (Greene, 2007: 706). Mirëpo, shpërtheu Lufta e Parë Botërore dhe nuk ishte as predispozicioni, as mundësia për takime ndërkombëtare të policive.

Ideja e një organizate policore ndërkombëtare do të merrte jetë pas afro dhjetë vjetësh, në shtator të vitit 1923. Johann Schober, shefi i policisë së Vjenës, në konferencën e mbajtur në Vjenë, në shtator të vitit 1923, theksoi me forcë nevojën që të zhvillohej komunikimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi midis agjencive policore (Fooner, 1989: 7). Përpjekjet e tij u finalizuan me themelimin e Organizatës së Policisë Ndërkombëtare. Kështu, në shtator të vitit 1923, u ngrit Komisioni Ndërkombëtar i Policisë Kriminale (emër që më vonë u ndryshua në Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale) (Greene, 2007: 706).

Ky Komision ishte pararardhësi i Interpol-it. Puna e tij ishte kryesisht përmirësimi i bashkëpunimit policor mes shteteve europiane, që përbënin anëtarësinë e organizatës. Prioritet u ishte dhënë shqetësimeve të problemeve policore të anëtarëve europianë dhe të SHBA-ve. Më pas, si rrjedhojë e zgjerimit të organizatës, aktivitetet e Interpol-it u shtrinë në të gjithë botën (Bantekas & Nash, 2009: 410-411).

Me kalimin e kohës, u mendua edhe për dokumentet bazë të jetës, të funksionimit dhe të veprimtarisë së organizatës. Asambleja e Përgjithshme, në sesionin e saj të 25-të, që u mbajt në Vjenë, në vitin 1956, miratoi Kushtetutën dhe Rregulloren e Përgjithshme të ICPO-Interpol, të cilat kanë pësuar ndryshime dhe modifikime të vazhdueshme në sesionet e mëvonshme.

Në kuadër të përpjekjeve ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit, Interpol-i ka miratuar disa rezoluta, si atë për bashkëpunim në çështjet e veprave penale të kryera kundër aviacionit civil ndërkombëtar (viti 1970); për marrjen e masave për të parandaluar ose shtypur format specifike moderne të kriminalitetit ndërkombëtar, në mënyrë specifike, mbajtjen e pengjeve me qëllim të kryerjes së shantazheve ose formave të tjera të grabitjes (viti 1971); për, masat kundër grupeve të organizuara që, të motivuara ideologjikisht, kryejnë akte dhune, vrasje, plagosje, rrëmbime, marrje peng, ndërhyrje të paligjshme në aviacionin civil, zjarrvënie dhe bombardime (viti 1979); për kontrollimin e prodhimit në mbarë botën, shpërndarjes, shitjes dhe ruajtjes së substancave eksplozive, që janë përdorur shpesh në veprat penale të dhunës (viti 1981) etj. (Snowden & Whitsel, 2004: 178-179).

3.2. Roli dhe struktura e Interpol-it

Përgjithësisht, Interpol-i njihet si organizatë, që është e përfshirë më shumë në çështje të luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar, trafikimit ndërkombëtar të drogës, kundër tregtisë ndërkombëtare të paligjshme të armëve, kundër praktikave ndërkombëtare të mashtrimeve financiare, në ndjekjen e të arratisurve anekënd globit etj. (Fooner,1989:7).

Por, bazuar në nenin 2 të Kushtetutës së kësaj organizate, e cila ka hyrë në fuqi më 13 qershor 1956, qëllimet kryesore të saj janë: “të sigurojë dhe të nxisë ndihmën e ndërsjellë të mundshme mes të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kufijve të ligjeve ekzistuese në vende të ndryshme dhe në frymën e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, si dhe të krijojë dhe të zhvillojë të gjitha institucionet e mundshme për të kontribuar në mënyrë efektive në parandalimin dhe goditjen e krimeve të parashikuara me ligje të zakonshme (Kushtetuta e Interpol-it, 1956: neni 2).

Në aktivitetet kundër kriminalitetit të organizuar ndërkombëtar Interpoli luan një rol të rëndësishëm duke realizuar katër funksione kryesore: shërbimin e komunikimit të policisë globale, të dhënat operative të shërbimeve dhe bazat e të dhënave për policinë, mbështetjen e shërbimeve të policisë operative, si dhe trajnimin dhe zhvillimin e shërbimeve të policisë (Eterno & Das, 2010: 229). Në rastet e dështimit të sistemeve nacionale të shteteve, policive ju duhen tri elemente themelore për të bllokuar kriminelët: informata, dëshmi dhe për të identifikuar kriminelët (Durmaz, 2005: 2).

Baza e të dhënave e Interpol-it është e zhvilluar në pesë drejtime: të dhënat nominale, vjedhja e dokumenteve të udhëtimit, vjedhja e veturave, DNA, dhe gjurmët e gishtërinjve (Committee of Ministers of the Council of Europe, 2007: 23). Kjo bazë të dhënash përmban informata për rreth 170.000 kriminelë dhe për afro 38.000 persona të kërkuar (Committee of Ministers of the Council of Europe, 2007: 123). Pra, ajo është një burim mjaft i dobishëm për zhvillimin me sukses të luftës kundër kriminalitetit nga shtete të ndryshme dhe nga organizatat policore.

Në vitin 2003, Interpol-i filloi punën me bazën e internetit të sigurisë së lartë në infrastrukturën e vet të komunikimit, të njohur si I-24/7. Atë vit, për herë të parë, numri

i të dhënave arriti në më shumë se 3 milionë. Ky sistem mundëson bashkëpunim të shpejtë dhe efikas në luftimin e të gjitha formave të krimit të rëndë ndërkombëtar.

Përmes këtij sistemi lidhen me njëri-tjetrin: Sekretariati i Përgjithshëm, Zyrat Qendrore Kombëtare dhe oficerët e policisë të vendeve anëtare, të cilët mund të dërgojnë dhe të marrin me shpejtësi informacione policore, përfshirë imazhe, në të gjithë botën, në kohë reale, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë (H. Abadinsky, 2010:398).

I-24/7 u mundëson përdoruesve të autorizuar të ndajnë informata të ndjeshme dhe urgjente të policisë me homologët e tyre nëpër botë. Ai është rrjeti që mundëson hetuesit për të hyrë në bazën e të dhënave kriminale të Interpolit. (<http://www.interpol.int/INTERPOL-expertise/Data-exchange/I-24-7>).

Në vitet e fundit, Interpol-i ka përshtatur mundësitë për të kontribuar në ngjarje të rëndësishme botërore. Pas sulmeve të 11 Shtatorit, u themelua një komandë qendrore, që është operacionale dhe krijoi bazën e të dhënave, e para në botë, për persona të lidhur me veprimtari terroriste (Dosen *et al.* 2013: 427).

Roli i Interpol-it përmendet në shumë instrumente, respektivisht, rekomandime të Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (Committee of Ministers of the Council of Europe, 2007: 15).

Kjo organizatë ka një anëtarësi prej 190 vendesh dhe një buxhet prej afro 60 milionë eurosh prej kontributeve vjetore. Sekretariati i Përgjithshëm i Interpol-it, aktualisht, ka një staf prej 673 vetash që përfaqësojnë 93 vende anëtare.

Struktura organizative e Interpol-it është e rregulluar me kushtetutën e saj. Në të janë të përcaktuara këto organe të Interpol-it: Asambleja e Përgjithshme, Komiteti Ekzekutiv, Sekretariati i Përgjithshëm, Zyrat Kombëtare Qendrore, Këshilltarët, Komisioni për Kontrollimin e Dosjeve (Kushtetuta e Interpol-it, 1956: neni 5).

Asambleja e përgjithshme është autoriteti suprem i organizatës, ajo përbëhet nga delegatët, të cilët emërohen nga anëtarët e organizatës (Kushtetuta e Interpolit, Neni 6). Çdo anëtar mund të përfaqësohet nga një ose disa delegatë, megjithatë, për secilin vend do të ketë vetëm një kryetar delegacioni, i emëruar nga autoriteti qeveritar kompetent i atij vendi. Kushtetuta, në nenin 8 përcakton edhe funksionet e asamblesë së përgjithshme. Kjo mbledhet në sesion të zakonshëm çdo vit. Në seancë të jashtëzakonshme mund të mbledhet me kërkesë të Komitetit Ekzekutiv ose të shumicës së anëtarëve (Kushtetuta e Interpolit, 1956: Neni 10). Vetëm një delegat nga secili vend ka të drejtën e votës në Asamblesë të Përgjithshme. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë, përveç rasteve kur kërkohet shumica prej dy të tretave me Kushtetutë (Kushtetuta e Interpolit, 1956: Neni 13 dhe 14).

Komiteti Ekzekutiv - përbëhet nga presidenti i Organizatës, tre nënkryetarët dhe nëntë delegatë. Të gjithë këta anëtarë janë nga vende të ndryshme, në mënyrë që të ketë një përfaqësim më të mirë gjeografik. Presidentin dhe nënkryetarët i zgjedh Asambleja e përgjithshme në mesin e delegatëve, presidenti zgjidhet me dy të tretat e votave, ndërsa pas votimit të dytë mjafton shumica e thjeshtë, dhe është rregull që presidenti dhe nënkryetarët të jenë nga kontinente të ndryshme.

Presidenti zgjidhet me mandat katërvjeçar, ndërsa nënkryetarët me mandat trevjeçar, asnjëri prej tyre nuk kanë të drejtë rizgjedhjeje, si dhe nuk kanë të drejtë të zgjidhen si delegatë në Komitetin Ekzekutiv (Kushtetuta e Interpol-it, 1956:neni 17).

Detyrat e Komitetit Ekzekutiv i përcakton qartë Kushtetuta e Interpol-it, në nenin 22.

Sekretariati i Përgjithshëm - përbëhet nga departamentet e përhershme të Organizatës. Ai vendos në zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe të

Komiteti Ekzekutiv; shërben si një qendër ndërkombëtare në luftën kundër krimit të zakonshëm dhe si qendër teknike dhe e informacionit; siguron administrimin efikas të organizatës etj.

Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e personave kompetentë në çështjet policore dhe propozohet nga Komiteti Ekzekutiv dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej pesë vjetësh, por edhe mund të riemërohet për periudha të tjera.

Zyrat Qendrore Kombëtare u krijuan për të siguruar një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe aktiv të anëtarëve të saj. Organizata e Interpol-it ka paraparë që secili vend të emërojë një trupë, e cila të shërbejë si Zyrë Qendrore Kombëtare, për të siguruar ndërlidhje me departamentet e ndryshme të vendit, me Zyrat e vendeve të tjera, si dhe me Sekretariatën e përgjithshëm të organizatës.

Këshilltarët janë funksionarë policorë me të cilët Organizata mund të konsultohet për çështjet shkencore. Roli i tyre është thjesht këshillues. Ata emërohen për tre vjet, nga Komiteti Ekzekutiv. Emërimi i tyre bëhet zyrtar vetëm pas njoftimit nga Asambleja e Përgjithshme. Ata zgjidhen ndër personat që kanë një reputacion të gjerë botëror në disa fusha me interes për Organizatën.

Komisioni për Kontrollin e Dosjeve është një organ i pavarur, i cili siguron që përpunimi i të dhënave personale nga organizata të jetë në pajtim me rregulloret e saj. Ky Komision i paraqet organizatës mendime lidhur me ndonjë projekt apo operacion, vendos rregulla ose çështje të tjera që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale. (Kushtetuta e Interpolit, 1956). Në vitet e fundit, Interpol-i ka përshtatur mundësit për të kontribuar në ngjarje të rëndësishme botërore. Pas sulmeve të 11 shtatorit, Interpol ka themeluar një komandë qendrore që do të jetë operacionale gjatë tërë kohës, kjo u pasua

edhe me krijimin e bazës së të dhënave, e para në botë, për persona lidhur me veprimtari terroriste, si dhe një bazë të të dhënave lidhur me dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit. Interpol-i gjithashtu ka bazën e të dhënave të shenjave të gishtërinjve, si dhe një bazë të dhënash të ADN-së (Dosen *at al.* 2013: 427).

3.3. Interpol-i dhe çështjet ligjore

Interpol-i funksion primar ka bashkëpunimin ndërkombëtar ndaj luftimit të kriminalitetit. Me aktet juridike që rregullojnë funksionimin e tij, qëllimet e Interpol-it janë:

a) Garantimi dhe zgjerimi i ndihmës reciproke midis të gjithave shërbimeve policore në bazë të dispozitave ligjore të shteteve të ndryshme dhe në frymën e Deklaratës Universale mbi të drejtat e njeriut.

b) Themelimi dhe zhvillimi i institucioneve që mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në parandalimin dhe ndëshkimin e autorëve të veprave penale të përgjithshme.

Por, siç e kemi thënë edhe më sipër, aktiviteti i tij në ndjekjen penale dhe në ruajtjen e sigurisë publike është i kufizuar funksionalisht: Si një trupë kordinuese, që nuk ka hetuesit apo agjentët e vet të zbatimit të ligjit, Interpol-i nuk ka kompetenca për të kryer hetime vetë apo të ndërhyjë me operacione më vete. Këto janë detyra që u takojnë autoriteteve të policive kombëtare, të cilat mund të përdorin Organizatën si një platformë për bashkëpunimin ndërkombëtar (Haubold, Vol. 09 No.11:1720). Kjo, sepse ndërhyrja e një policie të një shteti në shtetin tjetër nënkupton shkelje të sovranitetit shtetëror, gjë për të cilën shtetet janë të ndjeshme. Kompetencat e shtetit për këto veprime nuk transferohen as tek Interpol-i, as te shtetet anëtare që veprojnë në kuadër të bashkëpunimit nëpërmjet Interpol-it. Kështu, nga perspektiva e ligjeve kombëtare, masat administrative për çështje të tilla, si ekstradimi, përcaktimi i identitetit dhe masa

të tjera standarde të policisë në parandalimin ose ndjekjen e krimit mbeten përgjegjësi e vetë shteteve (Bogdandy, *at al*, 2010: 249). Kompetenca kombëtare ruhet edhe kur bëhet fjalë për të dhënat e arkivave dhe për qasjen në to.

Për të ruajtur neutralitetin, Interpol-it, sipas kushtetutës së tij, nuk i lejohet të ndërmarrë asnjë ndërhyrje apo aktivitet të natyrës politike, ushtarake, fetare apo lidhur me racën e njerëzve. Prandaj kompetencat e Interpol-it përqendrohen tek administrimi i informacionit, i të dhënave, dhe tek këmbimi i tyre. Për këtë Interpol-i ofron kanalet e ndryshme dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit në kuadrin e procedurave dhe standardeve të veta (Bogdandy, *at al*, 2010: 249).

Kjo veprimtari fokusohet në informacionet që lidhen me çështjet e sigurisë publike, dhe me të gjitha format e krimit të organizuar dhe terrorizmin, si dhe me krimet kundër njerëzimit, me krimet e luftës etj.

Siç shihet, roli i Interpol-it në luftimin e kriminalitetit është i shumanshëm: ai është një pikë reference për çështje ndërkombëtare, është një rrjet i komunikimit të gjithanshëm mes shteteve, burim për informata kriminale dhe inteligjente, një shërbim ndërlidhës dhe një medium i vendosjes së politikave të bashkëpunimit ndërkombëtar policor (Higdon, Koenig& Das, 2001: 30-34).

Aktivitetet e veta Interpol-i i realizon në shumë fusha dhe në forma të ndryshme. Edhe mënyrat e komunikimit të tij janë të shumta, ndër to edhe ajo përmes lidhjeve të internetit dhe nëpërmjet zyrave që ai ka në shtetet anëtare të tij.

Në kuadrin e bashkëpunimit midis policive të shteteve për zhvillimin e hetimeve për zbulimin e autorëve të veprave penale, si edhe të viktimave dhe të dëshmitarëve të veprave, gjithnjë mbi baza juridike të miratuara, Sekretariati i Përgjithshëm u shpërndan

rregullisht fletarreste speciale byrove nacionale, si fletarrestin e “**KUQ**” për personat që kërkohen për t’u privuar nga liria dhe për t’u ekstraduar (Marsden, 2008: 481).

Fletarresti “**GRI**”, kërkon që shteti marrës “të ofrojë informacione për *modus operandin*, për procedurën, objektet, pajisjet apo për vendet e fshehta të përdorura nga kriminelët dhe të përcaktojë vendbanimin dhe adresën” (Bassiouni, 2014: 848).

Në funksion të zbulimit të shpejtë të veprave penale dhe të autorëve të tyre Interpol-i bashkëpunon edhe për identifikimin e personave dhe të kufomave. Për konstatimin e identitetit të kufomës përgatitet dhe shpërndahet buletini i posaçëm me ngjyrë të “**ZEZË**”, me fotografi, me gjurmë të gishtërinjve ose çështje të tjera, me ndihmën e të cilave mund të konstatohet identiteti i personit.

Ndërsa për personat që kanë kryer vepra penale të rënda në territorin e disa shteteve, Interpol-i, nëpërmjet Sekretariatit të përgjithshëm, shpërndan kartonin e “**JESHIL**”, duke i paralajmëruar dhe duke u kërkuar që t’i përcjellin aktivitetet dhe sjelljet e kriminelëve seriozë (Durmaz, 2007: 9). Sistemi i komunikimit të Interpolit lidhë Sekretariatin e Përgjithshëm, Zyrat Qendrore Kombëtare, dhe oficerë të policisë në vendet anëtare në mënyrë që ata të mund të dërgojnë dhe të marrin informacion të policisë, duke përfshirë imazhe, në të gjithë botën, për një siguri, bazë kohore reale, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë (H. Abadinsky, 2010:398).

Pas sulmeve të 11 Shtatorit, Interpol-i forcoi edhe më shumë bashkëpunimin më të madh policor ndërkombëtar me FBI-në, si edhe me agjencitë e tjera, si: DEA, CIA, NSA etj. si dhe duke filluar një bashkëpunim policor me të gjitha shtetet aleate në mënyrë bilaterale edhe përmes Interpolit (Latifi & Beka, 2013: 246).

Disa javë pas sulmeve terroriste në SHBA, nga 24-28 shtator 2001, Asambleja e Përgjithshme e Interpol-it mbajti takimin e tij të 70-të në Budapest, Hungari, ku përveç

miratimit të Rezolutës që dënonte sulmet vrastare, u vendos që për të luftuar terrorizmin dhe krimin e organizuar në mënyrë më efektive t'i jepet prioritet më i lartë lëshimit të ashtuquajturave *njoftime të KUQE (urdhërarrestet ndërkombëtare të Interpol-it për të kërkuar arrestimin dhe ekstradimin)* për terroristët që kërkohen lidhur me sulmet.

Ndërsa, në tetor 2001, Interpol mbajti Simpoziumin e tij të 16-të për Terrorizmin, në të cilën 110 ekspertë nga 51 vende diskutuan iniciativa të reja afatgjata anti-terroriste, si mundësinë e ngritjes së një baze të dhënash të veçantë të aviacionit, financimin e terrorizmit dhe zgjerimin e masave kundër pastrimit të parave (Snowden & Whitsel, 2004: 180). Gjithashtu baza e të dhënave e Interpolit është zhvilluar në pesë drejtime: të dhënat nominale, vjedhja e dokumenteve të udhëtimit, vjedhja e veturave, DNA, dhe gjurmët e gishtërinjve (Committee of Ministers of the Council of Europe, 2007: 23).

3.4. Roli i Interpolit në luftimin e kriminalitetit në Kosovë

Para vitit 2008, Interpol-i ka vepruar në Kosovë në kuadër të misionit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK, në bazë të Rezolutës R/1244 të Këshillit të Sigurimit. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, aktiviteti i degës së Interpol-it në Kosovë ka vepruar si i ndarë dhe tani parashikohet të jetë në kuadër të strukturës organizative të Policisë së Kosovës. Kjo nuk është aktualizuar ende, për shkak të pengesave lidhur me statusin e Kosovës në OKB. Megjithatë, Interpol-i funksionon në Kosovë, në kuadër të degës së UNMIK-ut dhe ka dhënë një kontribut të çmuar në luftimin e krimit në Kosovë.

Kosova, edhe pse ende nuk është anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare, pra, as e Interpol-it, ka zhvilluar e zhvillon bashkëpunim të rregullt në fushën e policisë,

si me Interpol-in, dhe nëpërmjet tij edhe me shtetet e rajonit, në bazë të marrëveshjeve bilaterale që ka nënshkruar.

Zyra e Interpol-it në Kosovë ka lidhje të ngushta me Drejtorinë për Luftimin e Krimeve të Rënda në Policinë e Kosovës dhe rezultatet e këtij bashkëpunimi nuk kanë munguar. Vetëm gjatë vitit 2008 janë hetuar bashkërisht 35 raste dhe janë zhvilluar shumë aktivitete hetimore me theks të veçantë në rrafshin e BNP. Përmes Interpolit janë bërë 285 konfirmime (Raporti Vjetor i PK-së, 2008:13). Ndihmën e zyrës ndërlidhëse të Interpolit e ka pasur edhe Njësia për Hetimin e krimeve të luftës, duke dhënë kontribut sidomos në zbulimin dhe identifikimin e viktimave të luftës në Kosovë. Kjo zyrë ka ndihmuar, gjithashtu, edhe në luftimin e krimit me karakter ndërkombëtar në Kosovë, përmes një bashkëpunimi efikas. (Raporti vjetor i PK-së, 2008:13).

Aktivitetet e Zyrës ndërlidhëse të Interpol-it në Kosovë kanë qenë të fokusuara, gjithashtu, në kërkesat e proceduara ndër vite. Në vitin 2009 kanë qenë 5432 kërkesa, ndërsa në vitin 2010 ishin 5300. Kërkesa ka pasur edhe për shpalljen e personave të kërkuar (2, në vitin 2009 dhe 24, në 2010); për ekstradimet (5, në vitin 2009 dhe 5, në vitin 2010), si dhe për gjetjet e veturave (59, në vitin 2009 dhe 51, në vitin 2010) (Raporti vjetor i PK-së, 2010: 27).

Megjithë këtë bashkëpunim të frytshëm të zyrës së Interpol-it me Policinë e Kosovës, për shkak të pamundësisë së kësaj të fundit për të komunikuar drejtpërdrejt me institucionet ndërkombëtare, si Interpol dhe Europol, Policia e Kosovë has në shumë pengesa në luftimin e formave të ndryshme të krimit. Konkretisht, edhe pse Kosova bashkëpunon me Interpol-in përmes UNMIK-ut, ajo nuk mund të shfrytëzojë bazën e të dhënave EASF ose baza të tjera të të dhënave, që i ka dhe i shfrytëzon Interpol-i.

Mundësia në qasjen e bazës së të dhënave të Interpol-it do ta mbështeste jashtëzakonisht shumë Kosovën në ndjekjen dhe në hetimin e rasteve nga shtetet anëtare.

Prandaj Qeveria e Republikës së Kosovës ka si objektiv të saj edhe anëtarësimin në Interpol. Ajo ka aplikuar për pranimin e saj në këtë organizatë, duke u asistuar për këtë edhe nga ILECU, i cili ka ndihmuar në formulimin e kërkesës së Kosovës për anëtarësim në Interpol. Pasi këtë kërkesë e nënshkroi kryeministri i Kosovës, ajo u dërgua në Lion, nga Ministria e Punëve të Brendshme, përmes kanaleve të vetë Interpol-it. Në datat 8-10 qershor 2015 Komiteti Ekzekutiv në Lion është mbledhur për këtë çështje, por ende nuk ka informata se çfarë përgjigje ka.

3.5. Organizata e Inteligjencës Europiane - Europol

Themelimi i Europol-it. Europol është një organizatë mjaft e re. Ideja e krijimit të një agjencie të specializuar të Inteligjencës Europiane për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar policor u hodh në fillim të viteve nëntëdhjetë (Martenczuk, 2008:368) dhe, në vitin 1992, në Traktatin e Mاستrihtit për Unionin Europian, u miratua themelimi i Europol-it. Zyra Qendrore, Drejtoria e Europol-it ndodhet në Hagë, të Holandës. Themelimi i Europolit është miratuar në traktatin e Mاستrihtit për Unionin Evropian më 1992. Fillimisht e përfshirë vetëm në luftën kundër drogës, organizata ka zhvilluar detyrat e saj dhe tani merret me krimet, tema bazike e të cilave është paraparë në konventën e Europolit, e cila ka hyrë në fuqi më 1998 (Madsen, 2009: 98-99)

Në zhvillimin e Europol-it mund të identifikohen tri faza. Faza e parë, përfshin periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2006. Në këtë kohë, kjo organizatë që e përfshirë vetëm në luftën kundër drogës dhe bashkëpunimi i policive ende dominohej kryesisht nga marrja e vendimeve ndërqeveritare. Për këtë arsye dhe, për shkak të origjinës

ndërqeveritare të strukturave të bashkëpunimit të policisë që i paraprinë Europol-it, roli i Parlamentit European në mbikëqyrjen e tij ishte i kufizuar.

Në një fazë të dytë, nga viti 2006 deri në vitin 2009, korniza ligjore e Europol-it u ndryshua krejtësisht dhe një vendim i Këshillit të Europës, i 6 prillit 2009, e transformoi Europol-in, nga 1 janari 2010, në një agjenci të BE-së, që financohet nga buxheti i Komunitetit European dhe jo nga kontributet e shteteve anëtare, siç e përcaktonte Konventa e Europol-it.

Faza e tretë është në vazhdim e sipër. Në këtë fazë do të përcaktohet e ardhmja e Europol-it (Crum & Fossum, 2013:88). Tani, një rregullore e re ka zëvendësuar Vendimin e Këshillit, me qëllim zbatimin e dispozitave të reja të Traktatit të Lisbonës, sidomos, duke iu referuar pjesëmarrjes së parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit European në monitorimin politik të agjencisë.

3.6. Roli dhe struktura e Zyrës Policore – Europol

Zyra Europiane e Policisë (Europol) është një organizatë policore ndërkombëtare, e cila u formua për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit në BE, me 1993 dhe me fillimin e operacioneve të njësisë së drogave të Europolit në vitin 1994 (Occhipinti, 2003:51), në mënyrë që të parandalohet dhe të luftohet kriminaliteti i rëndë ndërkombëtar. I përshtatur brenda kontekstit të Traktatit të Bashkimit European, mandati i Europol-it përfshin luftimin e të gjitha formave të rënda të krimit ndërkombëtar, duke përfshirë edhe terrorizmin ndërkombëtar (Deflem, 2006: 336). Europol nuk u krijua për t'u marrë me vepra lokale apo të vogla, por për të dhënë një dimension evropian për hetimin e krimit (Cools, *at al*, 2010:63).

Ndërsa organizatat e tjera ndërkombëtare policore janë formuar jashtë kontekstit të ndonjë organi politik ndërkombëtar, mandati i Europol-it ka një specifikë, ai është

përcaktuar në mënyrë të qartë nga BE-ja dhe operacionet e saj mbikëqyren nga organet rregullatore të BE-së. Megjithatë, pavarësisht nga fakti se Europol-i është themeluar brenda strukturave politike dhe ligjore të BE-së, është argumentuar dhe provuar se organizata ka tipare të rëndësishme të ekspertizës profesionale, të ngjashme me ato që i karakterizojnë organizatat e tjera ndërkombëtare policore (Deflem, 2006: 336).

Objektivat e Europol-it janë që të përmirësojë efektivitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve policore të vendeve anëtare të BE-së. Në përputhje me to, edhe mandati i tij është zgjeruar dhe tani Europol-i merret me një gamë të gjerë të luftimit të formave të ndryshme të kriminalitetit. Numri i nismave për bashkëpunim policor dhe gjyqësor në Bashkimin Europian, për çështjet kriminale, është mbresëlënëse. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdemit (1999) ky set politikash u ristrukturua nën termin “Zona e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë” (Qesaraku, 2008:4). Kontributi i Europolit jepet në dy forma të veçanta bashkëpunimi: Aktivitetet e ekipeve hetimore të përbashkëta dhe pjesëmarrja e tij në këto aktivitete (Cools, *at al*, 2009: 329). Megjithatë, korniza ligjore e Europol-it është subjekt i një debati të vazhdueshëm, lidhur me format e ndryshme në të cilat do të mund të vendosen dispozitat e Traktatit të Lisbonës (Crum & Fossum, 2013: 88).

Struktura Organizative e Europol-it

Europol-i, si organizatë për bashkëpunim policor në kontinentin e Europës ka katër seksione: 1) seksionin për analiza, 2) seksionin e oficerëve ndërlidhës, 3) seksionin për informata, 4) seksionin e administratës. Ajo ka si organe drejtuese: Bordin drejtues, Drejtorin, Kontrolluesin Financiar dhe Komitetin Financiar, të përcaktuara me Konventën e Europol-it).

Bordi drejtues. Sipas nenit 28 të Konventës së Europol-it, merr pjesë në zgjerimin e objektivit të Europol-it, përcakton të drejtat dhe obligimet e oficerëve ndërlidhës, vendos për numrin e oficerëve të kontaktit që shtetet anëtare mund të dërgojnë në Europol, merr pjesë në miratimin e rregullave mbi marrëdhëniet e Europol-it me shtetet e treta dhe trupave të tretë brenda kuptimit të nenit 10 (4). Veprimtaria e tij shtrihet, gjithashtu, në pjesëmarrjen në emërimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorëve, në mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave të Drejtorit/së, në miratimin e rregulloreve të stafit, në përgatitjen e marrëveshjeve mbi besueshmërinë dhe në miratimin e dispozitave për mbrojtjen e fshehtësisë.

Neni 28 i Konventës së Europol-it përcakton shprehimisht se Bordi Drejtues përbëhet nga një përfaqësues të secilit vend anëtar. Çdo anëtar i Bordit ka një votë (Konventa e Europolit, 1956: Neni 28 paragrafi 2).

Drejtori. Emërohet për një periudhë katërvjeçare nga Këshilli i Europës, në pajtim me procedurën e përcaktuar në Titullin VI të TBE. Ai ndihmohet nga disa zëvendësdrejtorë. Drejtori është përgjegjës për kryerjen e detyrave të caktuara për Europol-in; për administrimin e përditshëm; menaxhimin e personelit; përgatitjen dhe zbatimin e vendimeve të Bordit drejtues; përgatitjen e projektbuxhetit, të projektplanit të themelimit dhe të projektplanit të financimit pesëvjeçar dhe për zbatimin e buxhetit të Europol-it. Drejtori dhe zëvendësdrejtorët mund të shkarkohen me vendim të Këshillit të Europës (Neni 29 i Konventës së Europolit).

Stafi. Drejtori, zëvendësdrejtorët dhe nëpunësit e Europol-it udhëhiqen në veprimet e tyre nga objektivat dhe detyrat e Europol-it dhe nuk marrin ose nuk kërkojnë urdhra nga asnjë qeveri, autoritet, organizatë ose person jashtë Europol-it, përveç kur parashikohet ndryshe në Konventë, dhe pa paragjykim të Titullit VI të TBE-së.

3.7. Europol-i në bashkëpunimin ndërkombëtar policor

Europol-i, ashtu si dhe Interpol-i ka për mision realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit dhe të terrorizmit. Sipas nenit (2) të Konventës së Europol-it, ka objektiv përmirësimin e efikasitetit të bashkëpunimit të autoriteteve kompetente të shteteve anëtare në parandalimin dhe luftimin e krimit të rëndë ndërkombëtar ku ka indikacione faktike apo baza të arsyeshme për të besuar se një strukturë kriminale e organizuar është e përfshirë në dy ose më shumë shtete.

Veçanërisht pas sulmeve terroriste të shtatorit 2001, u shtuan jo vetëm presionet politike për të rritur masa shtesë të sigurisë dhe të bashkëpunimit policor edhe në BE, për të intensifikuar shkëmbimin e informacioneve ndërmjet agjencive të BE-së dhe SHBA (Aden, 2013: 2), por edhe për një profesionalizëm dhe efektivitet më të lartë nga Europol-i në BNP. Ky preokupacion u ngrit me të madhe në programin TREVI (Terrorism, Extremism, Violence, International). Kjo bëri që të mblidhen ministrat e Policisë dhe ata të Drejtësisë së nëntë shteteve anëtare të BE-së dhe të shtronin nevojën dhe të diskutonin masat për intensifikimin dhe përqendrimin e bashkëpunimit policor në tri drejtime kryesore:

- angazhimi i profesionistëve kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, këmbimi i përvojave dhe pajisjeve;
- zhvillimi i takimeve dhe i mbledhjeve të shefave të policive të shteteve të Europës; dhe
- konferencat e ministrave të Policive të shteteve të Europës (Latifi & Beka, 2013: 234). Por Europol-i nuk kufizohet me kaq. Ai ka krijuar, tashmë, disa nismat edhe me vende të tjera jashtë BE-së, përfshirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe me organizatat ndërkombëtare.

Progres në punën e tij është arritur edhe me *fletarrestin europian*, i cili vlen në mbarë BE-në, qysh prej muajit janar 2004. Urdhërarresti mund të jepet për këdo që akuzohet për kundërvajtje, për të cilën dënimi më i vogël është një vit burgim. Fletarresti europian është formuluar për të zëvendësuar procedurat e gjata të ekstradimit (Borçard, 2010:37).

Europol-i ka lidhjet e tij edhe me Kosovën. Por Policia e Kosovës bashkëpunon me këtë institucion përmes Misionit të BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, e, gjithashtu, shfrytëzohen edhe kontaktet me vendet anëtare për të shkëmbyer informata me Europol-in.

Në fakt, Kosovës i duhet të nënshkruajë Marrëveshje Strategjike dhe Operacionale me Europol-in, siç kanë bërë shtetet e tjera të rajonit, si dhe të bëhet anëtare e organizatave rajonale dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të mund të ofrojë kontributin në fushën e sigurisë sidomos për qytetarët e Kosovës dhe të Europës, në tërësi. Por për momentin Kosova nuk mund të nënshkruaj një marrëveshje bilaterale me Europolin. Prandaj i është sugjeruar Kosovës që, në bazë të kontakteve dhe të takimeve me to, Policia e Kosovës mund të krijojë Ekipet të Përbashkëta Hetuese me shtete individualisht apo edhe në mënyrë kolektive, kur këto shtete i lidh interesi i përbashkët për ndonjë hetim të caktuar.

3.8. Shoqatat ndërkombëtare policore

Sot në botë përveç Interpol-it dhe Europol-it ka edhe disa organizime të tjera ndërkombëtare të policive të vendeve të ndryshme, në formë shoqatash. Këto, ndoshta, nuk kanë attribute të rëndësishme dhe autoritare apo vendimmarrëse në organizimin dhe zhvillimin në praktik të BNP, lidhur me veprimet konkrete hetimore apo operacionale,

por me veprimtaritë e tyre ato japin një kontribut në afrimin, në lidhjet, kontaktet ndërmjet kuadrove drejtuese të strukturave policore të vendeve e rajoneve të ndryshme, në këmbimin e përvojave dhe të ideve dhe në organizimin e vizitave a të aktiviteteve të përbashkëta.

Si të tilla, përmendim këtu Shoqatat ndërkombëtare policore **IACP** dhe **IPA**.

Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë (IACP) u themelua në vitin 1893 në Çikago, Ilinois, të SHBA. Fillimisht, ajo kishte për qëllim të shërbejë si një mjet për të kapur dhe për të kthyer kriminelët, që kishin ikur nga juridiksioni i agjencisë, në të cilën ata ishin të kërkuar. Shoqata është rritur për të shërbyer si organizata më e madhe e shefave të policisë në botë (International Association of Chiefs of Police, FY 2011-2016 Strategic Plan, August 2010:2).

Si një organizatë e lidërshipt, misioni i Shoqatës është të çojë më përpara shërbimet profesionale të policisë, të promovojë praktikën e zgjeruar të policisë administrative, teknike dhe operacionale, të nxisë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe të përvojës mes drejtuesve të policisë dhe organizatave policore të njohura në të gjithë botën, të rekrutojë dhe të trajnojë personat e kualifikuar në profesionin e policisë dhe të inkurajojë të gjithë personelin policor në mbarë botën për të arritur dhe për të ruajtur standardet më të larta të etikës, integritetit, ndërveprim të komunitetit dhe sjelljes profesionale (Kushtetuta e IACP-së, neni 1, paragrafi 2).

Policia e Kosovës, përmes autoriteteve të larta të saj, prej disa vitesh ka kontakte me Shoqatën **IACP**. Ata kanë vizituar drejtuesit e saj atje, kanë shkëmbyer përvojë dhe informacione të ndryshme me shefat e policive të tjera në zyrat e kësaj shoqate.

Kontaktet e zyrtarëve të Policisë së Kosovë me kolegë të huaj kanë ardhur duke u shtuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në rrjetet e bashkëpunimit ndërkombëtar policor të rregullt.

Shoqata Ndërkombëtare Policore (IPA). Ideja për krijimin e një asociacioni të përbashkët të policisë ndërkombëtare është shfaqur herët dhe, zyrtarisht, ajo u formua më 1 janar 1950. Për të treguar historinë e IPA-s, duhet njohur historinë e Arthur Troop dhe për të kuptuar krijimin dhe formimin e Shoqatës Policore Ndërkombëtare, duhet të kuptojmë ngjarjet e asaj periudhe (Gordon, 2013: 8).

Misioni i saj është të krijojë lidhje miqësie dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet oficerëve në pension dhe aktivë të policisë nëpër botë (<http://www.ipa-usa.org/>). Ajo është e angazhuar për parimet e përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të miratuar nga Kombet e Bashkuara, në vitin 1948.

Funksionet e Shoqatës përfshijnë edhe zhvillimin e marrëdhënieve kulturore mes anëtarëve të saj, zgjerimin e njohurive të tyre të përgjithshme dhe shkëmbimin e përvojës profesionale. Përveç kësaj, ajo nxit ndihmën e ndërsjellë në sferën sociale dhe kontribuon, brenda mundësive të saj, për bashkëjetesë paqësore mes popujve dhe për ruajtjen e paqes në botë. (International Police Association, 2013).

Në mesin e verës të vitit 2015 një zyrtar i kësaj Shoqate vizitoi Policinë e Kosovës dhe ofroi mbështetjen e IPA-s për anëtarësimin e Kosovës në radhët e saj dhe për krijimin e lidhjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar të Policisë së Kosovës me policitë e vendeve të ndryshme.

3.9. Roli i organizatave të tjera ndërkombëtare dhe i ambasadave të akredituara në Kosovë

Roli i organizatave ndërkombëtare që kanë vepruar dhe veprojnë në Kosovë, pa dyshim, ka qenë domethënës në zhvillimin dhe shtimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të strukturës policore kosovare. Ky rol është ndier sidomos në mbështetjen profesionale dhe logjistike që u janë dhënë institucioneve të zbatimit të ligjit në vendin tonë e sidomos Policisë së Kosovës. Kjo ndihmë ka qenë evidente që nga themelimi i PK dhe vazhdon edhe tani në forma dhe në përmasa të ndryshme.

Një rol të pamohueshëm në krijimin edhe në zhvillimin e Policisë së Kosovës kanë dhënë OSBE-ja, ICITAP-i, si edhe ambasadat e huaja të akredituara në Kosovë. Me bashkëpunimin dhe kontributin e tyre, jo vetëm është mbështetur financiarisht Policia e Kosovës, por edhe janë organizuar e zhvilluar shumë aktivitete për trajnimin e kuadrove dhe efektivave të policisë në aspekte të ndryshme të kualifikimit profesional, por edhe praktik, për luftën kundër krimit dhe terrorizmit.

Me të tilla veprimtari të përbashkëta ndërkombëtare është krijuar një bazë e mirë për një bashkëpunim të mirëfilltë ndërkombëtar të Policisë së Kosovës. Pas luftës në Kosovë, UNMIK-u dhe OSBE-ja, në bashkëpunim, morën përsipër dhe punuan e kontribuan për krijimin dhe zhvillimin e Shërbimit Policor të Kosovës. Këto organizma ndërkombëtarë i sinkronizuan detyrat e tyre në këtë drejtim. Konkretisht, Policia e UNMIK-ut kishte detyrë të krijonte strukturën e SHPK-së dhe monitorimin e saj, ndërsa OSBE-ja u mor me menaxhimin e Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës.

Krahas rolit udhëheqës që Misioni i OSBE-së në Kosovë luante në të gjitha çështjet që lidhen me institucionet dhe me ndërtimin e demokracisë, me të drejtat e njeriut, me qeverisjen e mirë, me barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen qytetare, mandati i tij kishte në

qendër të punës trajnimit e personelit gjyqësor dhe të Policisë së Kosovës (OSCE, Mandate: <http://www.osce.org/kosovo/105907>.)

OSBE-ja që nga fillimi i pranisë së saj në Kosovë ka ndihmuar në organizimin e një numuri të konsiderueshëm veprimtarish trajnuese dhe kualifikuese të zyrtarëve dhe oficerëve të PK-së, duke i rritur ata profesionalisht dhe duke i aftësuar më tej në luftën kundër krimit.

Ndër trajnimet më kryesore, përmendim: luftimi i krimit të organizuar ndërkufitar, teknikat e hetimit të drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, trajnimi praktik: stimulimi i operacioneve policore; trajnimi kundër motivimit fetar të terrorizmit; trajnimi kundër terrorizmit dhe ai për të drejtat e njeriut (Raport nga Departamenti i Personelit të PK-së, 2014).

Gjithashtu, vlen të theksohet se në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë, rol të veçantë kanë luajtur edhe ambasadat e shteteve të akredituara në vendin tonë, si dhe institucione tjera të BE-së. Përfitimet nga kjo ndihmë e çmuar kanë qenë të mëdha. Një pjesë e mirë e personelit policor kanë kaluar në grupet dhe aktivitetet e trajnimit të organizuara nga ambasadat e huaja dhe kanë dalë prej tyre më të përgatitur për t'u përballur me sfidat e kohës.

Ambasada e Austrisë në Prishtinë ka organizuar një numër të konsiderueshëm trajnimesh. Ato kanë konsistuar në çështje të tilla të mprehta të fushës policore, si zhvillimi i strategjive, i metodave, instrumentet e menaxhmentit, teoritë organizative etj.

Nga një shikim i kontributeve të dhëna në zhvillimin dhe shtimin e BNP në Kosovë, rezulton se një rol të padiskutueshëm në këtë drejtim ka luajtur dhe luan ambasada e SHBA. Veprimtaritë e saj për trajnimit e personelit policor të Kosovës kanë qenë të një niveli të lartë shkencor e profesional. Përfitime të mëdha ka pasur Policia e

Kosovës sidomos në trajnimet në Marshall Center-Gjermani, në trajnimet akademike për zbatim të ligjit ndërkombëtar (ILEA-Budapest) dhe ILEA-Rosvell-SHBA, në trajnimet për mbrojtjen e kufijve ndërkombëtarë (IBIT II), për teknikat e analizave financiare, në trajnimet për lidërsip dhe menaxhment etj. Ka qenë një privilegj i madhe për ata pjesëtarë të Policisë së Kosovës që janë njohur me përvojën amerikane dhe atë botërore dhe që kanë marrë prej saj në këto trajnime.

Një ndihmë të posaçme i ka dhënë Policisë së Kosovës edhe Departamenti i Drejtësisë së SHBA, i cili, së bashku me ICITAP-in/programi Anti-TIP dhe OPDAT, ka zhvilluar kurset mbi teknikat e vëzhgimit dhe mbi trajtimin e informatorëve. ICITAP-i ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë me zhvillimin e kurseve të gjuhës angleze, me trajnime taktike mbi vijën e gjelbër për policinë kufitare, me analizat e avancuara kundër pastrimit të parave, me trajnime për task-forcën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të drogave dhe korrupsionit publik etj. (Raporti vjetor i PK-së, 2010).

Nuk ngelet pas edhe ambasada gjermane, e cila, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe duke u vënë në ndihmë të saj, ka organizuar e zhvilluar trajnime mjaft cilësore lidhur me menaxhimin e ngjarjeve të mëdha; për bazat e terrorizmit etj.

Në kuadrin e këtij bashkëpunimi ndërkombëtar të gjerë dhe intensiv me institucionet e organizmat ndërkombëtare, Policia e Kosovës ka pasur edhe mbështetjen e fuqishme nga BE-ja, sidomos në problemet e luftës antikorruption. Shumë të dobishme kanë qenë kursi që BE-ja ka zhvilluar lidhur me hetimet ndaj korrupsionit, si dhe seminari trajnues që organizoi Komisioni European mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe të formave tjera të krimeve të rënda: instrumentet ligjore ndërkombëtare.

Kursi dhe seminari shërbyen si një shkollë e vërtetë për personelin policor kosovar, i cili u njoh në mënyrë të thelluar me këto problematika, në rrafshin teorik, organizativ dhe praktik.

Po ashtu, nga KE-ja, në kuadër të projektit të binjakëzimit, janë zhvilluar një varg trajnimesh me vlerë për zyrtarët tanë policorë. Përmendim këtu trajnimet lidhur me aftësitë komunikuese dhe marrjen në pyetje (C7.9, C7.10, C7.11, C7.12); me hetimin për trafikimin e qenieve njerëzore; lidhur me trajtimin e refugjatëve; me marrëveshjet specifike për kufijtë ndërkombëtarë; me çështjet në lidhje me kalimin e kufirit dhe me informatat e shkurtra mbi çështjet e vizave. Në to, personeli policor ka fituar shumë njohuri, shprehuri dhe aftësi praktike për përballimin si duhet të tyre.

Edhe shtete të tjera, si Italia dhe Turqia, kanë zhvilluar me Policinë e Kosovës një numër të konsiderueshëm trajnimesh, kryesisht, operative hetimore.

Me shumë rëndësi është edhe fakti që në sajë të bashkëpunimit të mirë ndërkombëtar të Policisë së Kosovës, është bërë e mundur që personeli i saj të marrë pjesë edhe në një numër të konsiderueshëm trajnimesh të specializuara jashtë vendit. Disa veprimtari të tilla janë zhvilluar në Turqi, si trajnime të kualifikuara në Akademinë e Inteligjencës Turke-ISAK &T dhe ADOC, lidhur me inteligjencën, me hetimet e kontrolluara rajonale dhe me dërgesat e kontrolluara në rajonet e trafikimit të drogës. Të gjitha këto janë organizuar me mbështetjen e OSBE-së (Raport nga Departamenti i Personelit dhe Trajnimeve, 2014).

3.10. Bashkëpunimi me agjencitë e huaja ligj-zbatuese në Kosovë

Këtu është fjala për bashkëpunimin e Policisë së Kosovës me organizmat e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, qoftë ushtarake apo civile. Prania ushtarake ndërkombëtare në vendin tonë përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht, Nenin 153 i Kushtetutës. Ajo ka mandat dhe pushtet të përcaktuar në instrumentet ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Pas Deklaratës së Pavarësisë, institucionet e Republikës së Kosovës mirëpritën edhe praninë civile ndërkombëtare për mbikëqyrjen e Planit të Ahtisarit dhe misionin e BE-së për Sundimin e së Drejtës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës: 2008). Në bashkëpunim të ngushtë me to janë bërë dhe bëhen përpjekje të vazhdueshme për të kordinuar aktivitetet në fushën e sundimit të ligjit. Qeveria e Kosovës, EULEX-i dhe Zyra e Bashkimit European kanë themeluar Bordin e Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e së Drejtës (BPBSD) për bashkëpunim të përgjithshëm strategjik të përpjekjeve të tyre të përbashkëta për reforma në fushën më të gjerë të sundimit të së drejtës në Kosovë. Ky bord bashkëkryesohet nga zëvendëskryeministri i Kosovës dhe nga Kryesuesi i Misionit të EULEX-it. Në bord përfshihen edhe kryesuesit e komponenteve të ndryshme të EULEX-it, si dhe ministrat e Drejtësisë, të Punëve të Brendshme, të Financave, drejtuesin e Policisë së Kosovës etj.

(http://www.clingendael.nl/publications/2011/20110106_CRU_publication_mderks.pdf).

Bordi ofron mbikëqyrje të nivelit të lartë të progresit sidomos në reformimin e sektorit të sundimit të ligjit. Këto reforma bazohen në qasjen e programit të EULEX-it për mentorim, monitorim dhe këshillim nga personeli i EULEX-it dhe të Procesit të

Stabilizim Asociimit. Nga ana e saj, Policia e Kosovës i ka mundësuar EULEX-it qasje në sistemin e informatave të Policisë dhe atë të menaxhimit të kufirit. Ndarja e informatave të tilla shërben në hetimin e rasteve të rënda penale, por PK-ja dhe EULEX-i, duhet të synojnë të formalizojnë shkëmbimin e informatave për çështje penale dhe inteligjencë në aranzhimet teknike.

(<http://eurex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2013:0066:FIN:EN:P>).

Me rëndësi është edhe vendosja e Qendrës së përbashkët për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK). Qeveria e Kosovës ka zhvilluar disa nismat për ngritjen e bashkëpunimit rajonal, me theks të veçantë bashkëpunimin me vendet fqinje në çështjet e kontrollit kufitar. Si rrjedhojë, Policia Kufitare ka bashkëpunuar në mënyrë aktive me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi për të ndërtuar qendra të përbashkëta të informatave dhe zhvillimin e bashkëpunimit operacional përmes patrullimeve të përbashkëta të kufijve tokësorë ndërmjet këtyre shteteve. Gjatë periudhës së verës Shqipëria dhe Kosova kanë funksionuar si një pikë e vetme kufitare në Vërmicë dhe dy qeveritë tanimë kanë plane për të funksionalizuar të gjitha pikat reciproke kufitare në baza të përbashkëta.

(<http://www.europarl.europa.eu/committees/en/studiesdownload.html?languageDocument=EN&file=75711>).

Për kryerjen me sukses të detyrave Njësia Kundër Terrorizmit e PK-së ka bashkëpunuar ngushtë me njësitë e tjera: KFOR-in, Qendrën e Inteligjencës Financiare (FIC) dhe njësi të ndryshme të policisë së UNMIK-ut (Raporti vjetor i PK-së, 2008:14).

Një fushë ku ka pasur bashkëpunim ndërkombëtar ka qenë edhe ajo e sektorit hetimeve të krimeve kibernetike. Rastet që trajtohen nga ky sektor janë: pornografia e fëmijëve përmes internetit, sulme në ueb-faqe (qeveritare, të institucioneve të ndryshme

publike, kompani biznesi etj.), vjedhje e identitetit (porositë apo blerjet me karta krediti), vendosja e skimerëve nëpër bankomate, kërcënime përmes e-mail-it, përfshirë edhe ndaj personaliteteve të rëndësishme publike dhe institucioneve, mashtrime në internet përmes ofrimit të shërbimeve të ndryshme etj.

Ky sektor ka pranuar një numur të konsiderueshëm kërkesash nga shtetet tjera, që kanë të bëjnë me raste të ndryshme të krimeve kibernetike. Sipas statistikave të pranuara, ky sektor ka pasur katër raste me bashkëpunim ndërkombëtar, me Maqedoninë, viti 2013, me Çekinë, 2014, SHBA, 2014, dhe me Gjermaninë në vitin 2015. Fillimisht, janë pranuar informata nga shtetet përkatëse për ekzistimin e dyshimit se shtetas nga Kosova kanë kryer veprën penale në shtetin përkatës përmes sistemit kompjuterik. Kanë pasuar shkëmbimi i informatave në nivel policor, si dhe takimet policore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i këtij sektori, mund të vlerësohet si pozitiv. Si rezultat janë zbuluar tri vepra penale dhe janë arrestuar pesë persona. Të arrestuarit janë të gjinisë mashkull, të moshës 20-35 vjeç, të kombësisë shqiptare. Rastet për të cilat ka pasur bashkëpunim ndërkombëtar policor janë vepra penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Neni 339 – Hyrje në sisteme kompjuterike dhe Neni 307-Keqpërdorimi i kartave bankare dhe të kreditit.

Lidhur me rastet që dalin, sektori i merr kërkesat përmes ILECU-t, dhe varësisht prej kërkesave, ai vepron në kohë dhe aktivisht.

Gjitashtu, personeli i këtij sektori ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme kualifikimi, si projekte, trajnime, konferenca, seminare etj.

KAPITULLI IV: BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR POLICOR NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

4.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër terrorizmit si domosdoshmëri globale

Terrorizmi po shfaqet si një fenomen global mjaft i vështirë për t'u luftuar. Në shpërthimin dhe përhapjen e tij kanë kontribuar edhe vetë proceset e globalizimit, rritja e shpejtësisë së komunikimit dhe të transportit, zhvillimi dhe shtimi i teknologjisë së mjeteve elektronike të informimit. Këto bëjnë që në shumë raste, terrorizmi të shihet edhe si reagim ndaj globalizimit të mbarë shoqërisë. Fotografitë e njerëzve të vrarë apo të gjymtuar nga sulmet terroriste në restorante ushqimi, në zyrat e ndërtesave, në autobusë dhe trena, apo përgjatë rrugëve normale janë sinjal për veprime (Eubank & Weinberg, 2006). E definuar gjerësisht si dhunë e motivuar politikisht e kryer kundër qaveve të paarmatosura nga grupe “nën-nacionale” ose “agjentë klandestinë” (Perl, 2010: 31), duhet të ndërgjegjësoj shtetet që të anashkalojnë nganjëherë edhe armiqësitë që kanë, me qëllimin sepse e kanë të njëjtin armik të përbashkët.

Veçanërisht në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI rreziku nga terrorizmi e ka alarmuar botën. Sulmet terroriste në fillimet e këtij shekulli ndryshuan rrjedhën e historisë botërore në luftën kundër së keqes së përbashkët ndërkombëtare. Tani dallimi midis sulmeve terroriste të brendshme dhe atyre të jashtme, veçanërisht kur në to përfshihen rrjete ndërkombëtare, është zbehur shumë. Për shembull, sulmet e Londrës në vitin 2005, vërtet u kryen nga qytetarë britanikë, por kjo nuk do të thotë se ato ishin thjesht sulme të brendshme, pasi qëllimi i terroristëve vetëvrasës kishte dimensione të qarta ndërkombëtare. Edhe fakti që Europa Perëndimore është bërë aktualisht skena më e madhe e dhunës së terroristëve, që vijnë nga jashtë saj,

flet se terrorizmi sot ka karakter transnacional. Përdorimi i forcës kundër njerëzve të paarmatosur me qëllim të arritjes së objektivave politike përmes dhunës (Aubrey, 2004: 11), lirisht mund të themi se pasqyron esencën e terrorizmit si fenomen negativ në shoqërinë bashkëkohore.

Duke qenë se terrorizmi nënkupton veprat e ndryshme penale të drejtuara kundër shtetit, të kryera nga individët ose grupet e ndryshme të personave në shtetin e vet ose në shtetin e huaj, për të realizuar qëllimin e caktuar politik” (Rebman,1985:1736) dhe se “terrorizmi konsiston në akte të dhunshme kundër individëve dhe pasurisë së tyre, që përbëjnë vrasje, sulme serioze kundër personave, dëme kriminale, sulme me armë zjarri apo që shkaktojnë shpërthime (Bonner, 2007: 16), në të drejtën ndërkombëtare ai konsiderohet sot si një nga krimet më të rënda ndërkombëtare.

Si një kërcënim dhe rrezik global, terrorizmi është edhe një faktor që i shtyn shtetet të bashkëpunojnë në luftë kundër tij, edhe përkundër divergjencave të mëdha që kanë ndërmjet tyre. Kjo, sepse trajtimi dhe përballimi i tij nga shtetet individualisht është i pamundur. Megjithatë duhet thënë se ka ende shtete, qeveritë e të cilave duhet të ndërjegjësohen dhe të ngrihen mbi armiqësitë dhe mbi mosmarrëveshjet që mund të kenë midis tyre, që t’i anashkalojnë ato dhe të bashkohen kundër të njëjtit armik të përbashkët, krimit transnacional dhe terrorizmit ndërkombëtar.

Duke e pasur parasysh këtë, secili shtet ndihet i detyruar të kërkojë ndihmë, por edhe t’u japë ndihmë shteteve të tjera që kërcënohen prej akteve terroriste. Sepse, siç thotë Schmid, bëhet fjalë për një fenomen mjaft dinamik: terrorizmi ndryshon paralelisht me instrumentet e dhunës dhe të komunikimit, duke bërë të ndryshojë edhe konteksti në të cilin vepron, dhe rrënjët e ka në paknaqësit politike (Schmid, 2011: 2).

Bashkëpunimi ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe rolin e diplomacisë, janë thelbësisht të rëndësishme për një përpjekje të suksesshme kundër kërcënimit terrorist, pasi terrorizmi ndikon në sigurinë dhe stabilitetin politik dhe ekonomik të kombeve. Aktet e terrorizmit ndërkombëtar përfshijnë qytetarët ose territorin e më shumë se një kombi, dhe terroristët janë duke zgjeruar veprat e tyre rajonale dhe globale,” (Great Britain: Parliament: House of Commons: Foreign Affairs Committee, 2005-2006). Edhe kreu i OKB-së pohon se “Terrorizmi është një nga kërcënimet kryesore në shoqërinë bashkëkohore të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Autorët e akteve terroriste minojnë të drejtat e njeriut, liritë themelore të njeriut dhe sundimin e ligjit, të cilat janë shtyllat e stabilitetit ndërkombëtar (Ban Ki-Moon, 2008).

Për zhvillimin efektiv të bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit OKB-ja, luan rolin kryesor dhe shumë të rëndësishëm në këtë fushë, ka nxjerrë instrumente të ndryshme universale dhe regjionale. Dihet që OKB-ja është një organizatë botërore ku diskutohet fuqishëm dhe bëhet trajtimi serioz i krizave ndërkombëtare, i motiveve politike të luftërave dhe akteve terroriste etj., si dhe ku merren vendime për t’i parandaluar dhe reduktuar ato. Gjithashtu, ajo është forumi për zhvillimin dhe miratimin e konventave ndërkombëtare, që i ofrojnë komunitetit ndërkombëtar, instrumente të përbashkëta për të luftuar terrorizmin në të gjitha format dhe manifestimet e tij (Ban Ki Mun, 2008). Si e tillë, ajo është një faktor sensibilizues dhe determinues për bashkëpunim ndërkombëtar dhe për lëvizje pozitive në këtë luftë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar midis vendeve, organizatave ndërkombëtare policore dhe strukturave policore vendore përbën një teknikë të rëndësishme antiterroriste. Agjencitë e sigurisë dhe ato policore, vërtet operojnë mirë në territorin e shtetit të tyre, por duhet pranuar që shërbimet kombëtare të informacionit nuk e kanë

kapacitetin dhe efikasitetin e të dhënave që kanë organizatat ndërkombëtare policore. Lufta kundër këtyre dukurive globale kërkon, jo vetëm bashkëpunim dhe bashkëveprim intensiv midis shteteve, por edhe kohë, mjete dhe para të shumta, infrastrukturë ligjore ndërkombëtare dhe burime njerëzore të gatshme dhe të përgatitura për t'u përballur me to. Shtetet e fuqishme, sidomos SHBA dhe shtetet e Europës, si Gjermania, Britania e Madhe, Franca etj., po përpiqen të japin tonin për të realizuar një bashkëpunim të fuqishëm ndërkombëtar kundër terrorizmit. Angazhimi i koalicioneve të shteteve të ndryshme, sidomos në rajone të tilla, si Lindja e Mesme dhe në Afganistan, po synon shkatërrimin e organizatave dhe të rrjeteve terroriste, si Al Qaeda, dhe të rrjeteve tjera, që kanë dalë tani, si ISIS (Shteti Islamik në Irak dhe Siri), si dhe arrestimin e të dyshuarve për akte terroriste.

Por, për të qenë e suksesshme kjo luftë, kërkohet një rreshtim maksimal, edhe i qeverive të tjera, edhe i organizatave dhe bashkimeve të tjera ndërkombëtare, kontinentale e rajonale, madje, edhe i institucioneve shkencore, i komuniteteve akademike dhe të komunikimit, që japin kontributin e tyre në shpjegimin e dukurive dhe problematikave që lidhen me terrorizmin dhe kriminalitetin. Ato duhet të ndihmojnë edhe më shumë vendimmarrësit dhe hartuesit e politikave, si dhe të bëjnë sqarimin dhe sensibilizimin e mbarë opinionit publik.

Pavarësisht debatit mbi natyrën e lidhjes ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit, është bërë e qartë se shtetet anëtare besojnë se ato mund të forcojnë veprimet e tyre kundër terrorizmit duke e fokusuar vëmendjen e tyre në forma të tjera të veprimtarisë kriminale që i paraprijnë ose shoqërojnë krimet terroriste (United Nations Handbook on Criminal Justice Responses to Terrorism, 2009: 28). Edhe shërbimet policore duhet të kapërcejnë kufijtë shtetërorë dhe të zhvillojnë një bashkëpunim të

gjithanshëm dypalësh e shumëpalësh për t'i luftuar me sukses këto dy rreziqe aktuale globale. Sipas studiuesit Garrison, terrorizmi mund të kuptohet si një mjet që ka shtatë komponente kryesore. (1) është i qëllimshëm, (2) ka një arsye, (3) akti i dhunës, (4) kryhet për të arritur një qëllim politik (5) duke shkaktuar frikë (6) në objektiv audienca ose te shoqëria (7), për të ndryshuar sjelljen në atë audiencë apo shoqëri, (Garrison, 2003: 41).

Sa i përket rajonit të Ballkanit, mund të themi se Ballkani Perëndimor, pjesë e të cilit është edhe Kosova, deri tani nuk ka pasur veprime të realizuara që mund të shquhen si terroriste, përkundër kërcënimeve të shumta ndaj institucioneve dhe objekteve me rëndësi shtetërore. Kjo ka qenë arsyeja që nuk ka edhe ndonjë aktivitet konkret dhe bashkëpunimi mes shteteve të rajonit përveçse shkëmbimit të informatave.

Megjithatë, edhe në rajonin tonë nuk ka vend për të fjetur mendjen. Kosova dhe shtetet aleate nuk janë të imunizuara nga terrorizmi, ndaj edhe mund të kërcënohen, qoftë edhe duke u nisur nga fakti i angazhimit të tyre në luftën globale kundër terrorizmit, si dhe nga fakti tjetër që në Kosovë dhe gjetkë ka prezencë ndërkombëtare.

Në vitin 2014, në Prishtinë, Policia e Kosovës ka arrestuar një person të nacionalitetit serb, shtetas nga Serbia, i cili kishte në veturë me dhjetëra kilogramë eksploziv tritol, që dyshohej se ishte përgatitur për ta shpërthyer në vend publik. Sasia e eksplozivit u konfiskua dhe ndaj tij ende është duke vazhduar gjykimi në Kosovë.

Por kryesorja është që të gjitha shtetet, ashtu dhe Kosova, duhet të jenë të përgatitura dhe të marrin masa parandaluese të akteve të befasishme terroriste dhe që të jenë në gjendje për t'i luftuar dhe ndëshkuar autorët e tyre. Kjo, pa dyshim, arrihet edhe nëpërmjet bashkëpunimit të rregullt ndërkombëtar policor.

Nga ana tjetër, krahas bashkëpunimit ndërkombëtar për luftën kundër

terrorizmit, është e nevojshme të vihen në lëvizje edhe mundësi tjera “paqësore”, që ndihmojnë parandalimin e akteve dhe të veprave terroriste. Si të tilla, kemi parasysh promovimin e aktiviteteve humane, kulturore dhe sportive ndërkombëtare, të cilat përçojnë mesazhe të paqes, të harmonisë, të miqësisë dhe të bashkëpunimit. Për këtë duhet të angazhohen, së pari, organizmat dhe institucionet ndërkombëtare.

Po ashtu në bashkëpunimin ndërkombëtar për luftimin e terrorizmit nuk mund të anashkalohet edhe shqetësimi që ka lindur për bashkësinë ndërkombëtare nga fakti që shpesh terrorizmi lidhet me krimin e organizuar ndërkombëtar. Ky shqetësim është pasqyruar edhe në paragrafin 4 të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së (R/1373 2001). Këshilli i Sigurimit theksoi me shqetësim lidhjet e ngushta midis terrorizmit dhe krimit të organizuar, sidomos me krimet që kanë të bëjnë me trafikimin e paligjshëm të armëve, me lëvizjen e paligjshme të armëve bërthamore, kimike, biologjike dhe të tjera materialeve potencialisht vdekjeprurëse, por edhe me prodhimin dhe trafikimin e drogave të paligjshme, me pastrimin e parave etj. Të veshur nën petkun e krimit të organizuar, kriminelët dhe terroristët bashkëpunojnë për realizimin e qëllimeve të tyre. Zakonisht, dallimi ndërmjet tyre është bërë duke iu referuar rezultateve të tyre: kriminelët kërkojnë përfitim derisa terroristët kanë motive politike dhe në mënyrë specifike kërkojnë që ta dobësojnë shtetin. Problemi në shumë raste është që të bëhet dallim ndërmjet motiveve politike nga pushteti politik (Wardlaw, 1998).

Rreth kësaj çështjeje të lidhjes ndërmjet terrorizmit dhe krimit të organizuar, kanë lindur debate, si brenda, edhe jashtë Kombeve të Bashkuara. Por pavarësisht debatit, shtetet anëtare po forcojnë veprimet e tyre kundër terrorizmit, duke u fokusuar edhe në forma të tjera të veprimtarisë kriminale që i paraprijnë ose shoqërojnë krimet terroriste (United Nations Handbook on Criminal Justice Responses to Terrorism, 2009:

28). Madje kjo shihet si një domosdoshmëri, pasi praktika tregon se terroristët kanë tendencë të jenë të përfshirë në instrumente të kriminalitetit të organizuar, të paktën, në dy mënyra. *Së pari*, në mungesë të mjeteve të tjera financiare, terroristët janë të detyruar të merren me forma të ndryshme të krimeve fitimprurëse konvencionale, për të mbështetur veten e tyre dhe të financojnë aktivitetet e tyre terroriste. *Së dyti*, në mungesë të qasjes normale në disa nga mjetet që ata kërkojnë për të kryer aktivitetet e tyre, terroristët të jenë të përfshirë në krime të atilla që u sigurojnë këto mjeteve (United Nations Handbook on Criminal Justice Responses to Terrorism, 2009: 29).

Nga kjo del se, paraprakisht, ekziston nevoja që të intensifikohet bashkëpunimi ndërkombëtar në dy fronte, edhe kundër kriminalitetit të organizuar, edhe kundër terrorizmit, gjë që do të ndikonte në rritjen e efikasitetit të këtij bashkëpunimi dhe në arritjen prej tij të rezultateve të dëshiruara.

4.2. Parimet themelore të bashkëpunimit ndërkombëtar kundër terrorizmit

Bashkëpunimi ndërkombëtar i shteteve në luftimin e terrorizmit mbështetet mbi bazën e disa parimeve, ndër të cilat, më themeloret janë: kriminalizimi i akteve terroriste; baza ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar kundër terrorizmit, instrumentet për bashkëpunim, obligimet e shteteve për bashkëpunim ndërkombëtar kundër terrorizmit, respektimi i të drejtave të njeriut etj. Shtetet kanë për detyrë të mbrojnë shoqëritë e tyre dhe të kontribuojnë në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, dhe terrorizmi konsiderohet si diçka që duhet shtypur dhe të kundërshtohet nga të gjithë anëtarët e komunitetit ndërkombëtar (Conte, 2010: 369).

Kriminalizimi i akteve të terrorizmit. Kriminalizimi i akteve terroriste është paraparë, si me konventa ndërkombëtare, ashtu edhe me ligjet nacionale; me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit; me instrumente universale; me instrumente rajonale dhe me

legjislationin kombëtar (UNODC-*United Nations Office On Drugs And Crime*, Manual on International Cooperation in Criminal Matters related to Terrorism, 2009: 5).

Vetëm mbi bazën e këtyre akteve juridike dhe dokumenteve të miratuara duhet vepruar kur është fjala për të vendosur se një akt apo veprim përbën terrorizëm dhe duhet të gjykohet e të ndëshkohet si i tillë. Duhet pasur mirë parasysh që aktet e terrorizmit, si rregull, karakterizohen si kriminale në bazë të ligjeve kombëtare, por edhe atyre ndërkombëtare. Kur veprohet jashtë përcaktimeve që përmbajnë këto ligje dhe dokumente, u lihet shteg voluntarizmave, dëshirave të njërit apo tjetrit që mund të ndërmarrin edhe veprime që mund të kenë rrjedhoja negative.

Zgjedhja e bazës ligjore. Ky kriter ka parasysh domosdoshmërinë që, për të përcaktuar mirë se cila nga të gjitha ato instrumente ligjore që ekzistojnë është e përshtatshme në një rast të veçantë. Lidhur me këtë, praktikuesi duhet të marrë parasysh: hierarkinë e standardeve ndërkombëtare; fushën e instrumenteve; traditën ligjore të shteteve lidhur me zbatimin e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare në të drejtën e brendshme (UNODC-*United Nations Office On Drugs And Crime*, Manual on International Cooperation in Criminal Matters related to Terrorism, 2009: 5).

Bazën ligjore për bashkëpunim ndërkombëtar midis shteteve në luftimin e terrorizmit e paraqesin konventat e dala nga Kombet e Bashkuara, traktatet rajonale dhe bilaterale, rezolutat, statutet, rregulloret, strategjitë, ligjet, raportet dhe akte të tjera administrative, të cilat i japin një frymë dhe impuls burimor trajtimit dhe përpjekjeve për luftimin e terrorizmit përmes bashkëpunimit ndërshtetëror.

Prej konventave ndërkombëtare kundër terrorizmit më të rëndësishme përmendim: Konventa ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, 1999, Konventa ndërkombëtare për ndalimin e akteve të terrorizmit bërthamor, 2005;

Konventa e Organizatës së Shteteve Amerikane për Parandalimin dhe Ndëshkimin e akteve të terrorizmit, duke marrë formën e Krimeve kundër Personave dhe lidhur me grabitjet që janë me rëndësi ndërkombëtare, 1971; Konventa Europiane për shtypjen e terrorizmit, e ndryshuar me Protokollin e saj, 1977; Konventa Rajonale për shtypjen e terrorizmit, e Shoqatës së Azisë së Jugut për Bashkëpunim Rajonal (SAARC) 1987; Konventa Arabe për Shtypjen e Terrorizmit, 1998, Traktati për Bashkëpunimin midis shteteve anëtare të bashkësisë së shteteve të pavarura në luftën kundër terrorizmit, 1999; Konventa e Organizatës së Konferencës Islamike për Luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, 1999; Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e terrorizmit, 1999 e Organizatës së Unitetit Afrikan (OUA) etj.

Duhet thënë se të gjitha konventat, si ato rajonale, edhe ato universale janë nxjerrë kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore. Por shihet qartë nga këto konventa të përmendura më lart se shumica e tyre është me karakter rajonal dhe se konventat me karakter universal janë më të pakta. Edhe pse do të ishte mirë që ato universale të jenë më shumë, përsëri duhet thënë se të gjitha konventat në fjalë përbëjnë një bazë të mirë për orientimin dhe zhvillimin si duhet të luftës kundër terrorizmit dhe sidomos të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë luftë. Rëndësi ka mbështetja në çdo rast në këto dokumente dhe instrumente dhe të vepruarit gjithmonë në përputhje rigoroze me to.

Obligimet që kanë shtetet për bashkëpunim ndërkombëtar kundër terrorizmit. Edhe ky është një kriter shumë i rëndësishëm, që duhet njohur mirë dhe që duhet ndjekur e zbatuar në përputhje me standardet e kërkuara.

Fakti që terrorizmi ndërkombëtar është bërë një kërcënim real dhe global, me pasoja katastrofale për njerëzimin, kërkon që secili shtet të ketë një qasje të guximshme, të ketë vullnet dhe gatishmëri për të marrë pjesë aktive në luftën kundër tij. Është pozitive që

shumë shtete sot në botë kanë ndërmarrë masa dhe kanë krijuar strategji për mbrojtje nga sulmet terroriste. Kjo tregon se ka një rritje të vetëdijes për rrezikun e madh që vjen nga terrorizmi, por duhet thënë që një vetëdije e tillë duhet ta ketë secili shtet edhe për nevojën e bashkëpunimit në luftën ndërkombëtare kundër këtij rreziku.

Dekada e fundit ka dëshmuar, nga njëra anë, se asnjë shtet nuk mund të jetë tërësisht i sigurt nga terrorizmi dhe, nga ana tjetër, se të gjitha shtetet kanë filluar të lëvizin, të ndërmarrin hapa në shërbim të luftës kundër terrorizmit, si hartimi i strategjive kombëtare, ngritja e kapaciteteve, si dhe ngritja e bashkëpunimit dhe e partneritetit ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit (Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit, 2009-2012:5). Kjo e bën edhe më të qartë se sa i domosdoshëm është ngritja e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor.

Disa reagime të qeverive të ndryshme dhe të institucioneve ndërkombëtare ndaj terrorizmit në shekullin XXI kanë ngritur edhe çështje të debatueshme, si rastet, kur për të arritur sigurinë dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut dhe aspekte të tjera të sundimit të ligjit, ndonjë subjekt është bazuar te dëshirat dhe në interesa të ngushta. Këto sjellje, që sigurisht nuk duhet ndodhin, të tërheqin vëmendjen për kujdesin që duhet të tregojnë shtetet që kriminalizimin e një akti apo një tjetri si terrorizëm ta bëjnë mbi baza të shëndosha, vetëm sipas ligjeve, dokumenteve dhe instrumenteve të përmendura më sipër.

Respektimi i të drejtave të njeriut gjatë bashkëpunimit ndërkombëtar

Çdo akt terrorist është në kundërshtim me ligjet e shteteve dhe me konventat ndërkombëtare, sepse, përveç dëmeve materiale, shkaktojnë edhe viktima, vdekje të shumta. Terrorizmi sulmon vlerat që shtrihen në zemër të Kartës së Kombeve të

Bashkuara, respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit, rregullat e luftës që mbrojnë civilët, tolerancën mes njerëzve dhe të kombeve dhe zgjidhjen paqësore të konfliktit.

Por edhe gjatë bashkëpunimit ndërkombëtar për luftën kundër terrorizmit mund të ndodhin eksese që mund të vënë në rrezik liritë civile të qytetarëve. Ky është një ndër shqetësimet e kohëve të fundit, i shfaqur në lidhje me përpjekjet antiterroriste në shumë vende. Pra, ekziston rreziku që disa prej masave të ndërmarra në kuadrin e antiterrorizmit mund të kërcënojnë liritë civile dhe të drejtat e njeriut. Kjo ndodh edhe pse në vendet demokratike ka disa kufij në mbledhjen e informacionit për individët, në kuadrin e ruajtjes së privatësisë, dhe këto kufij pengojnë zbulimin e elementëve kriminalë dhe terroristë, si dhe veprimet parandaluese. Në këto kushte, rritja e masave të sigurisë, ashpërsimi i kontrollove dhe i hetimevetë tjera me masa të rrepta mund të çojnë në shkelje të të drejtave të qytetarëve ose të rezidentëve të huaj.

Kjo ndodh, kur nuk respektohen procedurat e detyrueshme sipas konventave ndërkombëtare që është e papranueshme. Ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan, është shprehur me keqardhje për "dëmet kolaterale" të luftës kundër terrorizmit në të drejtat e njeriut. Raportet nga Amnesty International, Human Rights Watch, dhe Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të drejtat e njeriut, gjithashtu, kanë denoncuar abuzimin me të drejtat e njeriut në mbarë botën në emër të luftës kundër terrorizmit (Marangopoulos & Benedek, 2004: 3).

Në këtë kuptim, në çdo rast, lufta kundër terrorizmit është një sfidë e madhe. Shtetet kanë detyrë të domosdoshme për të mbrojtur popullsinë e tyre kundër akteve të mundshme terroriste dhe për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin në luftën kundër terrorizmit. Por në këtë proces në mënyrë të barabartë ato duhet të respektojnë

instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe në veçanti Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Europës dhe traktate të tjera të ratifikuara ndërkombëtare.

Lidhur me këtë kriter, në Kosovë trajtimi i kësaj çështjeje është rregulluar me shumë akte të brendshme dhe me ato të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në përputhje me aktet më të larta juridike ndërkombëtare, që u përmendën më sipër. Kujdes po tregohet që të mos ndodhin raste që bien në kundërshtim me këto dokumente të rëndësishme ndërkombëtare.

4.3. Masat shtetërore të Kosovës për BNP kundër terrorizmit

Duke e konsideruar terrorizmin ndërkombëtar si një rrezik permanent për vendin dhe si sfidë ndërkombëtare, Kosova e ka trajtuar atë si një problem shumëdimensional nga shumë aspekte. Në këtë kuadër ajo ka hartuar dhe po zbaton Strategjinë Kombëtare në luftën kundër terrorizmit, si dhe një kuadër të plotë ligjor bashkëkohor, i cili mundëson kontrollin, hetimin dhe ndëshkimin e akteve terroriste, të aktiviteteve që i mbështesin ato dhe të personave përgjegjës për kryerjen e tyre.

Ashtu si i gjithë komuniteti ndërkombëtar, edhe shteti i ri i pavarur i Kosovës e konsideron një objektiv madhor dhe specifik luftën kundër terrorizmit dhe kundër krimit të organizuar. Për këtë është vënë theksi te forcimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit dhe i bashkërendimit të punës së organeve ligj-zbatuese midis vendeve të rajonit dhe në nivel më të gjerë, për rezultate më efikase në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme. Një vend të rëndësishëm në këtë qasje zënë edhe strategjitë

e zhvillimit ekonomik kombëtar, sidomos për sigurimin e reduktimit të varfërisë, duke adaptuar instrumentet institucionale qeverisëse, mekanizmat ekonomikë e financiarë etj.

Së fundi, parlamenti i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 05/L -002, 'Për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, për ndalimin në pjesëmarrje në konflikte të armatosura qytetarëve të saj jashtë territorit të vendit', me të cilin ka shtuar listën e instrumenteve ligjore që lidhen me parandalimin dhe luftimin me efikasitet çfarëdo forme të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe të ndikimit të tyre në stabilitetin e saj dhe rajonal.

Sipas raporteve të nxjerra, bazuar në misionin dhe në kompetencat që ka, Policia e Kosovës në vazhdimësi bën vlerësime të rreziqeve të mundshme të sigurisë në vend dhe, në këtë kuadër, edhe vlerësime për rreziqet që mund të vijnë nga terrorizmi, nga grupet terroriste apo nga individë që ndërlidhen me këto aktivitete dhe, konform vlerësimeve, ndërmerr masat e nevojshme të sigurisë.

Referuar raporteve të analizuara, Policia e Kosovës, bazuar në normat juridike në vend si dhe në Strategjinë Nacionale Kundër Terrorizmit dhe Planit të veprimit, që buron nga kjo strategji, monitoron çdo aktivitet të personave fizikë dhe juridikë, për të cilët siguron informata se mund të paraqesin rrezik për rendin kushtetues apo mund të kryejnë ndonjë vepër penale. Kështu policia synon të arrijë të parandalojë dhe të zbulojë ndonjë organizim apo akt kriminal, përfshirë veprat e terrorizmit dhe të ekstremizmit fetar.

Sipas mandatit ligjor, ajo mbledh dhe analizon të dhëna për dukuri dhe persona që mund të paraqesin rrezik dhe kërcënim për sigurinë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunon me agjencitë e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare (Zyra për Informim, Policia e Kosovës, 2015). Gjithashtu, në kuadrin e përpjekjeve dhe të masave që qeveria

e Kosovës ka marr në funksion të ruajtjes së sigurisë kombëtare, ka krijuar të gjitha hapësirat ligjore dhe organizative që Policia e Kosovës të jetë realisht një nga aktorët më aktivë në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Asaj i janë dhënë të gjitha kompetencat dhe lehtësitë institucionale për një bashkëpunim real dhe konkret me institucionet tjera shtetërore të zbatimit të ligjit në Kosovë, si dhe me të gjitha strukturat dhe organizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë, si dhe me strukturat dhe organizatat ndërkombëtare policore jashtë vendit.

Gjithashtu, shteti i Kosovës, gjithnjë, si shtet i pavarur dhe sovran ka marrë të gjitha masat juridike dhe praktike për të qenë një partner i denjë në veprimtaritë që zhvillohen në bashkëpunimin ndërkombëtar në të gjitha nivelet në luftën kundër terrorizmit. Ai ka mirëpritur dhe vlerëson ndihmën e pakursyer që i japin shtetet e ndryshme dhe organizatat ndërkombëtare në kuadrin e këtij bashkëpunimi, por njëkohësisht po jep edhe ajo kontributin e saj në këtë bashkëpunim. Synim i Kosovës dhe, pa dyshim, edhe i politikës së jashtme të saj është forcimi i pozitës ndërkombëtare përmes traktateve prej të cilave do të krijohet një klimë pozitive në përmirësimin e politikave të bashkëpunimit ndërkombëtar (Hasani & Çukalovic, 2013: 66).

Dekada e fundit ka dëshmuar se asnjë shtet nuk mund të jetë tërësisht i sigurt nga terrorizmi, prandaj të gjitha shtetet kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për hartimin e strategjive kombëtare, ngritjen e kapaciteteve si dhe ngritjen e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit” (Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit, 2009-2012:5).

4.4. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër krimit të organizuar

Krimi i organizuar nuk kufizohet vetëm në kufijtë e një vendi, por është bërë një problem ndërkombëtar. Format e ndryshme të tij, si trafikimi i qenieve njerëzore, trafiqet e drogës, pastrimi i parave, trafikimi i armëve, emigracioni i paligjshëm etj. janë bërë aq të pranishme në botën e sotme, sa janë kthyer në një makth dhe rrezik për sigurinë dhe jetën e shoqërisë në mbarë botën. Shumë studiues dhe institucione që merren me krimin e organizuar e kanë përkufizuar atë në mënyra të ndryshme. Nuk ka një përkufizim të krimit të organizuar që të jetë i përkryer. Kjo ndodh ngaqë format e tij janë shumë të larmishme dhe ndryshojnë nga një vend në tjetrin, si rezultat i faktorëve të ndryshëm socialë, ekonomikë, historikë dhe ligjorë. Për këtë arsye, çdo përpjekje për të përcaktuar krimin e organizuar duhet të jetë në dritën e përvojës së secilit vend në trajtimin e problemit (Gandhirajan, 2004: 5).

Rrjetet kriminale janë shtrirë në të gjitha vendet e botës dhe përdorin metoda të perfeksionuara në kryerjen e krimeve me karakter ndërkombëtar, si trafikimi i qenieve njerëzore, i drogës, i armëve etj. Franz von Liszt, i Universitetit të Berlinit, në hyrje të teksteve të tij mbi legjislacionin krahasues, e percepton krimin ndërkombëtar në një këndvështrim interesant. Ai e ka quajtur epokën e tij si një kohë, kur hajdutët profesionistë apo mashtruesit ndihen të barabartë në shtëpi, si në Paris, në Vjenë apo në Londër, kur rubla të falsifikuara janë prodhuar në Francë apo në Angli dhe kalojnë në Gjermani, kur bandat e kriminelëve kanë vepruar vazhdimisht përgjatë disa vendeve (Fooner, 1989:27).

Me këtë ai kërkon të thotë se zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë u kishte mundësuar autorëve të krimit lehtësi të mëdha për fshehjen e gjurmëve dhe për arritjen e objektivave të tyre kriminale. Lehtësuar nga përparimet teknologjike, komunikimit dhe

transportit dhe tregjet botërore të integruar, krimi i organizuar transnacional tani lulëzon në një rrjet të gjerë të situatave ekonomike dhe politike dhe praktikisht çdo vend ku rregullimi i industrisë, qeveria, dhe administrimi i drejtësisë janë të pamjaftueshëm (Shanty & Mishra, 2008:). Po ashtu, teknikat e aplikuara të kimisë dhe fizikës u siguruan kriminelëve metoda të avancuara për falsifikimin e dokumenteve, për kryerjen e vjedhje me thyerje, për prodhimin e kartëmonedhave false, për mashtrimin e viktimave etj. (Fooner, 1989: 27).

Duke qenë se grupet e organizuara kriminale veprojnë në bashkëpunim dhe si qëllim kryesor kanë përfitimin financiar apo material, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional (2000), përcakton si grup të organizuar kriminal:

“grupin që është i strukturuar prej tre ose më shumë personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe vepron në bashkëpunim, me qëllim kryerjen e një ose më shumë veprave të rënda kriminale ose të veprave të parashikuara në Konventë, me qëllim përftimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të një përfitimi financiar ose material (Neni 2, paragrafi 1, i Konventës së OKB, 2000).

Po ashtu, Konventa përcakton se, kur kemi të bëjmë me krime të rënda apo krime serioze, sipas nenit 2, paragrafi 2 të Konventës, krim i rëndë apo krim serioz konsiderohet akti që përbën një vepër penale të dënueshme me privim maksimal të lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.

Drejtoria e Inteligjencës Kriminale të Policisë së Mbretërisë Kanadeze ka identifikuar 14 karakteristika të përbashkëta nga grupet e krimit të organizuar apo të organizatave kriminale: Korrupsioni, Disiplina, Infiltrimi, Izolimi, Monopoli, Motivimi, Përmbysja, Historia, Dhuna, Sofistikimi, Vazhdimësia, Diversiteti, Lidhja, Lëvizshmëria (Richard, 1998:4).

Krim i organizuar ndërkombëtar është kriminaliteti që kapërcen kufijtë kombëtarë dhe përshkon shtete të tjera. Forma të krimit transnacional, siç është tregtia e skllevërve, kanë ekzistuar prej shumë shekujsh, por tani ky fenomen është zgjeruar me shpejtësi. Lehtësuar nga përparimet teknologjike, komunikimit dhe transportit dhe nga tregjet botërore të integruara, krimi i organizuar transnacional lulëzon në një rrjet të gjerë dhe është i pranishëm kudo. Më i përhapur bëhet në vendet që kanë destabilitet politik.

Në rrethanat kur krimi i organizuar është kaq i përhapur dhe i sofistikuar, shtrohen pyetjet: a janë duke bërë sa duhet institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare për luftimin apo uljen e tij? A janë duke u dorëzuar shtetet përballë sfidave me të cilat po përballen, kur shihet se krimi nuk ka shenja të uljes, por po rritet gjithnjë e më tepër?

Përgjigjja është se shtetet nuk po i lëshojnë armët kundër krimit të organizuar. Mund të themi se ato kanë krijuar jo vetëm një gamë të gjerë aktesh juridike për të parandaluar dhe luftuar krimin, por edhe kanë ngritur strukturat përkatëse për parandalimin dhe luftimin e tij, duke u vënë në dispozicion mjete, pajisje, personel dhe fonde për realizimin e detyrave në fushën e luftës kundër kriminalitetit. Sigurisht që ato kanë nevojë të perfeksionohen e të zhvillohen më tej, sepse edhe vetë krimi i organizuar nuk ndalet në gjetjen e formave të reja të kryerjes së veprave penale.

Edhe organizatat ndërkombëtare, si OKB-ja, BE-ja etj., kanë miratuar shumë instrumente për të siguruar një bashkëpunim ndërkombëtar për luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Ato nuk reshtin së punuari për të zhvilluar një luftë sa më efektive duke krijuar të gjitha mundësitë për realizimin në praktikë të shkëmbimit të informatave, të pajisjeve, të personelit të kualifikuar, të përvojave, si dhe duke ofruar

mbështetje institucionale dhe logjistike për vendet që përfshihen në bashkëpunimin ndërkombëtar për luftën kundër krimit të organizuar.

4.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër tregtisë me sklevër, trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandës me migrantë dhe trafikeve të drogës

Është fakt se trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen global. Ky krim nuk është një fenomen i ri. Skllavëria dhe trafikimi i personave, ose për shfrytëzim seksual, ose për punë, ka ndodhur në forma të ndryshme qysh herët. Rritja kohëve të fundit duket të jetë ndihmuar nga rritja e globalizimit dhe nga teknikat moderne të komunikimit (Ollus, No.62: 16).

Shkaqet për ekzistencën e trafikimit të qenieve njerëzore janë të shumta. Këtu përfshihen varfëria, mungesa e mundësive të punësimit, pabarazitë ekonomike ndërmjet rajoneve të botës, korrupsioni, rënia e kontrolleve kufitare, diskriminimi gjinor dhe etnik, dhe jostabiliteti politik dhe konfliktet, (Shelley, 2010: 37). Por trafikimi i qenieve njerëzore zhvillohet edhe në vendet e pasura, ku grupet kriminale synojnë përfitime materiale prej tij.

Sipas protokollit të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, zhdukjen dhe dënimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, "Trafikimi i personave" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pritjen e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo të formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të mashtrimit, e abuzimit të pushtetit ose të një pozite të ndjeshme, ose të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi (Neni 3, paragrafi 1, i Protokollit për Parandalimin, zhdukjen dhe dënimin e trafikimit të

personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, për plotësimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, 2000).

Sipas raportit global të OKB, forma më e zakonshme e trafikimit të qenieve njerëzore (79%) është shfrytëzimi seksual. Viktimat e këtij shfrytëzimi janë, kryesisht, gratë dhe vajzat. Në 30% të vendeve që kanë dhënë informacion mbi gjininë e trafikantëve, femrat përbëjnë përqindjen më të madhe të trafikantëve. Forma e dytë më e zakonshme e trafikimit të qenieve njerëzore është puna e detyruar (18%). Por për këtë bëhen edhe shtrembërime, pasi me të mbulohet trafikimi për shfrytëzim seksual (UNODC, Report on human trafficking exposes modern form of slavery, 2005).

Gjithashtu, referuar raportit global të KB, në të gjithë botën, pothuajse 20% e të gjitha viktimave të trafikimit janë fëmijë, kurse në disa pjesë të Afrikës dhe të rajonit Mekong, fëmijët janë shumica deri në 100%.

Sipas Raportit të progresit të Komisionit European të vitit 2008, Kosova vlerësohej si një zonë e origjinës, e tranzitit dhe e destinimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe viktimat e trafikimit kryesisht për shfrytëzim seksual ishin nga Moldavia, Rusia dhe Ukraina.

Një formë tjetër të kriminalitetit mjaft të përhapur paraqet kontrabanda me migrantë. "Kontrabandimi i migrantëve" është prokurimi për të marrë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi dobi pasurore a financiare, hyrja e paligjshme e një personi në një shtet tjetër, ku personi nuk është shtetas ose banor i përhershëm (Neni 3, paragrafi 1, i Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër kontrabandimit me migrantë, nga toka, deti dhe ajri, që plotëson Konventën e KB Kundër krimit të Organizuar Transnacional.) Një trend i ikjes dhe kalimit në mënyrë ilegale në shtete të tjera zakonisht ndodh në vendet e varfra, ku njerëzit ikin për qëllime të gjetjes së një jete më të mirë, të punësimit etj.

Në vendet e Ballkanit ikja e njerëzve drejt vendeve të Perëndimit është shumë e madhe dhe rruga e ikjes, zakonisht, është kalimi ilegal i kufijve. Një fenomen i tillë, fatkeqësisht, ka ndodhur edhe në Kosovë, ku, nga rrethanat e cilësuara më lart, gjatë këtyre viteve vendin e kanë lëshuar në mënyrë ilegale me dhjetëra mijëra qytetarë. Në të shumtën e rasteve, kalimi i kufijve bëhet në bashkëpunim me grupe të ndryshme kriminale që bëjnë kontrabandimin e njerëzve për qëllime përfitimi. Kufijtë e Kosovës vlerësohen si të pasigurt dhe të brishtë, ku Veriu i vendit paraqet një sfidë të veçantë (Komisioni Europian, Raporti i progresit për Kosovën, 2009:51), sepse ata janë jashtë kontrollit të autoriteteve të shtetit të Kosovës dhe atje janë në mënyrë më shumë simbolike.

Por shumë problematike janë bërë sot trafiket e drogës. Këto përbëjnë edhe kriminalitetin më të organizuar ndërkombëtar, i cili organizohet, mbrohet dhe mbikëqyret nga grupe të fuqishme të njohura si kartelet të drogës, që bëjnë fitime të mëdha nga kjo industri miliarda dollarëshe (Sherman, 2010: 6-7). Në shumë raste, organizatat e trafikimit të drogës janë më të fuqishme, të financuara më mirë, dhe të armatosura më rëndë se qeveritë e vendeve ku ato veprojnë. Ndaj themi që trafiku i drogës është një problem global dhe i vështirë të zbulohet, edhe pse ndodh shpesh që në zonat ku veprojnë organizatat e trafikimit të saj dhe kartelet dhe grupet rivale ato hyjnë në konflikte të dhunshme mes tyre.

Sot janë të njohura lloje të ndryshme të drogave që kultivohen, prodhohen dhe shiten në mbarë botën. Rreth 230 milionë njerëz, ose 5% për qind e popullsisë së rritur në botë, vlerësohet të kenë përdorur drogë të paligjshme, të paktën, një herë, në vitin 2010. Përdorimi i paligjshëm i drogës është, përgjithësisht, i qëndrueshëm, ndonëse në disa vende në zhvillim ajo vazhdon të jetë në rritje. Heroina, kokaina dhe drogat e tjera

vrasin rreth 0,2 milion njerëz çdo vit, shkatërrojnë familjet, duke sjellë mjerim për mijëra njerëz të tjerë. Drogat e paligjshme minojnë zhvillimin ekonomik dhe social, dhe i kontribuojnë përhapjes së krimit, destabilitetit, pasigurisë dhe përhapjes së HIV-it (World Drug Report, 2012).

Prandaj dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë është shumë i nevojshëm për parandalimin dhe luftimin e kultivimit, të përhapjes dhe të përdorimit të drogës, megjithëse është shumë e vështirë dhe thuajse e pamundur të ndalohen përfundimisht.

Sa i përket Kosovës, bazuar në raportin e progresit të Komisionit Europian, Kosova gjendet në rrugën e trafikimit të heroinës së Ballkanit Jugor. Mungesa e statistikave të besueshme ka pamundësuar hartimin e një strategjie për të luftuar drogat dhe ka një bashkëpunim të pamjaftueshëm ndërkombëtar mes agjencive në luftën kundër trafikimit të drogës dhe Policia e Kosovës bën përdorim të pamjaftueshëm të statistikave të krimit si vegël për menaxhim (Komisioni Europian, Raporti i progresit për Kosovën, 2008: 60).

KAPITULLI V: REZULTATET DHE ANALIZA E TË DHËNAVE EMPIRIKE

5.1. Rezyme e analizës së të dhënave empirike

Në këtë kapitull përfshihet analiza e të dhënave nga pyetësi dhe rezultatet që janë nxjerrë. Përmes tyre bëhet shqyrtimi i vërtetësisë së hipotezave të ngritura mbi bazën e pyetjeve kërkimore. Pyetësi, përfshiu zyrtarë policorë që punojnë në fushën e luftimit të krimit. U anketuan 271 zyrtarë policorë, të Departamentit të Hetimeve dhe të Policisë Kufitare, që lidhen me fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, si ILEC, me fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, me hetimin kundër krimit të organizuar transnacional, me hetimin kundër trafikimit të narkotikëve, me hetimet transkufitare, me hetimin kundër krimeve kibernetike dhe me hetimin kundër terrorizmit. Të dhënat janë të evidencuara në mënyrë tabelore.

Kjo analizë synon t'u japë përgjigje disa pyetjeve kërkimore, që janë parashtruar në tezën e punimit dhe që lidhen me interpretimin e këtij roli, si dhe me impaktet funksionale të bashkëpunimit policor në shoqërinë e Kosovës.

Studimi është përqendruar në një pyetje primare hulumtuese: *“Cili është roli dhe si të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?”*.

Në mënyrë që të adresojmë pyetjen kryesore kam identifikuar edhe pyetjet përcjellëse analizuese, që janë:

1. Çfarë specifikash ka pozicioni i Policisë së Kosovës në fushën e BNP përballë statusit aktual të Republikës së Kosovës?
2. Si funksionon BNP dhe çfarë po bëhet për ta realizuar atë në Kosovë?

3. Si ka funksionuar Policia e UNMIK-ut në fushën e BNP në Kosovë?

4. Çfarë roli ka Policia e EULEX-it në fushën e BNP në Kosovë?

Hipotezat e ndërtuara lidhur me temën janë:

- 1) *Mungesa e një bashkëpunimi të mirëfilltë ndërkombëtar policor ka ndikuar në efikasitetin e Policisë së Kosovës në luftimin e kriminalitetit në Kosovë.*
- 2) *Bashkëpunimi ndërkombëtar policor në Kosovë pas vitit 2008 ka dhënë rezultate të dukshme në zvogëlimin dhe në luftimin e kriminalitetit.*
- 3) *Memorandumet e bashkëpunimit policor, në pamundësi të anëtarësimit të Policisë së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë policorë, janë parë si forma e vetme e bashkëpunimit dhe e luftimit të kriminalitetit në Kosovë.*

Për arritjen e synimeve tona, ndërtuam një model të analizimit të të dhënave, që është i ndarë në dy nivele: empirik dhe analitik. Pra, janë bërë analizimet e nevojshme, si empirike, ashtu edhe krahasuese dhe metodike të të dhënave primare dhe sekondare:

- 1) *pozitive*, domethënë, parametrat matës tregojnë një gjendje më të mirë ose një tendencë rritjeje apo përmirësimi;
- 2) *stanjante*, domethënë, parametrat matës tregojnë një gjendje të njëjtë ose një tendencë mosndryshimi; dhe
- 3) *negative*, domethënë, parametrat matës tregojnë një gjendje më të keqe ose një tendencë përkeqësimi.

Gjithashtu, ky studim e sheh variantin në dy rrafshe kohore:

- 1) *sinkronik*, domethënë, performancë që vëzhgohet në një vit, dhe
- 2) *diakronik*, domethënë, performanca që vëzhgohet përgjatë viteve.

Variabli i pavarur në këtë studim është “*sistemi policor*”. Në këtë studim BNP përfshin veprimtarinë që siguron realizimin e objektivave në mënyrë efektive dhe efikase, të përqendruara në procesin e ndikimit të luftimit të kriminalitetit të çdo departamenti policor në proceset e ndërtimit të një klime shoqërore sa më të qetë dhe jo kriminale të shoqëria e Kosovës.

Në analizimin e rolit të bashkëpunimit ndërkombëtar policor, ky studim interesohet për peshën e influencës të secilit prej komponenteve përbërëse të rolit të këtyre institucioneve ndaj shoqërisë. Pesa e influencës së secilës prej komponenteve përbërëse shihet në tri forma:

- 1) e lartë, 2) mesatare, 3) e ulët.

Kur varianti në peshën e influencës shihet i shtrirë në vite, tri format e tij janë:

- 1) në rritje, 2) njësoj, 3) në rënie.

Po tri forma merr edhe varianca në peshën e influencës së komponenteve edhe kur shihet në raportet që komponentet shfaqin me njëra-tjetrën:

- 1) më e madhe, 2) e njëjtë, dhe 3) më e vogël.

5.2. Rezultatet e hulumtimit të rasteve me bashkëpunim ndërkombëtar


Më poshtë janë shënuar statistikave të vitit 2008, për viktimat e identifikuar të trafikimit të *qenieve njerëzore*. Një pjesë e viktimave të këtij trafikimi janë shtetase të huaja, në bashkëpunim, në disa raste, edhe me vendet tjera, pas viti 2008.

Siç shihet nga diagrami numër 8, është bërë identifikimi i viktimave sipas origjinës. Një numër i konsiderueshëm i tyre janë shtetase të huaja. Nga kjo shihet se nga numri i përgjithshëm prej 197 viktimave të identifikuar në Kosovë për periudhën 2008 e tutje janë identifikuar: 133 ose 67.51 % kosovare, 36 ose 18.27 % moldave, 15

ose 7.61 % shqiptare, 2 ose 1.02 % bullgare, 8 ose 4.06 % serbe, 1 ose 0.51 % polake dhe 2 ose 1.02 % tjera të paidentifikuara.

Pra, nga totali janë identifikuar 64 shtetase të huaja ose 32.49 %.

Diagrami 8: Viktimat e trafikimit të identifikuara në Kosovë pas vitit 2008, sipas origjinës



Burimi: Raportet policore, Policia e Kosovës

5.3. Rezime e të dhënave nga pyetësi

Me synim për të njohur për së afërmi funksionimin, organizmin dhe konsideratat publike ndaj BNP në luftimin e kriminalitetit, metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave në terren mbështetet në drejtuesit e institucioneve policore bartëse të këtij bashkëpunimi dhe në njësitë policore të zgjedhura në mënyrë *ad hoc*.

Pas analizimit të të hyrave sekondare, pra, materialeve editoriale, kam ndërmarrë një hulumtim në terren, ku kam identifikuar gjendjen në praktikë përmes matjes së variablave. Kjo përmes realizimit të pyetësit, me të cilin synoj të vërtetoj hipotezat e parashtruara.

Në hartimin e pyetësit është marrë parasysh që pyetjet të ishin precize, të kuptueshme, dhe të gjeneronin informacionin që i duhej këtij studimi dhe jo informacion të panevojshëm.

Pyetësi u testua për të siguruar që ky instrument matës ishte i kuptueshëm për personat e pyetur dhe pa keqkuptime për të pyeturit lidhur me informacionin që kërkonte të nxirrte.

Ai u plotësua nga këto grupe të anketuarish: 1) Drejtuesit e njësive të PK të ngarkuara me bashkëpunimin ndërkombëtar policor, 2) Njësitë policore të zgjedhura nga departamente të ndryshme policore.

Kjo ndarje u përcaktua nga dy kriteret: 1) pesha e secilit aktor, dhe 2) parimi i konfirmimit. Domethënë, një nga pritshmëritë nga mbledhja dhe analizimi i të dhënave përmes pyetësit ishte të vëzhguarit përmes përgjigjeve të dhëna.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përmes pyetësit ka zgjatur 45 ditë.

Skedulimi i hulumtimit

Aktivitetet/ muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Dizajnimi i problemit dhe objektivat kërkimore												
Dizajnimi i metodologjisë												
Mbledhja e të dhënave dhe analizat statistikore												
Përshkrimi i projektit final												

Table 4: Skedulimi i hulumtimit

Zgjedhja e mostrës: Metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave përmban në vetvete analizën e të dhënave primare të mbledhura përmes pyetësorëve. “Madhësia e mostrës prej, së paku, 30 e, më së shumti, 500 është e përshtatshme për të kryer shumicën e hulumtimeve” (Sekaran U. 2003).

Kjo mostër mund të konsiderohet përfaqësuese shumë e mirë, nëse marrim parasysh raportin numër i përgjigjeve/variabla, sepse janë parashtruar pyetje dhe nga ato përgjigje janë nxjerrë tabela të ndryshme krahasimi mes variablave, për të vërtetuar hipotezat e parashtruara.

Sipas Field (2005), ekzistojnë shumë rregulla për sa i përket vëllimit të zgjedhjes, por si rregull i përgjithshëm duhen 10-15 përgjigje për variabël. Duke tentuar shtrirjen dhe gjithëpërfshirjen, pjesëmarrësit në këtë pyetësor janë zgjedhur sipas një mostre, që është kërkuar që të jetë sa më gjithëpërfshirëse, në mënyrë që edhe rezultatet të jenë gjithëpërfshirëse.

Pasi është identifikuar terreni më i përshtatshëm për sjelljen e pyetësorëve, të anketuarve u është kërkuar që të përgjigjen me sinqeritet në pyetësor, i cili është anonim. Pyetësorët u zhvilluan me mundësi anonimiteti, për arsye edhe të supozimit të marrjes të sa më shumë përgjigjeve të sakta.

Pas aplikimit të pyetësorëve dhe përshkrimit të popullatës sipas pikëpamjes statistikore, të dhënat janë futur në programin SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) për të nxjerrë korelacionet, devijimin standard dhe mesataren për secilin pyetësor. Më pas, të dhënat përshkruese të pyetjeve mbledhen dhe shohim sesi korelonin me njëra-tjetrën. Më tej këto të dhëna shërbejnë për të ndërtuar grafikët e tabelat të nevojshme për vizualizimin e rezultateve, sesi korelonin të dhënat e pyetjeve me njëra-tjetrën. Sipas analizës së pyetësorëve në terren mund të thuhet se gjithëpërfshirja është realizuar në pikën maksimale të mundshme.

5.4. Rezultatet e pyetësorit

Pyetësori me zyrtarët policorë përmbante 22 pyetje, prej të cilave 15 të tipit alternativ, 2 të kombinuara dhe 5 të tipit të hapur. Nga të anketuarit, 215 prej tyre ishin meshkuj apo 79% dhe 56 femra apo 21%. Përgjigjet nga pyetjet e tipit alternativ janë analizuar në mënyrë statistikore, kurse përgjigjet nga pyetjet e hapura janë analizuar me kujdes për të fituar një konkludim të përgjithshëm. Kjo edhe nga fakti se në shumicën prej tyre nuk kishte përgjigje. Në pyetjen “Çfarë niveli-pozite përfaqësoni në sektorin/departamentin tuaj?”, nga përgjigjet e marra nga 271 të anketuar, del se numrin më të madh prej tyre e përbëjnë 169 zyrtarët policorë apo 62.4 %, kurse alternativën ‘Mbikëqyrës i nivelit të parë’ 70 apo 25,8 %, ‘Mbikëqyrës i nivelit të mesëm’ 23 apo 8,5 %, ‘Niveli i lartë i menaxhmentit’ 9 apo 3.3 %

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Zyrtar policor	169	62.4%	62.4%	62.4%
	Mbikëqyrës i nivelit të parë	70	25.8%	25.8%	25.8%
	Mbikëqyrës i nivelit të mesëm	23	8.5%	8.5%	8.5%
	Niveli i lartë i menaxhmentit	9	3.3%	3.3%	3.3%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 5: Çfarë niveli-pozite përfaqësoni në sektorin/departamentin tuaj?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “A flisni ndonjë gjuhë të huaj dhe a zhvilloni komunikim me zyrtarë policorë ndërkombëtarë?”, nga totali i të anketuarve del se në alternativën: flas dhe komunikoj në detyrat e përditshme, janë përgjigjur 45 apo 17 %, vetëm flas anglisht janë 141 apo 52% dhe nuk flas gjuhë të huaj janë përgjigjur 85 apo 31%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Flas dhe komunikoj në detyrat e përditshme anglisht	45	17%	17%	17%
	Vetëm flas anglisht	141	52%	52%	52%
	Nuk flas gjuhë të huaj	85	31%	31%	31%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 6: A flisni ndonjë gjuhë të huaj dhe a zhvilloni komunikim me zyrtarë policorë ndërkombëtarë?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Përvoja juaj në njësitë lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar policor”?, nga gjithsej 271 të anketuar alternativën: deri në tri vite janë 82 të anketuar apo 30%, tri deri pesë vite, 75 apo 28 %, mbi pesë vite, 114 apo 42 %.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Deri në 3 vite	82	30%	30%	30%
	3-5 vite	75	28%	28%	28%
	Mbi 5 vite	114	42%	42%	42%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 7: Përvoja juaj në njësitë lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar policor?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Në cilën periudhë kohore punoni apo keni punuar në këtë njësi (ju lutemi shënoni vitin prej kur keni filluar)”? nga totali i të anketuarve del se nga viti 1999-2008 në njësinë që kanë punuar në raste me bashkëpunim ndërkombëtar janë 98 apo 36.2%, alternativën 1999-2012 janë 68 apo 25.1%, dhe 2008-2012 janë 89 apo 32.8%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valid e	1999-2008	98	36,2%	36.2%	36,2%
	1999-2012	68	25,1%	25.1%	25.1%
	2008-2012	89	32,8%	32.8%	32.8%
	Nuk janë përgjigjur	16	5,9%	5.9%	5.9%
	Totali	271	100%	100%	100%

Table 8 Në cilën periudhë kohore punoni apo keni punuar në këtë njësi (ju lutemi shënoni vitin prej kur keni filluar)?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “A keni vijuar ndonjë trajnim jashtë Kosovës apo ndonjë trajnim të përbashkët me zyrtarët policorë të shteteve të tjera në Kosovë?”, nga totali i të anketuarve del se për alternativën: kam vijuar trajnime jashtë, janë 84 apo 31%, nuk kam vijuar, 108 apo 40%, kam vijuar trajnime brenda Kosovës, 79 apo 29%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Kam vijuar trajnime jashtë	84	31%	31%	31%
	Nuk kam vijuar	108	40%	40%	40%
	Kam vijuar trajnime brenda Kosovës	79	29%	29%	29%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 9: A keni vijuar ndonjë trajnim jashtë Kosovës apo ndonjë trajnim të përbashkët me zyrtarët policorë të shteteve të tjera në Kosovë?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “A keni marrë pjesë në konferenca, seminare apo workshope të përbashkëta me zyrtarët policorë të shteteve të tjera dhe a kanë ndikuar në ngritjen e performancës dhe të efikasitetit në detyrat tuaja”?, nga totali i të anketuarve del se në alternativën: kam marrë pjesë dhe ka ndikuar në ngritjen e performancës dhe të efikasitetit, janë përgjigjur 93 apo 34.3%, relativisht, ka ndikuar në detyrat e përditshme, 75 apo 27.7%, nuk kam pasur rastin të marr pjesë në takime të tilla, 86 apo 31.7%, dhe nuk janë përgjigjur në këtë alternativë 17 apo 6.3% të anketuarve.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Kam marrë pjesë dhe ka ndikuar në ngritjen e performancës dhe të efikasitetit	93	34,3%	34,3%	34,3%
	Relativisht kanë ndikuar në detyrat e përditshme	75	27,7%	27,7%	27,7%
	Nuk kam pasur rast të marr pjesë në takime të tilla	86	31,7%	31,7%	31,7%
	Nuk janë përgjigjur	17	6,3%	6,3%	6,3%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 10: A keni marrë pjesë në konferenca, seminare apo workshope të përbashkëta me zyrtarët policorë të shteteve të tjera dhe a kanë ndikuar në ngritjen e performancës dhe të efikasitetit në detyrat tuaja?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Si e vlerësoni rolin e konferencave ndërkombëtare, trajnimeve në ngritjen e aftësive profesionale dhe në krijimin e pikave të bashkëpunimit?”, nga totali i të anketuarve del se alternativën: pozitiv, janë 145 apo 54%, relativ, janë 96 apo 35%, ka ndikuar në krijimin e pikave të kontaktit, 14 apo 5%, nuk ka ndikuar, 16 apo 6%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Pozitiv	145	54%	54%	54%
	Relativ	96	35%	35%	35%
	Ka ndikuar në krijimin e pikave të kontaktit	14	5%	5%	5%
	Nuk ka ndikuar	16	6%	6%	6%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 11: Si e vlerësoni rolin e konferencave ndërkombëtare, trajnimeve në ngritjen e aftësive profesionale dhe në krijimin e pikave të bashkëpunimit?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Cili është niveli i komunikimit mes zyrtarëve policorë vendas dhe atyre ndërkombëtarë që punojnë në kuadër të misionëve ndërkombëtare në Kosovë?”, nga 271 të anketuarit, alternativën: nivel i lartë i komunikimit, janë 185 apo 68%, ulët-mesëm, 78 apo 29%, dhe nuk komunikojmë fare, janë 8 të anketuar apo 3%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Nivel i lartë	185	68%	68%	68%
	Ulët-Mesëm	78	29%	29%	29%
	Nuk komunikojmë	8	3%	3%	3%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 12: Cili është niveli i komunikimit mes zyrtarëve policorë vendas dhe atyre ndërkombëtarë që punojnë në kuadër të misionëve ndërkombëtare në Kosovë?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Sa ju ka ndihmuar prezenca dhe përvoja e pjesëtarëve të misionëve ndërkombëtare policore në zgjidhjen e rasteve në punën tuaj?”, nga 271 të anketuarit, në alternativën: më ka ndihmuar shumë, janë përgjigjur 126 apo 46%, mesatarisht, 108 apo 40%, minimalisht, 27 apo 10%, nuk ka pasur efekt, 10 apo 4%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Më ka ndihmuar shumë	126	46%	46%	46%
	Mesatarisht	108	40%	40%	40%
	Minimalisht	27	10%	10%	10%
	Nuk ka pasur efekt	10	4%	4%	4%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 13: Sa ju ka ndihmuar prezenca dhe përvoja e pjesëtarëve të misionëve ndërkombëtare policore në zgjidhjen e rasteve në punën tuaj?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Cili është roli i bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?”, nga 271 të anketuarit, në alternativën: këshillues, janë përgjigjur 143 apo 53%, ekzekutiv, 97 apo 36%, monitorues, 16 apo 6%, dhe rol bashkëpjesëmarrës, 15 apo 5%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Këshillues	143	53%	53%	53%
	Ekzekutiv	97	36%	36%	36%
	Monitorues	16	6%	6%	6%
	Bashkëpjesëmarrës	15	5%	5%	5%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 14: Cili është roli i bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “A keni pasur shkëmbim të informatave dhe të zyrtarëve policorë me agjencitë policore të shteteve të tjera në luftimin e krimit dhe cilat janë përvojat tuaja në këtë aspekt?”, nga totali i të anketuarve del se alternativën: kemi shkëmbyer informata dhe zyrtarë policorë, janë përgjigjur 103 apo 38%, kemi shkëmbyer vetëm informacione, 114 apo 42 %, nuk kemi bashkëpunim në shkëmbim të informacioneve, 54 apo 20%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Kemi shkëmbyer informata dhe zyrtarë policor	103	38%	38%	38%
	Kemi shkëmbyer vetëm informacione	114	42%	42%	42%
	Nuk kemi bashkëpunim në shkëmbimin e informacioneve	54	20%	20%	20%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 15: A keni pasur shkëmbim të informatave dhe zyrtarëve policorë me agjencitë policore të shteteve të tjera në luftimin e krimit dhe cilat janë përvojat tuaja në këtë aspekt?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “A është vërejtur trend i zvogëlimit të krimit në Republikën e Kosovës pas bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet apo organizatat ndërkombëtare policore?”, nga totali i të anketuarve, në alternativën: ka rënie të krimit, janë përgjigjur 187 apo 69%, niveli është i njëjtë, 62 apo 23%, krimi është rritur në disa fusha, 22 apo 8 %.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valid e	Ka rënie të krimit	187	69%	69%	69%
	Niveli është i njëjtë	62	23%	23%	23%
	Krimi është rritur në disa fusha	22	8%	8%	8%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 16: A është vërejtur trend i zvogëlimit të krimit në Republikën e Kosovës pas bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet apo organizatat ndërkombëtare policore?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “A paraqet pengesë për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare policore mosanëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/ Europol/ Frontex etj.)?”, nga totali i të anketuarve del se në alternativën: paraqet pengesë, janë përgjigjur 106 apo 39%, bashkëpunimi është i kufizuar, 48 apo 18%, nuk paraqet fare pengesë, 117 apo 43%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Paraqet pengesë	106	39%	39%	39%
	Bashkëpunimi është i kufizuar	48	18%	18%	18%
	Nuk paraqet fare pengës	117	43%	43%	43%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 17: A paraqet pengesë për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare policore mosanëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/ Europol/ Frontex etj.)?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Në cilat fusha (specifikoni fushën tuaj) janë shënuar rezultate konkrete me organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/ Europol/ SECI/ etj.)?”, nga totali i të anketuarve, del se në alternativën: shkëmbim i informatave, janë përgjigjur 95 apo 35.1%, luftimin e narkotikëve, 56 apo 20.7%, kontrabandë, 54 apo 19.9%, trafikim i qenieve njerëzore, 48 apo 17.7%, dhe terrorizmi, 18 apo 6.6%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Shkëmbim të informatave	95	35,1%	35,1%	35,1%
	Luftimi i narkotikëve	56	20,7%	20,7%	20,7%
	Kontrabanda	54	19,9%	19,9%	19,9%
	Trafikimi i qenieve njerëzore	48	17,7%	17,7%	17,7%
	Terrorizmi	18	6,6%	6,6%	6,6 %
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 18: Në cilat fusha (specifikoni fushën tuaj) janë shënuar rezultate konkrete me organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/ Europol/ SECI/ etj.)?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Me kalimin e kohës, a ka shënuar ngritje besimi në organizatat ndërkombëtare që kontribuojnë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë”? nga totali i të anketuarve, del se në alternativën: nuk ka shënuar ngritje, janë përgjigjur 112 apo 41%, kam pak besim, 106 apo 39% dhe alternativën besoj shumë, janë 53 apo 20%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Nuk ka shënuar ngritje	112	41%	41%	41%
	Kam pak besim	106	39%	39%	39%
	Besoj shumë	53	20%	20%	20%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 19: Me kalimin e kohës, a ka shënuar ngritje besimi në organizatat ndërkombëtare që kontribuojnë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Në pyetjen: “Sipas përvojës suaj, ku ka më së shumti ngecje në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë”?, nga totali i të anketuarve, del se alternativën: shkëmbim të informatave, janë përgjigjur 18 apo 6.6%, luftimi i narkotikëve, 25 apo 9.3%, kontrabanda, 43 apo 15.8%, trafikim i qenieve njerëzore, 86 apo 31.7% dhe terrorizmi, 99 apo 36.6%.

		Pjesëmarrja	Përqindja	Validiteti	Përqindja e grumbulluar
Valide	Shkëmbim të informatave	18	6,6%	6,6%	6,6%
	Luftimi i narkotikëve	25	9,3%	9,3%	9,3%
	Kontrabanda	43	15,8%	15,8%	15,8%
	Trafikimi i qenieve njerëzore	86	31,7%	31,7%	31,7%
	Terrorizmi	99	36,6%	36,6%	36,6%
	Total	271	100,0	100,0	100,0

Table 20: Sipas përvojës suaj, ku ka më së shumti ngecje në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë?

Burimi: Anketa me njësitë policore nga Departamenti i Hetimeve dhe Departamenti i Policisë Kufitare

Sa i përket pyetjes së hapur: *Çfarë rezultate janë arritur në luftimin e krimit dhe a ka pasur ndikim në situatën e brendshme (situata në sektorin tuaj të bashkëpunimit)?*, nga shumica e të anketuarve që janë përgjigjur, del se ka pasur progres në luftimin e krimit, por ai nuk ka ndikuar shumë në uljen e krimit në vend.

Në pyetjen: *Pikëpamjet tuaja lidhur me rolin që ka misioni i Policisë së Eulex-it në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë?*, nga numri i përgjigjeve të

anketuarve, një pjesë e konsiderueshme mendojnë se Policia e Eulex-it ka pasur një rol simbolik në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në pyetjen: *Çka do të duhej të ndryshonte që bashkëpunimi ndërkombëtar policor në Kosovë të jetë më efikas?*, shumica e të anketuarve kanë mendimin se duhet gjetur mënyra më efikase dhe Policia e Kosovës të gjejë modalitete të bashkëpunimit me shtetet e tjera.

Në pyetjen: *A keni diçka për të shtuar, që nuk është përfshirë në këtë pyetësor dhe sipas mendimit tuaj është me rëndësi të ceket?*, një pjesë e vogël e të anketuarve që janë përgjigjur theksojnë se Policia e Kosovës duhet të përqendrohet më shumë në proceset dhe nismat rajonale dhe të krijojë kapacitete profesionale të mjaftueshme në fushën e luftimit të krimit.

Në pyetjen: *Me cilat shtete të botës keni pasur bashkëpunim policor në luftimin e krimit dhe në cilën fushë?* Përgjigjja ka qenë shumë e përgjithshme, por, në radhë të parë, konsiderohet bashkëpunimi me Shqipërinë në fushën e luftimit të narkotikëve dhe krimit të organizuar, pastaj bashkëpunimi me Maqedoninë në fushën e kontrabandimit dhe, në radhë të tretë me vendet e rajonit.

Në përfundim të këtij anketimi, nga rezultatet e marra nga përgjigjet dhe nga analizimi i tyre, mendoj se ai i përmbushi qëllimet e këtij studimi dhe synimet e mia. Përfshirja e sa më shumë kategorive profesionale të zyrtarëve policorë, ka rezultuar duke më dhënë një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale në fushën e BNP.

Përgjigjet e dhëna më ndihmuan të verifikoj në njëfarë mase potencialin intelektual dhe profesional të kuadrove, të shoh se a kanë njohuri të gjuhës angleze, e domosdoshme kjo për të komunikuar me zyrtarët policorë të shteteve të tjera në kuadrin

e bashkëpunimit. Këtë e kam arritur edhe përmes komunikimit të rregullt ditor që e bëjnë mbi 45 % të të anketuarve.

Gjithashtu përmes tyre arrita të vërtetoj se punonjësit e PK-së në fushën e BNP kanë një profesionalizëm, njohuri dhe përvojë në këtë fushë, si dhe faktin pozitiv se rreth 50% e të anketuarve janë përfshirë në veprimtaritë e BNP, kanë kryer trajnime të përbashkëta me kolegët ndërkombëtarë, kanë marrë pjesë në konferenca dhe seminare, gjë që ka pasur efekt në performancën dhe në efikasitetin në detyrat e tyre përditshme.

Nga pyetësi më rezultoi që kemi një nivel të lartë bashkëpunimi në rastet policore me karakter ndërkombëtar, që arrin në mbi 70%. Mbi 80% e përgjigjeve të të anketuarve vërtetuan se prezenca e faktorit ndërkombëtar të sigurse në Kosovë ka ndikuar në zgjidhjen e disa rasteve me karakter ndërkombëtar dhe ka çuar në rënie të trendit të krimit. U vërtetua se mos antarësimi i PK-së në organizatat ndërkombëtare pengon në luftimin efikas të kriminalitetit. Në pyetjen primare: *“Cili është roli i bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?”*, nga 271 të anketuarit, në alternativën: këshillues, janë përgjigjur 143 apo 53%, gjë që tregon faktin se faktori ndërkombëtar më shumë është i përqëndruar në forma të ndihmës dhe mentorimit se sa të formave ekzekutive.

Përgjigjet për këto dhe për shqetësime të tjera të pyetësit, mendoj se ishin të tilla që më përforcuan idetë dhe hipotezat e këtij studimi dhe më ndihmuan shumë në nxjerrjen e përfundimeve dhe të disa rekomandimeve.

KAPITULLI VI: KUADRI LIGJOR DHE INSTRUMENTET PËR BASHKËPUNIM KUNDËR KRIMINALITETIT

6.1. Instrumentet ndërkombëtare

Për t'u hapur rrugën agjencive të sigurisë të shteteve të ndryshme të bashkëpunojnë mes tyre, para së gjithash, kërkohen instrumente ligjore ndërkombëtare, nismat dhe instrumentet rajonale, si dhe ato kombëtare, të cilat krijojnë bazën juridike për lidhjen e marrëveshjeve, memorandumeve dhe të formave të tjera të bashkëpunimit.

Si instrumentet ligjore ndërkombëtare më të rëndësishme, pa dyshim, konsiderohen aktet e miratuara nga OKB-ja, e cila, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar luan rolin kyç, si organizata më e madhe në botë. Ajo ka një funksion thelbësor dhe mbështetës në zbatimin e ligjit ndërkombëtar. OKB-ja, gjithashtu, është një forum i rëndësishëm, ku mund të negociohen konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare dhe shërben për informata dhe statistika të ndryshme për çështje kriminale dhe mund të ofrojë ndihmë për agjencitë e zbatimit të ligjit në vendet me kapacitete dhe zhvillim të kufizuar (Bailey, 1995: 390).

Roli i OKB-së është i rëndësishëm edhe në promovimin e konventave ndërkombëtare, të cilat luajnë një rol kryesor në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, të kontrabandës, në parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi, si dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër kriminalitetit rëndësi të veçantë ka Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (UNTOC) dhe protokollet e saj. Po ashtu, një rol të veçantë luan edhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime (UNDOC) në kuadër të së cilës

janë mbajtur konferenca dhe janë themeluar komisione të ndryshme (UNODC, Trafikimi i Qenieve Njerëzore & Kalimi Kontrabandë i Migruesve, Udhëzues për bashkëpunim ndërkombëtar: 2010).

Kosova ende nuk është pjesë e këtyre konventave, pasi nuk i ka nënshkruar ato, për shkak të statusit të saj të papërcaktuar politik në OKB. Mos anëtarësimi i saj në këtë organizatë i ka krijuar Kosovës vështirësi dhe pengesa të mëdha edhe lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar policor.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)

Kjo konsiderohet instrumenti më i rëndësishëm në kuadër të konventave ndërkombëtare lidhur me krimin e organizuar ndërkombëtar. Konventa është miratuar përmes Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 55/25, të datës 15 nëntor 2000. Qëllimi i saj është të nxisë bashkëpunimin dhe promovimin midis shteteve për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar (UNTOC, Neni 1). Ajo u hap për nënshkrim nga shtetet anëtare në konferencën e nivelit të lartë politike të thirrur për këtë qëllim, në Palermo, Itali, më 12-15 dhjetor 2000 dhe ka hyrë në fuqi më 29 shtator 2003. Konventa u shërben shteteve për të kërkuar ndihmën e ndërsjellë juridike për një varg çështjesh, ndër të tjera, edhe: marrjen e provave, realizimin e shërbimit të dokumenteve zyrtare, ekzekutimin e kontrolleve, identifikimin e produkteve të krimit, nxjerrjen e informacionit dhe të dokumentacionit.

Konventa trajton edhe penalizimin e akteve kriminale të tilla, si pastrimi i të ardhurave nga krimi, korrupsioni etj., parashikon bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me konfiskimet etj., për veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë. Ajo vë në dukje se shtetet duhet të marrin në konsideratë traktatet, marrëveshjet ose ujdite, dypalëshe ose

shumëpalëshe, që janë nënshkruar, për të rritur efektivitetin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në mungesë të marrëveshjeve të tilla, mund të ndërmerren hetime të përbashkëta me marrëveshje, rast pas rasti.

Këtë metodologji, në fakt, e përdor Policia e Kosovës në raste individuale, në mungesë të marrëveshjes apo edhe të mungesës së anëtarësimit të saj në organizata ndërkombëtare.

Një aspekt tjetër të bashkëpunimit ndërkombëtar që trajtohet në Konventë është edhe mbrojtja e dëshmitarëve, të cilët dëshmojnë në procedurat penale lidhur me veprat penale të përfshira në këtë Konventë dhe, sipas rastit, për familjarët e tyre ose të njerëzve të tjerë të afërt, kundër raprezaljeve dhe kërcënimeve të mundshme (UNTOC: Neni 24). Gjithashtu, kjo vlen edhe për ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të veprave penale të përfshira në këtë Konventë, veçanërisht në rastet e kërcënimit për raprezalje dhe të terrorizmit.

Konventa kërkon që shtetet të bashkëpunojnë ngushtë midis tyre, në përputhje me sistemet e tyre përkatëse ligjore dhe administrative, për të rritur efektivitetin e zbatimit të ligjit në luftën kundër veprave penale të përfshira në të. Për këtë ata duhet të zhvillojnë dhe të përmirësojnë programe të veçanta trajnimi për personelin e tij të zbatimit të ligjit, që përfshijnë dërgime misionesh dhe shkëmbime të stafit të përbashkët në zonat e përmendura, pjesëmarrjen në konferencat dhe seminarët rajonale dhe ndërkombëtare për të nxitur bashkëpunimin.

Konventa plotësohet më tej nga tri Protokolle, që mbulojnë fusha specifike dhe manifestimet e krimit të organizuar:

Protokolli për Parandalimin, zhdukjen dhe dënimin e trafikimit të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve ka hyrë në fuqi më 25 dhjetor 2003. Ai paraqet

instrumentin e parë global ligjor detyrues, si dhe pajtimin lidhur me përkufizimin e trafikimit të personave.

Protokolli kundër Kontrabandës së migrantëve, nga toka, deti dhe ajri, ka hyrë në fuqi më 28 janar 2004. Qëllimi i tij është të parandalojë dhe të luftojë kontrabandën me migrantë, si dhe promovimin e bashkëpunimit midis shteteve palë. Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë sa më shumë të jetë e mundur për parandalimin dhe pengimin e trafikut të migrantëve me rrugë detare, në përputhje me ligjin ndërkombëtar të detit.

Protokolli kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe komponenteve dhe municionit ka hyrë në fuqi më 31 korrik 2005. Objektivi i protokollit, i cili ka qenë instrumenti i parë detyrues i armëve të vogla, që është adoptuar në shkallë globale, është të promovojë, të lehtësojë dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve palë dhe të parandalojë, të luftojë dhe të çrrënjosë prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit dhe të pjesëve tyre, të komponenteve dhe municionit (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime, <http://www.unodc.org>).

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit

Teksti i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit është negociuar gjatë seancës së shtatë të Komitetit *ad hoc* për negocimin e Konventës kundër Korrupsionit, mbajtur prej 21 të janarit 2002 dhe 1 tetor 2003. Konventa e miratuar nga Komiteti *ad hoc* u miratua nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 58/4 të datës 31 tetor 2003 (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime, <http://www.unodc.org/>).

Në përputhje me nenin 68 (1) të Rezolutës 58/4, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit ka hyrë në fuqi më 14 dhjetor 2005. Rëndësia e kësaj

Konvente lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar mes shteteve palë është paraparë më konkretisht në kapitullin ku thuhet se Shtetet Palë duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin në hetimet dhe procedurat në çështjet civile dhe administrative, që kanë të bëjnë me korrupsionin (Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, 2003: neni 43).

6.2. Kuadri ligjor kombëtar i BNP në Kosovë

Republika e Kosovës i ka kushtuar rëndësi të veçantë përmbushjes së kriterëve lidhur me instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, duke filluar nga akti më i lartë juridik, Kushtetuta e vendit, dhe strategjitë nacionale. Në vijim po i trajtojmë me radhë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e vitit 2008

Kushtetuta e Republikës së Kosovës si akti më i lartë juridik dhe politik dhe si bazament për të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore, ka përcaktuar rendin kushtetues të vendit, i cili bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik dhe politik dhe si bazament për të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore, ka parashikuar edhe bazën e bashkëpunimit ndërkombëtar në Republikën e Kosovës tek kapitulli i parë i saj, i cili rregullon rolin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në nenin 17, paragrafi 1 thuhet se: Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare. Ndërsa paragrafi 2 thekson se: Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunimin ndërkombëtar në promovimin e mbrojtjes së paqes, të sigurisë dhe të drejtave të njeriut. Po qe se analizojmë nenin 17, paragrafi 1, shihet në mënyrë të qartë

se shteti i Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare, që nënkupton se në këtë drejtim Kosova është e interesuar dhe ka vullnetin që të jetë pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke qenë e vetëdijshme se marrëveshjet ndërkombëtare kontribuojnë në sigurinë dhe në zgjidhjen e çështjeve rajonale dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, Republika e Kosovës i kushton rëndësi të veçantë edhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, qofshin ato rajonale apo globale, duke marrë parasysh se anëtarësimi ndikon në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kosova ende ka pengesa, sepse ende nuk është arritur anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare policore, siç janë: INTERPOL, EUROPOL, SECI, FRONTEX etj. Anëtarësimi në këto organizata ndërkombëtare është i lidhur drejtpërdrejt me statusin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara apo në BE, në organizatat rajonale të sigurisë etj.

Ligji Nr. 04/L-076, për Policinë e Kosovës – 2012

Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar policor, PK-ja këtë çështje e ka të rregulluar gjithashtu edhe me Ligjin e Policisë së Republikës së Kosovës. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe shtimit të sigurisë për të gjitha komunitetet në RKS, policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet ndërkombëtare të sigurisë. Këtë aspekt e ka të rregulluar me nenin (9) në paragrafët (1) dhe (2), ku thuhet: (1) “Policia bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet e tjera të huaja, në bazë të ligjit në fuqi ose sipas marrëveshjes ndërkombëtare”. (Ligji Nr. 04/L-076, 2012:12), në paragrafin (2) thuhet: “Policia mund të dërgojë zyrtarë policorë në shërbim të përkohshëm në një organizatë tjetër policore ndërkombëtare me qëllim të kryerjes së detyrave policore jashtë vendit, në përputhje me ligjin në fuqi ose në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare”.

Në bazë të këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare policore tani më janë dërguar zyrtarë policorë në vende të ndryshme të Evropës, si në Shqipëri, Kroaci, Angli. Gjithashtu në nenin (50) ka të rregulluar edhe caktimin e zyrtarit policor në detyrë jashtë shtetit:

1. Zyrtari policor mund të caktohet jashtë shtetit në detyrë si pjesë e punës së tij ose saj të rregullt në mënyrë që të mbështesë bashkëpunimin me autoritet ndërkombëtare kompetente ose organizatat ndërkombëtare.
2. Caktimi në detyrë jashtë shtetit mund të bëhet vetëm me pëlqimin e zyrtarit policor.
3. Caktimi jashtë shtetit zbatohet siç parashihet në marrëveshjen ndërkombëtare, nënshkruese e së cilës është Republika e Kosovës (Ligji Nr.04/L-076, 2012:65). Shikuar në tërësi mund të themi se ky ligj është një bazë e mirë përmes të cilës promovohet bashkëpunimi policor dhe luftimi i krimit si rezultat i dërgimit të zyrtarëve policor në detyra të caktuara të cilat kanë reflektuar edhe në thyerjen e barrierave dhe opinioneve për policinë e Kosovës, punën dhe profesionalizmin e saj.

Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale nr.04/L-213

Ky ligj është një akt tjetër juridik që rregullon kushtet dhe procedurat në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar mes Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera. Qysh në nenin 1 të tij, paragrafi 1, bashkëpunimi ndërkombëtar parashikohet edhe atëherë kur kjo çështje nuk është rregulluar me marrëveshje ndërkombëtare. Më konkretisht, format e bashkëpunimit policor janë paraparë te neni 98, lidhur me Njësitet e Përbashkëta të Hetimeve, ku parashihet që autoritetet e Kosovës, me marrëveshje, mund të krijojnë NJPH-të, për një çështje të caktuar, për një periudhë të kufizuar, në një apo në më

shumë shtete që kanë formuar njësinë. Njësitë e Përbashkëta të Hetimeve mund të formohen posaçërisht, nëse:

1. hetimi në një shtet për një veprë penale përfshin hetime të vështira dhe kërkuese të cilat kanë lidhje me shtetet e tjera;

2. disa shtete janë duke zhvilluar hetime për vepra penale dhe rrethanat kërkojnë veprim të kordinuar dhe të bashkuar të shteteve të përfshira (Ligji nr. 04/L-213, 2013:34). NJPH-të mund të lejohen të kryejnë hetime në territorin e Kosovës nën udhëheqjen e anëtarit të njësisë së Kosovës, në përputhje me marrëveshjen mes Kosovës dhe shtetit delegues. Atyre mund t'u ofrojnë informatat e siguruar për qëllime të hetimeve penale që kryhen nga njësia. Kur NJPH ka nevojë për veprime hetimore që duhet të ndërmerren në RKS, anëtarët vendorë të deleguar në atë njësi mund të kërkojnë nga organet gjyqësore vendore marrjen e atyre veprimeve. Ato veprime duhet të trajtohen në Kosovë në kushte të njëjta me ato që do të zbatoheshin, nëse ato veprime do të kërkoheshin gjatë hetimeve vendore.

Ndërsa në nenin 99 janë paraparë Hetimet e fshehta. Sipas tij, autoritetet e Kosovës, në bazë të kërkesës, mund t'i ofrojnë ndihmë një shteti tjetër që të zhvillojë hetime përmes hetuesve të fshehtë apo me identitet të rremë, në përputhje me ligjin vendor.

Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar 2009-2012 dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2012-2017

Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar është një dokument që përcakton synimet, parimet themelore, objektivat, institucionet përgjegjëse dhe mënyrat për arritjen e suksesit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar. Kjo strategji, mbështetet në Kushtetutën dhe në legjislacionin e aplikueshëm

në RKS, në instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare (Strategjia: 2009-2012: 6).

Kjo strategji identifikon qartë objektivat që duhet të përmbushen në funksion të parandalimit dhe të luftimit me sukses të krimit të organizuar në Kosovë, si dhe duke qenë partner me vende dhe organizata të tjera ndërkombëtare në luftë kundër kësaj dukurie, përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në të theksohet se zbatimi i ligjit në Kosovë në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar është i fragmentuar, i mungon kordinimi dhe bashkëpunimi efikas ndërinstytucional, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, që janë parakusht themelor për sukses në luftimin e kësaj dukurie (Strategjia 2009-2012: 8). Kjo mungesë bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar, më së shumti, reflektohet në vështirësitë për implementimin e programeve rajonale dhe, pa dyshim, e pengon punën për realizimin e objektivave strategjike për luftim efikas të krimit të organizuar.

Sipas Raportit të progresit të Komisionit European për Kosovën, 2009, ka pasur pak progres në luftimin e krimit të organizuar, sidomos në pjesën veriore të Kosovës. Progres të kufizuar ka sidomos në veri të Kosovës dhe në vijat kufitare mes Kosovës dhe Serbisë (Revista shkencore *Europa*, 2009: 120).

Sipas strategjisë, duhen intensifikuar përpjekjet për bashkëpunim ndërkombëtar, me qëllim të shkëmbimit të inteligjencës për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e krimit të organizuar. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, duhet të mbështetet edhe në përpjekjet e institucioneve të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare relevante, si dhe këto institucione të jenë pjesë aktive e përpjekjeve dhe angazhimeve ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar.

Në implementimin e kësaj Strategjie, qeveria e Kosovës luftën kundër krimit të organizuar e identifikon si një ndër prioritetet e saj për arritjen e qëllimeve në rrugën e integriteteve europiane. Për këtë qëllim ajo ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2012-2017, ku janë identifikuar objektivat strategjikë, objektivat specifike dhe aktivitetet për një implementim të suksesshëm të saj. Është vlerësim i përgjithshëm se gjatë kësaj periudhe, nga miratimi e deri tani, është arritur përparim në përmbushjen e parametrave, të objektiveve, veprimeve dhe aktiviteteve në kuadër të implementimit të strategjisë nga institucionet e përfshira në implementim (Vlerësimi i implementimit të Planit të Veprimit (PV) të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar 2012-2017, viti i tretë implementues 2014-2015).

Na tërheq vëmendjen fakti se objektivi strategjik 2 “Zhvillimi i bashkëpunimit dhe i kordinimit mes aktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar”, në vetvete, përmban 3 objektiva specifike dhe 8 aktivitete. Duke u bazuar në raportimin e institucioneve përgjegjëse lidhur me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, nga aktivitetet e parapara, janë implementuar: plotësisht, 6 aktivitete, pjesërisht 1 aktivitet, nuk është implementuar 1 aktivitet. Në përqindje, vlerësimi i aktiviteteve paraqitet kështu: plotësisht janë implementuar 75%, pjesërisht 13%, nuk janë realizuar sipas planit 12%.

Sfidat e identifikuar në rrafshin ndërkombëtar konsiderohen: Shkëmbimi i informacioneve lidhur me krimin e organizuar, ngritja e një sistemi të sigurt komunikues mes institucioneve, marrëveshjet e bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe me shtetet e tjera, anëtarësimi i Republikës së Kosovës në institucionet, iniciativat, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare dhe rastet lidhur me pastrimin e parave dhe me financimin e terrorizmit.

Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit

Në Strategjinë kundër terrorizmit, janë përcaktuar objektivat dhe prioritetet strategjike për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, kapacitetet efikase dhe efektive për t'u ballafaquar me terrorizmin, si dhe janë mundësuar zhvillimi dhe fuqizimi i partneritetit në nivel të vendit, rajonal dhe në atë ndërkombëtar në fushën kundër terrorizmit.

Republika e Kosovës është duke u angazhuar maksimalisht për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, por ka edhe synimin që të jetë partner i rëndësishëm dhe pjesë e pandashme e përpjekjeve ndërkombëtare kundër terrorizmit. Në këtë kontekst, Kosova, ka ngritur kapacitete institucionale të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, duke krijuar mekanizmat adekuatë nacionalë, burimet njerëzore të domosdoshme, si dhe infrastrukturën fizike, teknike dhe teknologjike. Ka progres në luftimin e terrorizmit, por konsiderohet se ende duhet bërë në këtë drejtim (Revista shkencore *Europa*, 2009:121).

Kosova është e angazhuar të punojë me qeveritë dhe me institucionet e tjera ndërkombëtare për të adresuar shqetësimet e përbashkëta për kërcënimet, madje, edhe me shtetet që nuk e kanë njohur formalisht shtetësinë e saj. Duke e konsideruar bashkëpunimin ndërkombëtar si esencial për mposhtjen e terrorizmit, Kosova është e angazhuar në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, por ka edhe synim që të jetë partner i rëndësishëm dhe pjesë e pandashme e përpjekjeve ndërkombëtare kundër terrorizmit (Strategjia e Kosovës kundër terrorizmit, 2012-2017: 5). Bashkërendimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Terrorizmit me strategjitë e tjera kombëtare e sidomos me atë kundër krimit të organizuar, drogave, trafikimit të qenieve njerëzore etj., është i

një rëndësie të veçantë, pasi në shumë vende është vërejtur një trend i afrimit të organizatave terroriste me organizatat kriminale (Strategjia 2012-2017: 6). Kosova udhëhiqet nga parimi i bashkëpunimit në fusha të tilla, si: ndjekja, hetimi dhe nxjerrja para drejtësisë e individëve apo grupeve që paraqesin kërcënim terrorist apo kryejnë akte terroriste, parandalimi, pengimi dhe hetimi i ekstremistëve të dhunshëm apo terroristëve që të influencojnë, të rekrutojnë, të planifikojnë dhe të ndërtojnë legjitimitet brenda vendit, si dhe bashkëpunimi dhe kordinimi ndërinstytucional, rajonal, ndërkombëtar (Strategjia e Kosovës kundër terrorizmit, 2012-2017: 3).

Është vlerësuar se Kosova ka kapacitete dhe burime të brendshme, por jo të mjaftueshme, për t'iu kundërpërgjigjur sulmeve terroriste të përmasave të mëdha dhe ka nevojë për bashkëpunim me subjektet tjera ndërkombëtare, në rast të një sulmi të tillë. Megjithatë, është arritur progres në luftën kundër terrorizmit, por Kosova në përgjithësi edhe nga Raporti i komisionit Evropian vlerohet se është në fazën e hershme të trajtimit të terrorizmit (Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, 2009: 56).

Për sa i përket implementimit të Strategjisë, Drejtoria Kundër Terrorizmit në Policinë e Kosovës në mënyrë aktive është angazhuar në implementimin e aktiviteteve dhe të objektivave që dalin nga Strategjia Nacionale Kundër Terrorizmit. Ashtu siç edhe është paraparë, Drejtoria Kundër Terrorizmit, në baza vjetore, ka hartuar Raportin vjetor të kërcënimit nga terrorizmi, ka identifikuar në mënyrë të vazhdueshme persona të radikalizuar me ideologji esktrmiste, si dhe vendet në të cilat ka qenë më aktive veprimtaria e këtyre personave. Informatat e shkëmbyera me partnerët ndërkombëtarë kanë ndihmuar në zhvillimin e hetimeve të mëtejshme dhe ndriçimin e rasteve që kanë qenë duke u trajtuar nga DKT. Megjithatë, DKT ka zhvilluar hetime të përbashkëta në nivel ndërkombëtar në dy raste, njërin në vitin 2014 dhe një rast tjetër në vitin 2015, që

ka rezultuar edhe me arrestimin dhe ndalimin e një personi të dyshuar shtetas kosovar, i nacionalitetit shqiptar, procedura penale ndaj të cilit është në vazhdim e sipër. Në përgjithësi është konkludim se në këtë drejtim duhet të shtohen përpjekjet për më shumë shkëmbim të informatave me partnerët ndërkombëtar.

Objekti	2013	2014	2015	Totali
Informata të shkëmbyera	6	69	82	158
Rastet e hetimeve të përbashkëta	0	1	1	2
Numri i personave të arrestuar	0	0	1	1

Table 21: Të dhënat lidhur me veprat penale në fushën e terrorizmit 2013-2015
Burimi: *Policia e Kosovës, Drejtoria Kundër Terrorizmit (2015)*

Strategjia shtetërore e Republikës së Kosovës kundër narkotikëve 2012-2017

Kosova, duke qenë e vetëdijshme për dukurinë e prodhimit dhe e trafikimit të drogave si një dukuri ndërkombëtare, që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë paraqet rrezik për vendin, ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Dytë Nacionale kundër Drogave. Duke marrë parasysh pozitën që ka Kosova, ku vazhdimisht ka tendenca të atakimit nga kjo dukuri, qoftë në përdorimin e drogave, qoftë në trafikimin brenda apo përmes territorit tonë, Qeveria e RKS-së, është duke bërë përpjekje që të përmirësojë situatën aktuale përmes parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie, me qëllim të progresit drejt rrugës së integriteteve euro-atlantike, njëkohësisht, shpreh vullnetin për të bashkëpunuar me të gjitha shtetet dhe me mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë për të minimizuar pasojat nga drogat (Strategjia Kombëtare Kundër Drogave, 2012-2017:6).

Kjo strategji është e mbështetur në Kushtetutën dhe në legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, në instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare (Strategjia Kombëtare Kundër Drogave, 2012-2017: 6).

Sipas strategjisë, hetimet duhet të jenë të kordinuara mirë dhe të centralizuara në njësitet përgjegjëse, me qëllim të racionalizimit të kohës, të shpenzimeve operativohetimore dhe të veprimeve tjera administrative, si dhe të eliminimit të dyfishimit të hetimeve, si brenda territorit të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe ato që ndërlidhen me shtetet tjera në aspekt ndërkombëtar e që mund të kenë ndërlidhje kriminale me vendin apo qytetarët tanë (Strategjia Kombëtare Kundër Drogave, 2012-2017: 24-25).

Bashkëpunimi dhe kordinimi mes institucioneve të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të tjerë me mandat në fushën e narkotikëve, ka si qëllim zvogëlimin e ofertës dhe të furnizimit. Policia e Kosovës, ka ndërmarrë një numër operacionesh efektive në luftën kundër abuzimit dhe trafikimit të narkotikëve dhe sasia e narkotikëve të konfiskuar dhe numri i rasteve dhe personave të arrestuar dhe ndjekur është rritur (Revista shkencore *Europa*, 2009:119). Gjithashtu, parashikohet ngritje e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare dhe një punë efikase të veprimeve të kordinuara, me synim parandalimin, trajtimin, hetimin, zbulimin dhe luftimin e drogave.

Zhvillimi i bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, për të përforcuar përpjekjet për shkëmbimin e inteligjencës, me qëllim pengimin apo shkatërrimin e aktiviteteve të keqpërdoruesve të drogave me shtetet tjera, ka ndikuar që Kosova të bëjë një përparim në luftën kundër trafikut të drogës. Ky përparim përfshin bashkëpunimin në luftimin dhe konfiskimin e heroinës dhe të drogave sintetike që vijnë nga Lindja e Mesme përmes

Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, si njëra nga rrugët kryesore të Ballkanit për tregjet europiane (Komisioni European, Raporti i Progresit për Kosovën, 2010:52). Sipas raporti të progresit të Komisionit European të vitit 2014, Kosova nuk ka shënuar progres në konfiskimin e narkotikëve, përkundrazi ka shënuar rënie, kur dihet se rrugët e trafikut të drogave janë të njëjta.

Në analizën që u është bërë arritjeve të vitit 2015 u krahasuan statistikatat ndër vite dhe sfidat me të cilat është ballafaquar DHTN-ja, si dhe u bë vlerësimi i realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë kombëtare dhe në Planin e veprimit.

Në kuadër të realizimit të objektivave të parapara nga Strategjia Nacionale (2012-2017) dhe Planin e veprimit lidhur me luftën kundër narkotikëve, DHTN-ja, ka realizuar me sukses aktivitetet e saj, si në fushën operacionale - hetimin e rasteve që kanë të bëjnë me narkotikë, ashtu edhe në fushën e parandalimit të trafikimit të tyre.

DHTN-ja, ka bashkëpunuar me mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë edhe në fusha të tjera, si në veprime operacionale, në hetime të përbashkëta, si edhe në shkëmbimin e informatave të rëndësishme, në identifikimin dhe hetimin e grupeve të dyshuara kriminale. Në periudha të ndryshme DHTN-ja ka inicuar raste me bashkëpunim ndërkombëtar, për të cilat ka realizuar hetime të përbashkëta, operacione të përbashkëta dhe takime operacionale.

Gjatë vitit 2015, Policia e Kosovës, në bashkëpunim me shtetet tjera, ka goditur gjithsej 19 grupe kriminale, ku ishin të përfshirë gjithsej 70 persona të nacionaliteteve të ndryshme, si në vijim:

- 53 persona nga Republika e Kosovës
- 11 persona – shtetas të Republikës së Shqipërisë
- 3 persona – shtetas të Republikës së Maqedonisë

- 1 person – nga SHBA
- 1 person – nga Kolumbia
- 1 person – nga Republika e Malit të Zi

Gjatë këtyre operacioneve të zhvilluara, përveç shkatërrimit të këtyre grupeve kriminale dhe konfiskimit të substancave të dyshuara narkotike të llojeve të ndryshme, janë konfiskuar edhe 28 armë në posedim ilegal dhe 472 fishekë të kalibrave të ndryshme. Madhësia e këtyre grupeve kriminale është deri në 8 persona për grup.

Një drejtim tjetër i bashkëpunimit ndërkombëtar të DHTN-së ka qenë edhe intensifikimi i shkëmbimit të informatave dhe i takimeve, me qëllim identifikimin e rrjeteve kriminale që veprojnë jashtë Kosovës. Janë shkëmbyer 19 informacione përmes ILECU-t, 2 informata u janë përcjellë autoriteteve austriake dhe janë realizuar dy raste të suksesshme që kanë pasur të bëjnë me konfiskimin e heroinës. Lidhur me rastet, janë përcjellë mesazhe përmes ILECU-5-ST.

Gjithashtu, janë zhvilluar takime të vazhdueshme me zyrtarët e EULEX-it lidhur me punën, si dhe operacione të përbashkëta me shtetet Zvicër, Shqipëri dhe me EULEX-in. Ndërkohë janë mbajtur 12 takime për bashkëpunim ndërkombëtar për 3 raste, në Shkup, Tiranë, Zagreb dhe në Malin e Zi. Nga Policia e Kosovës janë duke u hetuar 3 raste, me bashkëpunim ndërkombëtar, financuar nga fondi i Komisionit European IPA dhe GIZ.

Gjatë këtij viti është hartuar dhe realizuar një plan operativ në bashkëpunim me EULEX-in - patrullim me helikopter për identifikimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe janë identifikuar dy vende.

Duke analizuar këto të dhëna të raporteve të DHTN-së dhe rritjen e numrit të rasteve të posedimit të substancave narkotike, konsiderojmë se sot Kosova nuk njihet

vetëm si vend tranzit për substancat narkotike, por edhe si vend i shpërndarjes dhe i konsumimit të tyre.

Konkludojmë se situata politike në Kosovë dhe pamundësia e anëtarësimit të saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare (INTERPOL, EUROPOL, SECI,) etj. i pamundësojnë Kosovës që të kontribuojë sa duhet në fushën e luftës së krimit të organizuar dhe në kontrollimin e kufijve. Trendi global, pozita gjeostrategjike e Republikës së Kosovës, migrimi i popullsisë brenda dhe jashtë vendit, varfëria, papunësia, ekonomia e pazhvilluar, si dhe mungesa e zhvillimit të programeve preventive, edukative dhe shëndetësore kanë ndikuar që Kosova të njihet si vend i keqpërdorimit dhe i abuzimit me droga, si dhe të shfrytëzohet si vend tranzit për trafikimin e drogave përmes territorit të saj.

Strategjia nacionale kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2011

Hartimi i Strategjisë kundër trafikimit të qenieve njerëzore është një detyrim që rrjedh nga përparësitë që ka përcaktuar Republika e Kosovës për luftën kundër krimit të organizuar dhe të gjitha format e shfaqjes së tij. Strategjia, si produkt i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, reformat dhe politikat e zhvillimit, ashtu sikurse përballimi i situatave të vështira politike që ka kaluar vendi, janë mbështetur gjerësisht nga partnerët ndërkombëtarë (Strategjia nacionale kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2011: 8).

Një sërë dokumentesh dhe konventash ndërkombëtare përbëjnë bazën ligjore për hartimin e një legjislacioni adekuat kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ndër kryesoret janë: 1. Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut 2. Konventa Europiane dhe protokollet e saj për mbrojtjen e të Drejtave

të Njeriut dhe Lirisë së Lëvizjes 3. Korniza e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e pakicave kombëtare 4. Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor. 5. Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW, 3.9.1981). 6. Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve, 2.9.1990. 7. Konventa e KE për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, 25.1.1996. 8. Konventa kundër torturës dhe mizorive të tjera, trajtimit poshtërues apo jo human dhe keqtrajtimeve 9. Protokolli i KB për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore, Rezoluta e KB A/PEC/55/ 25 of 15.11.2000 (Protokolli i Palermos) etj. (Strategjia nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore 2008-2011: 8).

Gjithashtu, sipas Strategjisë parashikohet vendosja e kontakteve dhe e bashkëpunimit me organizatat qeveritare, ndërkombëtare në vendet e treta për vendosjen e viktimave të trafikimit si dëshmitarë të mbrojtur; si dhe vazhdimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat qeveritare, ndërkombëtare në vendet e origjinës së viktimave të trafikimit.

Sipas planit të veprimit është parashikuar të sigurohet zbatimi i instrumenteve përkatëse juridike për hetime të përbashkëta me shtetet e tjera dhe me organizata, si INTERPOL/EUROPOL/SECI, si dhe krijimi i pikës fokale të strukturës së QIEJL/SECI (Qendra e Iniciativave për Europën Juglindore) (Strategjia nacionale kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2011: 38).

Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit

Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK) dhe siguria në kufi përbëjnë një angazhim të veçantë që buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nga legjislacioni në fuqi, nga veprimet politike dhe siguria kombëtare brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet

ndërkombëtare, veçanërisht lidhur me procesin e anëtarësimit në BE, në strukturat e tjera ndërkombëtare dhe me ndërtimin e besimit me shtetet fqinje e më gjerë. Lëvizja e lirë e njerëzve dhe e mallrave është një element kyç ku bazohet BE, e cila bën thirrje për futjen e masave dhe të standardeve të kontrolleve të kufijve. Bashkimi Europian ka zhvilluar një sistem efektiv të kontrollit dhe të menaxhimit të kufijve, sistem i cili lejon lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave, parandalimin e krimit ndërkufitar, gjithmonë duke respektuar standardet e larta të drejtave dhe të lirive të njeriut (Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, fq. 8).

Një nga shtyllat e kësaj strategjie është bashkëpunimi ndërkombëtar. Policia kufitare bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, duke vepruar në përputhshmëri me legjislacionin e shteteve respektive dhe gjithnjë e më shumë janë shtuar aktivitetet e përbashkëta, si patrullimet e sinkronizuara, hetimi i incidenteve kufitare, hetimi i krimeve ndërkufitare, parandalimi i kontrabandës së emigrantëve dhe i kalimeve ilegale të kufirit, zbulimi i narkotikëve dhe arrestimi i personave të kërkuar (Ligji për Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, 2011:14).

Ndërsa Neni 50, Kreu X, parasheh bashkëpunimin ndërkombëtar policor në kryerjen e kontrollit kufitar, përfshirë aktivitete të shërbimeve të huaja policore në territorin e Republikës së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës në territorin e shteteve tjera, si dhe bashkëpunimin me organe të huaja të sigurisë dhe shkëmbimin e oficerëve ndërlidhës.

Në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, zyrtarët e huaj policorë mund të hyjnë në territorin e Kosovës dhe të kryejnë punën në bazë të autorizimeve dhe, po ashtu anasjelltas, zyrtarët vendas policorë mund të hyjnë në territorin e shteteve tjera, duke paraparë edhe procedurat e tjera sipas marrëveshjes ndërkombëtare. Kjo tregon mënyrën

e bashkëpunimit ndërmjet organeve shtetërore në kufirin shtetëror. Organet shtetërore të përfshira në menaxhimin kufitar janë treguar të përgatitura profesionalisht dhe po ndihmojnë e bashkëpunojnë ngushtë dhe në vazhdimësi, me qëllim realizimin sa më efikas dhe efektiv të kontrollit kufitar.

Po, me këtë ligj janë të rregulluara edhe bashkëpunimi me organet e huaja të sigurisë dhe me organet ndërkombëtare. Në nenin 52 është përcaktuar bashkëpunimi me organet e huaja të sigurisë, ku thuhet: Ministria, në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare, bashkëpunon me organet e huaja të sigurisë në kryerjen e kontrollit kufitar. Ndërsa Neni 53 përcakton edhe oficerët për ndërlidhje, ku është përcaktuar se: Ministria, në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare, mund të dërgojë jashtë vendit oficerët për ndërlidhje, për kryerjen e punëve të bashkëpunimit policor ndërkombëtar, si dhe u përcakton detyra konkrete dhe autorizime.

Sigurisht, autorizimet ligjore dhe udhëzimet administrative, së bashku me marrëveshjet e nënshkruara me shtetet fqinje dhe me mekanizmat ndërkombëtarë, i japin një rol dhe detyrë të veçantë policisë kufitare, duke e bërë atë një faktor domethënës në krijimin dhe ndërtimin e një shteti me kufij të kontrolluar dhe të sigurt.

Koncepti i RKS-së për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe koncepti i BE për këtë menaxhim përfshijnë të gjitha masat që kanë të bëjnë me linjat e veprimit (politikën), me legjislacionin, bashkëpunimin sistematik, ndihmën reciproke (shpërndarjen e barrës), personelin, pajisjet dhe teknologjinë (Strategjia për MIK 2013: 10). Menaxhimi i Integruar i Kufijve, është një koncept që përbëhet nga dimensionet e mëposhtme, bazuar në Rregulloren Nr. 562/2006 të Komisionit Europian, e publikuar nga Këshilli i BE për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme.

Bashkëpunimi më i afërt ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të kufirit nënkupton bashkëpunimin me vendet fqinje dhe vendet e tjera, si dhe me organizatat respektive rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si Frontex, OBD, UNODC, UNCTAD, UNHCR, IOM.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë aspekt i referohet bashkëpunimit ndërmjet shteteve fqinje, që mbulojnë çështje të ndryshme, të tilla si organizimi i patrullave të përbashkëta ose bashkërendimi i mbikëqyrjes kufitare, pikat e përbashkëta kufitare, shkëmbimin e informacionit, analizat të përbashkëta të rrezikut, trajnimet e përbashkëta, zyrat e përbashkëta të kontaktit dhe pikat e kontaktit (Strategjia për MIK, 2013:10). Në nivelin shumëpalësh, parashihet një qasje më e mirë në fushat e përbashkëta të punës, të tilla si: krimi ndërkufitar, migrimi i parregullt, trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi dhe kontrabandimi i mallrave, nëpërmjet bashkëpunimit me aktorët ndërkombëtarë, pjesëmarrja në forume rajonale dhe ndërkombëtare dhe përmes nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare (Strategjia për MIK, 2013:13).

Autoritetet përgjegjëse për MIK bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë ngushtë aktivitetet me partnerët ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë, posaçërisht, me Komisionin European, Zyrën e Bashkimit European në Kosovë, EULEX-in dhe me projektet përkrahëse, me qëllim realizimin e objektivave që dalin nga kjo strategji (Strategjia për MIK, 2013:54). Po ashtu, Policia e Kosovës synon që të angazhohet më aktivisht në proceset multilaterale të bashkëpunimit european, përmes pjesëmarrjes aktive në grupet përkatëse të punës të procesit të Budapestit.

Aktualisht, në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, Policia e Kosovës bazohet në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me vendet fqinje, si me Shqipërinë,

Maqedoninë dhe Malin e Zi. Me Serbinë marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe për lëvizjen e lirë është arritur me ndërmjetësimin ndërkombëtar në Bruksel.

Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë edhe marrëveshjet bilaterale për demarkacionin e vijës kufitare me vendet fqinje. Demarkacioni i kufirit shtetëror me Maqedoninë ka përfunduar, ndërsa ai me Malin e Zi është në proces.

Sipas PK është arritur përparim i dukshëm në fushën e patrullimeve të përbashkëta me Policinë e Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë, si dhe të patrullimeve të sinkronizuara me Malin e Zi. Një synim afatshkurtër i PK është miratimi dhe zbatimi i marrëveshjes për bashkëpunimin policor ndërkufitar me Republikën e Malit të Zi. Synim tjetër është arritja e një marrëveshjeje e bashkëpunimit me FRONTEX. Gjithashtu, Policia Kufitare synon të jetë pjesë aktive e nismatave dhe e mekanizmave rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit policor ndërkufitar, si, për shembull, Konventa e Vjenës për Sigurinë e Kufirit në Europën Juglindore, DCAF etj.

Sipas analizave dhe raporteve, Policia Kufitare zhvillon takime të rregullta ndërkufitare të nivelit lokal, rajonal dhe qendror. Me Shqipërinë, aktualisht, takimet e të gjitha niveleve mbahen në bazë të Protokollit të miratuar për organizimin e takimeve të tilla. Me Republikën e Serbisë, në bazë të marrëveshjes, takimet mbahen në baza mujore në nivel rajonal, ndërsa në nivel qendror mbahen çdo gjashtë muaj. Me agjencitë policore dhe me agjencitë e shteteve të tjera të rajonit dhe më gjerë, PK e ushtron komunikimin në mënyra të ndryshme, duke filluar nga takimet e rregullta, si dhe përmes zyrave për bashkëpunim, që janë në kuadër të Policisë së Kosovës dhe të Policisë Kufitare, si dhe qendrave të përbashkëta për shkëmbimin e informacionit.

Për sa i përket implementimit të Strategjisë në frymën e bashkëpunimit, janë mbajtur takime në Bruksel për zbatimin e marrëveshjes së arritur në Bruksel për

Menaxhimin e Integruar të Kufirit, për të cilën janë mbajtur katër takime. Me Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Serbinë janë mbajtur katër trajnime të përbashkëta me temën: “Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi i bashkëpunimit mes agjencive të zbatimit të ligjit të policive kufitare të shteteve të Ballkanit Perëndimor”. Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar me sukses projekti i binjakëzimit, nga i cili autoritetet e MIK kanë përfituar edhe donacione: një minilaborator për identifikimin e narkotikëve, 5 copë, 12 copë minidetektorë për identifikimin e narkotikëve në PKK.

Gjithashtu, si pjesë e implementimit të strategjisë për MIK, nga PK janë realizuar takime të rregullta me shtetet fqinje, si Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Qëllimi i këtyre takimeve ishte rritja e bashkëpunimit dhe e kordinimit të aktiviteteve të përbashkëta, si patrullimet, kontrollet dhe shkëmbimi i informatave. Konkretisht, në nivel qendror janë zhvilluar 29 takime; në nivel rajonal, 48 takime; dhe në nivel lokal, 304 takime.

Me palën Serbe, PK ka mbajtur takime të rregullta javore dhe mujore në nivel lokal dhe qendror, me ndërmjetësimin e EULEX-it. Përmendim këtu, takimet e zhvilluara në Pikat e Kalimit Kufitar Jarinjë (Rudnicë), Bërnjak, Merdare, Mutivodë dhe Dheu i Bardhë (Konçul) për realizimin e Marrëveshjes së arritur në Bruksel. Ndërsa Njësia e analizës dhe e vlerësimit të rriskut ka pasur takime bashkëpunimi me FRONTEX, ka dërguar raporte mujore, si dhe ka bërë shkëmbim informacionesh me 12 raporte.

6.3. Nisiativat rajonale

Konventa për Bashkëpunim Policor për Europën Juglindore (PCCSEE)

Ideja e themelimit të projektit PCCSEE ka ardhur prej Austrisë dhe Gjermanisë, në bazë të parimit të pronësisë rajonale. Për disa vite me radhë u bënë negociata për ta realizuar bashkëpunimin e përbashkët policor në këtë rajon. Më në fund, në vitin 2006, Konventa për Bashkëpunimin Policor për Europën Juglindore u nënshkrua prej ministrave të brendshëm të shteteve pjesëmarrëse, Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Moldavisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Serbisë (Banutai, 2013:72-73). Në thelb, kjo nismë synon ta bëjë Europën Juglindore ‘që t’i përvetësojë standardet e Shengenit përmes nënshkrimit të një konvente shumëpalëshe për përmirësimin e bashkëpunimit strategjik policor në rajon’ (PCCSEE, 2014).

Kosova nuk është pjesë e PCCSEE, për shkak të arsyeve politike dhe mungesës së konsensusit midis shteteve anëtare. Edhe pse Kosova mund të kërkojë t’i bashkohet dhe ta nënshkruajë kontratën, duke e shprehur vullnetin për përvetësimin e saj, statusi politik e pengon dukshëm pozitën e saj në raport me PCCSEE. E lënë jashtë këtij mekanizmi të madh organizativ, Kosova nuk mund të përfitojë ende prej disa programeve dhe projekteve të saj (Intervistë me zyrtarë të PCCSEE, 2014).

Konventa në fjalë parashikon forma moderne të bashkëpunimit midis palëve kontraktuese, siç janë analiza e përbashkët e kërcënimit, zyrtarët e ndërlidhjes, ndjekja e shpejtë, mbrojtja e dëshmitarëve, vëzhgimi ndërkufitar, dorëzimi i kontrolluar, hetimet e fshehta për të hetuar krimin dhe për të parandaluar veprat penale, dërgimi dhe krahasimi i profileve të ADN-së dhe i materialeve të tjera të identifikimit, masat teknike për lehtësimin e bashkëpunimit tejkuftar, operacione të kontrollimit kufitar, grupe pune të

përbashkëta për analiza, ekipe të përbashkëta të hetimit, patrulla të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror dhe bashkëpunim në qendra të përbashkëta.

Zbatimi i plotë i Konventës i ndihmon ato vende nënshkruese, që nuk janë anëtare të BE, për të përsheptuar pranimin eventual të tyre. Veprimtaritë kryesore për zbatimin e plotë të Konventës bazohen në tri shtylla:

Organet vendimmarrëse: - Grupi i punës i ekspertëve, roli i të cilit është të vëzhgojë aplikimin dhe zbatimin e Konventës dhe t'i japë rekomandime Komitetit të ministrave. Deri tani ky grup ka zhvilluar pesë takime, i pari është mbajtur më 6 mars 2009, në Beograd, Serbi; i dyti, më 29-30 qershor 2009 në Lubljanë, Slloveni; i tretë, më 19 maj 2010, në Sofje, Bullgari; i katërti, më 16 shtator 2010, në Shkup, Maqedoni, dhe i pesti, më 23-24 shkurt 2011, në Celje, Slloveni. Komiteti i ministrave ka rolin që të vendosë unanimisht mbi interpretimin, zbatimin dhe aplikimin e Konventës. Takimi i parë i komitetit është mbajtur më 17 korrik 2008, në Vjenë, Austri; takimi i dytë u organizua më 17 nëntor 2009, në Bruksel, Belgjikë; i tretë, më 21maj 2010 në Sofje, Bullgari; i katërti më 19 tetor 2010, në Bërdo Kranj, dhe i pesti, më 28 shkurt 2011, në Lubjanë, Slloveni.[\(http://www.pccseesecretariat.si/\)](http://www.pccseesecretariat.si/).

Bashkëpunimi operativ - Konventa në vetvete siguron një grumbull mjetesesh për bashkëpunim operativ, i cili pritët të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Anëtarësia - më 5 maj 2006 në Vjenë, ministrat e Punëve të Brendshme nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia nënshkruan Konventën për Bashkëpunim Policor për Europën Juglindore. Konventa hyri në fuqi më 10 tetor 2007, pas ratifikimit nga të shtatë shtetet nënshkruese. Përveç tyre, Bullgaria, Austria, Hungaria dhe Sllovenia u anëtarësuan më vonë.

Struktura: Sekretariati i Konventës për Bashkëpunim Policor për Europën Juglindore, i vendosur në Lubljanë, Slloveni, është themeluar me vendim të Komitetit të ministrave në takimin e tij më 17 korrik 2008, në Vjenë. Sekretariati, i organizuar dhe i përkrahur nga DCAF, u bë operativ më 1 shtator 2008. Personeli i DCAF në Lubljanë dhe personeli i deleguar nga palët kontraktuese (Austria dhe Sllovenia) bëjnë ekzekutimin e punëve të Sekretariatit. Mandati dhe detyrat e Sekretariatit, si dhe ndarja e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore është paraparë në Memorandumin e mirëkuptimit mbi bashkëpunimin dhe përkrahjen në lidhje me sekretariatin, të nënshkruar nga ministrat e palëve kontraktuese dhe drejtori i DCAF (Konventa për Bashkëpunimin Policor në Europën Juglindore).

6.4. Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në Europën Juglindore, RACVIAC

Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në Europën Juglindore është pasues ligjor i qendrës rajonale për asistim, verifikim dhe kontroll të armëve. Ajo është organizatë ndërkombëtare, e pavarur, jofitimprurëse, në pronësi rajonale dhe akademike dhe i përgjigjet organit të saj vendimmarrës politik, Grupit Këshillues Multinacional (MAG).

Misioni RACVIAC është nxitja e dialogut dhe e bashkëpunimit për çështjet e sigurisë në Europën Juglindore përmes partneritetit mes shteteve të rajonit dhe partnerëve të tyre ndërkombëtarë, duke “transformuar të menduarit mbi çështjet e bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar të sigurisë. Duke i ekspozuar pjesëmarrësit ndaj përfitimit të qasjeve bashkëpunuese mbi çështjet e sigurisë, kryesisht, përmes konferencave, kurseve, seminareve dhe takimeve në RACVIAC, si dhe përmes

trajnimeve gjuhësore dhe programeve të tjera të aplikueshme mbështetëse”
(<http://www.racviac.org/>)

Programi vjetor i RACVIAC përqendrohet në tri shtylla kryesore: reformën e sektorit të sigurisë, marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, me një fokus të veçantë në organizatat euro-atlantike, dhe mjedisi bashkëpunues për çështje të sigurisë, me një fokus në kontrollin e armëve. Për ndërtimin e profilit akademik, RACVIAC planifikon – seminare, workshop-e dhe konferenca. Ndër temat që përfshihen në programet e tyre janë: tranzicioni i personelit ushtarak, konvertimi i bazës ushtarake, menaxhimi i burimeve të mbrojtjes, kontrolli demokratik i forcave të armatosura, reforma e sektorit të sigurisë, lufta kundër terrorizmit, bashkëpunimi për çështje të sigurisë në rajon, menaxhimi i katastrofave/fatkeqësive, integrimi europian dhe euro-atlantik dhe kontrolli i armëve dhe CSBM.(<http://www.racviac.org/>)

Anëtarësia - Marrëveshja e re mbi RACVIAC është nënshkruar më 14 prill 2010 nga Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia, dhe tani është në proces ratifikimi.

Vëzhgues - shtetet, institucionet apo organizatat e tjera, që mund të marrin pjesë në veprimtaritë e RACVIAC si vëzhguese pas aprovimit nga MAG: Kanadaja.

Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e MAG dhe financimi i tij janë të specifikuara në Termat e Referencës. Anëtarët dhe ata të asociuar marrin pjesë në mënyrë të barabartë në diskutimet e MAG, i cili merr vendimet e veta në bazë të konsensusit vetëm të anëtarëve.

Kosova është pjesë e saj që nga tetori i vitit 2014 dhe nga shtatori 2015 ka një përfaqësues të saj në këtë Qendër (ILECU - Policia e Kosovës, 2015). Zyrtarë të PK-së në vitin 2015 dhe fillim të vitit 2016 kanë marrë pjesë në seminarin RACVIAC që u

zhvillua në Rakitije të Zagrebit, Kroaci, me qëllim marrjen e praktikave të mira të punës, shkëmbimin e informatave lidhur me menaxhimin e incidenteve kritike dhe pranimin e obligimeve si shtet mbi zhvillimin e Strategjisë Nacionale, lidhur me Armët e Shkatërrimit në Masë apo WMD (Weapon of Mass Destruction) ose CBRN (Chemical, Biological, Radiological and Nuclear Weapons).

Në këtë work-shop janë pranuar informata të shumta lidhur me marrjen e praktikave të mira të punës dhe me rritjen e kapaciteteve ekzistuese në menaxhimin e operacioneve të përbashkëta mes agjencive në menaxhimin e incidenteve kritike.

Është vlerësuar se Kosova përmes mekanizmave përgjegjëse, Polici-Doganë, rrit nivelin e vigjilencës në regjimin e kontrollit në pikat kufitare, fushë të cilën e rregullon Ligji mbi Mallrat Strategjike dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje.

Parashihet të planifikohet fillimi i ushtrimeve mes agjencive përgjegjëse sipas Planit për reagim kombëtar me skenar mbi menaxhimin e fluksit të emigrantëve dhe rasteve potenciale WMD/CBRN, e cila do të kontribuonte në njohjen e kapaciteteve dhe në plotësimin e boshllëqeve të evidencuara në procesin e mësimave të nxjerra.

6.5. SECI – Nisiativa e Europës Juglindore për Bashkëpunim

SECI u formua në vitin 1996, nën udhëheqjen e Richard Schifter, këshilltar i posaçëm i sekretarit amerikan Shtetit për Europën Juglindore, në administratën e Klintonit, i cili synonte t'i sillte rajonit stabilitet përmes themelimit të SECI-t.

Qëllimi fillestar i SECI-t ishte stabiliteti, jo përmes ndihmave financiare, por përmes bashkëpunimit rajonal të kombeve të Europës Juglindore, në formën e mjeteve që do të mund të ndihmonin në rindërtimin dhe stabilizimin e rajonit. Ndihma e vetme

që do të vinte prej kombeve dhe organizatave të tjera, përjashtuar ato të rajonit, ishte ajo teknike dhe e ekspertizës në fushat e rëndësishme.

Megjithë dallimet sektare dhe etnike në rajon, anëtarët e SECI-t janë: Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgaria, Maqedonia, Greqia, Hungaria, Moldavia, Rumania, Serbia, Mali i Zi, Kroacia, dhe Sllovenia. Më 7 tetor të vitit 2011, SECI u shndërrua në SELEC (South East Law Enforcement Center), duke ia bartur kështu detyrat operative dhe strategjike organizatës së re të quajtur SELEC, i cili e ka selinë në Bukuresht (SECI& SELEC, 1999). Objektivi i tij është ofrimi i mbështetjes për shtetet anëtare, si dhe zgjerimi i bashkërendimit në parandalimin dhe luftimin e krimit, përfshirë krimin e organizuar aty ku ndodh ky krim apo duket se do të ndodhë dhe që është një veprimtari që i kalon kufijtë e një shteti të caktuar.

Në kuadër të UNMIK-ut, Kosova ishte vëzhguese e SELEC. MPJ e Kosovës kishte dorëzuar një shkresë zyrtare, duke kërkuar informacion për çështjen e anëtarësimit të saj. Më pas i dërgoi një shkresë zyrtare kryesuesit të SEEPAG, ku i parashtronte kërkesën për anëtarësim, por nuk mori ndonjë përgjigje. Siç duket, autoritetet e Kosovës nuk u ishin përmbajtur procedurave për parashtrimin e kërkesave në SELEC (ILECU, PK- 2014). Kështu që pas refuzimit të qartë ndaj kërkesës së saj për anëtarësim, Kosova ende po përballlet me pengesa që të bëhet anëtare e SELEC. UNMIK ka statusin e vëzhguesit në këtë organizatë, e cila më shumë cilësohet si organizatë që organizon takime operationale në Europën Juglindore dhe është krah i Europol-it. Komunikimi me SELEC bëhet rast për rast dhe përmes një shteti të tretë.

Dërgimi i një zyrtari të Kosovës në këtë organizatë do të bëhej me marrëveshje mes Doganës dhe Policisë së Kosovës.

6.6. SEECP – Procesi i Bashkëpunimit i Europës Juglindore (EJL)

Procesi i bashkëpunimit i Europës Juglindore (SEECP) nisi në vitin 1996. Kjo nismë, fillimisht, u quajt “Procesi i marrëdhënieve të mira fqinjësore, i stabilitetit, i sigurisë dhe i bashkëpunimit mes vendeve të EJL”. Kjo strukturë u paraqit nga vendet e EJL-së dhe kishte për qëllim të përfaqësonte ‘zërin unik të rajonit’. SEECP është një strukturë fleksibël, e cila u themelua nga shtetet e rajonit, si shprehje e solidaritetit të tyre. Korniza e përgjithshme e SEECP përbëhet prej bashkëpunimit, kryesisht, në fushën e sigurisë, të stabilitetit, të qëndrueshmërisë, të zhvillimit ekonomik, të bashkëpunimit në fushën e drejtësisë, të krimit të organizuar, të trafikimit të narkotikëve, të luftimit të krimit të organizuar, të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të armëve.

Një prej përgjegjëseve të shteteve anëtare është që të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën për të krijuar dhe për të hartuar strategji të përbashkëta për stabilitetin e rajonit, në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë sfidat e reja në fushën e sigurisë (SEECP, objektivat kryesore). Si një prej nismave të vetme të themeluara nga shtetet rajonale me qëllim promovimin e demokracisë, të prosperitetit, të paqes dhe të zhvillimit ekonomik, si dhe të integritetit euro-atlantik për të gjitha vendet e rajonit, SEECP përbëhet prej 12 anëtarësh: Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Greqisë, Maqedonisë, Moldavisë, Malit të Zi, Rumanisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Turqisë (SEECP, Compromise Proposal of the SEECP).

Duke e konsideruar SEECP, si një ndër platformat më serioze të bashkëpunimit rajonal në Ballkan, Kosova synoi dhe kërkoi të bëhej anëtare me të drejta të plota e saj. Por SEECP u la jashtë listës së Cooper-it. Sipas ‘marrëveshjes për fusnotën’, kërkesa për anëtarësim në SEECP ishte e paevitueshme, duke pasur parasysh që përfshirja e Kosovës do t’i sillte përfitime edhe vetë SEECP, si dhe do të kontribuonte në

konsolidimin e plotë të paqes dhe të zhvillimit rajonal (MPJ, 2014). Në qershor të vitit 2014, Kosova, që e kishte statusin e vëzhguesit, u bë anëtare me të drejta të plota e SEECP, kur këtë e kryesonte Rumania.

Në deklaratën e SEECP, që u bë me këtë rast, mes të tjerash, theksohej:

“E kemi mirëpritur pjesëmarrjen e Kosovës në aktivitetet e SEECP gjatë vitit të kaluar dhe kemi vendosur ta ftojme Kosovën që të marrë përherë pjesë në aktivitetet dhe takimet e SEECP në të gjitha nivelet dhe në mënyrë të barabartë” (Deklarata e SEECP në samitin e Bukureshtit, 2014:5).

Pra Deklarata e miratuar prej SEECP e shpalli Kosovën pjesëmarrëse të përhershme dhe të barabartë. Me anëtarësimin e saj me të drejta të plota në SEECP, Kosova bëri një progres të madh në forumin shumëpalësh rajonal. Ky anëtarësim ia ka hapur dyert asaj që të kualifikohet edhe për anëtarësim në RACVIAC, të cilin e kemi përmendur më sipër.

6.7. ILECU – Njësia Kordinuese për Zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar

Pas përpjekjeve të vazhdueshme për ta përforsuar bashkëpunimin rajonal, posaçërisht në fushën e sundimit të ligjit, BE-ja e ka filluar zbatimin edhe të një morie veprimesh e programesh të ndryshme. Duke pasur si synim përforsimin e platformave kombëtare për policinë ndërkombëtare dhe bashkëpunimin në zbatimin e ligjit, BE-ja themeloi Njësitë Kordinuese të Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar (ILECU-s) për shtetet e Europës Juglindore. ILECU është një projekt rajonal i BE-së, që ka për qëllim themelimin e njësive kordinuese kombëtare dhe fuqizimin e bashkëpunimit në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të dy projekteve të financuara të BE-së – ILECU-s dhe

DET-ILECU-s, u krijua një rrjet nën udhëheqjen e Shërbimit Inteligent Penal të Austrisë, i cili, aktualisht, përbëhet prej njërive të shtatë vendeve: Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Moldavia. Synimi i ILECU-s në rajon është që të ketë një qendër të vetme, domethënë, një institucion/njësi në secilin vend të rajonit, gjë që mundëson kontakt dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet tyre dhe me organizatat ndërkombëtare, si Interpol, Europol, Eurojust, Frontex, Qendrën SECI (SELEC), OLAF, Sistemin Informativ Shengen, dhe SIRENE, zyrtarët ndërlidhës (kombëtarë dhe të huaj). ILECU ofron një platformë qendrore të kordinimit, të komunikimit dhe të shkëmbimit të informatave mes njësive dhe institucioneve të ndryshme që janë pjesë e agjencive kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatimit të ligjit në vendet e Ballkanit Perëndimor (ILECU, 2012).

Kosova u bë pjesë e ILECU-t në bazë të vendimit për themelimin e Njesisë Kordinuese për bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit në kuadër të Policisë së Kosovës. Qeveria e Kosovës mori vendim për themelimin e ILECU-t në kuadër të PK-së në qershor të vitit 2011. Kjo njësi do ta inkorporojë zyrën e ILECU në kuadër të PK-së, dhe në Mekanizmat e Policisë Ndërkombëtare, Interpol, Europol, dhe Frontex (MoU, 2011: Art. 1).

Duke pasur parasysh faktin që Kosova nuk ka nënshkruar marrëveshje strategjike me Europol-in, si dhe fakti që ajo nuk është anëtare e Interpol-it, ILECU i Kosovës shërben si mekanizëm që e lehtëson komunikimin midis Interpol-it, të përfaqësuar nga administrata e UNMIK-ut, dhe Europol-it, të përfaqësuar nga misioni i Eulex-it në Kosovë. Sidoqoftë, ILECU ka dëshmuar se është një mënyrë e drejtpërdrejtë, edhe pse joformale, e komunikimit dhe e kordinimit ndërmjet shteteve rajonale. ILECU njoftohet për të gjitha komunikimet që zhvillohen mes Qendrave për

Komunikim të përbashkët me Maqedoninë dhe Shqipërinë dhe që zhvillohen nga Policia Kufitare.

Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar ka në mandatin e saj kordinimin e komunikimeve që ndërlidhen me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Njësitë operative në kuadër të PK dhe me atë për asistimin mbi Ekstradimin, Transferimin dhe Deportimin e shtetasve tonë nga vendet e tjera për në Kosovë dhe anasjelltas. Kjo Drejtori bën verifikimin e të gjithë shtetasve të Republikës të Kosovës, të cilët në nivel Stacioni/Rajoni paraqesin kërkesë për ndryshim të të dhënave të tyre personale. Ky verifikim bëhet nëpërmes një ndërlidhësi Policorë këtu në Kosovë, duke shfrytëzuar bazat e të dhënave ndërkombëtare të Interpol dhe SIS.

Policia e Kosovës ka marrë pjesë në 11 takime operacionale, në 1 takim Kordinues dhe në 1 operacion të përbashkët (Operacioni RANDO); në 3 trajnime në Francë, Turqi dhe Kroaci dhe në 5 konferenca (Mal të Zi, Slloveni, Serbi, Rumani dhe Kazakistan). Kosova ka komunikim shumë të mirë me Ndërlidhësit Policorë, që janë të akredituar në Kosovë nga 7 shtete, si Austria, Shqipëria, Zvicra, Gjermania, Franca, Italia dhe Shtetet Nordike dhe 2 që janë të akredituar edhe për Kosovë, si Belgjika dhe Britania e Madhe. Ndërlidhësit Policorë të Kosovës shfrytëzohen edhe për rastet kur kanë të bëjnë me verifikime të identiteteve apo dokumenteve edhe për shtete të ndryshme, si Guatemala apo Kameruni. Sfidë për PK-në është mos pjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare, pasi në këtë mënyrë asaj nuk i ofrohet ekspertiza për sigurinë e qytetarëve të Europës dhe më gjerë.

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

7.1. Përfundime

Qëllimi i këtij studimi, në radhë të parë, është identifikimi dhe të provuarit e bashkëpunimit policor ndërkombëtar si një dodmosdoshmëri e kohës, si dhe të ndikimit të tij në luftën kundër kriminalitetit dhe terrorizmit në botë dhe në Kosovë. Në kuadër të këtij punimi kam ardhur në disa përfundime lidhur me mënyrën e qasjes dhe rolin e BNP-së në luftimin e kriminalitetit, sidomos atij të organizuar dhe terrorizmit, përfshirë edhe rolin që luajnë organizatat ndërkombëtare në këtë çështje.

Krimi i organizuar, korrupsioni dhe terrorizmi sot konsiderohen kërcënimet më serioze për sigurinë kombëtare të secilit vend, por, duke pasur parasysh trendet globale të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, ato janë, gjithashtu, edhe njëri ndër kërcënimet më serioze për sigurinë ndërkombëtare.

Krimi i organizuar, korrupsioni dhe terrorizmi i kanë shtrirë rrënjët e tyre edhe në Kosovë dhe si pasojë e kësaj ka lindur gradualisht nevoja e komunikimit dhe e bashkërendimit të masave dhe e aktiviteteve ndërkombëtare për t'u përballur me sukses me këto dukuri negative.

Siç na ka dalë edhe nga vëzhgimi në terren, zbatimi i ligjit në Kosovë në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar është i fragmentuar, i mungon kordinimi dhe bashkëpunimi efikas ndërinstitutional, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, që janë parakusht themelor për sukses në luftimin e kësaj dukurie.

Nga analiza e rasteve të zhvilluara nga Policia e Kosovës me agjencitë dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë rezulton me zgjidhjen pjesërisht të disa rasteve me

karakter ndërkombëtar, që kanë çuar në arrestimin dhe shkatërrimin e disa grupeve të organizuara kriminale, që kanë vepruar në Kosovë, por që kanë pasur shtrirje edhe në shtetet e tjera të rajonit dhe në Europë.

Edhe në bazë të analizës së pyetësorit të anketës të zhvilluar me pjesëtarë të niveleve të ndryshme të Policisë së Kosovës vërtetohet se bashkëpunimi ndërkombëtar policor është i nevojshëm për zgjidhjen e shumë problemeve dhe se ai ka shënuar rritje. Nga intervista me pyetësor janë përfutur përgjigje shumë produktive, të cilat shërbejnë për formulimin e disa rekomandimeve dhe sugjerimeve edhe për institucionin e policisë. Pyetjet e tipit alternativ janë analizuar në mënyrë statistikore, kurse përgjigjet për pyetjet e hapura na kanë mundësuar për ndonjë konkluzion të përgjithshëm, ngaqë për shumicën prej tyre nuk u dhanë përgjigje. Nga pyetësi janë marrë përgjigje nga nivele të ndryshme të zyrtarëve policorë, duke filluar nga niveli operativ hetimor e deri te niveli i menaxhmentit të lartë policor.

Prej këtyre përgjigjeve del se për të pasur një bashkëpunim të mirëfilltë policor ndërkombëtar, Policisë së Kosovës i nevojitet paraprakisht personel i kualifikuar profesionalisht dhe që të jetë në gjendje të komunikojë dhe të punojë me kolegë ndërkombëtarë nga shtetet e ndryshme. Nga analiza e të dhënave del se mbi 70% e personelit policor është i përgatitur që të komunikojë në gjuhën angleze dhe kjo është një përparësi në bashkëpunimin policor. Mbi 80% e përgjigjeve të të anketuarve vërtetuan se prezenca e faktorit ndërkombëtar të sigurisë në Kosovë ka ndikuar në zgjidhjen e rasteve me karakter ndërkombëtar dhe ka çuar në rënie të trendit të krimit. Gjithashtu, zyrtarëve policorë nuk u mungon përvoja në bashkëpunimin ndërkombëtar policor, mbi 70% e tyre janë përfshirë në veprimtari të ndryshme të BNP, një nivel ky i lartë. Mbi 50% e të anketuarve deklarojnë se punojnë në njësi që lidhen me

bashkëpunimin ndërkombëtar prej mbi pesë vjetësh, gjë që konstatohet edhe nga periudha kohore e rasteve me karakter ndërkombëtar.

Në aspektin e trajnimeve zyrtarët policorë kanë vijuar trajnime të konsiderueshme jashtë vendit dhe trajnime brenda vendit me homologet ndërkombëtarë. Në bazë të statistikave të marra nga pyetësi, mbi 30% e tyre kanë vijuar trajnime jashtë vendit dhe ky është një matës i mirë i përfitimit nga trajnimet dhe programet e avancuara dhe nga implementimi i praktikave ndërkombëtare. Konferencat, seminarët dhe puntoritë e përbashkëta me homologë ndërkombëtar kanë pasur ndikim në ngritjen e performancës dhe të efikasitetit në detyrat e përditshme të policëve të Kosovës.

Shumë pozitiv është vlerësuar krijimi i pikave të kontaktit. Niveli i komunikimit mes zyrtarëve policorë vendas dhe atyre ndërkombëtarë që punojnë në kuadër të misionëve ndërkombëtarë në Kosovë është vlerësuar shumë i lartë. Mbi 90 % të anketuarve thanë se kanë komunikim të shkëlqyeshëm me ndërkombëtarët.

Prezenca dhe përvoja e pjesëtarëve të misionëve ndërkombëtarë ka ndihmuar në zgjidhjen e rasteve të karakterit ndërkombëtar. Mbi 80 % e të intervistuarve bënë vlerësim shumë të lartë për ndihmën e ofruar.

Në pyetjen primare se “Cili është roli i bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë”?, nga mbi 53% e të anketuarve është theksuar se ky rol është këshillues, çka lë të kuptohet se, në shumicën e rasteve, zyrtarët e PK janë të angazhuar në mënyrë të pavarur dhe se faktori ndërkombëtar ndihmon me dhënien e këshillave dhe të udhëzimeve për mënyrat dhe format e qasjes ndaj bashkëpunimit.

Lidhur me bashkëpunimin në shkëmbimin e informacioneve dhe të zyrtarëve policorë me agjencitë policore të shteteve tjera, sundon mendimi se ky shkëmbim është i

kënaqshëm dhe ndihmon shumë në hapin e parë të komunikimit dhe në zgjidhjen e rasteve.

Trendi i zvogëlimit të krimit në Republikën e Kosovës pas bashkëpunimit ndërkombëtar policor me autoritetet apo organizatat ndërkombëtare policore konstatohet si i suksesshëm. Nga totali i të anketuarve, në alternativën: a ka rënie të krimit?, janë përgjigjur 187 apo 69%, niveli është i njëjtë 62 apo 23%, krimi është rritur në disa fusha 22 apo 8 %. Sa i përket alternativës së fundit se krimi ka shënuar rritje apo siguria është në regres, më shumë lidhet me pikëpamjet se kjo ka ndodhur në disa raste në Kosovë, ku kanë qenë të përfshirë si të dyshuar personel ndërkombëtar që kanë punuar në institucione të zbatimit të ligjit.

Është konkludim se mos anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare policore siç janë Interpol, Europol, Frontex e tjera paraqet pengesë në bashkëpunimin dhe në luftën efikase dhe, si pasojë, bashkëpunimi është i kufizuar. Sa i përket fushave të bashkëpunimit me organizatat policore si Interpol, Europol, SECI etj. dhe rezultateve konkrete, del se shkëmbimi i informatave zë një vend të rëndësishëm, i pasuar nga fusha e luftimit të narkotikëve, kontrabanda, trafikimi me qenie njerëzore dhe terrorizmi. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka bashkëpunimi policor lidhur me luftën kundër terrorizmit Policia e Kosovës, por edhe mekanizmat e tjerë shtetërorë të sigurisë duhet vënë prioritet gjetjes se modaliteteve për të rritur bashkëpunimin me shtetet tjera sepse paraqet një ndër segmentet kryesore të sigurisë për qytetarët e Kosovës dhe më gjerë. Kjo është vërtetuar edhe në pyetjen verifikuese, në përgjigjet për të cilën ka rezultuar se, sipas përvojës së zyrtarëve policorë, më së shumti ngecje ka në fushën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar (trafikimit të qenieve njerëzore).

Sa i përket ngritjes së besimit në organizatat ndërkombëtare që kontribuojnë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë, nuk ka shënuar ngritje kjo me faktin sepse mundësitë e drejtpërdrejta me këto organizata janë të kufizuara.

Suksesi në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit është i mundur vetëm me bashkëpunim policor të mirëfilltë dhe një angazhim sistematik, të planifikuar dhe të kordinuar në nivel kombëtar dhe në atë ndërkombëtar, si domosdoshmëri për efikasitet në ndjekjen dhe zbulimin e krimeve të ndryshme ndërkombëtare.

Sfidat e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë proces janë të dukshme. Infrastruktura adekuate ligjore në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor ka ende mungesa dhe sfidues mbetet implementimi i ligjeve në praktikë dhe mekanizmave adekuatë për të luftuar në mënyrë proaktive fenomenet negative në Kosovë.

Sfidë për PK është mospjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare, pasi kjo pengon dhënien e ekspertizës për ofrimin e sigurisë për qytetarët e Europës dhe më gjerë.

Marrëveshjet ndërkombëtare zgjidhin shumë çështje në fushën e krimit të organizuar dhe në këtë kuadër edhe për Kosovën janë si të vetmet forma dhe zgjidhje për luftimin e kriminalitetit në Kosovë edhe më tej. Në anën tjetër, shtetet përveç përfshirjes në konventa multilaterale, rëndësi i kushtojnë edhe lidhjes së marrëveshjeve bilaterale në mënyrë që të krijohet baza juridike.

Zgjidhja e çështjeve aktuale të sigurisë në Kosovë përmes angazhimit në forumet rajonale të sigurisë, anëtarësimit në organizatat policore ndërkombëtare, zbatimit të normave të së drejtës ndërkombëtare e, para së gjithash, konventave ndërkombëtare, konsiderohet imperativ i kohës në luftimin kombëtar, por edhe ndërkombëtar të krimit.

Rol të rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkombëtar luajnë OKB, BE dhe institucionet e agjencitë e tjera të sigurisë, siç janë: EUROPOL, INTERPOL etj., përmes të cilave është bërë një punë shumë e madhe. Kosova ende nuk është pjesë e këtyre organizmave ndërkombëtarë të rëndësishëm për luftimin e krimit në vend dhe me elemente ndërkombëtare.

Rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në veçanti është shtuar edhe për shkak të zhvillimit të teknologjisë. Kjo u ka mundësuar autorëve të veprave penale marrje të shpejtë të informacionit, lëvizje të shpejtë nga një vend në tjetrin etj. Për rrjedhojë, edhe policisë në të gjitha vendet e botës, për të qenë sa më efikase në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti, u duhet të bashkëpunojnë dhe të ndërtojnë mekanizma për veprime të përbashkëta për luftën kundër kriminalitetit. Nëpërmjet institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare policore të cilët janë ndërtuar enkas për këtë çështje, si Europol-i dhe Interpol-i, kjo luftë bëhet më e kordinuar dhe më efektive dhe ka dhënë rezultatet e veta.

Edhe Kosova nuk është e imunizuar nga krimi i organizuar dhe terrorizmi, që kërcënojnë jetën sociale, ekonomike dhe sistemin politik të vendit. Që të luftohen si duhet këto dy fenomene globale, është e nevojshme krijimi i besimit ndërmjet agjencive ligj-zbatuese, siç është mbajtja sekret e burimeve të informacioneve, shkëmbimi i shpejtë i tyre, heqja e barrierave burokratike në mes të shteteve, për një bashkëpunim sistematik dhe efektiv. Pra, nuk mjafton vetëm ndërtimi dhe konsolidimi i strukturave policore koherente në Kosovë, por kërkohet që atyre t'u ofrohet mbështetje dhe ndihmë efektive përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe, para së gjithash, duke i inkuadruar ato sa më shpejt në sistemin ndërkombëtar të sigurisë përmes anëtarësimit në organizatat

ndërkombëtare policore si Interpol dhe Europol që edhe ato të jenë pjesëmarrëse aktive në nismat e përbashkëta rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë.

BE dhe SHBA janë kontribuesit më të mëdhenj në ndihmën dhe promovimin e BNP në Kosovë, si dhe në ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme për Policinë e Kosovës. Përvoja dhe ndihma e këtyre vendeve në praktikën e hetimeve, në luftën kundër trafikëve të drogës, kontrabandës së migrantëve, trafikut të qenieve njerëzore, etj., kanë bërë që PK të aftësohet dhe të modernizohet në bazë të standardeve më të larta ndërkombëtare. Nga ana tjetër, BNP i Kosovës me shtetet fqinje dhe me partnerët strategjikë ndërkombëtarë vërtet është prioritet për luftimin e kriminalitetit në vendin tonë, por, në të njëjtën kohë, ai kontribuon edhe në sigurinë e vet partnerëve të Kosovës.

Ndikimi i organizatave ndërkombëtare policore në Kosovë ka qenë i limituar për shkak të mos anëtarësimit të Kosovës dhe si pasojë Kosovës i është kufizuar veprimi i saj dhe e drejta në qasje në data-bazat e këtyre organizatave që do të ishin me përfitim të madh për Kosovën. Si pasojë e mosnjohjes së Republikës së Kosovës nga të gjitha shtetet, ka bërë që bashkëpunimi të jetë i kufizuar me disa shtete. Prandaj Kosova është e detyruar të lidhë marrëveshje bilaterale policore me shtetet veç e veç. Bazuar në anketën dhe rezultatet e nxjerra nga pyetësi, rezulton se ky lloj bashkëpunimi policor ka ndikuar në uljen e kriminalitetit në Kosovë, por jo në parametrat të cilët kanë qenë pritur. Megjithatë, duke mos mundur të jetë pjesë e nismave kryesore rajonale për sundimin e ligjit, Kosova nuk mund të përfitojë prej trajnimeve e seminareve të përbashkëta për hetues, gjyqtarë e prokurorë, nuk mund të bashkëpunojë me lehtësi me vendet e tjera, dhe; se bashkëpunimi bilateral merr shumë kohë dhe nuk është shumë efikas.

Ndaj strukturat policore në Kosovë, por edhe qytetarët e saj mbështesin dhe mirëpresin zgjerimin bashkëpunimit ndërkombëtar policor dhe përfshirjen më të madhe të Kosovës në nismat dhe mekanizmat ndërkombëtare për një bashkëpunim në shkallë më të gjerë dhe më efikas.

Përfundimet në lidhje me hipotezat e punimit doktoral

Hipoteza e parë: Mungesa e një bashkëpunimi të mirëfilltë ndërkombëtar policor ka ndikuar në efikasitetin e Policisë së Kosovës në luftimin e kriminalitetit në Kosovë. Kjo hipotezë është vërtetuar. Si rezultat i hulumtimit të bërë, rezulton se nuk ekziston një bashkëpunim i mirëfilltë në mes të Policisë së Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare policore. Ky bashkëpunim është i rregulluar më shumë në bazë të marrëveshjeve individuale të nënshkruara me shtete veç e veç për fusha të caktuara. Koha e globalizimit ka bërë që krimi të mos kufizohet brenda kufijve shtetërorë. Mungesa e informacioneve për të dyshuar ndërkombëtarë vështirëson përpjekjet e Policisë së Kosovës. Pjesëmarrja e kufizuar në konferenca ndërkombëtare, gjithashtu e dëmton Kosovën në proceset dhe aktivitetet vendimmarrëse. Kështu, Policia e Kosovës pëson nga mungesa e informacioneve dhe e ekspertizave ndërkombëtare, të cilat ndihmojnë në parandalimin e krimit dhe në luftimin e tij.

Hipoteza e dytë: Bashkëpunimi ndërkombëtar policor në Kosovë pas vitit 2008 ka dhënë rezultate të dukshme në zvogëlimin dhe në luftimin e kriminalitetit. Kjo hipotezë është vërtetuar. Pas vitit 2008, Republika e Kosovës ka bërë përpjekje të vazhdueshme për bashkëpunim policor me organizatat ndërkombëtare policore. Në këtë rrafsh ka arritur që pjesërisht të bashkëpunojë me disa shtete fqinje dhe europiane dhe si rezultat i kësaj është arritur që të zbulohen disa raste me karakter ndërkombëtar por që

kanë qenë të lidhura me elementë kriminalë vendorë, janë shpartalluar disa grupe kriminale të organizuara, që vepronin në Kosovë. Si pjesë e këtij bashkëpunimi me shtetet fqinje është zvogëluar edhe kontrabanda me migrantë, janë arrestuar një grup i kontrabanduesve, të cilët e kanë përdorur territorin e Kosovës si vend tranzit për të kontrabanduar në Europë. Rezultate të dukshme janë arritur edhe falë bashkëpunimit me zyrën ndërlidhëse të Interpol-it, përmes UNMIK-ut, dhe Europol-it, përmes Eulex-it në Kosovë, në fushën e zbulimit të disa rasteve të karakterit ndërkombëtar. Edhe përkundër disa rezultateve në luftën kundër krimit, mos anëtarësimi i Kosovës në Interpol ka bërë që Kosova të jetë një vrimë e zezë në mes të Europës, si i vetmi vend ende i paanëtarësuar.

Hipoteza e tretë: Memorandumet e bashkëpunimit policor, në pamundësi të anëtarësimit të Policisë së Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë policorë, janë parë si forma të vetme të bashkëpunimit dhe luftimit të kriminalitetit në Kosovë. Kjo hipotezë është vërtetuar. Pa dyshim, se ndër sfidat kryesore të Republikës së Kosovës është pamundësia e Kosovës për anëtarësimin e saj në mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të siguriës. Për pasojë, Kosova vuan nga mungesa e shkëmbimit të informacione nga dora e parë. Si pasojë e mos anëtarësimit në OKB dhe në organizatat ndërkombëtare Kosova humb shumë nga bashkëpunimi ndërkombëtar. Policia e Kosovës për shkak të statusit politik ndërkombëtar të pazgjidhur të Kosovës nuk mund të marrë pjesë në forumet dhe takimet e rregullta që mbahen nga këto institucione të siguriës.

Gjithashtu, Kosova në shumë raste është përjashtuar apo nuk është ftuar të marrë pjesë në konferencat dhe në forumet rajonale, ku janë diskutuar çështje të siguriës. Për shkak të statusit të saj, Kosova nuk mund të nënshkruajë dhe nuk aderon në shumë konventa ndërkombëtare dhe rajonale të siguriës dhe të luftës kundër krimit të

organizuar. Po ashtu, ajo nuk mund të nënshkruajë as marrëveshje kontraktuale, gjë që do të ndikonte në uljen e krimit në Kosovë.

Të gjitha pengesat e Kosovës për pjesëmarrje në nismat, takimet dhe forumet rajonale apo më gjerë janë si pasojë e obstrukcioneve dhe pengesave që vijnë nga Serbia. E detyruar nga pamundësia e antarësimit, deri tani Kosova ka lidhur një numër të konsideruar marrëveshjesh me shtetet veç e veç dhe ka arritur të shënojë rezultate konkrete në luftimin e kriminalitetit në të gjitha fushat. Kjo ka treguar për aftësitë dhe profesionalizmin e treguar nga PK-ja dhe për interesimin e shteteve për bashkëpunim konstruktiv.

7.2. Rekomandime

Bazuar në përfundimet që kanë dalë nga ky punim, kam ardhur në formulimin e disa rekomandimeve, që mendoj se do të ndihmonin në forcimin e përpjekjeve të Republikës së Kosovës në gjetjen e rrugëve edhe më të mira dhe të përshtatshme për të luftuar si duhet kriminalitetin në bashkëpunim me mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë.

Disa nga këto rekomandime do të ishin:

- Institucionet ligjzbatuese të Republikës së Kosovës duhet të harmonizojnë objektivat dhe aktivitetet në strategjitë e tjera nacionale me Strategjinë kundër krimit të organizuar.
- Të fillojë qysh tani puna për hartimin e Strategjisë së veprimit për anëtarësim të Policisë së Kosovës në organizatat ndërkombëtare policore, si: Interpol, Europol,

Frontex, Sirena dhe të tjera, si dhe për pjesëmarrje në të gjitha forumet dhe nismat rajonale me të drejta të barabarta si të gjitha shtetet tjera.

- Policia e Kosovës, me departamentet për luftimin e kriminalitetit, të krijojnë sa më parë bazën e të dhënave me standarde ndërkombëtare. Për këtë të alokohen edhe fondet nga buxheti i shtetit ose të gjenden donacione nga Europa a nga ndonjë shtet tjetër.

- Të vazhdojë me prioritet kualifikimi profesional i personelit dhe i strukturave policore nëpërmjet trajnimeve dhe seminareve të ndryshme ndërkombëtare.

- Strukturat policore të insistojnë edhe më fort për përfshirjen e tyre në veprimtaritë që zhvillohen në kuadrin e BNP në rajon e më gjerë. Ato duhet të tregohen më të afta dhe të lëvizin të gjitha hallkat për të siguruar pjesëmarrjen në vazhdimësi në sa më shumë trajnime, seminare, simpoziume dhe konferenca etj.

- Policia e Kosovës të shfrytëzojë të gjitha kontaktet që të sigurojë marrjen pjesë në aktivitete civile paqeruajtëse ndërkombëtare, ku do të promovohet bashkëpunimi policor, aftësia e saj, si dhe do të rritet eksperiencia dhe personeli do të fitonte mjaft nga bashkëpunimi me kolegët e huaj.

- Qeveria e Kosovës të punojë intensivisht dhe me efikasitet që Kosova të arrijë të nënshkruajë sa më parë Marrëveshje Strategjike dhe Operacionale me Europol-in, siç e kanë edhe shtetet e tjera të rajonit.

- Të punohet në bazë të një programi të hartuar me kujdes që reformat policore në Kosovë t'u përshtaten më mirë trendeve bashkëkohore duke marrë parasysh rëndësinë që ka BNP-ja.

- PK të bashkërendojë më mirë punën me agjencitë e tjera të sigurisë e të zbatimit të ligjit, sidomos me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI) etj.,

duke përsosur më tej kanalet e bashkëpunimit, të vendosë kontaktet bilaterale dhe multilaterale për shkëmbimin e informacioneve me agjencione ndërkombëtare, si dhe për zgjerimin e kontakteve ndërmjet hetuesve dhe bashkëpunimit gjatë hetimeve.

- Strukturat e PK të krijojnë një grup të specializuar pune për të evidencuar përvojat, praktika të veçanta dhe standardet bashkëkohore, sipas fushave të caktuara, të shteteve të zhvilluara, që kanë rezultate të dukshme në luftën kundër krimit, dhe t'i implementojë ato.

- Policia e Kosovës të sigurojë aktivitete të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar, për të fituar besimin e partnerëve, që të bëhet pjesë e organizatave ndërkombëtare policore si një partner i përgatitur profesionalisht dhe i konsoliduar.

- Qeveria dhe institucionet e tjera të shtetit të përqendrohen në diplomacinë aktive ndërkombëtare që Kosova, por edhe Policia e saj, të promovohen si faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon, dhe të dëshmohet për kapacitetet dhe partneritetin në luftimin e fenomeneve negative, si krimi i organizuar dhe terrorizmi, dhe në përballimin e sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Policia e Kosovës të krijojë forma permanente bashkëpunimi me mediat, me komunitetet akademike, me shkollat dhe universitetet, për ekspozimin dhe interpretimin e aktiviteteve kriminale për publikun e gjerë, me synim njohjen e rreziqeve nga publiku, por edhe sensibilizimin e tij për më shumë kujdes me brezin e ri, që të qëndrojë larg veprave të tilla.

- Ka ardhur koha të ngrihet një Institut kombëtar i specializuar për të analizuar dhe trajtuar në vazhdimësi fenomenin e terrorizmit dhe krimit të organizuar në Kosovë, i cili të ketë bashkëpunim profesional dhe shkencor me institucionet e vendeve të rajonit dhe më gjerë dhe të botojë edhe organin e vet shkencor, informativ.

LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA

Literaturë

- Abadinsky, H. (2010) *Organized Crime*, Wadsworth, faqe 398.
- Aden, H. (2013) *The transnational exchange of information between security agencies in the EU and beyond: Tensions between security interests and data protection*. Paper for the European Union Studies Association/EUSA Thirteenth Biennial Conference, Baltimore, 9-11 May 2013, panel 9K: The Area of Freedom, Security and Justice 5: AFSJ agencies.
- Anderson, M. (2002) *Trust and Police Co-operation*, in Malcolm Anderson and Joanna Apap (eds) *Police and Justice Cooperation and the new European Borders*, 2002.
- Andreas, P. & Nadelman E. (2006) *Policing the Globe, Criminalization and Crime Control in International Relations*, 2006, faqe 4.
- Aubrey, S.M. (2004) *The New Dimension of International Terrorism*, vdf Hochschulverlag AG, 2004, faqe 11.
- Bailey, E.G. (1995) *The encyclopedia of police science*, second editon, Library of Congres.
- Bantekas, I. & Susan, N. (2009) *International Criminal Law*, Taylor, Francis e-Library, 2009, faqe 410-411.
- Bassiouni, Ch. (2014) *International Extradition: United States Law and Practice*, Oxford University Press, faqe 848.
- Baylis, J., Wirtz, J.J., Colin, S.G., & Eliot, C.(2010) *Strategjia në botën bashkëkohore*, Hyrje në studimet e strategjisë, UETPRESS, 236-

- Berdal, M.R.&Serrano, M. (2002) *Transnational Organized Crime and International Security: Business as Usual?*
- Bigo, D. (2000) *When Two Become One: Internal and external securitisations in Europe, Threats, Internal Security and Defence: some entanglements, In international Relations Theory of Politics of European Integration, Power, security and community*, edited by Morten Kelstrup and Michael C.Williams, 171-204, London: Routledge.
- Bogdandy, A.Von., Wolfrum, R., Bernstorff, J. Von., Dann, Ph., Goldmann, M. (2010), *The Exercise of Public Authority by International Institutions Advancing International Institutional Law*, Springer, 2010.
- Borçard, K.D. (2010) *ABC- ja e të Drejtës së Bashkimit European*, Bashkimi European, 37.
- Conte, A. (2010) *Human Rights in the Prevention and Punishment of Terrorism: Commonwealth Approaches: The United Kingdom, Canada, Australia and New Zealand*, Springer.
- Cools, M., Easton, M., Lieven, P. & Paul, P. (2010) *EU and International Crime Control: Topical Issues*, Maklu, faqe 63.
- Cools, M., Sofie De. K., Ruyver, B.De. & Easton, M. (2009) *Readings on Criminal Justice, Criminal Law & Policing*, Maklu, faqe 329.
- Craig, P.P. & Burca, G.De. (2011) *EU Law, Texts, Cases and Materials*, Oxford University press, 2011.3-4.
- Crum, B. & Fossum, J. E. (2013) *Practices of Inter-Parliamentary Coordination in International Politics: The European Union and Beyond*, ECPR Press, faqe 88.

- Deflem, M. (2006) Europol and the Policing of International Terrorism: *Counter-Terrorism in a Global Perspective*, Justice Quarterly, volume 23, number 3, 336.
- Deflem, M. (2007), "*International Police Cooperation Against Terrorism: Interpol and Europol in Comparison.*" Page 18 in *Understanding and Responding to Terrorism*, edited by H. Durmaz, B. Sevinc, A.S. Yayla, and S. Ekici, Amsterdam: IOS Press.
- Deflem, M. (2001) International Police Cooperation in Northern America: *a review of practices, strategies and goals in the United States, Mexico and Canada*, in Frederic Limeux, International Police Cooperation. Villan Publishing.
- Den Boer, M. (2005) Copweb europe: *venues, virtues and vexations of transnational policing*, in Lemieux, F., International Police Cooperation, Villan Publishing.
- Dosen, A., Ballantyne, T., Brumpton, M., Gibson, K., Harris, L. & Stephen, L. (2013), *Investigation Legal Studies for Queensland*, University of Cambridge.
- Durmaz, H. (2005) *International police cooperation as a response to transnational organized crime in europe*: improvements in extradition, page 2.
- Durmaz, H. (2007) *Understanding and Responding to Terrorism*, IOS Press, page 9.
- Eterno, J. & Das, D.K. (2010) *Police Practices in Global Perspective*, Rowman & Littlefield.
- Fooner, M. (1989) Interpol: *Issues in World Crime and International Justice*, Springer Science & Business Media, Aug 31.
- Gandhirajan C. K. (2004) *Organized Crime*, APH Publishing, fq. 3-5.
- Garrison, A. H. (2003) *Terrorism: The Nature of its History, Criminal Justice Studies*, vol. 16(1).

- Gerspacher, N. (2008) *The History of International Police Cooperation: a 150-Year Evolution in Trends and Approaches*”, *Global Crime* 9, no. 1,
- Giraldo, J. & Trikunas, H.(2013) tek Alan Collins, Studime bashkëkohore të Sigurisë, *Krimi Transnacional*.
- Gordon, K. (2013)*The History of the International Police Association*, US-section, 8.
- Greene, R.J. (2007) *The Encyclopedia of Police Science*, Third Edition, Volume 1 A-I, Index, Routledge, Taylor & Francis Group, New York , fq. 706 .
- Gruda, Z. (2007) *E drejta Ndërkombëtare Publike*, Furkan ISM-Shkup.
- Halili, R. (2011) *Kriminologjia*, Prishtinë.
- Hasani, E. & Cukalovic, I. (2013), *Komentar i Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, botimi I.
- Haubold, B. S, *The Administration of Information in International Administrative Law - The Example of Interpol*, German Law Journal, [Vol. 09 No.11], f. 1720.
- Hufnagel, S. (2013) *Policing Cooperation Across Borders: Comparative Perspectives on Law*.
- Koenig, D.J. & Das, D.K.(2001) *International Police Cooperation – A World Perspective*, Oxford, faqe 6.
- Latifi, V. & Beka, A. (2013) *Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi, Zbulimi dhe te Provuarit*, Kolegji Europian „Juridica” Prishtinë.
- Latifi, V. (2014), *Kriminalistika, Zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë.
- Lemieux, F. (2010) *International Police Cooperation, Emerging Issues, Theory and Practice*.
- Madsen, F. (2009) *Transnational Organized Crime*, Routledge, faqe 98-99.

- Marangopoulos, A.Y.& Benedek, W. (2004) *Anti-Terrorist Measures and Human Rights*, Martinus Nijhoff Publishers.
- Marsden, Ph. (2008) *Handbook of Research in Trans-Atlantic Antitrust*, Edward Elgar Publishing, Jan 1.
- Martenczuk, B. (2008) *Justice, Liberty, Security: New Challenges for EU External Relations*, Asp / Vubpress / Upa, faqe 368.
- Maslesha, R. (2008) *Policia dhe Shoqëria*, Universiteti AAB-Prishtinë dhe Universiteti i Sarajevës f.24.
- Moore, H. (1996), *International crime and integration: The development of Europol*. Retrieved February, 27, 2005 from <http://www.is.rhodes.edu/modus/96/Moore.html>, cituar te Hysein Durmaz.
- Nadelman, E. (1993) *Cops across borders*. Pennsylvania Park, PN: Penn State University Press.
- Occhipinti, J. D. (2003) *The Politics of EU Police Cooperation: Toward a European FBI?* Lynne Rienner Publishers,
- Ollus, N., *The United Nations Protocol To Prevent, Suppress And Punish Trafficking In Persons, Especially Women And Children: A Tool For Criminal Justice Personnel*, Resource Material Series No.62,fq. 16
- Perl, R.F. (2010) *International Terrorism: Threat, Policy, and Response*, DIANE Publishing, 2010, faqe 31.
- Pradel, J., Corstens, G. & Vermeulen, G. (2009) *E Drejta Penale Europiane*, Botimet Papirus, Tiranë.
- Puto, A. (2010) *E drejta ndërkombëtare Publike*, Botimet Buqaj, Tiranë, 2010.

- Richard, J.R. (1998) *Transnational Criminal Organizations, Cybercrime, and Money Laundering: A Handbook for Law Enforcement Officers, Auditors, and Financial Investigators*, CRC Press, fq. 4
- Salihu, I. (2005) *E drejta ndërkombëtare Penale*, Prishtinë.
- Sang, F.K.A. (1997) A Discussion Paper on International Police Cooperation: The Challenges Facing It and How to Improve It for More effective Work. Paper prepared for the fourth International Police Executive Symposium, Vienna, Austria.
- Snowden, L.L. & Whitsel, B.C. (2004) *Terrorism: Research, Readings, & Realities*, Pearson Prentice Hall, faqe 178- 179.
- Spennbauer, M. (2010) *Eulex Kosovo – Mandate, Structure and Implementation: Essential Clarifications for an Unprecedented EU Mission*, Cleer Working Papers 2010/5, Neni 3, paragrafi (d), (e) dhe (f), faqe 15-16.
- Schmid, Alex.P (2011) *Radicalisation, De-Radicalisation and Counter-Radicalisation*
- Shanty, F. & Mishra, P.P. (2008), *Organized Crime: from trafficking to terrorism*, volume I, ABC-CLIO, Introduction.
- Shelley, L. (2010) *Human Trafficking*, Cambridge University Press, fq. 37
- Sherman, J. (2010) *Drug Trafficking*, ABDO, fq. 6-9.
- Varbes, de H.D. (1928) *Les Principes modernes du droit penal international*, f.302.
- Wiarda, J. (1997) Presentation at the Fourth International Police Executive Symposium, Vienna, Austria.
- Wright, R.A. & Miller, M.J. (2005) *The Encyclopedia of Criminology*, New York Routledge, faqe 795-798.
- Wardlaw, G. (1998), *Political Terrorism, Theory, Tactics and Counter Measures*.

Literaturë parësore

- Ban Ki-Moon, (2008), International Instruments related to the Prevention and Suppression of International Terrorism, Preface, United nations, New York,
- CARPO (2006), Raport mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomike në Europën Juglindore, raporti mbi situatën CARPO.
- Committee of Ministers of the Council of Europe (2007), Co-operation Against Terrorism Between the Council of Europe and Its Member States, and the International Criminal Police Organization (ICPO-Interpol): Recommendation Rec (2007) 1, on 18 January 2007 and Explanatory Memorandum.
- Council Joint Action (2008), 124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX Kosovo, OJ 2008 L 42, Article 2.
- Deklarata e procesit të bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECp) në samitin e Bukureshtit, 2014.
- General Secretariat, ICPO-Interpol, 15 janar 1989, References 1.2.
- Instrumente Ligjore dhe Teknika të Luftës Kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Itali – Shqipëri: *Përballje përvojash*, Botues Unicri, 2007.
- International Association of Chiefs of Police, (2010), FY 2011-2016 Strategic Plan, August, faqe 2.
- International Police Association, (2013) Article 2 (1), of International Statute, International Rules .
- Komisioni European (2008), Kosova 2008 Raporti i Progresit, Bruksel, 05 nëntor, SEC(2008) 2697.
- Komisioni European (2009), Kosova 2009 Raport i Progresit, Bruksel, 14 tetor,

SEC(2009) 1340.

- Komisioni European (2010), Kosova 2010 Raport i Progresit, Bruksel, 09 nëntor, SEC(2010) 1329.
- Komisioni European (2014), Kosova 2014 Raport i Progresit, Bruksel, 08 tetor 2014, SWD(2014)306.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, (2003), neni 43.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, (2000), Neni 2, paragrafi 1.
- Konventa për Bashkëpunim Policor e Europës Juglindore, (2006).
- Kushtetuta e INTERPOL-it dhe rregullat e përgjithshme, by The Icpo Interpol
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, hyrë në fuqi me 9 prill 2008.
- Ligji Nr. 04/L-076, 2012, për Policinë e Kosovës.
- Ligji Nr. 04/L-052, -Për marrëveshjet ndërkombëtare, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 2011.
- Ligji Nr. 04/L-213, Për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale.
- Ligji nr.03/L-178, Për Klasifikimin e Informacioneve dhe verifikimin e sigorisë.
- Ligji për Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, (2011).
- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë
- Marrëveshje e Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për bashkëpunim në parandalimin dhe luftimin e krimit, nënshkruar më 26 qershor 2009.
- Marrëveshjet Teknike të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Misionin e EULEX-it në Kosovë në vitin 2009.
- Memorandum i Bashkëpunimit e nënshkruar mes Ministrisë së Punëve të

Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Shtetit dhe Ministrisë së Financave për Kordinim dhe Mbështetje për Njësinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit (ILECU), 2011.

- Memorandum i Bashkëpunimit mbi Organizimin e Shërbimeve të Përbashkëta të strukturave të policisë rrugore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në akset rrugore të Republikës së Shqipërisë, për vitet 2010-2015.
- Memorandum i Bashkëpunimit ndërmjet Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-ve dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkëmbimin e informatave të identifikimit biometrik (24 shkurt 2012).
- Memorandum of Understanding between ILECU Countries, 2012.
- Memorandumi i bashkëpunimit në fushën e punëve të brendshme mes Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, e nënshkruar më 25 shtator të vitit 2008.
- Memorandumi i bashkëpunimit policor ndërmjet Republikës së Austrisë dhe Republikës së Kosovës, pas vitit 2008 (pa datë).
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë-UNMIK, nënshkruar nga palët në dhjetor të vitit 2002.
- Protokoll i Kombeve të Bashkuara kundër kontrabandimit me migrantë, nga toka, deti dhe ajri, që plotëson Konventën e KB Kundër krimit të Organizuar Transnacional, Neni 3, paragrafi 1.
- Protokoll për Parandalimin, Zhdukjen dhe Dënimin e Trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, (2000), për plotësimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të organizuar ndërkombëtar, Neni 3, paragrafi 1.

- Qendra për Studime të Sigurisë (2008), IDN, Instituti për Siguri dhe Ndërmjetësim.
- Raport ILECU-2014.
- Raport nga Departamenti i Hetimeve i Policisë së Kosovës, 2014.
- Raport nga Departamenti i Personelit të PK-së, 2014.
- Raport nga zyra për informim dhe marrëdhënie me publikun, 2015 Policia e Kosovës.
- Raporti vjetor i punës i Policisë së Kosovës për vitin 2008.
- Raporti vjetor i punës i Policisë së Kosovës për vitin 2010.
- Reformat në Policinë e Kosovës, Forumi për Siguri, 2011.
- [Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo \[S/2000/177\]](#)  of 3 March 2000
- [Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo \[S/2002/436\]](#)  of 22 April 2002
- [Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo \[S/2002/779\]](#)  of 17 July 2002
- [Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo \[S/2002/1126\]](#)  of 9 October 2002
- Resolution 1244, UN Doc. S/Res/1244 (10 June 1999)
- Revista për shtëpinë e përbashkët Europa (2009), numër 6, Biblioteka Europiane e Kosovës.
- Revista policore, (2012) *Mbrojtësi*.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/22 “*Mbi masat kundër krimit të organizuar*”, e miratuar më 20 shtator 2001.

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4 “*Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë*” e miratuar më 12 janar 2001.
- Rregullorja nr.2002/6, “*Mbi masat e fshehta dhe masat teknike të vëzhgimit dhe hetimit*” e miratuar më 18 Mars 2002.
- Saint Group, (2007), UNMIK police, *CIVPOL Language and Culture*.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2012-2017.
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar, 2009-2012.
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit, 2009-2012,
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.
- Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008-2011.
- Struktura e brendshme e Policisë së Kosovës e miratuar nga ministri i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë më 17.05.2012.
- United Nations Convention Against Transnational Organised Crime,A/RES/55/25.
- United Nations Handbook on Criminal Justice Responses to Terrorism,(2009), New York, 2009, faqe 28.
- UNMIK-Police, (1999), United Nation Mission in Kosovo, Policia e Kombeve të Bashkuara e vendosur në Kosovë.
- UNODC, (2009), United Nations Office On Drugs And Crime, *Manual on International Cooperation in Criminal Matters related to Terrorism*, New York,
- UNODC, Report on human trafficking exposes modern form of slavery, 2005).

- UNODC,(2010), Trafikimi i Qenieve Njerëzore & Kalimi Kontrabandë i Migruesve, Udhëzues për bashkëpunim ndërkombëtar.
- Vendim i Kryeministrit të Kosovës (2011), nr.04/02, dt.02.03.2011, Për themelimin e ILECU-Kosovë.
- Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Europian dhe Traktati për funksionimin e Bashkimit Europian (2008), (82-83).
- World Drug Report, (2012), United Nations Office On Drugs And Crime, Vienna, New York.
- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime, <http://www.unodc.org/>

Literaturë dytësore/ interneti

- http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/drug-control/drugs-situation-in-the-eu/index_en.htm
- <http://www.europarl.europa.eu/committees/en/studiesdownload.html?languageDocument=EN&file=75711>).
- http://www.clingendael.nl/publications/2011/20110106_CRU_publication_mderks.pdf.
- <http://www.dppi.info/>
- <http://www.europaelire.org/content/article/1037248.html>,shikuar me 12.05.2015.
- <http://www.interpol.int/>
- <http://www.interpol.int/Interpol-expertise/Data-exchange/I-24-7>
- <http://www.ipa-usa.org/>
- <http://www.mpb-ks.org>
- <http://www.osce.org/kosovo/105907>.

- <http://www.racviac.org/>–
- <https://www.unodc.org/unodc/en/human-trafficking/global-report-on-trafficking-in-persons.html>
- <http://www.pccseesecretariat.si/>).
- [Interpol Member States: The United Kingdom](#)". [interpol.int](http://www.interpol.int). Retrieved 17 August 2012.
- [Interpol Member States: The United States](#)". [interpol.int](http://www.interpol.int). Retrieved 5 January 2012.
- [Interpol members and dates of membership](#)". [Interpol.int](http://www.interpol.int). Retrieved 17 April 2011.
- [Interpol timeline](#)". [Interpol.int](http://www.interpol.int). 12 November 2010. Retrieved 30 January 2011.
- [Great Britain: Parliament: House of Commons: Foreign Affairs Committee](#)
(2005-06). *Foreign Policy Aspects of the War Against Terrorism: Fourth Report of Session 2005-06; Report, Together with Formal Minutes, Oral and Written Evidence*, fage 173.

SHTOJCË

UDHËZIME SE SI DUHET TË PLOTËSOHET PYETËSORI

Quhem Muhamet Berisha dhe jam kandidat për titullin doktor i shkencave juridike pranë Universitetit Europian të Tiranës. Si pjesë e studimeve të doktoratës është edhe ky pyetësor, në mënyrë që hulumtimi im të jetë më i saktë, më domethënës dhe përmbajtësor. Në këtë kontekst kam marrë për detyrë të bëj një hulumtim lidhur me tezën e doktoratës: “Bashkëpunimi ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë”. Synimi i këtij pyetësori është që të mbledh informacione lidhur me rezultatet që janë arritur në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë dhe a ka ndikuar ky bashkëpunim në uljen e kriminalitetit në Kosovë.

Pyetësori u drejtohet të gjitha niveleve të zyrtarëve policorë në Departamentin e Hetimeve dhe Policisë kufitare, të cilët janë të angazhuar në sektorët përkatës. Rezultatet e këtij pyetësori do të përdoren për qëllime akademike, për të kuptuar më mirë rolin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë dhe për të parë se në cilat fusha ka dhënë rezultate më të mëdha.

Pyetësori përbëhet nga gjithsej 22 pyetje dhe plotësohet si në vijim:

Udhëzime mbi plotësimin e pyetësorit:

-  Pyetësori plotësohet në mënyrë anonime dhe të dhënat tuaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.
-  Ju lutem që përgjigjet tuaja të jenë të sinqerta.
-  Ju do të keni kohë të mjaftueshme të plotësoni pyetësorin.
-  Pyetjet të cilat kanë alternativa të përgjigjes, ju lutemi që të përcaktoheni vetëm për njërën.
-  Për pyetjet të cilat nuk kanë alternativë për përgjigje, jeni të lirë që me fjalë të përshkruani këndvështrimet tuaja.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe ju falënderojmë për përgjigjet dhe për bashkëpunimin.

PYETËSORI

Pjesa e përgjithshme:

Gjinia: Mashkull: _____, Femër: _____

1. Çfarë niveli-pozite përfaqësoni në sektorin/departamentin tuaj?
 - a) Zyrtar hetues
 - b) Mbikëqyrës i nivelit të parë
 - c) Mbikëqyrës i nivelit të mesëm
 - d) Niveli i lartë i menaxhmentit
 - e) Tjetër (shëno): _____
2. A flisni ndonjë gjuhë të huaj dhe a zhvilloni komunikim me zyrtarë policorë ndërkombëtarë?
 - a). Flas dhe komunikoj në detyrat e përditshme _____ (gjuha që flisni)
 - b). Vetëm flas _____ (gjuha që flisni)
 - c). Nuk flas gjuhë të huaj
3. Përvoja juaj në njësitë lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar policor?
 - a) deri në 3 vite
 - b) 3-5 vite
 - c) Mbi 5 vite
4. Cila është njësia/sektori në të cilin punoni?

5. Në cilën periudhë kohore punoni (keni punuar) në këtë njësi (ju lutemi shënoni vitin prej kur keni filluar)

a) 1999-2008 b) 1999-2012 c) 2008 e tutje tjera (specifiko)_____

6. A keni vijuar ndonjë trajnim jashtë Kosovës, apo ndonjë trajnim të përbashkët me zyrtarët policorë të shteteve tjera në Kosovë?

a). Kam vijuar trajnime jashtë

b). Nuk kam vijuar

c). Kam vijuar trajnime brenda Kosovës

7. A keni marrë pjesë në konferenca, seminare apo workshope të përbashkëta me zyrtarët policorë të shteteve tjera dhe a kanë ndikuar në ngritjen e performancës dhe efikasitetit në detyrat tuaja?

a). Kam marrë pjesë dhe ka ndikuar në ngritjen e performancës dhe efikasitetit

b). Relativisht kanë ndikuar në detyrat e përditshme

c). Nuk kam pasur rastin të marr pjesë në takime të tilla

8. Si e vlerësoni rolin e konferencave ndërkombëtare, trajnimeve në ngritjen e aftësive profesionale dhe krijimin e pikave të bashkëpunimit?

a). Pozitiv b). Relativ c). Ka ndikuar në krijimin e pikave të kontaktit d). Nuk ka ndikuar

9. Cili është niveli i komunikimit në mes të zyrtarëve policorë vendës dhe atyre ndërkombëtarë që punojnë në kuadër të misionëve ndërkombëtare në Kosovë?

a) Nivel i lartë

b) Ulët-Mesëm

c) Nuk komunikojmë

10. Sa ju ka ndihmuar prezenca dhe përvoja e pjesëtarëve të misionëve ndërkombëtare policore në zgjidhjen e rasteve në punën tuaj ?

- a) Më ka ndihmuar shumë
- b) Mesatarisht
- c) Minimalisht
- d) Nuk ka pasur efekt

11. Cili është roli i bashkëpunimit ndërkombëtar policor në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?

- a) Këshillues
- b) Ekzekutiv
- c) Monitorues
- d) Bashkëpjesëmarrës

12. Me cilat shtete të botës keni pasur bashkëpunim policor në luftimin e krimit, dhe në cilën fushë?

a) Shteti:_____

Fusha e bashkëpunimit:_____

c) Shteti:_____

Fusha e bashkëpunimit:_____

d) Shteti:_____

Fusha e bashkëpunimit:_____

13. A keni pasur shkëmbim të informatave dhe zyrtarëve policorë me agjencionet policore të shteteve tjera në luftimin e krimit dhe cilat janë përvojat tuaja në këtë aspekt?

- a). Kemi shkëmbyer informata dhe zyrtarë policorë
- b). Kemi shkëmbyer vetëm informacione
- c). Nuk kemi bashkëpunim në shkëmbim të informacioneve

14. A është vërejtur trend i zvogëlimit të krimit në Republikën e Kosovës pas bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet apo organizatat ndërkombëtare policore?

- a). Ka rënie të krimit
- b). Niveli është i njëjtë
- c). Krimi është rritur në disa fusha

15. A paraqet pengesë për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare policore mosanëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/Europol/ Frontex, etj.)?

- a). Paraqet pengesë
- b). Bashkëpunimi është i kufizuar
- c). Nuk paraqet fare pengesë

16. Në cilat fusha (specifiko fushën tuaj) janë shënuar rezultate konkrete me organizatat ndërkombëtare policore (Interpol/Europol/Seci/etj.)?

- a). Shkëmbim të informatave
- b). Luftimi i narkotikëve
- c). Kontrabanda me (Specifiko)_____
- d). Trafikimi me qenie njerëzore
- e). Terrorizmi

17. Me kalimin e kohës, a ka shënuar ngritje besimi në organizatat ndërkombëtare që kontribuojnë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë?

- a). Nuk ka shënuar ngritje
- b). Kam pak besim
- c). Besoj shumë

18. Sipas përvojës tuaj, ku ka më së shumti ngecje në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë?

- a). Shkëmbim të informatave inteligjente
- b). Luftimi i narkotikëve
- c). Kontrabanda
- d). Trafikimi me qenie njerëzore
- e). Terrorizmi

19. Çfarë rezultate janë arritur në luftimin e krimit dhe a ka pasur ndikim në situatën e brendshme (situata në sektorin tuaj të bashkëpunimit)?

20. Pikëpamjet tuaja lidhur me rolin që ka misioni i Policisë së EULEX-it në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor në Kosovë?

21. Çka do të duhej të ndryshonte që bashkëpunimi ndërkombëtar policor në Kosovë të jetë më efikas?

22. A keni diçka për të shtuar, që nuk është përfshirë në këtë pyetësor dhe sipas mendimit tuaj është me rëndësi të ceket?
